GJOKË DABAJ

KONTRIBUT PËR HISTORINË E TIVARIT

- Gjokë Dabaj -

~~~~~~
~~~~~~

1

REFERENCAT, te Dr. Millan fon Shuflai:

"Situata e Kishës në Shqipërinë Paraturke"

BIBLIOTEKA FRANÇESKANE "*AT GJERGJ FISHTA*"

DR. MILAN FON SHUFLAJ (Milan von Šufflay)

*** * ***

Situata të Kishës në Shqipërinë Paraturke

Zona e depërtimit ortodoks në "digën" katolike

*** * ***

Përktheu nga origjinali gjermanisht dhe përgatiti për botim:

Dr.phil. MA Edmond Malaj.

BF

Botime Françeskanë

Shkodër, 2013

Sqarim hyrës: Citimet do të bëhen me … (**Bodoni MT blek**), shënimet e mi, Gj.D, do të jenë në Tajms Nju Roman (Times New Roman).

Nëse diku, ku e shoh të arsyeshme, bëj ndonjë ndryshim fjale a shprehjeje, i kërkoj ndjesë, në radhë të parë përkthyesit, i cili gjithsesi ka bërë një punë të lavdërueshme, si dhe lexuesit, i cili, mbasi t'i bien në sy dallimet, mund të lodhet apo të bezdiset pak. Ndryshime të rëndësishëm kam vetëm 2: Në vend të emrit ***Shqipëri***, kam përdorur: ***Arbëri*** dhe në vend të: ***Shqipëri Veriore***, kam përdorur: ***Arbëri Veriperendimore***. Mendoj se kam vepruar drejt.

- **Viti 535. "Ipeshkvitë e Prevalit në vitin 535 ishin nën Kishën e Justiniana Primës". (f.29)**

Pikërisht këtu fillon tragjedia, të cilën iliro-arbro-shqiptarët do ta kenë gjithë jetën pjesë të jetës së vet: Perandori ynë, Justiniani i Madh, bëri mirë që e krijoi Kishën e Justiniana Primës, që ndryshe quhet: Kisha e Ilirikut Lindor, bëri mirë që e ndau Kishën Ilire nga Kisha Greke dhe që ia mbështeti atë kishë Papatit të Romës, por nuk bëri mirë, dhe të gjithë iliro-arbërit e fuqishëm, që erdhën pas tij, nuk bënë mirë që, PËR KISHËN E VET, nuk krijuan edhe SHKRIMIN NË GJUHËN E

VET. Ky është shpjeguesi i të gjitha tragjedive që i kanë ndodhur etnisë sonë, në të gjithë shekujt e mëpasmë: prej grekëvet, prej sllavëvet dhe prej turqvet. Grekët e kishin shkrimin dhe e përhapnin krishtërimin në gjuhën e vet, e kishin, madje ***Biblën*** të shkruar, para se ajo të shkruhej latinisht. Sllavët nuk e kishin shkrimin, por e krijuan 8 shekuj mbasi ne ishim një etni e krishterë, dhe e përhapën krishtërimin në gjuhët e tyre. Osmanët, ***Kur'anin*** e kishin arabisht, por administratën, ndonëse me shkronja arabe, e mbanin në gjuhën e vet. Të gjithë faktorët e tjerë, që ne u bëmë, disa grekë, disa sllavë, disa turq, kanë vepruar dhe duhen mbajtur parasysh, por faktori kryesor, i brendshëm, ka qenë ky dhe vetëm ky: **MOSPRAKTIKIMI I SHKRIMIT NË GJUHËN TONË**.

-Viti 732. (Perandori Leo Izaurasi ia mori Kishës Romane Epirin e Ri dhe Prevalin dhe i vuri nën pushtetin e Patriarkanës së Konstantinopolit.) (f.30)

Njihet gjithë ajo luftë që është bërë, për të mos u shkëputur ipeshkvitë e Ilirikut Lindor nga Kisha e Romës. Megjithatë, më në fund, mbasi e kishin uzurpuar, në Konstantinopol, pushtetin shtetëror gati 2 shekuj më parë, dhe pasi kishin vendosur administratën shtetërore në gjuhën e tyre, grekët ia arritën që edhe Kishën tonë t'ia nënshtrojnë Patriarkanës Greke.

-Sh.VI. Krijohet Ipeshkvia e Stefaniakës, selinë e së cilës nuk mund ta përcaktojmë me saktësi. Diçka më vonë krijohet ajo e Krujës, që deri në sh XIII, ishte identike me atë të Arbënit. (f.31)

Lidhur me Ipeshkvinë e quajtur të Arbënit, shenjat janë që ajo të ketë qenë diku në trevën e sotme të Mirditës, por kjo nuk lidhet me temën tonë të këtushme.

-Pastaj krijohen ipeshkvitë e ngulimevet të rinj romakë: Antibari, Drivasto, gjithashtu edhe Suacium (Shasi). (f.32)

M.Shuflai i quan, qytetet që i përmend, "ngulime të rinj" edhe: "romakë". Ne jemi të detyruar të pohojmë që ata ngulime s'kanë pse të quhen "të rinj", sepse arkeologjia po vërteton ekzistencë shumë të hershme të këtyre "ngulimeve" dhe, e dyta, emërtimi "romakë" i bie të jetë njësoj sikur myslimanët e sotëm të Tivarit t'i qujmë nëpër vepra historike "turq". Aq sa janë "turq" myslimanët e sotëm të Tivarit, aq ishin romakë banorët e atëhershëm të Antivarit.

Përveç kësaj, emërtimi i hershëm i TIVARIT është më drejt të jetë ANTIVARI, sepse kjo formë e afrom më shumë me prejardhjen e vërtetë të këtij emri. Emri i TIVARIT shpjegohet me mjetet gjuhësorë të shqipes: *ËN(Ë)-TË-VAR. Në përdorimin vendës, parashtesa parafjalore ËN(Ë)- ka rënë, ndërsa Ë-ja midis T-së dhe V-së ka dhënë I, si te SHË(N)JAK që ka dhënë SHIJAK.

-Viti 743. (Është themeluar Arqipeshkvia e Raguzës.) (f.46)

Kuptohet që Papati merr masa për t'u mbrojtur prej invazionit të mëtejshëm të Bizantit, i cili tashmë, nga Perandori Romake Lindore, ishte shndërruar në perandori që sundohej prej grekëvet dhe që donin edhe Krishtërimin ta kishin të vetin. Nuk e dimë, në këtë kohë, në sh VIII, në ç'përmasa kish hyrë elementi sllav në këtë pjesë të Dalmacisë, por dimë që një pjesë e lashtovendësvet ilirë, që banonte në qytete dhe e cila, në të shkruar, përdorte latinishten, quhej popullsi romane. Për pjesën tjetër, e cila doemos fliste ilirisht, nëpër dokumente flitet fare pak e edhe më pak, qëllimisht, në historiografinë e shekujvet të mëvonshëm. Por ne nuk po trajtojmë tani këtë temë, prandaj po kalojmë në shekujt më të vonshëm.

-Shek.X. Të shkrira së bashku në Temën Dyrrahion, nën dominimin e Konstantinopojës... provincat e dikurshme të Prevalit dhe të Epirus Nova, morën edhe një mitropolit të përbashkët që përfaqësohej nga prelati i Durrësit, i cili, deri në shek.X, kishte tagër mbi 14 njësi qytetesh...: Antibari, Diokleja, Scodra, Drivastum, Polaton, Ulcinium, Alesium, tek të cilët mund të renditet edhe Suacium; në lindje: Stefaniaka, Kruja, Kunavia, Cerniku dhe, më në Jug, Gradeci, Pulheriopolis (Belgradi, Berati), Aulona dhe Glavnica.(f.33-34)

"Antibari", siç thashë, duhej ANTIVARI, siç është përdorur në dokumentet mesjetarë edhe shumë herë të tjera. Mirëpo këtu, në pjesët e cituara, megjithatë, do të përdoret siç e ka përdorur vetë autori ynë i nderuar, M.Shuflai.

Përndryshe, në këtë fragment, shohim 3 gjëra: 1. Tivari dhe krejt Prebalitana janë pjesë e Temës së Durrësit, që do të thotë: nën pushtetin, në atë kohë të riorganizuar, të Bizantit. 2.Këtë pushtet të riorganizuar bizantin, i cili, si i tillë, jepte favore sidomos për ushtarakët, e shfrytëzoi elmenti sllav për të fituar pushtet lokal dhe për të zënë feude, prona, të cilat Tema e Durrësit ua dhuronte luftëtarëvet

të merituar. Midis tyre, edhe knez Vojisllavi, prej të cilit, në këto hapësira mirëfilli iliro-arbërore, zë fill një dinasti sllave, sundimtare e këtushme për gati 100 vjet. 3.Ndonëse katolicizmi, siç do të vërtetohet më vonë, ndërmori masa për të mbijetuar, elementi ortodoks midis lashtovendësvet në Prebalitanë nuk do të rikthehet i tëri në katolicizëm, gjë që do t'i shërbejë Kishës së mëvonshme Pravosllave Sërbe, si bazë për t'iu kundërvënë Krishtërimit Perendimor dhe që, në fund të fundit, në shek.XV e këndej, do të rezultojë në krijmin e kombit pravosllav malazias. M. fon shuflai nuk e ka nëntitulluar kot librin e vet "***Zona e depërtimit ortodoks në 'digën'katolike***".

-Shek.X. Provincat veriore romano-arbërore, dhe këtu nuk ka rëndësi, nëse këto provinca ishin nën Raguzën apo nën Antibarin, mbetën edhe gjatë kësaj kohe katolike të fshehta dhe, kur Papa u bëri thirrje, ato ikën menjëherë nga Dyrrahioni ortodoks. (f.34-35)

Duhet thënë: ***veriperendimore*** e jo: ***veriore***. Termi "***roman***" tashmë e kemi të qartë se si përdoret: ***Populli ilire qytetare, e cila ruante ende traditën e një Rome të dikurshme***. Duhet saktësuar që edhe vetë Dyrrahioni, me këtë rast, iku pjesërisht prej ortodoksisë (greke). Do përsëritur ajo që thashë pak parë që, jo krejt Prebalitana ka ikur nga ortodoksia greke. Sidomos disa pjesë malore të Malit të Zi të mëvonshëm kanë mbetur ortodokse, jo se ishin populli sllave, por sepse Kisha Katolike nuk i përfshiu dot të gjithë nën kujdesin e vet. Këtë e ka favorizuar ardhja shumë shpejt e pushtuesit sërb, udhëhequr për rreth 200 vjet prej dinastisë së Nemanjiqëvet.

-Shek.XI. Ndoshta ipeshkvi i Dioklesë e kishte rezidencën e tij për një kohë të gjatë tek rrënojat e këtij qyteti, porse tashmë është jashtë çdo dyshimi fakti që në shek.XI trashëgiminë e tij e mori ipeshkvi i Tivarit, siç bënë kështu edhe prelatët e Spalatos (Splitit) dhe Raguzës me trashëgiminë e Salonës dhe Epidaurumit. (f.32)

-Shek.XI. Në të vërtetë, Diokleja, ashtu sikurse Epidaurumi, nuk kishte qenë kurrë një metropol, porse nami (nimbusi) i këtij qyteti të zhdukur romak prej të cilit kishte marrë emrin edhe

krahina përreth, tek popullsia romane dhe sllave ishte kaq i madh, saqë, me sa duket, kishte mundur të ngrinte në Romë edhe prestigjin e ipeshkvit të Antibarit. (f.40)

Diokleja nuk ka qenë kurrë qytet ***ROMAK***, aq sa Nju Delhi mund të quhej ndonjëherë qytet ***ANGLEZ***, edhe kur India ish koloni e Mbretërisë Bashkuar. Madje, jo vetëm historianët, por as njerëzit e tjerë, as Rio de Zheneiron nuk do ta qyanin qytet ***PORTUGEZ***.

Popullsia "***SLLAVE***", në shek.XI, në Dioklenë e atëhershme nuk ka pasur peshë të atillë demografike, sa, së bashku me popullsinë "***ROMANE***", të mund t'ia ngrinte **prestigjin** ipeshkvit të Tivarit.

Diokleja ka qenë një qytet ilir me peshë në Prebalitanë, të cilin e ka shkatërruar perandori sllav, Samuili, dhe vetëm kjo do të mjaftonte për të dëshmuar që ai qytet nuk banohej prej ndonjë popullsie sllave.

-1020. "(Më 1020-n vendosen kufij midis Kryepeshkopatës së Ohrit dhe Arqipeshkvisë së Durrësit, gjë që e konfirmon edhe perandori bizantin Baziliosi II.) 2 vjet më vonë (1022) Durrësi humb po ashtu në mënyrë formale edhe 2 provinca veriperendimore, Antibarin dhe Ulciniumin, të cilat, megjithatë, kurrë nuk kishin qenë fort pjesë e asaj mitropolie. Këtë herë Durrësit i erdhi sulmi edhe nga ana katolike. Ishte pikërisht Papa Benedikti VIII, që ia caktoi provincat e lartpërmendura arqipeshkvit të Raguzë-Epidaurumit. (f.36-37)

-1022. Kjo ngjarje (vënia e Tivarit dhe Ulqinit nën varësinë e Raguzës, Gj.D.**), si dhe ngritja e prestigjit kishtar të Antibarit, ishte kryesisht rezultat i 2 forcave që ndikonin paralelisht. (f.37)**

-Këto 2 forca (që e ngritën prestigjin kishtar të Raguzës dhe Antibarit**), ishin: nga njëra anë trysnia e arqipeshkvijvet të Raguzës dhe të Antibarit, 2 qytete që ishin në kufij midis Spalatos (Splitit) dhe me Durrësit, ipeshkvij që, për shkak të situatës së favorshme, gjithmonë në kontakt me Romën, përpiqeshin të përfitonin paliumin arqipeshkvnor dhe të zgjeronin dioqezat e tyre në**

mediumin roman të qytetevet arbërorë; dhe, nga ana tjetër, ishte tendenca historike e papëvet romanë që të forconin latinitetin kudo, në luftë për fuqinë universale kundër Bizantit. (f.37-38)

-1026-1054. "Ipeshkvi i Antibarit... e kishte vënë në rrugë të mbarë punën që të vinte nën pushtetin e tij provincat veriperendimore të dioqezës së Durrësit." (f.38-39)

-Shek.XI, gjysma e parë. "Përballë mitropolitit të Spalatos, Raguza diti të mbahej si arqipeshkvi, por... ajo humbi të gjitha dioqezat arbërore në favor të prelatit të Antibarit, i cili e kishte shpallur veten arqipeshkëv." (f.39)

-Mesi i shek. XI. "Pikërisht në këtë kohë në Arbërinë Veriperendimore shfaqen linjat e para të perceptueshme të një pushteti të ri mitropolitan të Arqipeshkvisë së Antibarit. Sigurisht që princërvet sërbë nuk u kishte ikur pa vënë re fakti që pushteti kishtar në vendet e tyre ushtrohej nga arqipeshkvijtë, rezidencat e të cilëvet ndodheshin jashtë sferavet të pushtetit të tyre. Ata ishin jo vetëm kundër Durrësit, por edhe kundër Spalatos dhe Raguzës dhe mbështesnin tendencën autonome të ipeshkvijvet të Antibarit, që ishte e ngjashme me atë të ipeshkvijvet latinë në Apuljen Bizantine. Këta ipeshkvij të Antibarit kishin krijuar për vete një bazë ligjore Diokle-Antibari, sipas shembullit Salona-Spalato, Epidaurum-Raguza." (f.40)

Është spekulluar shumë, duke e paraqitur Arqipeshkvinë e Tivarit si krijesë të sundimtarëvet sllavë të Vojisllavleviqvet. Në të vërtetë, në citatin e këtushëm shihet mirë që punën e krijimit të arqipeshkvisë e kishin tendencë, e kishin synim, madje e kishin në dorë, vetëm klerikët vendës të Arbërisë Veriperendimore. Ata kanë shfrytëzuar, për interesat e vet, (që, në këtë rast, ishin edhe interest e kësaj pjese të Arbërisë), të vënit re, nga ana e princërvet sllavë, që pushteti kishtar gjithkund ushtrohet nga arqipeshkvijtë. Pra, princërvet sllavë, të cilët ishin fuqizuar në këto hapësira falë rrethanavet që u kish krijuar Bizanti, tani u interesonte të lidheshin me kishën vendëse, katolike, kishë e cila gjithë jetën kish qenë kundër

Bizantit. Ka qenë zotësia pikërisht e prelatëvet vendës, që kanë ditur ta shfrytëzojnë lakminë e atyre princërve për kurora.

-1089. "I shtyrë nga lutja e Bodinit, princit të sërbëvet, në vitin 1089, Klementi III (që ishte kundërpapë i papës Urbani II) vuri nën administrimin e "Pjetrit", arqipeshkvit imagjinar të Dioklesë ("Petro Dioclensis sedis archiepiscopo"), por në fakt nën administrimin e ipeshkvit të Tivarit, provincat e Arbërisë Veriperendimore, Ulqinin, Shasin, Shkodrën, Drishtin, Pultin; aty përmendet edhe Kotorri (Cattaro) krahas Kishë së Sërbisë, Bosnjës dhe Trebinjës (ecclesia Serbiensis, Bosniensis, Tribuniensis) (f.40-41)

Këtu ka shumë për të diskutuar, por kryesorja është që, një ipeshkëv i Tivarit, duke e paraqitur veten si arqipeshkëv i Dioklesë, ka arritur të bëhet arqipeshkëv i një arqipeshkvie me histori të madhe, tashmë, në shek.XXI, 1000-vjeçre. Aty thuhet që kjo punë ka ndodhur, sepse papa Klementi III është shtyrë nga lutja e Bodinit, princ i sërbëvet (i biri i knez Mihaillo Vojisllavleviqit). Ky pohim është për t'u besuar, sepse dihet që pushteti kishtar dhe pushteti laik, në të gjitha kohët, kanë vepruar të lidhur njëri me tjetrin. Por kjo nuk duhet të na shtyjë kurrsesi të mendojmë se edhe ipeshkvi Petro, gjegjësisht Pjetër, të ketë qenë edhe ai një sërb si Bodini.

-1089. Kjo bulë (bula e papës Klementi III), formon pikënisjen e një faze të re të historisë së Kishës në Arbëri, faze në të cilën, nga njëra anë, Durrësi u spostua plotësisht, por, nga ana tjetër, lindi çështja në lidhje me pushtetin mitropolitan, ose të Raguzës, ose të Antibarit, mbi dioqezat e Arbërisë Veriperendimore. f.41)

Atë që thashë pak më lart, po e thotë tash edhe M.Shuflai: Formimi i Arqipeshkvisë së Tivarit, përbënte pikënisjen e një faze të re të Kishës **NË ARBËRI**. Kisha e Ilirikut Lindor (Justiniana Prima) kish kohë që praktikisht nuk ekzistonte më, sepse e kish shkatërruar ortodoksia greko-sllave, Mitropolia e Durrësit gjendej vazhdimisht nën një trysni, edhe këtu, shkatërruese nga ana e Konstantinopolit, qoftë laik, qoftë kishtar, arqipeshkvia e Shkodrës, edhe ajo në rrethanat e depërtimit përherë e më agresiv kundër katolicizmit, ish ulur tashmë në

shkallën e ipeshkvisë. Me sa duket, Tivari u gjet si pika më e përshtatshme për ta mbajtur më këmbë, sa të ish e mundur, këtë pjesë tashmë të vogël të Kishës së Ilirikut Lindor të dikurshëm, krijuar prej vizionarit, Justinianit të Madh. Duhet thënë që arbërit, në atë fillim mijëvjeçari, nuk kishin asnjë pushtet të vetin laik, ku të mund të mbështeteshin. Prandaj dhe ishte e mirseardhur tendenca e asaj dinastie sllave për të krijuar një shtet të pavarur në këta vise të Arbërisë. Kasta e klerikëvet arbërorë, kryesuar nga një tjetër vizionar, ipeshkvi, më vonë arqipeshkvi Pjetër, i shfrytëzoi ambiciet e një dinastie sllave dhe bëri, ç'ish e mundur të bëhej, kundër depërtimit të ortodoksisë edhe në këta vise të Ilirisë së dikurshme. Duhet ta kemi mirë parasysh: Kisha Greke dhe Kisha Sllave, qoftë bullgare, qoftë sërbe, ishin në thelbin e tyre kisha **NACIONALE**. Duke qenë të tilla, ato e kishin në natyrën e tyre zhdukjen e çdo etnie jogreke apo josllave. Etniteti iliro-arbëror, i quajtur edhe etnitet epirot, etnitet maqedon, madje edhe etnitet dalmatin, nën pushtetin e të 2-ja atyre kishave, s'mund të priste tjetër përveç zhdukjes si etni. As Kisha e Romës nuk i mbronte etnitetet, por, të paktën, ajo bënte njëfarë tolerimi. S'e kish parim kryesor fshirjen e cilësive nacionale. Kjo ka qenë edhe arsyeja që iliro-arbërit e kanë ndjerë më mirë veten nën pushtetin kishtar perendimor. Mirëpo, fatkeqësisht, ata nuk arritën të krijonin kurrë **NJË KISHË NË GJUHËN E VET**. Sidoqoftë, Arqipeshkvia e Tivarit, në vitin 1089, e ka filluar një histori të gjatë, si mbrojtëse jo vetëm e fesë katolike, por edhe e etnitetit të kësaj pjese të Arbërisë. Pikërisht për shkak të këtij komponenti të dytë, ajo edhe është martirizuar në të 10 shekujt e ekzistencës së vet. Vështirësitë kanë filluar që në ditët e para të ekzistencës së kësaj Arqipeshkvie, me pretendimet e Raguzës për t'i qeverisur vetë ipeshkvitë e Arbërisë Veriperendimore.

-1089.Për Kurien Romane, e para (Raguza) mund të kishte rëndësi universale dhe e dyta (Antibari) vetëm një rëndësi lokale. (f.41)

Kuria Romane nuk e kuptonte që pikërisht Arqipeshkvia e Tivarit do të duhej të kishte një rëndësi, përveç asak lokale, edhe universale. Qysh prej Tivarit e deri në Shkup, jetonte një popull i rrëzikuar 2-fish për t'u shpërbërë: Nga Greku dhe nga Sllavi. Madje 3-fish, në rast se bullgarët dhe sërbët do t'i konsiderojmë 2 lloje sllavësh. Madje, pas 4 shekujsh, ky popull do të gjendej 4-fish i rrëzikuar, sepse 3 asgjësuesve të tij permanentë, do t'u shtohej edhe asgjësuesi i katërt, Turqia. Mbështetja nga Kuria Romane, dhe nga shtetet perendimorë pritej me dëshirë të

madhe nga ky popull. Por, as Roma, as shtetet perendimorë nuk ia dhanë ndihmën këtij populli, në intensitetin dhe në sasinë që i duhej dhënë. Në vend të ndihmës, u lejua një grindje e pakuptimtë mbi 200-vjeçare midis 2 arqipeshkvivet: Raguzës dhe Tivarit.

-1089. Në bulën papnore... të vitit 1089, arqipeshkvit katolik të Tivarit i jepen nën varësi të gjithë manastiret, si të dalmatinëvet (latinëvet), ashtu edhe të grekëvet e të sllavëvet, të cilët dalloheshin nga njëri-tjetri kryesisht nga gjuha e libravet të tyre liturgjikë. (f.81)

Në territorin e Arqidioqezës së Tivarit, dmth në Tivar, Ulqin, Shas, Shkodër, Drisht, Pult dhe, në krahun tjetër, në Kotorr, sipas asaj që e përcakton bula, gjenden, pra, këta 3 lloje manastiresh. Me "***DALMATINË***" do të nënkuptojmë manastiret e arbërvet dhe manastiret e të quajturvet "***romanë***", që gjithashtu janë arbër. Liturgjia në këta manastire mbahet në gjuhën latine. Me manastire "***GREKË***" do të nënkuptojmë sërish manastire arbërish, por ku pushteti bizantin kish vendosur prej kohësh liturgjinë në gjuhën greke. Manastiret e **SLLAVËVET**, në këtë parashtrim, dallohen qartë. Ata u shërbejnë enklavavet të veta, sllavësh të ardhur aty prej 3 a 4 shekujsh ose edhe më vonë, në gjuhën e tyre, falë veprës madhore të Cirilit e Metodit, krijuesvet të alfabetit sllav. Manastiret sllavë janë **MË TË PAKËT NË NUMËR**, gjë që shikohet nga vendi që ata zënë në tekstin e bulës.

Prej kësaj që u tha, janë për t'u nxjerrë 2 konkluzione të rëndësishëm:

1.Popullata që mblidhej rreth manastirevet që quhen grekë, në shekujt që vijnë do të jetë e gatshme t'u mbështetet kishës dhe manastirevet pravosllavë dhe ashtu ta shtojë numrin e sllavishtfolësvet me besimtarë e banorë lashtovendës josllavë. Prej këtyre popullatave lashtovendëse josllave, dmth ilire, përzier me ato pak enklava sllave, ingranuar nën pushtetin e Kishës Pravosllave me seli në Cetinjë, do të krijohet, në shekullin XV e këndej, kombi malazias.

2. Manastiret e quajtur dalmatinë, që, në të vërtetë ishin manastire të lashtovendësvet dhe që qartas përbënin shumicën, në rrjedhë të kohëvet, ose do të sllavizohen, psh ata në trevat e Kotorrit, duke mbetur katolikë, ose, këta të ipeshkvivet të tjera arbërore, edhe në paçin arritur të mbijetojnë prej sundimit 200-

vjeçar të Nemanjiqëvet, do të shkatërroheshin më vonë prej islamikëvet. E gjithë kjo do të ndodhte për një arsye fare të thjeshtë: Ilirët, dalmatinët, arbërit, **NUK E THANË LITURGJINË NË GJUHËN E VET**, por mbeti liturgjia e tyre në gjuhën latine, deri në shekullin XX, kur ishte tepër vonë.

Jezusi pat thënë afërsisht kështu: "***Ruajeni tufën tuaj, të mos e hajë ujku***!" Ilirët e hershëm dhe arbërit (dalmatinët, epirotët, maqedonët) e mëvonshëm, nuk pranuan bari, që t'u rrijë mbi kokë dhe t'i ruajë. Përkundrazi, ata, në vend që ta dëgjonin bariun e vet eventual, e sulmonin atë, e shanin, nuk ia vinin veshin, donin ata ta mësonin bariun e jo të dëgjonin fjalët e tija, dhe kjo bëri që etnitetin iliro-arbro-shqiptar mundi ta hajë, ta çapëlejë e ta asgjësojë, çdo lloj bishe, çdo lloj ujku, që i ra rruga të kalojë këndej.

-1120. Arqipeshkvijtë e Raguzës u paraqitën në Romë si pionierë të konvertuar të latinizmit dhe të katolicizmit në Ballkanin ortodoks, dhe ia arritën qëllimit që tek çdo papë të shek.XII të kishin gjithmonë një vërtetim të freskët për pushtetin e tyre mitropolitan mbi dioqezat arbërore veriperendimore.

Kaliksti II (1120) i urdhëroi drejtpërdrejtë ipeshkvijtë e Budves, Kotorrit, Antibarit, Ulqinit, Shkodrës, Drishtit dhe Pultit, që të njihnin superioritetin e Raguzës. (f.42)

Raguza, siç duket, në këtë kohë, është sllavizuar tërësisht ose në shumicën e vet. Ajo tani përfaqëson një fuqi katolike sllave. Ne nuk e dimë për ç'arsye, por e dimë tashmë që Papati, në të gjithë shekujt, ka qenë me gjithë shpirt i gatshëm të përkrahë sllavët në këtë gadishull e jo ilirët apo postilirët autoktonë. Papati madje ua ka zgjatur dorën sa herë që e kanë kërkuar, edhe sllavëvet ortodoksë, në dëm të postilirëvet, egërsisht të rrëzikuar prej tyre. Kështu shpjegohet edhe vendosja e Raguzës tanimë të sllavizuar në krye të ipeshkvivet të Arbërisë Veriperendimore, kështu shpjegohet edhe miratimi nga ana e Papatit e Arqipeshkvisë së Tivarit, sa herë prelatët e kësaj arqipeshkvie paraqiteshin të mbrojtur prej një sundimtari sllav. Le të ishte ai sllavi deri në palcë një antilatin dhe antikatolik, mjafton që të paraqitej si mik dhe papët i kishin gati kurorat mbretërore për të. PAPËT I KANË PASUR GJITHMONË GATI KURORAT

MBRETËRORE PËR SLLAVËT. Kështu ndoshta do të mund të shpjegojmë edhe faktin, pse në shek.XI nuk u ngrit ipeshkvia e Shkodrës në rang arqipeshkvie, por, në vend të Shkodrës, u afirmua ajo e Tivarit. Në Shkodër antisllavizmi ishte më i fuqishëm, ndërsa në Tivar, duke qenë edhe si mënjanë, edhe si më i ekspozuar drejt brigjevet të Dalmacisë, tashmë, në mos tërësisht, pjesërisht të konvertuar në sllave, politika prosllave e Kuries Romake do të mund të zbatohej me më pak pengesa. Tragjeditë nuk ndodhin asnjëherë pa pasur shkaqe madhorë në prapashpinë.

- 1153, 1167. Nën papën Anastazi IV (1153) ipeshkvjtë e Drishtit dhe të Ulqinjit, që nuk pranuan, u hoqën.

Pushtei mitropolitan i Raguzës arriti kulmin e tij në vitin 1167. Në kohën e arqipeshkvit Tribunus (1158-1187). Prelati i Antibarit quhet thjeshtë ipeshkëv dhe, për shkak të mosbindjes, ishte dënuar me dëbim, së bashku me ipeshkvin e Ulqinit. (f.42)

Më 1167-n arqipeshkëv i Tivarit ka qenë Imz. Loroja. Nuk është nevoja të gjurmohen me imtësi pretekstet rastësorë të të këtillë keqtrajtimeve. Mjafton të njihet kursi i përgjithshëm, kursi kryesor: Kush po bëhet tani i fuqishëm në Gadishullin e Ilirisë? Dinastitë sllave. Ato të përkrahim! Jo viktimat e tyre! Jo ata që duan të mbijetojnë, por ata që ia arrijnë të sundojnë! Jo ata që duan dhe nuk dinë, por ata që duan dhe dinë të bëhen të fuqishëm, qoftë edhe duke masakruar. Kështu shpjegohet ky qëndrim i Papatit ndaj ipeshkvivet të Arbërisë në rastet që i ka përmendur këtu Dr.M. fon Shuflai.

- Shek.XII, vitet 70. Por shumë shpejt ndodh një kthesë që, në të vërtetë, ishte në favor të Antibarit. Kundër ekspansionit raguzan në vitet 70 të shek.XII, doli me gjithë fuqinë e tij Gregori, prelati i Antibarit, i cili për nga origjina ishte patric nga Zara. (f.43)

Prelati i Antibarit, pra, arqipeshkvi i Tivarit, sipas dëshmivet që kanë dalë në dhjetëvjetëshat e fundit, s'është kush tjetër, veçse i shumënjohuri "Prifti Dokleat" ("Pop Dukljnini"), autori i kronikës "Mbretëria e Sllavëvet" ("Sclavorum Regnum"), shkruar në Tivar pikërisht në fund të sh.XII.

Ne nuk e dimë sa ka ndikuar kjo te krerët e Kryekishës Katolike në Romë, por dimë që arqipeshkvi Gregor, në librin e vet, sado që në shumë vende është një pasqyrues realist, ka mbajtur anën e sllavëvet. Me qenë se banorët e Tivarit nuk e dinin sllavishten, ai thotë se atë libër e ka përkthyer nga sllavishtja në latinisht, pikërisht që rinia e Tivarit të ketë mundësi për t'u njohur me Mbretërinë e Sllavëvet. Aq i apasionuar është arqipeshkvi Gregor pas etnitetit sllav, pas racës së sllavëvet, sa, duke përshkruar "dinastinë" e tyre mbretërore, në shumicën e saj të trilluar, nuk i lë gjë mangut Mbretërisë Izraelite të përshkruar te Dhjata e Vjetër.

Kur bashkojmë vendimin e Kuries Romane për t'ia hequr Arqipeshkvisë së Raguzës kompetencat mbi ipeshkvitë e Arbërisë dhe për t'ia dhënë ato Arqipeshkvisë së Tivarit, na shkon mendja që Kuria Romane e paska kuptuar që edhe Arqipeshkvi i Tivarit e ka për zemër opcionin sllav. Ky është konkluzioni ynë dhe këtu ne shikojmë edhe njërën prej arsyevet që Arqipeshkvia e Tivarit, në të 10 shekujt e jetës së saj, ka bërë jetë prej martiri. Martirizimin Arqipeshkvisë së Tivarit, nuk ia kanë shkaktuar vetëm skizmatikët e pushtuesvet sllavë dhe islamikët e pushtuesvet osmanë, por edhe vetë Roma Katolike, së cilës kjo Arqipeshkvi i qëndroi besnike në të gjitha kohët.

-Shek.XII. I përkrahur nga princi Mihael dhe pastaj duke u paraqitur në Romë me dokumente false dhe të vërtetë, duket se Gregori kërkoi paliumin arqipeshkvnor po nga i njëjti papë, ambasadorët e të cilit, afërsisht para 10 vitesh, e kishin ekskomunikuar "ipeshkvin e Antibarit" për shkak të mosbindjes. (f.45)

Unë nuk e di kush ishte ky princi Mihael në gjysmën e dytë të shek.XII. Megjithkëtë, kjo nuk na prish shumë punë.

1172. (Prelati i Antibarit, Gregori) lidhi aleancë me arqipeshkvin e Barit, i cili, në vitin 1272, e vuri Kotorrin përsëri në pushtetin (e vet), hyri në lidhje e marrëdhënie të ngushta me arqipeshkvin e Spalatos, i cili, nga ana e tij i shihte me sy të shtrembër sukseset e arqipeshkvit të Raguzës, që dikur kishte qenë sufragan i tiji. (f.44)

1177. Me sa duket, gjatë qëndrimit të tij në Zarë (1177), (papa) aleksandri III u informua në mënyrë të ngjashme nga arqipeshkvi spalatin Raynerius në favor të aspiratvet të Gregorit të antibarit, si dhe për primatin e Salonës, së cilës Gregori duhej t'i përkulej. (f.45)

-1186. Nëse Gregori e fitoi paliumin me të vërtetë apo jo, kjo nuk dihet, por fakt është që arqipeshkvi i Raguzës me ndihmën e Vilhelmit, mbretit norman, ... (1186), ia arriti shumë shpejt të kishte pretendime për pushtet nominal mbi dioqezat e Arbërisë Veriperendimore dhe, në disa qytete, si psh në Ulqin, ia arriti me të vërtetë ta ushtronte këtë pushtet në mënyrë faktike. (f.45)

Këto, sigurisht, janë çështje të orgtanizimit të brendshëm kishtar, por janë edhe manovra, të cilat bëhen me qëllim përfitimesh nga më të ndryshmit, midis tjerash, më kryesorët, përfitimet ekonomikë.

-1189. Por kur Gregori, i cili ishte, si të thuash, i së njëjtës parti me Mihaelin, u dertyrua të arratisej (1189) nga Antibari, për shkak të princit sërb, Nemanja,... arqipeshkvi (i Raguzës) Bernard I (1189-1201), u përpoq t'i bënte Antibarit një goditje përfundimtare. (f.45-46)

I adresuar më së miri tek Kuria nëpërmjet lidhjevet normane me zotërinë e ri të Dioklesë (Dukla), zhupanin e madh Nemanja, ... i pajisur me dokumente të vërtetë dhe me disa të falsifikuar, të cilët duhej të vërtetonin qoftë falsitetin e bulavet të Antivarit, qoftë moshën e vjetër të Arqipeshkvisë së Raguzës (viti 743), si dhe vazhdimësinë legjitime të pushtetit mitropolitan mbi dioqezat e Arbërisë së Veriperendimit dhe tërësinë e pronavet, Bernardi I (arqipeshkvi i Raguzës) i u nis në vitin 1189 për në Romë, ku situata e krijuar ishte jashtzakonisht e favorshme për qëllimet e tij. (f.46)

Zhupani i madh sërb, **Stefan Nemanja, e kishte shkatërruar gjer në themele Tivarin** në vitin 1183. Kjo, vetëkuptohet, ka ndodhur, sepse Tivari e ka kundërshtuar pushtimin sërb. Arqipeshkvi, sado prosllav, por i lidhur shpirtërisht

me banorët josllavë të Tivarit, për të mos gjetur vdekjen, është detyruar të arratiset para sërbëvet. Është e kuptueshme që Nemanja të kërkojë për t'ia hequr atij lloj Tivari titullin e kryeipeshkvisë dhe për t'ia kaluar ato kompetenca Raguzës, me të cilën ai i kishte marrëdhëniet grurë.

-1189-1199. (Arqipeshkvi i Raguzës, Bernardi I) u kthye (nga Roma) si mitropolit i vetëm i të gjitha dioqezave të Arbërisë së Veriperendimt, porse vetëm për një kohë shumë të shkurtër, sepse tashmë nën Inocentin III (1199), Ulkani (Vlkani), princi i madh i Dioklesë, besnik i kishës katolike dhe që, me sa duket, ishte edhe i afërm i papës, arriti që prelatit të Antibarit t'i jepej paliumi arqipeshkvnor. (f.46-47)

Vukani (Vlkani, Ulkani) është i biri i Stefan Nemanjës. Por ai e shikon, e kupton, që populli i Zentës nuk mund të qeveriset me metoda ortodokse lindore. Kasta e klerit të këtyre trevave **ARBËRORE** është mësuar tashmë të veprojë me sundimtarë sllave, sepse ka rreth 150 nën sundimin e tyre. Ajo kastë klerikësh vendës, e kryesuar nga arqipeshkvi i shtitulluar Johannes (Gjon apo Ivan), **E JOSHI VUKANIN ME KURORËN MBRETËRORE** dhe ai bëhet "mik" i tyre. Del madje edhe kushëri me papën.

-1199-1215. Të gjitha përpjekjet që u bënë, si psh, që papa u vu në dijeni nga ana raguzane, që sipas libravet regjistrues të Dhomës Papnore 'Kisha e Antibarit numërohej si kishë sufragane e mitropolisë raguzane', nuk ndihmuan aspak dhe nuk ndihmoi aspak as fakti që arqipeshkvi Leonard i Raguzës në kohën e Koncilit Lateran të vitit 1215 u ankua personalisht te papa për këtë vendim të padrejtë. (f.47)

Kuria Romane tashmë e kish siguruar një aleat të ri sllav më në jug dhe asaj nuk i interesonte më Raguza në krye të ipeshkvivet arbërore.

-1199. Në një sinod interesant të mbajtur në vitin 1199 në Tivar, (Fill pas njohjes apo rinjohjes si arqipeshkvi, Gj.D.**) u morën vendime kundër martesës së priftërinjvet dhe kundër mbajtjes së mjekrrës. (f.81) Ndër ipeshkvijtë e sinodit të Antibarit, të vitit**

1199, që kishin nënshkruar, ishte edhe Dominiku, arqipresbitri i Arbanumit: Dominicus arcipresbiter Arbanensis. (f.53)

Nuk do të ndalemi te përshkrimi i atij sinodi, pasi as vetë M. fon Shuflai nuk ka folur më gjatë, por do të vëmë në dukje që, në atë sinod, vërtet janë marrë masa shumë të rëndëshme në mbrojtje të popullsisë katolike, që do të thotë, në mbrojtje të shpirtit arbëror, i cili, me gjithë tmerret e shkaktuar prej pushtuesit sërb, rrënuar e pakta 7 qytete, nuk po shuhej. Ka pasur, me sa duket një solidaritet edhe më të gjërë se territori që mbulonte Arqipeshkvia e Tivarit dhe këtë e dëshmon tërthorazi prania aty e kryepriftit të Arbanumit, i cili, mendoj unë (dhe jo vetëm unë), nuk e ka pasë selinë në Krujë, por diku në Mirditë.

-1204. Bie Perandoria e Lindjes, krijohet zinxhiri i ipeshkvivet katolike përgjatë Bregdetit të Adriatikut, por shkëputet menjëherë nga epirotët. (f.51)

Despotati i Epirit është fragment i historisë së shqiptarëvet që duhet ristudiuar. Por këtu na bie në sy, sa të gatshëm ishin arbërit për t'iu ribashkuar Perendimit.

-Shek.XIII-XIV. Historia e ipeshkvivet, të vendosura krejt ngjeshur me njëra-tjetrën, ndikimi i ipeshkvijvet të dioqezavet të vjetra, të Shkodrës (Skorda), Sardës, Ulqinit (Dolcigno), Drishtit (Drivasto), ... talenti për të përballuar vështirësitë dhe roli ndërmjetësues i Arqipeshkvisë së Antibarit (Tivarit), e cila ishte më tepër e ekspozuar, krijimi i Arqipeshkvisë ekzotike të Kranjës (Krajina), forcat e fshehta perendimore në Durrës, që mundën të mbanin vazhdimisht një arqidiakonat latin në Ohër, në afërsi të mitropolitit grek, dhe që, në shek. XIII, çuan në ekzistencën paralele të një arqipeshkvi katolik dhe të një kryepeshkopi ortodoks dhe krijimi i një rripi ipeshkvishë në truallin e brendshëm arbëror, duke filluar nga Baleci (Balezo), nëpër Sapë, Danjë, Kunavi, Skampë-Cerrnik-Vrego deri në Prizren dhe Ohër, që nëpërmjet këtij rripi ipeshkvishë në gjysmën e dytë të shek. XIV (pra, "në mbrëmjen (natën)..." që do të sillte pushtimi turk), u arrit një periudhë shkëlqyese e katolicizmit, këto, pra, janë pikat fikse, mbi të cilat ne do të

përqëndrojmë vështrimin tonë kryesor, sepse këto pika kanë dhënë një ndihmesë të rëndësishme në historinë mesjetare botërore. (f.22-23)

Fjalia kaq e gjatë dhe e thellë e dijetarit, serioz dhe vetëmohues, të gjysmës së parë të shek.XX, që e ka emrin **Dr.Milan fon Shuflai**, na bën edhe ne të biem në mendime shumë të gjatë dhe të thellë: Paskemi qenë ne, arbro-shqiptarët, që paskemi dhënë "***NJË NDIHMESË TË RËNDËSISHME NË HISTORINË MESJETARE BOTËRORE***"!?! I përfytyrojmë të gjitha këto vatra religjiozo-ideologjike, njëkohësisht etnimbrojtëse, në Arbërinë e atëhershme, gjithanësisht të rrëzikuar prej 2 strategjive, edhe ato religjiozo-ideologjike, por etnimbytëse në drejtimin tonë, dhe krijojmë as më pak e as më shumë se përfytyrimin e një **KOMBI-HERO**, i cili, duke u përpjekur të mbijetojë, po realizonte "***NJË NDIHMESË TË RËNDËSISHME NË HISTORINË MESJETARE BOTËRORE***". Vetëm duke përfytyruar këtë lloj heroizmi, i cili e niste rrugëtimin nga Arqipeshkvia e Tivarit, do të mund ta kuptojmë **KULMIN E HEROIZMIT RENESANSIAN**, njërin prej kulmevet të heroizmavet botërorë, që e ka emrin **EPOKA E GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT**.

-1199-1215, 1227-1238. Pushteti mitropolitan faktik mbi dioqezat arbërore të epërme qysh në atë kohë (1199-1215) mbeti vazhdimisht në duart e Arqipeshkvit të Antibarit dhe, në Romë, titulli, karakteri dhe njësitë administrative të tijat, u njohën përfundimisht. Megjithatë, Arqipeshkvi Raguzan me ndihmën veneciane, ia arriti disa herë (1227, 1238) të nxirte listën e tij të vjetër të arqipeshkvivet, të vërtetuar sërish nga Kuria. (f.47)

-Shek.XIII e më parë. Disa manastire benediktinë, arbërorë, duket se janë madje edhe më të vjetër se zinxhiri i manastirevet benediktinë, ndërtuar nga urdhëri që fillon në Montekazino... Manastiri i Shën Salvadorit në Tivar etj. (f.140)

-Shek.XIII e më parë. Një vend të veçantë kishte Abacia e Rotecit (Rtac, Rotezo, Rotecium) në rrethin e Tivarit (sot quhet Punta Ratac dhe është tokë austriake), e cila fillimisht, nën ndikimin e kultit të Kryeengjëllit në Monte Cargano (Monte Kargano) i ishte

dedikuar Shën Mëhillit, porse në fund të Shek.XIII iu dedikua Shën Mërisë. E rrethuar nga elementi ortodoks, ajo qe një vend i famshëm pelegrinazhi për katolikët. Për festën e lindjes së Shën Mërisë mbahej aty një panair, ku merrnin pjesë fyelltarë nga Raguza (piffarë), që kishin një leje zyrtare (apostafat) për këtë rast. (f.152)

Kur Dr.M.fon Shuflai, kur e quan "***tokë austriake***" vendin ku ndodhet Manastiri i Ratëzit, e ka fjalën për kohën para se të Krijohej Mbretëria Sërbe, Kroate e Sllovene. Kur thotë: "***E rrethuar nga elementi ortodoks***", duhet ta ketë fjalën për kohën pas krijimit të Kishës Pravosllave Sërbe në vitin 1219, kur do të krijohej Manastiri Pravosllav i Vraninës, si dhe pas shek.XV, kur, nën ndikimin e vlladikatit Pravosllav të Cetinjës, do të merrnin fenë pravosllave edhe pashtroviqasit. Elementi i fyelltarëvet të Raguzës na shtyn të mendojmë diçka lidhur me trashëgiminë kulturore shumë të lashtë ilire. Por kjo kërkon hulumtime.

-1249-1252, 1324-1344. [Pas benediktinëvet vijnë françeskanët dhe dominikanët, 2 rende rregulltarësh që mundohen ta mbajnë gjallë Kishën Katolike Arbërore deri në kohët tona. Ata kanë ardhur në Arbëri qysh në gjysmën e parë të shek. XIII, por edhe në fillim të shek.XV, kur forcat politike ortodokse (sërbe e greke) përsëri arritën të marrin epërsi në trevat e Arbërisë.] **Midis tyre kishte murgj të famshëm, psh minoriti Johanes de Plano Karpini (Johannes de Plano Carpini) arqipeshkëv i Tivarit (1249-1252), (dhe) dominikani Guilelmus Ade (Guillelmus Adae) (1324-1344). (f.155)**

Por këto nuk mund të ishin masa të mjaftueshme nga ana e Papatit. Nën trysninë e skizmës, arbërvet nuk u rrëzikohej vetëm besimi tradicional, por u rrëzikohej vetë ekzistenca si etni.

-1250. Qysh në vitin 1250, papës Inocens IV (Innocens IV) iu desh të kujdesej, që objektet e vjedhur të tryezës së altarit arqipeshvnor të Tivarit të ktheheshin edhe një herë aty ku e kishin vendin. (f.115)

-1307. Në vitin 1307, pronat e kishës ishin grabitur aq shumë, sa që papa u detyrua t'i drejtohej mbretit Urosh II. (f.115)

Është krejt e qartë, se deri ku arrinte subversioni shkatërrues i forcavet, të cilat kurrsesi nuk e ndienin veten të qetë, përderisa raca jonë ekzistonte akoma. Vetëm kështu mund të shpjegohen gjëra të këtilla. Por asnjëherë nuk duhet shkarkuar krejt fajet mbi armikun, pa e fajsuar edhe veten.

-1283. Minoritët që kishin filluar të depërtonin në Arbëri, që në fillim ishin nën mbrojtjen e veçantë të Papës. Në vitin 1283 misionet e tyre në Kotorr, Tivar, Ulqin dhe Durrës, ishin nën kujdesin raguzan (Custodia Ragusina). Në atë kohë fjala e priorit dominikan dhe e gardianit minorit të Raguzës, si të besueshëm të Papës që ishin, kishte peshë në çështjet e rëndësishme kishtare të Arbërisë Veriperendimore. Misionet e përmendur u zgjëruan shumë shpejt, me manastire të rregullt... (f.158)

-1452. Në Tivar, në vitin 1452, përmendet Manastiri i Shënkollit jashtë murevet të qytetit (Domus S.Nikolai extra muros civitatis Antibarensis ordinis Minoris). (f.158)

-1288,1303, 1433-1610. Manastirit (të Ratëzit), nga Mbretëresha Helenë (1288) dhe nga i biri i saj Uroshi II (1303), iu dhuruan

troje kryesisht në fshatrat e krahinës Spica (Spizza, СЬПИЧ**)**

por, në lidhje me pronat e tij, Manastiri vuajti nga Cërnojeviqtë, të cilët me tokat e tija ushqenin Kishën Ortodokse (chiexa grècha). Për shekuj (1433-1610) ai vuajti edhe nga fisi i Pastroviqëvet, që kish mbështetjen edhe tek venedikasit. Problem pati edhe nga farefisi i Medinëvet (Medini), të cilët gjatë shek.XVI mundoheshin të kishin nën zotërimin e vet disa fshatra të Spicës, jo vetëm me anë të dhunës, por edhe me anë të falsifikimit të aktevet të dhurimit. Në shek.XV, Manastiri, përveç abatit, kishte edhe një abat zëvendësues (viceabbas) dhe filiale në Praskavica e në Dubovica, të cilat mundoheshin të shkëputeshin

nga Manastiri-mëmë. Manastiri u fortifikua (fortificium Retecii) shumë heret (para vitit 1410), ashtu siç qe vepruar me manastiret benediktinë hungarezë të pushtuar nga Turku. (f.152-153)

Historia e Manastirit të Ratëzit është pjesë e historisë së Arbërisë, nganjëherë edhe e shkëputur prej politikës ditore të Arqipeshkvisë së Tivarit. Duke qenë i fuqishëm ekonomikisht dhe duke qenë i lidhur drejtpërdrejt me Papatin, në varësi nga abatët që i gjendeshin në krye, shumë ngjarje të rëndësishme, psh ajo e propagandimit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Perendim, kanë lidhje me këtë abaci. Pikërisht për shkak të një të këtillë roli, ai manastir, ose është marrë me të mirë, me dhurata etj, ose është goditur rëndë prej po atyre që i jepnin dhurata.

-1232. Pronat e Manastirit të Shënkollit, i cili gjendej në ishullin e Vraninës në Liqen të Shkodrës, dhe që, sipas dëshmivet të shek. XIV, ishte themeluar rreth vitit 1232 nga peshkopi i pare (pravosllav) i Zentës, shtriheshin përgjatë bregut veriperendimor të Liqenit, në Zhupa Cërmnica, me popullsi të vjetër arbërore dhe sllave, nga Tërnovo deri në Godinje. (87-88)

Dr.M. fon Shuflai thotë se Zhupa e Cërmnicës banohej me "***populli të vjetër arbërore dhe me sllavë***". Studiuesit sërbë e malazezë të kohës sonë e kanë harruar fare faktin që kjo krahinë ka qenë banuar dikur **edhe me arbër,** madje më shumë me arbër se sa me sllavë. Kjo sjell si pasojë që, këta dijetarë, as emrin e Cërmnicës nuk dinë ta shpjegojnë.

-1232. (Pronat e Manastirit të Vraninës në Cërmnicë) kufizoheshin me pronat e Abacisë katolike të Rotecit (Rotezo, Rtac) dhe me ato të familjes patrice Zare të Tivarit.

Shërbimin e mbajtjes së kuajvet në këtë krahinë (Cërmnicë, Gj.D.), e cila ishte e famshme që me kohë për mbarështrimin e tyre, e bënin familjet arbërore. (f.88)

Kuajt i mbarështronin familjet arbërore, sepse sllavët e ardhur, për të cilët, siç thashë, nuk mund të themi se ishin të shumtë, nuk e kanë pasur traditë rritjen e kuajvet. Ata e kanë marrë këtë traditë prej arbërvet, siç kanë marrë, po në atë

krahinë, edhe kultivimin e rrushit, edhe punimin e çerepëvet, edhe zënien apo përdorimin e peshkut. Sllavët e ardhur, jo vetëm aty, por në krejt Malin e Zi të sotmin, kanë marrë aq shumë elementë të kulturës e të gjuhës nga arbërit, sa dijetarëvet nuk do t'u mjaftonte krejt shek.XXI për t'i evidentuar.

-1232. Disa dokumente dhurimi të (Manastirit të Vraninës) janë shumë të falsifikuar. Ata u falsifikuan pjesërisht nga pretendimet që u bënë nga murgjit, me kalimin e kohës, në lidhje me fshatin Shtitar, që gjendej direkt në breg të Liqenit, dhe pjesërisht, ngaqë Manastiri në vitin 1348 u vu nën zotërim të Mnastirit të Kryeengjëllit të Jerusalemit, që ishte themeluar nga Mbreti Urosh II dhe që është edhe sot e kësaj dite nën misionin rus. (f.88)

Merre vetëm këtë fragment dhe shkruaj një libër 100-faqesh, me interpretime të histories së këtyre anëve! Por, falsifikimet e çdo gjëje që mund të falsifikohet, vazhdojnë edhe sot, 8 shekuj më vonë, dhe konkluzioni më mbushamendës është ky:

1.Sllavët e ardhur kanë shumë frikë nga fara iliro-arbro-shqiptare.

2. Në radhët e këtyre sllavëve të ardhur ka një përqindje të madhe ish-arbër dhe ish-shqiptarë, të cilët duan të harrojnë, por nuk harrojnë dot çfarë kanë qenë. Shkoni tani në Tivar dhe shihni sa frikë kanë shqiptarët e Shestanit t'ua përmendësh gjuhën shqipe! Kanë frikë dhe frika u kthehet në urrejtje. Kjo është e shëmtuar.

-1232 deri më 1886-n. (Përveç Manastirit të Vraninës), i cili u braktis në vitin 1843, por që u ripërtri në vitin 1886... ne kemi njohuri edhe për manastire të tjerë ortodoksë nëpër ishujt e Liqenit të Shkodrës, të cilët gjetën, që të gjithë, favorizuesit e vet nëpër familjet dinastike të Zentës, Bosnjës dhe tek despotët sërbë.

Lëshuar të huajt dhe vendësit, shërbëtorë të të huajvet, mbi Liqenin e Shkodrës si ujqërit mbi trupin e një dashi a mëzati, të shtrirë përtokë!

Këta manastitre janë:

• Komi (Odrinska Gorica) me Kishën e Nanës së tën' Zot, me varrin e Lesh Gjurasheviqit [Leš Đurašević (Crnojević)] dhe despotit Stefan. (f.88-89)

• Starčeva Gorica (Gorica e Plakut), që është edhe vendi ku është varrosur Bozhidar Vukoviqi (Božidar Vuković) (†1540), i cili mori merita jashtzakonisht të mëdha për shtypjen e librave kishtarë për kishën ortodokse. (f.89)

• Beška Gorica (Gorica e Besit, Gj.D) me 2 kisha, që, në Kishën e Nanës së tën' Zot, ndodhet varri i Helenës, së vesë së Gjergj Balshës II, e cila u bë pastaj e shoqja e vojvodës së madh Sandal Hraniq (Sandalj Hranić) (†1442) (f.89)

• Maraçniku i Kishës së Marisë, së cilës iu fallen dhurata në vitin 1417 nga Balsha i fundit (Balsha III) (f.89)

• Manastiri tashmë i sipërpërmendur i shën Mërisë në Kranjë. (f.89)

Historia nuk mund të ndryshohet. Përkundrazi, dëshmitë e historisë duhen ruajtur me shumë seriozitet dhe duhen interpretuar. Duhen interpretuar dhe ruajtur, por jo më me mentalitetin e Mesjetës. Shqiptarët dhe malazezët duhet të merren vesh njëri me tjetrin si 2 popuj bashkëkohorë. Ishujt e Liqenit të Shkodrës, përveç atyre të Vraninës dhe të Komit, u takojnë shqiptarëvet të Shestanit dhe të Kranjës.

Ruajtjen e tyre dhe restaurimet eventualë duhet të nismohen prej shqiptarëvet, ndërsa fondet, natyrisht, duhet të sigurohen prej financavet të republikës. Të ardhurat turistike prej ishujvet, nuk mund t'i takojnë dikujt tjetër, përveç Muriqit, Besit dhe Ostrosit.

-1247.Pushteti mitropolitan raguzan që teorikisht kishte një bazë të fortë ligjore, ishte dëmtuar shumë tashmë, pasi përveç ipeshkvit të Ulqinit, i cili bënte politikë raguzane si rrjedhojë e rivalitetit të qytetit të tij ndaj Antibarit dhe të princit të tij laik, Gjergjit, ndaj shtëpisë mbretërore sërbe, Raguzës nuk i bindej asnjë nga sufraganët e Arbërisë së Veriperendimit; madje, ky

kufi ndërmjet kishash, kjo urrejtje që ekzistonte ndaj Raguzës, kërcënonte të kthehej në urrejtje edhe kundër Papatit vetë dhe madje kjo gjë po bëhej edhe më e lehtë, pasi dinastia sërbe në atë kohë filloi ta trazonte këtë urrejtje tashmë edhe publikisht. (f.48)

("*Kush është papa? Zoti ynë mbreti Urosh është për ne papë*!" Kjo thënie është e vitit 1247. E ka shqiptuar dikush në një kuvend të tivarasvet, kur i deleguari raguzan ka mbrojtur tezën se edhe tivarasit duhej të mbështetshin te autoriteti papal.) (f.48)

Shqiptuesi i këtyre 2 frazave është qartësisht një provokator i vënë nga njerëzit e mbretit të Sërbisë, por krjet episodi dëshmon që sllavët po i thoshin Papatit: "***O na përkrah ne sërbët, o do të na kesh armiq dhe kjo ty s'të levërdis!***" Kuptoje tani, se në ç'pozitë ishin tivarasit dhe arbërit e tjerë!

-Shek.XIII. Meqenëse lufta ndërmjet Raguzës dhe Antibarit në shek.XIII kishte humbur tashmë çdo mprehtësi kundër Durrësit ortodoks dhe meqë Antibari, në zonën depërtuese sllave kundër Kishës Autoqefale të Sërbisë të organizuar nga Shën Sava, përshtatej më tepër si një rojë e lartë, sesa Raguza, përpjekjet e arqipeshkvijvet raguzanë, të para nga këndvështrimi universal i Kuries, kishin marrë tërësisht një kolorit lokal, pikërisht në kohën kur intensiteti i këtyre përpjekjeve nga pikëpamja lokale kish arritur pikën kulmore. (f.47-48)

Si do kuptuar kjo? Kjo do kuptuar se Papatit i duhej ta kish një forcë të organizuar katolike brenda shtetit sërb të Nemanjiqvet dhe ky ishte Tivari, në krye të Arbërisë Veriperendimore. Ishte, pra, Arbëria Veriperendimore, një forcë e gatshme për t'iu kundërvënë Kishës Autoqefale Pravosllave Sërbe, një kishë kjo **POLITIKE E NACIONALE**, e cila, që në fillimet e saj po tregohej shumë e rrëzikshme. Mirëpo, ne duhet ta kuptojmë se Kuria asnjëherë nuk e ka kuptuar, që, **kishës politike nacionale sërbe**, do të duhej t'i kundërvihej një **KISHË NACIONALE ARBËRORE.** Por duhet të shtojmë edhe këtë: Kuria e Romës asnjëherë nuk ka pasur kundërshtim që popullsitë pasilire, aktualisht arbërore, të konvertoheshin në sllave, mjaftonte që ato të mbeteshin katolike.

-Shek.XIII. 1248. Për Kurien ishte e rëndësishme që në krye të Kishës së Antibarit, e cila ishte mjaft e ekspozuar, të kishte me çdo kusht burra të besueshëm. Murgu minorit dhe udhëtuesi i Botës, Johanes de Plano Karpini (Johannes de Plano Carpini), i cili në vitin 1248, kur procesi i Raguzës po bënte dallgë të mëdha, u emërua nga miku i tij, Papa Inocens IV (Innocens IV), si arqipeshkëv i Antibarit. Në truallin arbëror ai paraqitet si pararendës i një sistemi që menjëherë më pas nuk do të zbatohej askund me aq përpikmëri se në Arbëri. (48-49)

-1249. Nga ana e Kuries, Antibari, si ... edhe gjithë Arbëria kundër Ortodoksizmit, u dallua si bazë operacioni e Perendimit kundër sllavizmit. Johanes de Plano Karpini, i cili e mori rrugën për në arqipeshkvinë e tij me qëllime shumë paqësorë, duke kaluar nëpër Raguzë (më 12 janar 1249), menjëherëmë pas, u bë një luftëtar i vendosur pararendës për të drejtat mitropolitane të arqipeshkvisë së tij. (f.49)

Pra, duhet të kuptojmë që, në Romë, krejt ndryshe njihej Arbëria me kryekishën e vet në Tivar, dhe krejt ndryshe ish në terren. Në terren ajo ishte një "***bazë operacioni kundër sllavizmit***", ndërsa në Romë kjo kuptohej thjeshtë si një avanpost kundër skizmatizmit.

-Arqipeshkvi i Antibarit Johanes de Plano Karpini e bëri të vëmendshëm Papën në lidhje me Ipeshkvinë e Arbanumit (Krujës) dhe në lidhje me klerikët e shumtë latinë që gjendeshin në këtë provincë, si në Pult (Polaton), ashtu edhe në Kunavi. (f.54)

M.fon Shuflai e ka vënë në kllapa: Krujë, por, e kam thënë edhe njëherë, ipeshkvia e Arbanumit duket se ka qenë më në verilindje dhe konkrtetisht diku në trevat e Mirditës, disa prej të cilavet sot i përfshin rrethi i Matit. Vetë përmendja e Kunavisë dhe Pultit aty, na e përforcon këtë hamendje. Ndërkaq, shohim këtu edhe sa realist ka qenë arqipeshkvi Karpini në vlerësimin e gjendjes dhe të kërkesavet reale që kishin banorët e këtij vendi.

-1255. Procesi në Napoli, që u bë vetëm sa për të ruajtur fytyrën, u ndërpre përfundimisht nga vetë raguzanët në vitin 1255. Në qetësinë më të madhe, Raguza u zmbraps tërësisht nga trualli arbëror edhe nga ana formale. (f.50)

Unë nuk e di hollësisht me çfarë është marrë ai "***proces në Napoli***", por e rëndësishme është që këtu marrim vesh se pretendimet e Kishës Raguzane mbi dioqezat arbërore tashmë ishin mbyllur. Janë plot 166 vjet përpjekje të Kishës së Tivarit për t'u pavarësuar (dhe ndoshta ashtu puna e saj do të kish qenë më e suksesshme), por pretendimet e Raguzës e edhe të forcavet të ndryshme në Selinë e Shenjtë, nuk e patën lejuar një pavarësim të tillë. Pse ka ndodhur kjo, është vështirë të thuhet me saktësi. Kishën e Ilirikut Lindor, që ish një kishë mirëfilli ilire dhe që duhej të trashëgohej e plotë prej postilirëvet, Selia e Shenjtë e kish humbur ç'prej vitit 732. A ish kjo një përpjekje e Selisë së Shenjtë për të pasur në Raguzë një "Kishë të Ilirikut Perendimor" si kompensim i asaj ç'i ishte rrëmbyer prej grekëvet në Lindje? Më shumë do besuar që vëmendja e Selisë së Shenjtë, prej shekujvet VIII-IX e këndej, ka qenë për të bërë për vete sa më shumë sllavë, se sa për të shpëtuar nga zhdukja ilirët apo postilirët.

-1256. Titulli Arqipeshkëv i Sllavëvet (Archiepiscopus Sclavinensis) që shfaqet në vitin 1256 për Arqipeshkvin e Antibarit dhe që në shek.XV u shndërrua në titullin e një Primati të Sërbisë, tregon qartë detyrën që iu caktua këtij eksponenti të Romës, si dhe ipeshkvit të Kotorrit njëkohësisht. (f.50)

Del ajo që thashë pak parë: Roma e kish hallin te Sërbia! Te ajo Sërbi, e cila, si edhe Greqia, s'u bë kurrë me Romën. Madje as në shekujt e rrëzikut islamik dhe as në dhjetëvjetëshat e rrëzikut komunist!

Por, në anë tjetër, do pranuar që, për gjithë këtë tragjedi apokaliptike të etnisë iliro-arbro-shqiptare, për këtë vdekje të ngadalshme tonën, nuk e ka krejt fajin Kuria Romane, por e kanë edhe vetë ilirët dhe pasardhësit e tyre.

Një popull aq i vogël, sa helenët, arriti të ketë kishën e vet, sepse i **SHKROI** mësimet e kishës në gjuhën e vet. Një popull aq i prapambetur, sa fiset arabë të Mekës e Medinës, arriti të ketë xhaminë e vet, e cila do të mblidhte rreth vetes, në

shek.XXI, 2 miliardë e gjysmë njerëz, pikërisht sepse e **SHKRUAN** Kur'anin në gjuhën e vet. Popuj aq të paqytetëruar sa sllavët e shekullit IX, arritën të kenë kishat e tyre, sepse edhe ata e **SHKRUAN** krishtërimin në gjuhët sllave.

Në qoftë se Konstantini i Madh do të kish thënë më 313-n: "***Le të SHKRUHET feja e Krishtit edhe në gjuhën time***!", ç'fat do të kishin pasur ilirët?!

Në qoftë se Justiniani i Madh do të kish thënë: "***Le t'i PËRKTHEJË Iliriku Lindor (Justiniana Prima) Ungjijtë në gjuhën e vet dhe Kodet e mi le të SHKRUHEN edhe në gjuhën time!***", çfarë do të thuhej sot për të në historinë botërore?!

Në qoftë se Alipashë Tepelena do të kish thënë: "***Le të hapen SHKOLLA NË GJUHËN SHQIPE në krejt pashallëkun tim dhe le të SHKRUHEN të gjitha letrat në gjuhën shqipe!***", a do të kish arritur sulltani t'ia presë kryet?!

Dhe, në qoftë se Kara Mahmutpashë Bushatasi, me 1/5-n e flotirit që kishte, në pashallëkun e vet, në atë që ai pat qejf ta quante Ilirida, do të kish hapur **SHKOLLA SHQIP** me alfabetin e Gjon Buzukut e të Pjetër Budit, a do t'ia kishin prerë dot kokën malazezët, në një natë të errët, në Kruse?!

Nëse këta 2 të fundit do të kishin vepruar kështu si thashë, gjëja më e pakët që do të kishim sot, do të ishte një **SHQIPËRI E PLOTË**. Kjo, s'do të ish gjë e mirë vetëm për ne, por për të gjithë popujt e Ballkanit.

-1255. Qëllimi i kësaj detyre (Archiepiscopus Sclavinensis) ishte që, nëpërmjet raportevet të mirë me dinastët sërbë, që do të arriheshin me anë të lokalitetevet të besimit katolik të shpërndarë nëpër Sërbi, të mbahej e qëndrueshme supremacia romane mbi ipeshkvitë katolike në këtë zonë të depërtimit sllav. (f.50)

Nuk besoj të ketë qenë krejt kështu. "***Lokalitete të besimit katolik***" nuk ka pasur nëpër Sërbi. Ata "***lokalitete***" kanë qenë shpërndarë nëpër Arbërinë Veriore, deri në Argjentinë, te Mitrovica e sotme, deri në Novobërdë e deri në Janjevë, por që, me mënyrën e atëhershme të ngatërrueshme, quhej Sërbi. Këto ishin enklavat arbërore katolike, të mbetura gjallë deri në atë kohë. Por qëllimi i Papatit do të ketë qenë diç tjetër. Papati ende ëndërronte që sërbët, gjuha të cilëvet quhej gjuhë ilire, të

uniatizoheshin e të ktheheshin "***në gjirin e Kishës Perendomore***". Këso ëndrrash të thata ka thurur Vatikani gjithë jetën e vet.

-1301-1307. Marinus Zare, një tivaras nga një familje e fisme princësh, i cili më parë kishte qenë klerik i oborrit të mbretëreshës Helenë, lindur franceze, e kishte mirë punën edhe me mbretin Urosh II. Si arqipeshkëv i Antibarit (1301-1307), ai ishte personi i përshtatshëm për të rregulluar çështjet e mbetura pezull të katolikëvet që jetonin nëpër njësitë kishtare ortodokse të sërbëvet. (f.58)

-1303. Arqipeshkvi i Tivarit, Marinus Zare, mund të haset në vitin 1303 në shpurën e mbretit Urosh II në Kotorr. (f.100)

Janë të dhëna të mjaftueshme për të treguar se kjo familje tivarase punonte tashmë në kursin e dinastisë sërbe të Nemanjiqvet në pushtet. Kështu shpjegohet edhe fakti që këta tashmë edhe pranemrin, llagapin, e kishin përshtatur me preferencat e pushtuesvet: Zharetiq. Por kjo nuk do të thotë që ata nuk ishin arbër. Ata ishin arbër në shërbim të pushtuesvet. Ndonës të vetëvetes, por ndoshta jo të gjithë.

-1303, 1341. Për qytetin e Tivarit (arqipeshvij vendës janë): Marinus Zare (1303) dhe Johanes Zaulini (Johannes Zaulini) (1341). (110)

Informacioni vlen për të konfirmuar se Tivari merrte pjesë efektivisht edhe në jetën e vet kishtare, ashtu si në atë laike qytetare, sido që ndonjëri prej subjektevet, ashtu si edhe sot, mund të punonte në dëm të vetë tivarasvet. Emrat familjarë, si Zare, ashtu edhe Zaulini, lidhen me fjalët e sotme shqipe: Z(J)AR(M) dhe ULLI,-NI.

-1405. Kur Tivari iu dorëzua Venedikut (1405), konstatohet aty edhe kontrata kishtare. (110)

Kisha, pra, është faktor shumë i rëndësishëm. Ajo nuk mund të anashkalohet as në marrëveshje të atilla, të cilat kanë të bëjnë me ndërrime sundimtarësh. Përkundrazi, kisha mund të ketë nganjëherë edhe rol vendimtar.

-1422. Pjetër Spani (Petrus Span), që më parë kishte qenë kanonik i Drishtit, bëhet në vitin 1422 Arqipeshkëv i Tivarit. (f.110)

Është pakëz për t'u çuditur se si, edhe pas rënies së një pushteti të huaj (psh Perandoria Sërbe ra fill pas vitit 1355), ndër ne gjenden përkrahës apo simpatizues të atij pushteti prej kohësh të rrëzuar. I tillë, me sa duket, është edhe Arqipeshkvi Pjetër Spani. Por këto gjëra, vetëkuptohet, mbeten për t'u saktësuar. Asgjë në historiografi nuk thuhet përfundimisht.

-1323. Në vitin 1323 dërgohen nga Uroshi III, për shkak të martesës me Blankën e Napolit, një patric nga Kotorri dhe një farë diakoni i quajtur Vite që ishte nga Tivari. (101)

E dhënë që dëshmon se, sado që dihet sa i urrente Uroshi III, edhe katolikët, edhe arbërit si bartës dhe ushtrues të katolicizmit, ai prapëseprapë, për interesa të vet, i përdorte të gjithë këta, madje edhe në misione të rëndësishëm, siç ishte martesa me një katolike.

-1307-1324. (Arqipeshkvi Andreas Hungarus, françeskan nga Zara, cilësohet si një ndër arqipshkvinjtë dhunues, i cili shfuqizonte sufraganët sipas interesit të vet dhe që madje arrin të përzihet edhe në punët e Arqipeshkvisë së Durrësit.) (f.105-106)

Por unë nuk shikoj këtu diçka shqetësuese, nëse qëllimet e veprimevet të tij nuk kanë qenë në thelbin e vet negativë.

-1336. Kuria i lejoi ipeshkvit të sapoemëruar të Shkodrës, kreut të mëparshëm të katedrales së Antibarit, që të merrte të ardhurat e kanonikatit të tij, për aq kohë deri sa të rimerrte pronat e ipeshkvisë së vet, të cilat i mbaheshin nga dofarë njerëzish. (f.116)

Janë vitet kur kral Dushani, më vonë car, sapo e kish marrë pushtetin. Puna e prelatëvet dhe graduatëvet të Kishës Katolike ishte në të gjithë drejtimet e vështirë.

-Shek.XII-XIV. Gjer në kohërat e Stefan Dushanit, arqipeshkvijtë e Tivarit, ipeshkvijtë e Ulqinit dhe të Kotorrit, rekomandoheshin sipas emërtimit të tyre... me anë një fraze të këtillë: "Birit tone shumë të dashur në Krisht, mbretit të Sërbisë, të famshmit". Vetëm me sundimin e Dushanit... ndodhi për herë të parë ndërprerja e këtyre marrëdhënieve të mira. (f.103)

Kemi këtu një cilësi që duhet vënë në dukje: Veprimtaria e klerit, sidomos e atij katolik, ka si përbërës të vetin edhe diplomacinë. Kështu do shpjeguar edhe mbijetesa e kishës sonë veriperendimore, katolike, në të gjithë shekujt e Mesjetës. Por nuk duhet të mendojmë që edhe klerikët tanë Jugut nuk kanë qenë po kaq diplomatë. Përndryshe nuk do të mund të mbërrinim deri në Epokën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

-1319. Me porosi të Selisë së Shenjtë Papnore, ipeshkvi i Krujës, Andreasi, ndez një kryengritje të të gjithë elementit arbër kundër skizmatikut famëkeq Uroshit II, që nga Diokleja e deri në Muzakie (Myzeqe). Ndikime e kësaj kryengritjeje do të ndjeheshin edhe në vitet '30 të të njëjtit shekull. (f.58)

Shikojmë këtu një ndryshim të madh midis vitit 1307 dhe 12 vjet më vonë. Pyetja shtrohet: Pse ndryshoi qëndrimi i Selisë së Shenjtë ndaj Sërbisë? A varej ai qëndrim prej individëvet që vinin në krye? Apo mos presioni i bazës së besimtarëvet arbër dhe klerikëvet të ulët bëri që Uroshi II të shikohej me sy më realist?

-1329-1332. Gati në të njëjtën kohë (22 vjet mbas arqipeshkvit prosërb Marin Zare, 10 vjet mbas kryengritjes të nxitur prej ipeshkvit Andreas, Gj.D.) në fronin arqipeshkvnor të Antibarit qëndronte i ulur një armik fanatik ndaj të gjithë skizmatikëvet. Ky ishte domenikani nga Franca e Jugut, Gijom Ade (Guillielmus Adae), një informues i Perendimit, i cili, kur po rrinte në Avinjon (1329-1332), shkroi për mbretin francez veprën e tij (1332) "Directorium ad passagium faciendum". (f.58-59)

Midis tjerash, Imz.Gijom Ade shkruan: "***Arbërit kanë një gjuhë fare të ndryshme nga latinishtja." "Arbërit përdorin në gjithë librat e tyre shkronjën latine***." Ade

shkruan edhe këtë: "(Në këto hapësira) ***rrojnë 2 popuj: arbërit dhe latinët. Latinët janë në 6 qytete: Tivar, Kotorr, Ulqin, Shas, Shkodër, Drisht. Jashtë murevet të këtyre janë arbërit***." Ade në fund thotë kështu: "***Të 2 këta popuj rrojnë të shtypur nën robërinë shumë të rëndë të sundimit të urryer e të neveritshëm të sllavëvet***." Asnjë nga këta informime shumë të qartë të këtij prelati, për ne, nga më të mëdhenjtë që janë ulur në fronin e Arqipeshkvisë së Tivarit, nuk ka nevojë për sqarime e komente. Pyetja që unë bëj në këta çaste, është kjo: Imz.Marin Zare, që ishte vendës, që ishte i të njëjtit gjak me ne, pse nuk ia çoi Evropës këta njoftime, por u desh të vijë një njeri nga Franca, të na shohë kush jemi, në ç'gjendje jemi e çfarë kërkojmë?! Dhe, fill pas kësaj, pyesim: A ishte Imz.Marin Zare një frikacak, apo ishte një interesaxhi i ulët?!

1347, 1361. Rreth kësaj kohe shfaqet përsëri edhe ipeshkvi i Lezhës, sufragan i Durrësit, dhe krahas radhëve të vazhdueshme të ipeshkvijvet të Shasit (Suacium), Shkodrës (Skodra), Ulqinit (Ulcinium), Drishtit (Drivastum), fillon edhe seria e ipeshkvijvet të Balecit (Balezo) (para vitit 1347), që ishte një qytet i vogël në afërsi të Shkodrës, dhe të atyre të Danjës (Dagnum) (para vitit 1361), që ishte një kështjellë (në juglindje të Shkodrës) (të gjitha) sufragane të Antibarit. (f.61-62)

Shohim kështu një përpjekje të arbërvet për t'u kompaktësuar edhe në pikëpamje kishtare. Kanë ndodhur kryengritjet, janë shtypur kryengritjet. Janë nxjerrë mësime. Përpjekjet për të mbijetuar janë në shkallën e një heroizmi permanent dhe tash, me sa duket, me vdekjen e Car Dushanit, ky popull po përgatitet për t'u pavarësuar. Në vitet 1360, rezultat i një qëndrese afër 200-vjeçare nën sërbët e Nemanjiqvet, ka për t'u krijuar këtu një principatë e arbërvet nën dinastinë e Balshëvet, principatë, të cilën prapë historiografia sllave po do ta quajë të vetën.

-1351. Në librat noterialë përmenden 24 priftërinj arbër shekullarë si rezidentë në Raguzë. (midis tyre edhe 2 tivaras.) (f.136)

Për ne ka rëndësi të marrim vesh edhe njëherë, se banorët e Tivarit, edhe në shek. XIV, konsideroheshin dhe ishin **ARBËR,** dhe se ata, si të tillë, përndiqeshin prej pushtetarëvet të car Dushanit.

-1351. Prelatët e ipeshkvivet veriperendimore, Tivar, Shkodër, Pult, Sardë (Antibari, Skodra, Polato, Sarda) regjistronin të ardhura mjaft të pakta në librat regjistrorë të Kuries (Antibari 80, Sarda 33, Polato 33 guldë flori). Megjithatë, ata i dorëzonin mbledhësit të së dhjetës papnore shuma të larta, për vete dhe për klerin e tyre. (f.116)

Konstatimi i parë, i domosdoshëm për t'u mbajtur parasysh prej cilitdo

historishkrues: **Tivari është pjesë e ipeshkvivet veriperendimore të Arbërisë.** Tivari s'është pjesë asnjë e njësie tjetë historiko-kulturore, sado që shtetet vijnë e shkojnë.

Konstatimi i dytë: Arbëria, kjo pjesë e Arbërisë që mezi kish mbetur **PERENDIMORE**, rripet, xhvatet nga Selia e Shenjtë, pra, nga **PERENDIMI**, i cili duhej t'i jepte e jo t'i merrte flori këtij vendi të robëruar. A s'kish ku merrte gjetkë flori Papati?!

-Shek.XIV, vitet 70. Në fronin arqipeshkvnor të Tivarit, qëndronte priori i dikurshëm i manastirit dominikan të Raguzës, që ishte sigurisht arbër... Ky arqipeshkëv mbajti lidhje me fisnikët e latrë arbro-veriperendimorë, me Balshajt e Zetës, me Dukagjinët e Lezhës, me zotrinjtë e Pultit dhe me familjen Suma (Summa) në bregun verior të Bunës. Ky arqipeshkëv bënte çfarë të donte në Arbërinë Veriperendimore. Emërimet papnorë që nuk i pëlqenin atij, nuk i merrte parasysh. (f.106)

Është fjala për Imz.Johanes IV (Gjoni IV) (1363-1373).

-1370. (Për shkak të veprimevet kokë më vete), Gjonit IV, arqipeshkëv i Tivarit, iu hoq titulli në korrik 1371 dhe, për dënim, u urdhërua të shkojë në Cezarea (Kajserie) të Palestinës... Administrimi i Arqidieqezës iu besua ipeshkvit të Drishtit dhe patricit të këtij qyteti Johan de Lepore (Johannes de Lepore).

Porse kjo gjë në praktikë nuk u zbatua, ngaqë arqipeshkvi i Tivarit e kundërshtoi urdhërin e papës. Qëndroi në Tivar dhe papa qe i detyruar t'u drejtohej drejtpërsëdrejti zotërinjvet të Zentës dhe, në vitin 1974, disa herë edhe Karl Topisë, me qëllim që t'ia hiqnin mbështetjen metropolitit të qortuar zyrtarisht... Më në fund, prelati i paskrupull qe detyruar të ikte nga Tivari. Në vitin 1388 e gjejmë atë në Regjo të Italisë së Sipërme; ai vdiq pas vitit 1393 në Raguzë. (f.108-109)

Thuhet "***i paskrupull***", por unë nuk e di sa i merituar ka qenë ky cilësim. Pse e mbështesnin fisnikët e vendit këtë prijës të Kishës?! Arqipeshkvi pasardhës është Johannes V (Gjoni V) (1373-1382).

-1374. (Papa Urbani V) në vitin 1373, përveç zhupanëvet të Zentës, i kërkon edhe Karl Topisë (në Durrës), që të ndihmojë arqipeshkvin e sapoemëruar të Tivarit. (f.103-104)

Nuk e di kush janë "***zhupanët e Zentës***", pasi për Balshët nuk thuhet që mbanin një titull të tillë. Titulli ***zhupan***, me sa di unë, i takon vetëm hierarkisë sërbe. Pra, cilët ishin këta "***zhupanë***", të cilëvet po u drejtohej papa Urbani V, për të përkrahur një arqipeshkëv katolik? E dyta, më 1385-n pat një luftë midis Balshajvet dhe Karl Topisë, ku u vra një nga sundimtarët më të suksesshëm dhe më me perspektivë të Arbërisë Mesjetare, Balsha II. Një pyetje lind vetëvetiu: Shkarkimi i Imz. Gjoni IV nga detyra, midis tjeravet, edhe me ndihmën e Karl Topisë, të kërkuarit e ndihmës, nga Karl Topia dhe nga "***zhupanët e Zentës***", për të përkrahur arqipeshkvin e ri, Imz.Gjonin V, armiqësia midis Karl Topisë dhe Balshëvet katolikë, që përfundon me vrasjen e Balshës II, madje me dorën e turqvet, mos kanë të gjitha këto farë lidhjeje?!

-1396. Në vitin 1396, pas luftës së përgjakshme midis Radiq Cërrnojeviqit dhe Gjergjit II Balshës, u riparuan pothuajse njëkohësisht kishat katedrale të Tivarit, të Ulqinit dhe abacia e Rotecit (Rtac). (f.134)

Janë 2 dinasti princërish arbër, nga të cilat, njëra ka marrë rrugën e sllavizimit, ndërsa tjetra qëndron ende në shtratin e vet arbëror, ndonëse edhe aty martesat me

gra sërbe e kanë bërë punën e vet. Katedralet, siç nënkuptohet, janë shkatërruar pikërisht nga ajo luftë vëllavrasëse.

-Shek.XIV e këndej. Në Tivar, krahas Katedrales së Shën Gjergjit, me varre të vjetër princash sërbë dhe me relike të kushtueshme shenjtorësh, me epitafe latinë të shkruar në heksametër apo në vargje leoninë, përmbi varre të abatëvet dhe të prelatëvet, përveç kishavet të manastirevet, përmenden edhe kishat e Shën Gjergjit, Shën Shtjefnit, Shën Pjetrit dhe më tej edhe kisha e Shën Markut jashtë murevet të qytetit, si dhe tri kisha fshati (ecclesie ruralis). (f.129)

Mua më tërheq vëmendjen shprehja "**varre të vjetër princash sërbë**". Sërbët, sidomos mbas vitit 1219, kanë qenë pravosllavë konsekuentë. Pra, nuk varroseshin në kisha katolike. Në Tivar nuk di të ketë pasur as kisha pravosllave, as ortodokse, të ritit grek. Në kishën e Shën Shirgjit, në Breg të Bunës, kanë qenë varrosur 3 a 4 dinastë Vojisllavleviq, por ajo ka ndodhur para vitit 1219, dhe prapë s'e di, ata dinastë, a ishin katolikë apo ortodoksë të ritit grek? Mos nuk është shprehur saktë M.fon Shuflai lidhur me varret në kështjellën e Tivarit? Apo mos ka konsultuar dokumente që nuk e bëjnë saktë informimin?

Sa u përket epitafevet në latinisht, ato janë vepërza letrare të arbërvet, ashtu siç është psh vepër letrare e arbërvet edhe Historia e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, ndonëse është shkruar në gjuhën latine. Epitafet e Tivarit, pra, i përkasin letërsisë shqiptare, si trashëguese e letërsisë arbërore. Letërsia arbërore dihet se është shkruar: greqisht (Kodikët e Beratit) latinisht (Rrrethimi i Shkodrës, relacionet e prelatëvet arbër dërguar papëvet) dhe arbërisht (Meshari i Gjon Buzukut, vepra e Pjetër Budit, vepra e Pjetër Bogdaniot, vepra e Fran Bardhit, vepra e Lekë Martrëngës etj. etj. etj).

Fati i mëtejshëm i kishavet, që i përmend Dr.M. fon Shuflai, është më shumë se i hidhur.

-Shek.XV. Për shkak të rrëzikut turk, portreti i Shën Mërisë u transportua nga Roteci dhe u deponua në katedralen e Shën Gjergjit në Tivar. Kjo ka ndodhur para vitit 1443. (f.152)

Përveç sllavëvet pravosllavë, tashmë një pushtues tjetër, pushtuesi osman, i dhunshëm dhe i prapambetshëm në të gjithë drejtimet, veçanërisht këtu ku **Renesansa Evropiane** kish lëshuar prej gati 2 shekujsh rrënjët dhe degët e veta shpirtushqyese dhe shpirtzbukuruese. Portreti i Shën Mërisë doemos do të ketë qenë një vepër me vlerë të madhe artistike, vepër e **Renesansës**, por a do të mund të shpëtonte ajo vepër edhe brenda në kështjellën e Tivarit?!

-1400. Ashtu si ai i Tivarit, edhe kapitoli i Drishtit ishte i ndarë në kolegje; në vitin 1400 përmenden këtu kanonikët e Shën Mërisë (canonisi de Sancta Maria) dhe kanonikët e Shën Gjergjit (canonisi de San Zorzi). Me sa duket, të gjithë këta banonin në një kanonikë të përbashkët (canonica). (f.119)

E mora këtë kumt, sepse kapitoli i Tivarit, asambleja priftërore e kishave të qytetit, ashtu si ai i Drishtit dhe i qytetevet të tjerë të Arbërisë Katolike, në shumë raste është subjekt ngjarjesh të rëndësishme lidhur me zgjedhjen e kryeprelatëvet apo miratimin e tyre. Por kjo do të ishte një temë tjetër shqyrtimi.

-1402. (Gjergj Basha II) përdor në vitin 1402 për (marrëdhëniet me Venedikun) edhe arqipeshkvin e Tivarit që kishte lindur në Ulqin dhe që vlerësohej në Venedik në mënyrë të shkëlqyeshme. (f.101)

Është fjala për Imz. Marinin II, arqipeshkëv për 24 vjet. Sigurisht që Balshët, deri sa ditën ta mbajnë veten pranë popullit të vet, do ta gjenin përkrahjen edhe te Arqipeshkvia e Tivarit, aq më tepër kur arqipeshkvi ishte vendës. Por kjo nuk do të zgjatë shumë, sepse Jelenë Balsha, lindur Llazareviq, do ta bëjë përshesh krejt vendin, duke e kthyer edhe djalin e vet Balshën III te kisha pravosllave.

-1402. Minoritët (françeskanë) të Arbërisë u ndanë nga Raguza... në vitin 1402, duke formuar kështu një njësi separate (Custodia Duracensis), me Drishtin, Shkodrën, Ulqinin dhe Tivarin. (f.158)

Sado që presioni i ortodoksisë greke ka qenë shumëshekullor, shihet që as në Durrës katolicizmi, dmth lidhja edhe fetare me Perendimin, nuk është shuar. Përkundrazi, në këtë fillim të Shekullit Skënderbejan, ai, pra Durrësi, bëhet qendër

e rendit shumë të rëndësishëm të rregulltarëvet françeskanë, madje duke e përfshirë edhe Tivarin në të njëjtën kustodi.

-1402, 1474. Marini II, arqipeshkvi i Tivarit, i cili në vitin 1402 po qëndronte në Venedik si i dërguar i Gjergjit II Balsha, qe i detyruar nga nevoja, që, me lejen e Republikës, të mblidhte ndihma të vogla në truallin venecian "sepse të ardhurat e tija ishin shuar krejtësisht për shkak të pushtimit turk"; ky kishte qenë po i njëjti prelat, që, në vitin 1397, kishte dërguar në Romë 2 thasë me saraga të thata (gjuhca, sërb. ukljve), specialitet i Liqenit të Shkodrës.

Në 5 vjet gjithë kjo rënie.

-1421-1442. Në hapësirën kohore 1421-1442, 4 priftërinj nga Tivari ishin kancelarë në Medena. (f.137)

Kancelarë arbër nga Tivari gjejmë edhe në Split. Janë dëshmi shumë domethënëse, që tregojnë se viset tanë të Arbërisë ishin ngjitur tashmë në një shkallë të lartë të kulturës.

Fenomenin, të thuash botëror, të **Qëndresës Skënderbejane**, unë nuk e shpjegoj ndryshe, veçse me impaktin çudibërës të **Renesansës**. S'ka dyshim që Arbëria dhe arbërit kanë qenë pjesë e djepit të **Rilindjes Evropiane**, bashkë me krejt pellgun e adriatik-Jonit.

-1421, 1438, 1463. Për shkak të pasurisë së manastirit (të Ratëzit, Gj.D.) shpeshherë priftërinj shekullarë, të cilët ishin madje të lindur nga prindër ortodoksë, hynin në urdhër dhe përpiqeshin të bëheshin abatë; por edhe te Kuria papnore abacia e Rotecit ishte e njohur mirë dhe, njerëz të fuqishëm, si psh kardinali Jordan de Ursinis (1421), luftonin për të fituar komendën e tij. Disa komendatarë ditën të ishin këmbëngulës, me qëllim që manastiri, gjatë kohës së tyre, të ishte i çliruar nga jurisdikcioni i arqipeshkvit të Tivarit dhe të ishte drejtpërdrejtë nën fronin papnor. Në kohërat e Skënderbeut dallohej psh komendatari i atëhershëm Gjergj Pelini (1438-1463), i cili, si

mik i venedikasvet dhe i Skënderbeut, në luftërat kundër turqvet sakrifikoi shumë. (f.153)

Nuk them që Manastiri i Ratëzit ka rëndësinë e një arqipeshkvie, por me një ipeshkvi ai mund të krhasohet. Së bashku me Arqipeshkvinë e Tivarit, ai manastir ka një meritë të pazëvendësueshme në krejt historinë mesjetare e Arbërisë, si pasojë edhe të Shqipërisë, si trashëguese e Arbërisë. Mjafton të njihet vetëm kontributi i Gjergj Pelinit, **anamalasit** të pavdekshëm, në shërbim të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Nuk gaboj nëse them që Gjergj Pelini, për nga rëndësia dhe rezultatet e punëvet të tija, mund të barazohet me arqipeshkvin e Durrësit Pal Engjëlli.

Në vitin 1474, të ardhurat e këtij altari arqipeshkvnor ishin aq të vogla, kështu që gjatë kohës kur qe arqipeshkëv Stefani II, për t'ia bërë atij jetën të durueshme, Kuria bashkoi me këtë Arqipeshkvi ipeshkvinë vakante, me sa duket akoma rentable, të Drishtit. Kjo është periudha e tkurrjes së ipeshkvivet, periudhë për të cilën u bë fjalë edhe më sipër. (f.118)

[Shek.XIV, gjysma e dytë. Në gjysmën e dytë të shek.XIV, gjendja e dioqezavet katolike kishte arritur kulmin e saj, me ipeshkvitë në Ulqin, Shkodër, Shas, Sardë, Sapë, Danjë, Balec, Drisht, Pult, Prizren, Arbën, të gjitha nën metropolitin e Tivarit (Antibari)... Duke luftuar kundër ortodoksisë, Roma, në të vërtetë, e kishte shndërruar zemrën e Arbërisë Mesjetare në një kështjellë kundër Islamit. (f.63-64)

Do të ish ndoshta më e saktë të thuhej: Arbërit e kishin shfrytëzuar antiortodoksizmin e Romës për t'u përballur me sllavët dhe me grekët dhe tash do të përballeshin edhe me një pushtues të tretë, në një qëndresë edhe më heroike, nën Gjergj Kastriotin Skënderbeun.**]**

-1467. Si pasojë e të ardhuravet minimale të Arqipeshkvisë së Tivarit, në vitin 1467 iu dha për administrim po këtij arqipeshkvi dioqeza e Shasit, rezidenca e së cilës ishte kthyer në rrënojë që në fillim të shek.XV, ipeshkvijtë e së cilës jetonin më tepër në Itali.

-1474. Iu dha në përdorim edhe Drishti, si rrjedhojë, ky vendim i Kuries nga ana e pushtetit lokal hasi në rezistencë të ashpër.

-1476. Kundër (dhënies për administrim të Drishtit) u përpoq Rep.e Venedikut dhe më 28 qershor 1476, Senati vendosi që të sekuestrojë të ardhurat e Arqipeshkvit të Antibarit për aq kohë sa ky i fundit të mos heqë dorë nga ipeshkvia e Drishtit.

- Shek.XV. Bashkësitë katolike që ishin nën administrimin e Arqipeshkvit të Antibarit, por që ishin shpërndarë nga sërbët ortodoksë, humbën shumë shpejt çdo lidhje me prijësin e tyre kishtar. (f.66-67)

Të gjithë këta fragmente tregojnë përpëlitjet e **Shpirtit të Arbërit**, tashmë të shtrirë për tokë. Lufta 25-vjeçare kundër Turkut ishte bërë. Gjergj Kastrioti Skënderbeu kishte vdekur. Mijëra arbër po iknin për në Itali. Varret e heronjvet dhe shenjtorët që i kishin mbrojtur, po mbeteshin në mëshirën e pushtuesit. Kishat arbërore, si ato ortodokse, por antigreke dhe antisllave, ashtu edhe ato katolike, përjetësisht arbërore, do të rrënoheshin, 5 sot e 5 nesër, Gjergj Pelini, anamalasi, abati i Ratëzit, përkrahësi i madh i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, kishte vdekur. Evropa do të fillonte ta shikonte dhe ta kuptonte madhështinë e këtij **Shpirti Arbëror**, vetëm në shek.XVI, kur një prift i Shkodrës, Marin Barleti, do të shkruante për të. Ndërkaq, Arqipeshkvia e Tivarit mundohej ta mbante veten me shpirt ndër dhëmbë, duke pasur kundër vetes herë-herë edhe Venedikun.

***

Po në këtë shekull, kemi edhe një fenomen tjetër kishtaro-nacional, për të cilin na flet Dr.Millan fon Shuflai. Është **Arqipeshkvia** vetanake **e Kranjës**, të cilën unë e gjej si një ndër tendencat **UNIATISTE** të arbërvet, në përpjekje për të shkuar andej nga i kish orientuar dikur Justiniani i Madh, sado që riti tashmë ishte lindor e jo perendimor. Këtë dukuri e hasim shumë herë në truallin e Arbërisë, por më së miri e shikojmë te arbëreshët e Kalabrisë dhe të Sicilisë, atje ku ata, më në fund, ishin të çliruar prej mallkimit përçarës të vitit 1054.

-Shek.XV.1452-1495. Rezidenca e (Arqipeshkvit të Kranjës) duhet kërkuar në Kranjë (Kraina), në Makarska, në Arbëri dhe,

për kompetencën e këtij arqipeshkvi dihet vetëm kaq, që ai nuk kishte kisha sufragane. (f.69)

Nuk e di pse na ka çuar studiuesi i nderuar deri edhe në Makarskë të Kroacisë. Atje ekziston një komunë me emrin Shestanovac, por s'po mund ta kuptoj ç'lidhje mund të kish parë M. fon Shuflai midis kësaj Arqipeshkvie dhe asaj krahine aq të largët.

-Shek.XV.1452-1495. Seria e mitropolitëvet (të Arqipeshkvisë së Kranjës) përbëhej vetëm nga 6 burra, 2 nga të cilët, 1 arbër dhe 1 kroat, e meritojnë një vend në historinë e Botës. (f.69)

- ["Arqipeshkvi i Kranjës" (Archiepiscopus Crainensis)]... një krijim kishtar ekzotik i shek.XV në zonën ortodokse të depërtimit, krijim ky që u shkaktoi dhimbje koke shumë historiografëve të vjetër kishtarë, që edhe në kohërat e reja për vetë Kurien mbeti plotësisht enigmatik... Mitropolit që përmendet në akte ndërmjet vitevet 1452-1495, pra në kohën e presionit më të madh shkaktuar nga turqit. (f.69)

Sigurisht që as këtë herë nuk do të mund të hiqet dhimbja e kokës, por mendimin e vet ka për detyrë ta shfaqë secili historishkrues, që i bie të merret midis tjeravet, edhe me këtë kapitull.

Në trevën e **MËRKÒTIT**, që ndodhet në pjesën perendimore të vargmalit që ndan Kranjën nga deti, që së lashti ka jetuar një fis sllav. Me sa duket, aty ka pasë ardhur dikur një **MARKO**, pra, ka qenë një sllav i krishterë, është shtuar, dhe arbërit, vendbanimin e pasardhësvet të tij e kanë quajtur, në trajtë të shquar, **MÀRKOT**. "***Aty ku rrinë MÀRKOT***" etj. Dikur, sepse koha e përdorimit është e gjatë, edhe ligjet e gjuhës arbërishte, si të çdo gjuhe të gjallë, kanë vepruar, në këtë rast, në mënyrë të atillë që theksi i atij tashmë emërvendi është zhvendosur nga A-ja te O-ja. Zanorja A, duke mbetur pa theks, është rrëgjuar në Ë dhe sot ne asaj treve i themi: ***MËRKÒT,-I***. E thashë këtë, për të dëshmuar që, ajo familje sllave, më vonë, ai fis sllav, ka jetuar në të gjitha kohët në fqinjësi me arbërishtfolësit, pra, me arbërit. Në sllavisht, **MËRKÒTIT** i kanë thënë: ***MARKOVIQI*** ose ***MËRKOJEVIQI***.

Në krahun tjetër të vargmalit të Rumisë, në anë të Liqenit të Shkodrës, gjendet fshati i sotëm ***SKJE,-JA***. Në një shqiptim më të hershëm E-ja artikulohet si zanore midis A-së dhe E-së: ***SKJÆ,-JA***. Nëpër dokumente, ky emër fshati gjendet me formën ***SKLAVUS*** (***Sclavus***). Kjo na e çon mendimin, se edhe aty ka pasur dikur një familje apo një enklavëz sllave. Banorët e atij fshati mund edhe të jenë ndërruar, por emri ka mbetur. Edhe gojëdhënat apo të dhënat e fillimit të shekullit XI mbi jetën e Shën Gjon Vladimirit, çojnë te mendimi se aty mund të ketë pasur ndonjë enklavëz të sllavëvet. Është shumë e kuptueshme që, gjatë sundimit gati 2-shekullor të dinastisë sërbe të Nemanjiqëvet, aty të jetë ushtruar presion për sllavizimin edhe të pjesës tjetër të popullsisë, sidomos me anë të murgjvet pravosllavë, apo edhe grekë, që biheshin herëpas'here në ishujt e Liqenit. Të tillë presione ka pasur edhe në brigjet e Shestanit, pjesës së epërme të Kranjës, ose, siç quhet ndryshe, Kranjës së Sipërme. Këtë e dëshmojnë fshatrat Selcë, Krricë, Pecanj, por edhe gjurmët e 2 a 3 kishave pravosllave në Pinçanj e në Ljare. Ka aty-këtu ndonjë pohim që krejt banorët e Kranjës kanë qenë sllavë dhe që janë shqiptarizuar. Por kjo nuk mund të jetë e vërtetë, sepse, po të ish ashtu, ata do ta kishin ruajtur të folurit, siç e kanë ruajtur mërkotasit fqinjë. Kranjanët, përfshirë aty edhe shestanasit, kanë qenë gjithë jetën, në vazhdimësi shumëshekullore, iliro-arbro-shqiptarë, me gjithë migrimet që mund të kenë ndodhur dhe që janë krejt të natyrshëm.

-1417. (Sipas Ivo Jovoviqit, autorit të librit "*Nga e kaluara e Arqipeshkvisë Dokleato-tivarase*", më 1417-n, në Kranjë gjendej, e vendosur ndoshta qysh më parë, selia e Mitropolitit të Kishës Pravosllave, prurë aty prej vendit që quhet Prevllakë, në Grykat e Kotorrit, ku ajo Mitropoli kish qëndruar qysh me themelimin e Kishës Pravosllave Sërbe, në vitin 1219.) (Krs. Ivo Jovoviq, f.111)

Këtë zhvendosje, thotë z.I.Jovoviq, e ka kryer Balsha III, për të cilin ne e dimë që ka qenë një prosërb i pandreqshëm dhe prandaj arbërit e principatës së tij nuk e kanë dashur. Unë e besoj një pohim të tillë, sepse pikërisht në ata vite para vdekjes (1421), Balsha III, i konvertuar në pravosllav, ka vepruar me forca të armatosura rreth Liqenit të Shkodrës, në përpjekje për t'u konsoliduar në ato hapësira. Ka shfrytëzuar, sigurisht, edhe legjendën e Shën Gjon Vladimirit, edhe famën e Kishës

së Shënmërisë, edhe përkrahjen me të dyja duart nga ana e mërkotasvet përtej malit. Por unë mendoj se aty janë shfrytëzuar edhe disa rrethana jo fort të favorshme për arbërit në vetë kupolën e Arqipeshkvisë së Tivarit.

Mitropolia Pravosllave ishte në hall. Ajo nuk kish mundur të mbizotërojë, në atë ambient arbërish katolikë, edhe kur aty e kishin pasur pushtetin Nemanjiqtë, të fuqishëm, por edhe të njohur për mizotitë ndaj arbërvet katolikë. Tani, ajo mitropoli pravosllave, do të përpiqej të shfrytëzonte çdo mundësi, për t'u kapur pas saj, si i mbyturi pas kashtës dhe, duhet thënë që, më në fund, ka për t'ia arritur, jo falë Balshëvet, por falë një tjetër familjeje arbërore, Zezë-Cërrnojeviqvet. Zezë-Cërrnojeviqtë do ta strehojnë fillimisht Mitropolinë Pravosllave Sërbe në ishullin Kom, përtej Liqenit, pastaj do ta çojnë në Rijeka Cërrnojeviqa dhe, përfundimisht, do ta vendosin, duke i dhënë prona të shumta, në Fushën e vogël të Cetinjës. Prej asaj Fushe të Cetinjës, ajo Mitropoli Pravosllave Sërbe, do të arrijë, në fund të shekullit XV e këndej, të krijojë një komb të ri sllav në viset e Ballkanit, **KOMBIN MALAZIAS**.

Kranjanët, ndërkaq, do të përpiqen ta kapërcejnë provokimin e radhës të sllavëvet dhe këtë ata do ta arrijnë duke e kthyer selinë e përkohshme të Mitropolisë Pravosllave Sërbe në Mitropoli Uniate Arbërore. Meritë të posaçme për këtë ka i madhi Arqipeshkëv Uniat i Kranjës, Imz.Pal Dushmani. Por, të shohim ç'na thotë për këtë Arqipeshkvi, dijetari i shquar Millan fon Shuflai.

-1439- Çdo vit në Ditën e Rrëshajëvet, qoftë myslimanët, qoftë të krishterët, ortodoksë apo katolikë, bëjnë pelegrinazh në Malin e Rumisë (1595 m i lartë), duke mbajtur një kryq. Ata ngrihen herët në mëngjes, pa lindur dielli, me qëllim që rrezet e tij ta gjejnë rreshtin e pelegrinëvet në majë, para së cilës hapet një pamje gjigante përrreth, ku mund të shihen: Liqeni i Shkodrës, malësitë e Malit të Zi dhe të Shqipërisë së Veriut, si dhe zona bregdetare midis Kotorrit dhe Durrësit. Ishte, pa dyshim, i njëjti shkëlqim, i cili, i kondensuar akoma edhe sot në Kryqin e Kranjës, realizon një dukuri të tillë që nuk i gjendet shoqja kund tjetër, që është në gjendje të fshijë për një çast diferencat tepër të mëdha të 3 religjioneve dhe që në atë kohë (1439), në lidhje me

bisedimet tepër seriozë të atëhershëm, që u bënë për bashkim, krijoi edhe Arqipeshkvinë e Kranjës. (f.71-72)

Ky është gjykimi i M. fon Shuflait. Ai, si një nga arsyet pse u krijua Arqipeshkvia e Kranjës, sheh edhe aftësinë e banorëvet të këtyre anëve për t'i fshirë, të paktën për një çast, dallimet në pikëpamje fetare. Por M.fon Shuflai nuk vë re këtu që merita për këtë "***fshirje dallimesh***" u takon arbërvet, sot shqiptarëvet, e jo sllavëvet.

Krijimi i Arqipeshkvisë së Kranjës ka qenë një veprim **ME HILE** i pjesës **PRAVOSLLAVE**.

Jo: **ORTODOKSE**, sepse kish edhe arbër ortodoksë. Psh në Pecanj, në Selcë, në Kranjë të Poshtme, por edhe familja e **PERANËVET** nga Mikuliqi, së cilës i qe besuar ruajtja e Kryqit të Shën Gjon Vladimirit. Prapashtesën **–OV-VIQ**, që ka krijuar formën e ndajemrit **PERANOVIQ**, ajo familje e ka marrë nën presionin e pravosllavëvet.

Të përmendurit e vitit 1439 nuk do të thotë që ajo Arqipeshkvi është krijuar në atë vit. Në ata vite ka pasur një klimë tolerimi, sidomos nga ana e Venedikut, ndaj enklavëzave pravosllave rreth Liqenit të Shkodrës, me qëllim për t'ua kundërvënë ata pravosllavëvet që mbroheshin nga Gjurashanjt (Zezë-Cërrnojeviqtë). Ishte kjo, si përherë, shprehje e politikës miope, qorre, për interesa çasti, e Republikës së Shën Markut.

-1446. Para vitit 1446 njëfarë Teodosius, me sa duket igumen i Manastirit të Kranjës, u ngrit me titull si arqipeshkëv i atyshëm... Fakti që ky manastir i famshëm përfitoi një arqipeshkëv, nuk ra në sy, pasi, gati të gjitha rezidencat e peshkopëvet ortodoksë ishin nëpër manastire, madje edhe vetë kryepeshkopi (sërb) i Zhicës. (f.73)

Ky është gjykimi i zotit M. fon Shuflai, por në terren situata do të ketë qenë ndryshe. Kranjanët nuk e kanë duruar aty një Arqipeshkvi **PRAVOSLLAVE**. Ata kanë kërkuar mënyra për ta rregulluar statusin e tyre dhe janë përpjekur të gjejnë njerëzit për t'i kryer këto punë.

-1453. Teodosi u shkarkua shpejt nga titulli i Arqipeshkvit, ngaqë, pa dyshim, ai nuk ishte i besueshëm për katolikët. (Duhej thënë: për ortodoksët arbër. Gj.D.) në vend të tij erdhi (1453) (një farë) Sabbas, ipeshkvi i Termopilevet. Vetë emri i këtij prelati (Sabbas) (Sveti Sava quhej edhe themeluesi i Kishës Autoqefale Sërbe) tregon për maturinë e madhe që përdori këtu Kuria. (f.73-74)

Unë nuk mendoj që ka qenë ndonjë maturi. Është mosnjohja nga ana e Kuries e problemevet realë të këtij vendi ose mosdashja për të na njohur.

-1454. Si Arqipeshkëv i tretë i Kranjës paraqitet në vitin 1454 një burrë me talent të shkëlqyeshëm dhe me ambicie të madhe. Pa dyshim ky ishte një arbër ... , nga fisi fisnik i Dushmanëvet të Pultit.

Në vitin 1440, kur ishte akoma famullitar i Kishës Augustine në Trevezo të Venedikut, Pali u bë ipeshkëv i Shasit, pastaj në vitin 1446 u emërua ipeshkëv i Drishtit. (f.74)

Ky do të ketë qenë njeriu i duhur që e kanë gjetur kranjanët për t'i përfaqësuar ashtu si duhej para Selisë së Shenjtë. Por unë nuk mendoj që ky ka qenë i treti. Balsha III, i manipuluar nga e ëma, Jelena Balsha-Llazareviq, do të ketë prurë aty, nga Prevllaka, peshkopë të tjerë pravosllavë para Teodosit. Kjo, doemos, kërkon hulumtime.

-1452-1454. (Me titullin e ipeshkvit të Drishtit, Pal Dushmani) qëndroi deri në vitin 1452, pra pikërisht në kohën e shfronësimit të Arqipeshkvit (Teodos) të Kranjë. Në korrik të këtij viti dërgohet nga Papa si ambasador i tiji në Arbëri, për të qetësuar armiqësinë ndërmjet Skënderbeut dhe familjes Dukagjini... 2 vjet më vonë (1454) ai emërohet si Arqipeshkëv i Kranjës, por krahas kësaj Arqipeshkvie, ai merr edhe administrimin e dioqezës së Drishtit. (f.75)

-1456. Tek Papa, tek i cili e kishte punën mjaft mirë, (Imz.Pal Dushmani) ndikoi sidomos për lirimin e dioqezës së Drishtit nga

varësia e arqipeshkvit të Tivarit, duke e vënë atë drejtpërdrejtë në varësi të Papatit, dhe kjo gjë i solli atij pa dyshim armiqësinë e arqipeshkvit të atëhershëm të Tivarit, i cili duhet ta ketë konsideruar në atë kohë arqipeshkvin ambicioz të Kranjës si një rival të rrëzikshëm. (f.75)

Në ata vite në fronin arqipeshkvnor të Tivarit qëndronte Imz.Andrea II OFM. Por principatën e Zentës në atë kohë e ka sunduar Stefan Zezë-Cërrnojeviqi, dhëndër i Gjon Kastriotit dhe kunat i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, por përkrahës i Kishës Pravosllave. Kur në fronin e Arqipeshkvisë së Kranjës ka ardhur Imz.Pal Dushmani, Stefan Zezë-Cërrnojeviqi ka protestuar te Papa, duke kërkuar që aty të vendosen jo arbër, por sllavë. (Krs:I.Jovoviq, f.114) Nuk do harruar fakti që vetë Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte një uniat. Ai, kur është martuar, ka vënë kurorë në Manastirin ortodoks të Ardencies.

1456-1457. Kundër Palit u dërgua në Romë një rrebesh i madh denoncimesh, që ai gjoja i jepka besimit grek favorizim, që ai paska predikuar që vetë Froni Papnor Roman i mbron rusët dhe grekët, që gjoja shkishëronte katolikët dhe që mbante para vetes një kryq dhe i binte gjoksit me grusht se paska pushtet papnor. (Papa kish urdhëruar hetimet, por Imz.Pal Dushmani vdiq më 1457). (f.75)

Që Arqipeshkvi Pal Dushmani ka qenë një njeri i zoti dhe edhe kokëshkretë, kjo pak a shumë duket nga angazhimi i tij dhe nga veprat që ka kryer. Por që, nga ana tjetër, ka pasë punë me njerëz të këqinj dhe shpifës, edhe kjo shihet. Pranimi dhe praktikimi nga ana e tij e ritit lindor, I është marrë si përkrahje ndaj grekëvet. Insinuatat ndaj njerëzvet të kupolës në Romë, se ata vetë mbronin rusët dhe grekët, ai doemos mund t'i mbështeste edhe në fakte. M.Shuflai thotë:

-Nuk është aspak e vështirë të supozohet që të gjitha këto akuza kundër Arqipeshkvit të Kranjës e kishin një bazë të vërtetë. Si ipeshkëv i Drishtit, i bërë i pavarur nga mitropoliti i tij, duke qenë edhe Arqipeshkëv i Kranjës, ai donte të rriste autoritetin e vet, të ishte i barabartë me Arqipeshkvin e Tivarit dhe të shtinte madje në dorë edhe titullin e Primatit të Sërbisë, titull ky që

tashmë po krijohej. Kjo dhe imitimi i zakonit shumë të vjetër i mbajtjes së kryqit përpara, që e bënte (vetëm) Arqipeshkvi i Tivarit, ishin krimet e tij. (f.76)

Por M.Shuflai thotë edhe këtë:

-Ai, i vendosur në një ambient ortodoks, duke luftuar edhe kundër turqvet, mund ta zhvillonte misionin e tij me sukses të plotë – ashtu siç e bëri në të vërtetë – vetëm nëse nuk dilte tepër haptazi kundër ortodoksëvet. (f.76)

Kjo që thotë studiuesi M.fon Shuflai, unë mendoj se duhet kuptuar kështu: Kisha Pravosllave Sërbe po e sfidonte, madje vetë Stefan Zezë-Cërrnojeviqi lëshonte akuza ndaj tij, ai s'kish si thoshte ndryshe, veçse: "***Ja, edhe ne ritin ortodoks po praktikojmë!***" Sa i përket titullit Primat i Sërbisë, kur është fjala për një person si Pal Dushmani, ai mund të ketë gjykuar edhe kështu: "***Më mirë t'i kem unë ata nën vete, se sa të më kenë ata mua nën vete.***"

-1480. Pas 20 vjetësh sedisvakancë (pa titullar), iu dëgjua përsëri zëri një Arqipeshkvi të Kranjës, dhe këtë herë për të foli e gjithë Evropa. Si njeri i besuar i perandorit roman, Arqipeshkvi Andreas, që ishte kroat nga fisi shumë fisnik i Jamometiqvet, bëri në vitin 1480 marrëveshje të rëndësishme me Papën Sikstus IV. Ky domenikan (Andreasi) ishte gjenial, një folës dhe agjitator i parezistueshëm dhe trim aventurier. Ai, në luftë të shumëfisht kundër Papës, e bëri të famshme Arqipeshkvinë e tij, por vetes i solli fatkeqësi. Agjitacioni i tij për vazhdimin e Koncilit gjoja të pandërprerë të Bazelit, i siguroi një vend nderi në radhët e revolucionarëvet të Kishës Romane... I hequr nga posti i Arqipeshkvit, vdiq (rreth vitit 1483) në burgun e Bazelit. Menjëherë pas tij u shua, nga sundimi turk (1480), edhe Arqipeshkvia e Kranjës, e cila tashmë ishte bërë titullare. (f.77)

Në vitin 1479 është pushtuar Shkodra prej turqvet osmanë. Bashkë me Shkodrën, janë vënë nën sundimin e Perandorisë Osmane edhe trevat tona në bregliqenin veriperendimor, ndërsa Tivari e Ulqini do të rrinë edhe gati 100 vjet të rrethuar. Por, ajo që thotë M. fon Shuflai që Arqipeshkvia e Kranjës "***u shua nga sundimi***

turk", do kuptuar, që nuk vazhdoi më si institucion e jo që popullsia jonë aty u islamizua. Islamizimi do të bëhet aty shumë më vonë.

Lidhur me arqipeshkvin Andreas, s'kemi ç'themi më shumë se ç'ka thënë Dr.M. fon Shuflai, por mua më duket që ai arqipeshkëv, duke u marrë me **doktrinat e fesë së krishterë**, për vetë kranjanët, përveç emrit që ia ka përhapur nëpër Evropë, s'do të ketë bërë ndonjë punë tjetër të dukshme.

-Shek.XV, fundi. Kështu u përfundua depërtimi i madh në sferën katolike, fare pak kohë para pushtimit turk dhe, nga pjesa ortodokse e Zentës, e cila dikur kishte qenë e lidhur ngushtë me Arbërinë, qoftë etnikisht, qoftë historikisht, nën Cërrnojeviqtë krijohet shumë shpejt një Mal i Zi (Montenegro) i pastër sllav. (f.91)

Do të ish më saktë të thuhej, bazuar në krejt çka u lexua në këtë libër të këtij dijetari nga më skrupulozët, **martir i albanologjisë**, se, prej pjesës ortodokse të Zentës, u krijua një Mal i Zi, jo "***I PASTËR SLLAV***", por: një Mal i Zi me shumicën **ARBËR TË SLLAVIZUAR**.

SHËNIM PËRMBYLLËS: Nuk e di sa do të kem kontribuar deri këtu për historinë e Tivarit, por jam i vetëdijshëm dhe i bindur që kjo histori **DUHET TË SHKRUHET**. I takon historiografisë shqiptare ta kryejë këtë punë, duke u munduar, sa të jetë e mundur më shumë, të jetë **OBJEKTIVE**.

"***E se për fat në kesh kun ëmbë ëndonjë vend fëjyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë ëndë e mirë***." (**Dom Gjon Bdek Buzuku**)

Gjokë Dabaj - Durrës, gusht 2013

2

REFERENCAT, te Prof.Dr.Petrikë Thëngjilli:

"*Shqiptarët midis Lindjes dhe Perendimit*"

Prof.dr. PETRIKA THËNGJILLI

SHQIPTARËT MIDIS LINDJES DHE PERENDIMIT

(1506-1839)

TIRANË, 2002

SHËNIM SQARUES: Citimet, si edhe te pjesa 1 e këtij libri, ku i jam referuar Dr.Millan fon Shuflajt, do të bëhen me…(**Bodoni MT blek**). Shënimet dhe komentet e mi, Gj.D., do të jenë në Tajms Nju Roman (Times New Roman).

Emërvendi ***Shqipëri*** dhe etnonimi ***shqiptar***, deri në shek.XVIII, do të thuhen: ***Arbëri*** dhe ***arbër***. Do të ketë edhe ndonjë ndryshim të vogël, me karakter gjuhësor, por e gjithë kjo, besoj unë, nuk përbën shkelje të paarsyetueshme në punën e të cituarit. Sidoqoftë, është e udhës t'i kërkoj ndjesë autorit, të cilit i jam referuar dhe i cili, me këtë libër, i ka dhënë një ndihmesë të madhe historiografisë shqiptare.

LINDJA DHE PËRHAPJA E KRISHTËRIMIT

"**Shën Pali apostull dhe shokët e tij, zbritën në Apolloni e për t'u shpërndarë në Ilirik, Epir e Maqedoni." (f.13)**

Lidhur me këtë pohim shumë të rëndësishëm, në historiografinë e iliro-arbro-shqiptarëvet, duhet konstatuar dhe korrigjuar, se **Krishtërimi** në etninë tonë **nuk ka ardhur si fe e pushtuesit**, siç është pohuar në shumë raste, por ka ardhur si fe që e kundërshtonte pushtetin njeriskllavërues dhe popujskllavërues të romakëvet. Prandaj dhe janë persekutuar për 300 vjet të krishterët anembanë asaj perandorie.

Teza bazë e krishtërimit, e monoteizmit, ishte: ***Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara Zotit.*** Kjo nuk ish një gjë pakët. Si skllevërit, si skllavopronarët, kur do të

gjykoheshin, nuk do të shihej cilës klasë i kanë përkitur, por cilët kanë qenë mëkatet e tyre. Kur izraelitët i thanë Jezusit: ***Ti je Mbreti ynë***!, ai u tha: ***Unë jam Biri i Zotit, unë jam Mbreti të gjithëvet***. Kjo do të thoshte që edhe popujt ishin të njëjtë përpara Zotit. Në historinë e Njerëzimit, pa dyshim që lindja e Krishtërimit përbën një revolucion, ashtu siç përbën revolucion edhe të rrëmbyerit e zjarrit zotavet nga ana e Prometeut.

-484-519. (PREBALITANA**) Me papën vazhduan lidhjet peshkopët e Dardanisë, të Prevalit, të Splitit të Vjetër e të Nikopojës, kurse Durrësi mbajti qëndrim pro Konstantinopojës. (13)**

Në vend të formës ***Preval***, unë, tash e tutje, do të përdor formën: ***Prebalitanë***, sepse kjo formë është më e afërt me rrënjë ***baltë***, që është pjesë fjalëformuese e këtij emërvendi.

Vitet 484-519 përkojnë me kohën kur ilirët, të cilët Vija e Teodosit i kish ndarë në 2 pjesë, në pikëpamje administrative, po përpiqeshin për ta korrigjuar atë ndarje, duke e përfshirë krejt Ilirinë në të quajturën Perandori romake Lindore, kurse, në pikëpamje kishtare, në një kohë kur grekët po donin të ndaheshin prej Romës, ilirët po përpiqeshin për të mbetur me Romën, me Selinë e Shenjtë në Romë. Këto 2 përpjekje ilirët do t'i shfaqnin me forcë shumë të madhe pak më vonë, nën sundimin e perandorit të vet, Justinianit të Madh. Justiniani i Madh do të krijonte kishën e Ilirikut Lindor, Justiniana Primën, dhe atëherë, jo vetëm ipeshkvia e Durrësit, por të gjitha ipeshkvitë e Ilirisë, deri në vitin 732, do të mbanin Papatin si qendër të vetën kishtare. Prebalitana, me qendrën e vet në Tivar, sado e copëtuar dhe e martirizuar, do të qëndronte gjithë jetën me Papatin dhe kjo nuk ka qenë thjeshtë një kërkesë fetare.

RUAJTJA E KRISHTËRIMIT PERENDIMOR NË ARBËRINË VERIPERENDIMORE

-Shek.X-XI. Nga fundi i shek.X, në viset e Malit të Zi të sotmit, u formua shteti i Dioklesë, nën drejtimin e Gjon Vladimirit. Princi Stefan Vojislavi zgjëroi shtetin e vet në tokat e Arbërisë Veriperendimore duke marrë Shkodrën dhe Tivarin. Kufiri jugor i shtetit arriti deri në lumin Drin. Djemtë e Stefan Vojislavit e shtrinë shtetin në jug deri në lumin e Vjosës, kurse në lindje deri

në Prizren e në Shkup. Me fjalë të tjera, ... kemi një zgjërim të ndikimit të ortodoksizmit tek arbërit, por përsëri, me veprimet që kreu më vonë (i biri i Vojisllavit, Gj.D.**), i eliminoi ata rezultate. Për të siguruar pavarësinë, sundimtari i Dioklesë Mihali, u lidh me papa Grigorin VII (1077). Papa i dërgoi atij kurorën mbretërore. (f.331)**

1.Knez Vlladimiri nuk besoj të ketë krijuar ndonjë shtet, pasi ai nuk kish nën sundim asnjë qytet dhe rezidencën e vet e kish në një ambient rural, ku edhe uji i pijshëm sigurohej me ubla. 2.Populllsia e vendevet, ku u krijua shteti i Diokle-Zentës, nuk ka qenë sllave. Ajo ka qenë iliro-arbërore, kurse sllavë ka pasur fare pak, të vendosur nëpër enklavëzat e tyre, të quajtura skllavini e më vonë zhupa. 3.Dinastia e Vojisllavleviqvet është një familje sllavësh, e fuqizuar ushtarakisht dhe ekonomikisht, e cila ia arriti të sundojë në një vend josllav, krahasueshëm, psh, me sundimin një dinastie franceze në Italinë e Jugut. Në Mesjetë ka pasë shumë të këtillë shtete me sundimtarë jovendës. 4.Në lidhje me kufijtë, se deri ku u shtri ai shtet, nuk po hyjmë tash në hollësi.

-Shek.X-XI. Në shek X-XI u riorganizua arqipeshkvia e Tivarit... si kryeqendër (e ritit katolik). (f.14)

Para shek.XI në Tivar nuk ka pasur arqipeshkvi, prandaj nuk mund të themi: u riorganizua.

Prebalitana, si njësi administrative, e krijuar nga perandori ilir, pra, nga perandori ynë, Diokleciani, ka të ngjarë nga Konstantini i Madh, por, me siguri, nga Justiniani i Madh e këndej, ka pasur edhe arqipeshkvinë e vet me seli në Shkodër. Nuk e di pse ka ndodhur që, në shek. X-XI, madje edhe më parë, Shkodra të mos quhet më arqipeshkvi, por kjo duhet të ketë ndodhur si rezultat i këmbënguljevet shekullore të Perandorisë Bizantine për t'ia pakësuar sa më shumë Papatit të Romës influencën mbi kishat e Ilirikut Lindor.

Është thënë që një qendër arqipeshkvnore e ka pasur Diokleja. Por këtu duhet të ketë një nga tërresë konceptesh: Duke qenë se Shkodra përfshihej në provincën me emrin Diokle, pjesë e së dikurshmes Prebalitanë, arqipeshkvia me seli në Shkodër është quajtur Arqipeshkvi Dokleate. Më vonë, shkrues të ndryshëm e kanë quajtur sikur selia e saj ka qenë vendosur në qytetin Diokle. Në këtë alibi janë mbështetur

ipeshkvijtë e tivarit, për të nxjerrë nga Papati titullin, gjoja "të ripërtrirë" të Arqipeshkvisë së dikurshme Dokleate. Nuk duhet të harrojmë që kemi të bëjmë me kalime shekujsh.

-Shek.X. Metropolia e Durrësit shtrihej nga Tivari në Vlorë me 15 seli peshkopale. (f.14)

Metropolia e Durrësit është metropoli ortodokse, me anën e së cilës Patriarkana e Konstantinopolit mundohet t'i shkëpusë arqiipeshkvitë dhe ipeshkvitë katolike iliro-arbërore nga varësia e Papatit katolik. Kur themi: ***Mundohet t'i shkëpusë***, kemi parasysh edhe veprimet shtetërisht, edhe ata politikisht, dmth kishërisht. Shteti bizantin i ka përdorur të gjitha format, qysh në shek.VII. Midis tyre, edhe favorizimin e sllavëvet, të vendosur midis populates ilire, me pëlqimin e Perandorisë Bizantine.

-Shek.X. Provinca e Prebalitanës me qytetet: Shkodër, Drisht, Danjë, Shas, Tivar dhe Ulqin... vazhdojnë lidhjet me Romën. (f.14)

Pra, me gjithë këmbënguljet, makinacionet dhe presionet e gjithfarëllojshëm të shtetit bizantin, i cili, qysh prej shek. VII, gjendej nën domonimin e grekëvet, për shkak se edhe për gjuhë administrative ia kishin arritur të përdornin greqishten, këto ipeshkvi iliro-arbërore ia kanë dalë të mos shkëputen nga Papati. Është ky një llpj heroizmi që, me anë të fesë, të ruhet edhe etnia.

-Shek.XI. (Në këso rrethanash, Gj.D.**) u themelua Kryeipeshkvia e Tivarit, që përfshinte ipeshkvitë arbërore të Shkodrës, Ulqinit, Drishtit, Sasit e Shurdhahut, duke i shkëputur nga Metropolia (**ortodokse, Gj.D.**) e Durrësit. Tivari e siguronte lidhjen kishtare me Romën nëpërmjet Raguzës. (f.331)**

Fjalia: ***E siguronte lidhjen kishtare nëpërmjet Raguzës***, nuk është e saktë, sepse e kemi parë në pjesën e parë të këtij libri që Raguza, për nja 2 shekuj, s'ka pushuar së luftuari për t'i pasur nën drejtimin e vet të gjitha ipeshkvitë e Arbërisë Veriperendimore.

-1054. Enklava e Tivarit u bë bazë e shtrirjes së katolicizmit në tokat e tjera arbërore. (f.14)

Me këtë formulim krijohet koncept krejt i gabuar. Duhet thënë: Ipeshkvia e Tivarit, duke u ngritur në rangun e arqipeshkvisë, u bë bazë **E RUAJTJES** së katolicizmit në tokat e tjera arbërore. Sepse, po të themi: ***E SHTRIRJES***, do të nënkuptojmë që s'paska pasur më parë katolicizëm "***në tokat e tjera arbërore***".

-1558. Ipeshkvia e Tivarit kishte 4000 frymë katolikë. (f.33)

Ish koha kur vetë Kruja ish e krishterë dhe luftonte kundër depërtimit të fesë islame. Shkodra donte edhe 20 vjet për t'u pushtuar.

-1570. Bejlerbeu i Rumelisë i cilëson kryengritësit e zones së Shkodrës si të pafe që kanë ngritur krye dhe kanë njohur për zotër të pafetë e kalavet armike të Tivarit e të Ulqinit, që varen nga Venediku... sulltani urdhëron bejlerbeun të shkojë me të gjitha forcat kundër armiqvet të nëmur... Qëllimi është i qartë. Luftës kundër kryengritësvet arbër sulltani përpiqej t'i jepte ngjyrën e një lufte fetare, të drejtuar kundër të pafevet që nuk i nënshtroheshin Sherjatit. Jo vetëm në këtë rast, por edhe në periudhat e mëvonshme, përvoja historike ka treguar se, në rast sde feja shrfytëzohet për problem politikë, ajo e humb karakterin e mirëfilltë të sdaj njerëzor. (f.232)

RRËNIMI I KISHËS ARBRO-SHQIPTARE NËN SUNDIMIN OSMAN

-Fundi i shek.XVI. Në Tivar ka 291 shtëpi. Nga këto, 214 janë të krishtera (74%) dhe 77 janë myslimane (26%). (f.36)

Tashmë, pas një qëndrese 92-vjeçare (1479-1571), Tivari, bashkë me Ulqinin, 2 qytetet e fundit të Arbërisë, kishin rënë nën sundimin e Perandorisë Osmane. Nuk duhet kaluar përciprazi, por përkundrazi, duhen bërë analiza të thelluara: Pse ndodhi që, një Arbëri e vogël, nën udhëheqjen e një Gjergj Kastriot Skënderbeu, të rezistonte aq shumë për të mos iu dorëzuar pushtimit osman?! Dhe, pse ndodhi që, 2 qytete fare të vegjël, në një cep të Arbërisë Veriperendimore, rezistuan gati 1 shekull, për të mos iu dorëzuar Perandorisë së stërmadhe Osmane?! Këtu ka doemos një arsye që s'është aspak e thjeshtë dhe këtu ka, si pasojë e asaj arsyeje, një heroizëm të pashoq: Heroizëm jo 2-mujor, as 2-vjeçar, por plot 2-shekullor, po të llogaritet koha nga Beteja e Maricës e vitit 1371.

-1582. (Banorët myslimanë) të Tivarit (ishin liruar) nga taksat që mbështeteshin në Sheriat (hukuk-i sheriat) (f.244)

Dëshmia është e mjaftueshme. Pushtuesi përdor fenë në fushën ekonomike. Feja, institucion i shtetit. Nëse je mysliman, shteti të merr me të mire. Individi jo i qëndrueshëm (dhe dihet se të paqëndrueshëm ka shumë në këtë botë), thotë: "Epo mirë, më levërdi kam me qenë mysliman e të përfitoj ndonjë gjë, se sat ë ruaj fenë që më ka lënë gjyshi." E kjo do të thotë që pushtuesi e ka përdorur fenë, jo për të predikuar të vërtetën, por për të mashtruar naivët dhe hallexhinjtë.

-1582. Tivari ka 81 familje myslimane dhe 359 familje të krishtera...Kranja ka 62 shtëpi myslimane (500 të krishtera)... Shestani ka 6 familje myslimane (158 të krishtera). (30-31)

Megjithse ka mbi 10 vjet që kur janë pushtuar prej Turqisë, Kranja dhe shestani janë ende në shumicë të krishterë. Në Tivar, në 11 vjet, ritmi i islamizimit është më i shpejtë. Kjo duhet të ketë arsyet e veta: 1.Tivari ka rezistuar 1 shekull dhe tani duhen marrë masa për ta shuar rezistencën edhe me anë të fesë. 2.Tivari është avanpost përballë një Evrope të madhe të krishterë, prandaj aty Islami duhet të ngulet sa më fort. Përndryshe, ai mund të bjerë prapë në duart e kryqtarëvet. 3.Tivari është qytet. Aty mund të zbatohen më lehtë masat taktiko-shtërnguese, se sa nëpër male.

-Shek.XVI, gjysma e dytë. Arqipeshkvi i Tivarit, Gjon Bruno Harapi dhe shumë meshtarë u burgosën dhe, më vonë, u ekzekutuan me qenë se ishin përpjekur të ngrinin 70 fshatra kundër osmanëvet për të çliruar shkodrën mbas rënies në duart osmane. (f.129-130)

Këtu kemi një të dhënë shtesë: Imz. Gjon Bruno Harapi, arqipeshkëv i Tivarit (që unë mendoj se është më mirë të pranemërohet: Murra), është ekzekutuar, sepse nuk ka dashur t'i dorëzohet Tivari Tuqisë. Tash marrim vesh që ai paska qenë edhe organizues i një pryengritjeje të mëparshme, për të çliruar Shkodrën. Gjithsesi, kjo luftë ka karakter fetar. Është ideologjia ajo që ushqen me ide kundërshtarët e secilës palë. Çështja do parë, se cila ideologji është më progresive. Në këtë rast nuk ka asnjë dyshim që është më progresive ajo ideologji që

përfaqësohet nga Imz.Gjon Murra dhe klerikët e tjerë katolikë, sado që kjo palë nuk i ka mjetet e nevojshëm për ta fituar luftën.

-1571. Gjatë konfliktit të shtetit osman me koalicionin evropian, të njohur me emrin 'Lufta e Shenjtë', pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit, popullsia katolike u ndodh në një luftë të pabarabartë me osmanët, e cila përfundoi me një hakmarrje të paparë deri atëherë. (f.136)

Evropa, në radhë të parë Venediku, e la Arbërinë në duart e Perandorisë Osmane. Ajo tashmë do të merrte masa për të mbrojtur Kotorrin, si pikë më të rëndësishme strategjike, ndërsa viset e Arbërisë, pasi ishin bërë parzma, gjoks njerëzor, në portat e Evropës, do të shndërroheshin në një trup të shtrirë përdhe, dhe, ndonëse gjithnjë gjallë, të shkelur e stërshkelur vit pas viti dhe shekull pas shekulli.

-1571. Pas pushtimit, si shumë qytete të tjerë të Arbërisë, qyteti i Tivarit është katandisur në madhësinë e një katundi. Atij s'i kanë mbetur veçse 77 shtëpi (familje). Shkodra kish 80 shtëpi, Drishti 15 shtëpi, Podgorica 40 shtëpi, Durrësi, më 1501-shin, asnjë shtëpi. (f.19)

Mjerimi s'ka ku ta çojë më poshtë jetën njerëzore të këtij populli, deri para 40 vjetësh të mbuluar me lavdinë më të ndritshme të të gjitha kohëve. Ky mjerim na kujton vetëm fundin e shekullit XII, kur një Stefan Nemanjë i Sërbisë i pat rrafshuar me token të gjithë këta qytete, përveç Durrësit.

-1571. Kisha arqipeshkvnore, me titullin e Shën Gjergjit, me një ndërtim madhështor, pak vjet pasi kishte rënë qyteti në duart e osmanëvet, ishte shndërruar në xhami... dhe në stallë kuajsh. Deri në vitin 1611, në godinën e arqipeshkvisë, turqit vazhdonin të kishin stallën e kuajvet edhe sanën, kurse në të ndarën tjetër banonte kadiu. (f.122)

Ironi, sarkazëm, komedi, tragjedi. Të gjitha mund të përjetohen, veçse jo në skenën teatrore, por drejtpërdrejtë në skenën e jetës, ku kultura dhe dinjiteti njerëzor shkelen, duke u zëvendësuar me antikulturë: Midis murevet të veshur me mermer, disa kuaj, disa dengje me bar të thatë dhe një kadi me personelin e vet shërbyes.

-1609. Marin Bici, para se të shkonte në Tivar, kërkoi lejen nga sulltani, i cili i jep lejen si më poshtë: Urdhëri perandorak është se mbajtësi i këtij urdhëri Marin Bici, fetar dhe Antivarens i të krishterëvet frëngj në krahinën e Tivarit, pasi dha një dhuratë prej 880 aspra, i njeh atë privilegj dhe të shkojë e të jetë ipeshkëv i kombit frëng sipas zakonit dhe sipas ritit të vet, dhe të gjithë priftërinjtë e tjerë e fretërit duhet ta njohin si ipeshkëv të tyrin. (f.127)

Thuhet që Marin Bici kish një vëlla të vetin, të kthyer në mysliman dhe në shërbim të pallatit sulltanor. Nëpërmjet tij ai e siguroi lejen, gjithsesi duke paguar ryshfetin, i cili përmendet këtu.

Në pallatin sulltanor, lidhur me popullsinë katolike të Tivarit, zotëron një INJORANCË shembullore: Arbërit katolikë të Tivarit konsiderohen francezë. Është e njëjta injorancë, sigurisht e qëllimshme, e cila tivarasit e Mesjetës kërkon t'i paraqesë, ose romanë, latinë, ose sllavë.

Vëllai i gjyshit tim, Gjoka i Nikë Pjetrit, ka jetuar në Stamboll 60 vjet, në kapërcyell të shekujvet XIX e XX. Ai punonte aty në një kompani franceze dhe kish marrëdhënie të ngushta me francezët. Që të gjithë ata kishin bindjen se Gjoka ishte francez dhe ia përsësnin vazhdimisht: "***Ju jeni francezë***." Dmth: "***Ju, 'katolikët e Malit të Zi', më vonë 'të Jugosllavisë', jeni francezë.***"

Në fund, Gjoka vdiq dhe nipi i tij, që ishte shqiptar nga Zalefi i Tivarit, ia ndërtoi varrin dhe shkroi atje, e gdhendi në mermer, llagapin DABOVIQ. Pra, në mes të Stambollit, ky shqiptar, i cili nuk dinte asnjë fjali sllavisht, figuron si një sllav i mirëfilltë. I njëjti shqiptar, i cili, për 60 vjet, u konsiderua prej francezëvet: francez.

E shkrova këtë episod, për të dëshmuar se sa kokëfortë dhe sa jetëgjatë mund të jetë INJORANCA NJERËZORE. Lërua në dorë të këtillë dokumente edhe STUDIUESVET INJORANTË dhe bëj qejf me historinë.

-1610-1611. Në Tuxhemile (sipas Imz.Marin Bici**) kish 40 shtëpi të krishtera... Në Shushan, 80 shtëpi (të krishtera). (f.63)**

-1611. Më 1611-n mbërriti në (fshatin) Samrish një i deleguar i patriarkut (të Pejës) për të nxjerrë me dhunë nga priftërinjtë e kishavet latine dhuratat (regalet) që (s'u takonin atyre, por) i takonin arqipeshkvit të Tivarit, sipas zakonit të vjetër e të miratuar prej sulltanëvet: 2 akçe për çdo shtëpi, 12 për çdo martesë, 22 akçe për martesat e dyta dhe 48 akçe për martesat e treta. Këtë veprim ata e përsërisnin 2-3 herë në vit, duke pasur ndihmën e osmanëvet. Mbledhësit mbanin në duar disa urdhëra të sulltanëvet për skizmatikët dhe jo për katolikët. (f.321)

Ka mbi 160 vjet që nuk ekziston më shteti i Sërbisë, megjithatë, Kisha Pravosllave Sërbe ushtron presion mbi arbërit, duke pasur edhe ndihmën e pushtetit osman, lokal edhe qendror. Me këtë rast, arbërit s'do të kishin kë të akuzonin më shumë se paraardhësit e vet, gjyshërit e vet, të cilët nuk patën treguar mençuri për të krijuar një kishë të vetën naciopnale. Ta shkruanin një Ungjill në gjuhën e vet dhe ta predikonin atë Ungjill në gjuhën e vet.

-1611. Fshati Tuxhemile (Togjemil), 3 milje larg Tivarit, ishte në varfëri të madhe, sepse turqit nuk i linin veçse sa për të jetuar, ndërsa teprica shkonte si haraç. (f.124)

Këto do të kenë qenë edhe arsyet pse Togjemili më vonë u islamizua.

-1611. Pasuria e fshatit Zupç ishte grabitur prej turqvet. (f.124)

Megjithatë, Zupçi nuk u islamizua. Duhet të ketë edhe këtu një arsye. Si mundën të qëndrojnë katolikë banorët e Zupçit, që nuk janë as 2km larg prej Togjemilit?

-1614. Një grua zonjë, turke, gruaja e Dushiagës, e re dhe fisnike, por pak e egër dhe e furishme, në Tivar, iu lut M.Bicit që t'i pagëzonte vajzën e porsalindur, mbasi atje kishte qenë zakoni që të gjithë turqit e martuar me gra të krishtera, kërkonin pagëzimin e fëmijëvet të tyre, ndonëse nuk e lejonte feja islame. Arsyet ishin se, po të pagëzoheshin, nuk mund të dëmtoheshin nga magjitë e as nga ujqërit. M.Bici nuk ia plotësoi dëshirën, mbasi nuk e lejonte besimi katolik. (f.321)

Përplasja e 2 besimeve, ndër të cilët, i dyti, besimi islam, është thjeshtë variant i të parit dhe, që të 2 s'janë tjetër, veçse zhvillim i të mëparshmit besim hebre, sjell gjithë këtë fatkeqësi në shpirtin e një nëne. Dhe jo nënë dosido, por një nënë e bukur, një nënë fisnike. Nënë e bukur dhe fisnike, por edhe e ashpër, sepse vetë jeta e ka egërsuar.

Unë i përfytyroj pikërisht të tilla, mijëra nënat arbërore të atyre shekujve: Dinjitoze, por të poshtëruara keqas.

Martuar me një "turk", i cili, në të vërtetë, s'është kurrfarë turku, e detyruar të shpikë përralla, se fëmijën mund ta dëmtojnë magjitë dhe se fëmijën mund ta hajë ujku, ajo i lutet arqipeshkvit të bëjë të njëjtën punë që e ka bërë Shën Gjon Pagëzuesi mbi Jezu Krishtin. Arqipeshkvi, mëkëmbësi i Shën Gjonit në Tivar, nuk ia plotëson dot kësaj gruaje, këtë dëshirë tradicionale, 15-shekullore.

Mjafton kjo pamje dhe e kuptojmë fort mirë ç'ka sjellë Islamizmi në Tivar, vetëm 45 vjet mbas pushtimit. Po kur të kalojnë 450 vjet?

-1625. Në bazë letrës së arqipeshkvit të Tivarit (shkruar nga Imz.M. Bici më 1624, Gj.D.**), më 1625-n, Kongregata e Shenjtë diskutoi nëse duhej të pagëzoheshin fëmijët e myslimanëvet, jo për t'i bërë të krishterë, por që të ruanin e të fitonin shëndetin, të liroheshin nga dhuna e keqe, nga sëmundjet e epilepsisë, nga rrëziku i syrit të keq e nga ujqërit. Përsëri u vendos që të mos bëhej pagëzimi i këtyre fëmijëve, mbasi pagëzimi ishte dera e të gjithë sakramentevet të tjerë. Kërkesa për pagëzimin e tyre u përsërit në vitin 1641 (**nga Imz.Gjergj Bardhi, Gj.D.**) dhe përsëri u refuzua. (f.321)**

Midis alternatives: A ta ndërrojnë fenë e Krishtit me fenë e Muhametit, arbërit e shohin më të arsyeshme t'i rikthehen paganizmit. Ky është thelbi i të këtilla kërkesave, të cilat s'janë aspak të papërfillshme, gjersa arrijnë për t'u debatuar deri në kupolën e Kishës Katolike.

-1625. D.Theodhori i Tivarit, me ndihmën e turqvet, kishte shtënë në dorë kishën e Shën Madalenës pranë Shkodrës. Ndonëse ishte i shkishëruar, ai kishte detyruar banorët e asaj

krahine të jepnin detyrimet që nuk i takonin atij, edhe pse askush nga banorët nuk shkonte në shërbesat e tija. (f.185)

Pushteti osman sjell shthurjen edhe nga brenda të infrastruktures kishtare. Është krejt e kuptueshme që, fitorja, qoftë e pushtetit laik, shtetëror, qoftë e pushtetit ideologjik, fetar, në Arbëri, në këtë rast, në Arqipeshkvinë e Tivarit, nuk ka ardhur vetëm si rezultat i forces së Perandorisë Osmane. Ajo fitore ka ardhur edhe si rezultat i dobësivet të pafundme të vetë Kishës Katolike dhe i pushtetvet laikë që ushqeheshin prej ideologjisë së asaj Kishe.

-1625-1634. Misioni (françeskan) i Shën Pelegrinit, ... përfshinte krahinat e Tivarit e të Ulqinit, dhe një pjesë të mirë të (dioqezës) së Shkodrës, fshatrat nga bregu i lumit Bunë deri në Trush. (f.179)

Kisha Katolike përpiqet që, me anë të rendevet të rregulltarëvet, të përmirësojë punët e veta. Shumë prej anëtarëvet të këtyre rendeve, edhe këtu në Arbërinë Veriperendimore, si në vendet e tjerë, bëjnë punë, thuajse gjithherë, vetëmohuese, në përmbushjen e misionit të tyre. Por, sa ia arrijnë?! E gjithë historia e atyre rendeve në krejt Arbërinë, më vonë, në krejt Shqipërinë, e unë do të thosha, madje, në krejt botën, ka qenë luftë për të mbijetuar feja e krishterë. Jo luftë që do t'i sillte krishtërimit fitoren.

-1625. P.Mazreku kërkoi të holla nga Roma, para se të vizitonte Tivarin, për të bërë dhurata për qeveritarët e qytetit. (f.128)

Këtë kërkesë ia bën Imz.Pjetër Mazreku Vatikanit me anë të një letre nga Shkupi. Më 1638-n do të bëhet arqipeshkëv I Tivarit, me emrin Pjetri III Mazreku. Dihet, pra, që besimi katolik duhet t'i japë para atij që është kundër atij besimi. Kjo nuk ishte rrugëzgjidhja. E vërteta është se as Vatikani, as krejt Evropa Perendimore, nuk e gjetën kurrë zgjidhjen, as me ortodoksinë greke, as me pravosllavizmin sllav dhe as me islamizmin.

-1628. Ka pasur një grindje midis ipeshkvit të Lezhës dhe arqipeshkvit të Tivarit lidhur me një kishë të Barbullushit. (f.185)

Në atë vit, arqipeshkëv i Tivarit ka qenë Imz.Pjetri III Mazreku.

-1629. Dioqeza e Shkodrës kishte qenë qysh prej 40 vjetësh pa bari (dmth, pa ipesjkëv). Kjo i kishte dhënë mundësi klerit të Tivarit t'i ndryshonte kufijtë nga perendimi dhe klerit të Sapës nga lindja. (f.185)

Nga viti 1622 deri më 1640 thuhet se ipeshkëv i Shkodrës ka qenë Imz.Dominik Andriasheviq. Ndërsa në Sapë-Sardë thuhet se ka qenë ipeshkëv Imz.Gjergji I Bardhi. Duhet të verifikohet sa janë të vërtetë informacionet dhe si kanë qenë zhvilluar ngjarjet konkretisht.

-1633. Arqipeshkvi i Tivarit ishte kërcënuar nga turqit se do t'i prisnin rrugën e do ta zhvishnin nga çdo gjë, ashtu sikundër i ishte bërë, në Tivar e në Prizren. Vizita në Prizren atij i kushtoi 100 skudë dhe për pak jetën. (f.132)

Sigurisht, jo nga turqit, por nga myslimanët vendës, që kishin pushtetin në dorë. Arqipeshkëv është Imz. Pjetri III Mazreku. Tabloja është, nga pikëpamja shpirtërore, rrënqethëse, ndërsa, nga pikëpamja e gjykimit logjik, nga më të zymtat. Arqipeshkvi ish kërcënuar e trajtuar keq edhe 2 herë tjera, tani ish e treta here që po kërcënohej, madje me jetë. Ç'ish ai shtet që sillej ashtu me institucionet shtetërisht të lejuar?!

-1633. Sipas M.Bicit, 1611, ... ipeshkvijtë nuk kishin me se të mbaheshin... Shumë kishin vetëm 3 muaj bukë... Për këto arsye, sipas P.Mazrekut, deri në vitin 1633, asnjë prej tyre nuk kishte qëndruar as në Tivar, as në Kosovë. (Madje) nuk kishin (as) shtëpi..., prandaj ata banonin sa në një vend, sa në një tjetër, me shumë mjerim dhe shqetësim, sa nuk bëhet më. (f.188)

Shtrohet pyetja për historianët e sotëm të Rep.së Turqisë: A ish sundimi osman, në Arbërinë e shekujvet XV-XX, një sundim prej një pushtuesi nga më të egrit, apo ish, siç pretendohet, një qeverisje normale brenda një shteti normal ?!

-1633. Në zonën e Tivarit më 1633-shin ishin nja 15 fshatra 15-20-tymëshe, me rreth 3000 frymë. (f.64)

Kur thuhet: "***Në zonën e Tivarit***", s'e dimë a bëhet fjalë për rrethinën e ngushtë apo për krejt dioqezën.

-1633. Arqipeshkvi i Tivarit propozon formimin e një kolegji të veçantë për Arbërinë (edhe me Koosvën), me 16 nxënës në 2 gjuhët, sllavisht-arbërisht dhe (arbërisht-sllavisht). (f.177)

Propozimin e ka bërë, sigurisht, Imz. Pjetri III Mazreku. Ai, qysh në vitet 1622-1624, kur ende nuk ish arqipeshkëv, pat shkruar: "***Arbërit kanë humbur e po humbin duke mos pasur priftërinj***." (f.176) Për dalmatinët, që tashmë flisnin sllavisht dhe nuk ishin nën sundimin osman, Kolegji Ilirik i Romës kish rezervuar shumë vende, ndërsa për Kosovën vetëm 2. Por pyetja shtrohet: Pse arqipeshkvi i Tivariit kërkon që nxënësit, kandidatë për priftërinj në Arbëri dhe në Kosovë (që gjithashtu ish Arbëri, sado që nuk quhej ashtu) të mësonin edhe sllavisht? Historiografët slave pretendojnë që midis katolikëvet të këtyre ipeshkvivive kish edhe besimtarë sllavishtfolës. Por kjo duhet studiuar. Nuk mund të merret apriori.

-1633. Tivari, më 1633-në, banohej më shumë prej myslimanëvet sesa prej të krishterëvet... numri i të krishterëvet, që jetonin brenda dhe jashtë murevet, ishte 60 familje. (f.59)

Fjala është, sigurisht, për kështjellën dhe për varoshin jashtë kështjellës. Por 60 familje janë gjithsesi pak për një qerndër arqipeshkvnore. Kjo është dëshmia më e mirë, që në Perandorinë Osmane nuk ekzistonte liria e besimit. Ose ekzistonte vetëm formalisht. Por mund të mendohet edhe që, për Arbërinë, sidomos për pjesën katolike, ka pasur të tjerë kritere.

-1635. Gj.Bardhi, me të mbërritur në Tivar, si gjë të parë, shpërndau dhuratat për zotërinjtë turq, sipas të cilit, nuk kishte gjetur më të këqinj në gjithë Perandorinë, sesa në Tivar. (f.128)

Nuk janë turq, por janë arnautë (arbër të islamizuar) të Tivarit. Kështu e kemi ne, kur është për të zhvatur njerëzit e gjakut tënd: Bëhemi më turq se Turku dhe bëhemi më katolikë se Papa.

-1636. Gj.Bardhi, arqipeshkëv i Tivarit, pohonte... se ipeshkvijtë e huaj kanë shkaktuar në këto krahina skandale të mëdhenj e të pafund, aq sa krishtërimi e ka humbur atë përshpirtshmërinë e parë që kishte. (f.186)

E dime tashmë që, të paktën qysh në mesin e shek.XVI, kur u shtyp Meshari i Gjon Buzukut, kemi përpjekje për ta kthyer shërbimin meshtar në gjuhën e vendit. Në shekullin XVII kemi të njëjtat përpjekje, me Pjetër Budin, me Fran Bardhin, me Pjetër Bogdanin. Deklarata e sipërme e Imz.Gjergj Barshit është në po atë vazhdë përpjekjesh. Edhe para shek.XVI doemos ka pasur tentative për ta organizuar Kishën mbi bazat e kërkesavet të vendit. Por unë shikoj këtu një shkak kryesor, që s'është arritur ky synim: Kleri vendës nuk ka pasur përkrah vetes edhe pushtetin vendës. Të vetmit raste kanë qenë: 1.Koha e Konstantinit të Madh, por ai i shikonte problemet, me sa duket, më gjërë se ç'i interesonte etnisë së tij. 2.Koha e Justinianit të Madh. Ai e krijoi Kishën e Justiniana Primës (Kishën e Ilirikut Lindor), por nuk e dimë pse nuk u tentua që edhe liturgjia të thuhej ilirisht. 3. Në Kohën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut kemi, më në fund, një bashkëpunim të konsoliduar midis Kishës dhe pushtetit, përpjekje edhe për ta shkruar gjuhën liturgjike arbërishte, por kjo kohë qe shumë e shkurtër dhe prandaj s'u hodhën dot themelet e një **INSTITUCIONI** ideologjik kombëtar **JETËGJATË**, siç e kishin psh: grekët, sllavët e, po në atë shekull, po krijonin edhe protestantët nëpër Evropë.

-1637. Në qytetin e Tivarit ishin dom Pjetër Samueli dhe Dom Françesk Paskuali, me zell të pakët për t'i kullotur shpirtrat, por vetëm të kullotnin vetëveten dhe jo grigjën dhe jetonin me pak nder në këtë vend. Të krishterët kishin pak respekt ndaj tyre dhe nuk kishin besim tek ta. (f.192-193)

Emri ***Pjetër*** ndoshta është shënuar në formën arbërishte nga përkthyesi, sepse nga pranemri, ***Samueli***, nuk duket si vendës. Kemi të bëjmë, pra, me 2 priftërinj jovendës, të cilët, në një situatë rrëziku të madh për etnitetin tonë, gjejnë komoditetin për të mos e kryer detyrën si duhej. Në përgjithësi gjendja arsimore e priftërinjvet tanë në ata dhjetëvjetësha ishte fare përtokë.

-1637. Zupçi ka 40 shtëpi me 500 frymë të krishtera. Shushani ka 80 shtëpi me 900 frymë katolikë. Spiçi ka 35 shtëpi me 230 frymë katolikë dhe 40 skizmatikë. Sozina ka 20 shtëpi me 230 frymë katolike dhe 2 shtëpi skizmatike me 22 frymë. Tuxhemile ka 20 shtëpi me 230 frymë katolike. (f.65)

Nëse shifrat janë të sakta, gjëja e pare që na bie në sy, është se familjet në fshatrat e atëhershëm të Tivarit ishin të mëdha, thuajse random me mbi 10 pjesëtarë. Shihet që, në krahasim me qytetin, islamizimi nuk është përhapur ende. Pra, është ruajtur besimi i krishterë, por, në Spiç dhe në Sozinë ka filluar tashmë të hyjë riti pravosllav. Relacionet nuk japin të dhëna nëse popullata e këtyre fshatrave ka qenë në ata vite arbërishtfolëse apo sllavishtfolëse. Kjo do të ish me rëndësi të dihej.

-1637. Kisha e Shënmërisë, jashtë murevet të Tivarit, ishte kthyer në mesxhide. (f.122)

Mesxhide është xhami pa minaret.

-1637. Brenda në Tivar kishte 11 shtëpi të krishtera, kundrejt 117 shtëpivet myslimane. (f.59)

Krahasuar me Shushanin, që në të njëjtën kohë ka pasur 80 shtëpi (Shih pak më lart.) Tivari si qytet, pasi ka pësuar rënien e madhe me pushtimin prej forcavet osmane më 1571-në, edhe pas 70 vjetësh ende nuk e ka marrë veten. Në anë tjetër, duke parë që fshatrat përreth janë gati tërësisht të paislamizuar, Tivari duket si mish i huaj: Një fortesë e perandorisë, rrethuar me kundërshtarë të perandorisë. Jetesa në një të tillë ambient nuk mund të ishte normale.

-1638. Dioqeza e Tivarit, e përbërë nga 2 qytete e fshatrat: Zupç, Shuhshan, Spiç, Sozinë, Togjemil dhe komuna e Shestanit, ku përfshiheshin mbi 10 fshatra, kishte 5 meshtarë. Vetë qyteti i Tivarit kishte 2 klerikë. Dioqeza kishte 5000 katolikë. (f.175)

Si qyteti i dytë, me sa duket, konsiderohet Lastua e Budves. Sozina e Spiçi janë 2 fshatra që, me kohë, u skizmatizuan, dmth kaluan jo në islamizëm, por në fenë pravosllave, dhe kjo i ka shpjegimet e vet, ndërsa me pjesën tjetër ndodhën transformime të tjerë. Bie në sy që në dokumente nuk përmenden Fusha e Tivarit, me fshatrat Zalef, Tombë, Bartull, Dobrovodë (Ujëmirë). Pse?

-1638. Fran Leonardi: Banorët e fshatit Spiç nga katolikë kthehen në skizmatikë, nga mungesa e priftërinjvet. (f.176)

1.Emri original i Imz.Fran Leonardit do të ketë qenë Francisk (Franciscus). Duhet pranuar që në shënimin e emravet vetjakë të pesonavet, për shkak se edhe ata "përkthehen", ka një ngatërresë të madhe.

2.Mungesa e priftërinjvet mund të jetë vetëm shfaqja sipërfaqësore e dukurisë. Priftërinj nuk kanë pasur as skizmatikët, dmth sllavët pravosllavë. Problemi është shumë më i ngatërruar. Filluar qysh prej Spalatos, Splitit të sotëm, dalmatët-ilirë gradualisht janë sllavizuar pikërisht me anë të kishës katolike. I njëjti proces ka ndodhur në Raguzë (Dubrovnik) dhe i njëjti process ka vazhduar edhe më në jug, në Grykat e Kotorrit. E lëmë dhe nuk e shkoqisim më gjatë, në këtë vend, këtë dukuri.

Në bregdetin e Batuas së dikurshme ilire (Budves së sotme), një fis barinjsh arbër, i zbritur për dimërim bagëtish nga malet e Llovqenit (*Leqënit), i cili përfundimisht do të quhej: fisi i Pashtroviqit (nga lat. pastor, bari), do të pravosllavizohej, dmth do të merrte fenë pravosllave, do të ndërronte edhe gjuhën dhe, i nxitur e përkrahur nga Vlladikati malazias i Cetinjës, nëpërmjet manastirevet të Brajiqit dhe Mainës, do të krijonte probleme në atë bregdet gjatë gjithë Mesjetës së Vonë. Zgjërimi i këtij fisi, dikur arbëror, tani i sllavizuar, drejt vendbanimevet kufitarë të Tivarit, do të sillte edhe skizmatizimin, pra sllavizimin, edhe e të tjerë banorëve në trevën e Spiçit, bashkë me problemet që ai fis i bartte me vete thuajse gjenetikisht. Arbërit e kthyer në myslimanë, të qytetit të Tivarit, bartnin në genin e vet sindromën e të bërit sherr me ata që mendonin ndryshe ose që besonin ndryshe. Arbërit e kthyer në slave malazezë, të Pashtroviqit, bartnin edhe ata në genin e vet sindromën e të bërit sherr me këdo që mendonte apo besonte ndryshe. Ky është problem! Dhe ky është problem i madh, të cilin ne shqiptarëve na takon ta trajtojmë edhe ta zgjidhim.

-1638. Më 1638-n dioqezi i Tivarit kishte 5000 katolikë. Pas 30 vjetësh (dmth në vitet 1670-1680**) në këtë dioqezë kish 8 fshatra me 229 shtëpi katolike, me 2400 frymë. (f.65)**

Këto të dhëna të vitevet 80 të shek.XVII flasin për një rrudhje të katolicizmit në dioqezën e Tivarit. Nga 15 fshatra me popullsi katolike, kishin mbetur gjysma (8), kurse numri kishte zbritur nga 5000 në 2400 frymë. (f.65).

Do pasur parasysh që është fjala për dioqezën dhe jo pë rrethinën e ngushtë të Tivarit. Islamizimi i qendrës, i vetë qytetit të tivarit, nga ushtrohej edhe pushteti, do të sillte doemos edhe shtrirjen nëpër fshatra.

-1638-1744. Togjemili: 1638, 16 shtëpi katolike me 125 frymë; 1744, 12 shtëpi katolike me 98 frymë. Pinçi: 1744, 10 vjet pas eksodit , 55 shtëpi me 86 banorë. (f.89)

Togjemili ka rënie, me 4 shtëpi, të cilat mund të jenë kthyer në myslimane, dhe me rreth 30 frymë. Por Pinçi na jep një tablo krejt tjetër: 55 shtëpi katolike me vetëm 86 frymë. Më pak se 2 banorë pë shtëpi. Kjo dëshmon që, thuajse të gjithë pinçanjorët, përveç pleqvet, janë larguar për në Dalmaci në vitet 1726-1733 dhe janë vendosur në Zarë. Në fshatrat në afërsi të Zarës, Zemunik etj, vërtetohet kjo tezë me pranemrat Pinçiqi të një numri jo të vogël familjesh.

Por për ne është e rënmdësishme të konstatojmë se këtu, në shekujt XVI-XVIII, ka një përplasje shumë të ashpër midis krishtërimit perendimor dhe islamizmit oriental. Pse ka ndodhur kjo përplasje? Çfarë përfaqësonte filozofia zanafillëse e Jezu Krishtit, nëse do të qëndronte e padeformuar, dhe çfarë përfaqësonte filozofia e Muhamedit, në çfarëdo forme që ajo do të zabatohej? Arqipeshkvia e Tivarit dhe, parë më ngusht, dioqeza e Tivarit, ia vlen të bëhen objekt studimesh në fushën e filozofisë, teologjisë, sociologjisë dhe etnologjisë. Konkluzionet që do të nxireshin këtu, besoj se do t'i shërbenin me shumë rendiment diturisë gjithnjerëzore.

-1643. (Nga relacioni i Imz. Gjergj Bardhit): (Imz.Leonardisi, arqipeshkëv i Tivarit, ishte) inteligjent, i urtë e, mbi të gjitha cilësitë e duhura, (kishte) edhe një përvojë të gjatë. (f.184)

Por ka shërbyer në Tivar vetëm 2 vjet, 1644-1646. Në krye të Arqipeshkvisë së Tivarit kanë ardhur, në kohë të ndryshme, disa prelatë me vlera nga më të lartat. Mirëpo, për fat të keq, shumica e tyre kanë shërbyer për fare pak kohë, duke qenë tashmë në fund të jetës.

-1648. Gjatë kohës kur Venediku ishte në luftë me shtetin osman... disa ipeshvij, si ai i Durrësit, i Lezhës, i Tivarit, nuk mundën të hynin (në Arbëri). (f.137)

Është normalisht e kuptueshme: Popullata ishte në çdo kohë e gatshme për të vepruar kundër pushtuesit. Arbërit, në të gjitha kohët, mezi kanë pritur që dikush nga Perendimi të hynte në luftë kundër Perandorisë Osmane, që edhe ata të çoheshin në kryengritje. Në të tillë raste, udhëheqësit shpirtërorë duhej të ishin pranë popullit. Perandoria Osmane e dinte rëndësinë e kësaj pune, prandaj ua ndalonte hyrjet pikërisht atyre udhëheqësve.

Por ka edhe raste kur pikërisht ata udhëheqës, edhe kur ndodheshin aty, nuk e kryenin si duhej misionin e tyre. Në vitin 1648, arqipeshkëv i Tivarit ishte Imz.Josip I Bonaldi (Jozef I Maro Bonaldi) nga Zara e Dalmacisë.

-1648-1649. Jo rrallë klerikët e huaj nuk kanë shprehur as gatishmërinë më të vogël për të mbrojtur katolikët nga ndjekjet osmane. Gjatë Luftës Veneto-osmane (1648-1649), Tivari u kthye në teatër lufte. Turqit, si armiq të fesë (katolike), ua shkurtuan kokat 40 burrave, të gjithë besimtarë katolikë, të cilët u gjendën brenda në qytet.

Disa u bënë myslimanë nga frika ose nga dhuna. 30 familje të tjera kërkuan ndihmën e arqipeshkvit të Tivarit, bariut të tyre (i cili tashmëkish ardhur)**, por ai, me mendjemadhësinë dhe krenarinë e vet, nuk veproi si duhej të bënte bariu i vërtetë, por si grabitës, i përzuri egërsisht, pa asnjë ndihmë. (f.187)**

Të dhënat janë marrë nga një letër që krerët e Tivarit i shkruajnë Selisë së Shenjtë më 2 korrik 1449 dhe nga një letër e Anton Tomës, vikar i Tivarit, shkruar më 28 gusht 1449. Në letrën e parë, Imz. Bonaldi madje akuzohet tepër rëndë. Atë e quajnë konkubinar dhe sodomist. Është vërtet një përfytyrim rënqethës: më një anë 40 burra japin jetën jetën në emër të një besimi (edhe kulture njëkohësisht), më anë tjetër, një i ngarkuar për t'i ruajtur e kultivuar atë besim e atë kulturë, është shndërruar në një përdhosës. Dante Aligieri këtë arqipeshkëv do ta çonte pa dyshim në rrethin IX të Ferrit.

-1649-1650. Gjatë Luftës Veneto-osmane të vitevet 1649-1650 u përdor dhuna masive. Me të marrë vesh qeveritarët osmanë se popullsia e krahinës së Tivarit ishte bashkuar me venedikasit, u zemëruan aq shumë, sa kishin ngulur në hunj të gjithë të huajt

që kishin ardhur në atë krahinë, mbasi shikoheshin si ndërlidhës të venedikasvet me banorët e asaj krahine. Shumë të tjerëvet iu pre koka, të tjerë u lanë nën gurë, që të vdisnin ngadalë. Vetëm në qytetin e Tivarit u vranë 74 vetë. Të krishterët e qytetit dhe të varoshit pranuan fenë islame, pë ttë mos humbur jetën dhe plaçkat. (Sipas Fra Donald Jeliqit, 1650, ku shifra 74 tregon se ndëshkimet kanë vazhduar edhe pasi janë ekzekutuar 40 të parët.) **(f.313)**

Terrori është aq i egër, sa edhe tash pas 364 vjetësh, po edhe pas 3000 vjetësh, njeriut i rrënqethet misht kur e përfytyron. Njerëz të ngulur në hunj, që vdesin ngadalë. Midis tyre edhe të atillë që ndoshta s'kanë kurrfarë lidhjeje me spiunazhin. 74 qytetarë e banorë vendës, të dënuar me vdekje të tmerrshme, me prerje koke ose të lënë nën gurë, për tëvdekur aty edhe më keq se i ngulur në hu.

Me gjykim të ftohtë, njeriu mund të thotë: Epo, ishin bashkuar me armikun. Ishin ngritur kundër shtetit. Ashtu është. Por, ai shtet kish ardhur me dhunë në vendin tonë. Ne nuk i donim, as atë shtet, as fenë që donin të na impononin njerëzit e atij shteti. Dhe, e gjithë kjo, e kish arsyen e vet: Bota perendimore, sado që as ajo nuk ish e përsosur, përkundrazi, ish shumë e papërsosur, prapëseprapë, ish shumë më e përparuar se kjo lindorja. Ne, që ishim në kufi, e shihnim dallimin më mirë se kushdo tjetër.

-1650. Në një letër të ditëvet të para të janarit 1650, midis tjerash, thuhej: Ne katolikët e shkretë e të pangushëlluar të qytyetit të mjerë të Tivarit, tani jemi të gjithë myslimanë me trup, por me shpirt jemi shumë të bindur ndaj besimit të shenjtë katolik. Shkaku që u bëmë myslimanë, është urrejtja e madhe dhe dobësia e bariut tonë, Bonaldi, të cilit i kërkuam ndihmë, kurse ai na u ppërgjigj që të mos shpresonim, por të bëheshim myslimanë. Ne të shkretët, duke parë veten të braktisur, dëgjuam fjalët e tija, prandaj vendosëm të braktisim të gjitha skamet tona e të jetonim larg që këtej, kurse ai na u përgjegj që të mos lëviznim e të rrinim ashtu turq... Ç'mund të pësosh nga klerikë të tillë, të cilët janë kthyer në vegla të qeveritarëvet osmanë për të përhapur fenë islame?! (f.186)

Vazhdojnë informacionet në lidhje me Imz. Jozef I Mara Bonaldi, arqipeshkëv i Tivarit, pikërisht në vitet kur aty duhej të ishte, përkrah 74 heronjve, edhe një Gjon Murrë i vitit 1571, i cili ta kundërshtonte Evropën (Venedikun), duke dhënë edhe vetë jetën.

Por ne duhet ta shohim punën pak më thellë. Tivarasit e shek, XVII u detyruan, ose të ikin nga vendi i vet, ose të marrin fenë e pushtuesit. Po këta tivaras, në shek.XIX, u gjendën përballë dënimit nga ana e Evropës, duke iu dorëzuar Tivari Malit të Zi, midis tjerash, edhe sepse ishte një qytet mysliman (turk, siç i thoshin ata, pa ditur fare ç'po thonë). Në shek, XVII Evropa i thoshte Tivarit: Bëhu mysliman! Në shek.XIX Evropa i thoshte Tivarit: Pse je bërë mysliman!

-1649. (Në Shestan) Dom Gjergj Vuskoviqi dëshmon se kishte shërbyer rreth 20 vjet në Arbëri si misionar, gjatë të cilëvet kishte hequr mundime e shpenzime shumë të mëdha dhe me jetën, në rrëzik të tij e të familjes së tij. Ai kish qenë sulmuar 2 herë prej turqvet për t'ia prerë kokën. Nuk e kishin gjetur në shtëpi, por i qenë plaçkitur shtëpia dhe gjithë pasuria. (.133)

Atë Gjergj Vuskoviqi rronte midis malesh. Por as atje nuk e linin të predikonte fenë e vet. Fenë e vet dhe, doemos, edhe idetë e veta, të cilat përputheshin me idetë e besimtarëvet të tij dhe që shkonin kundër krejt moralit që përhapte pushteti i osmanëvet.

Mirëpo, studiuesi nuk mund të mos shikojë, në këtë realitet të rëndë të historisë sonë, një të vërtetë edhe më të hidhur se vetë pushtimi, i cili kish ardhur prej kahmosit: Persekutuesit e Atë Gjergj Vuskoviqit nuk ishin, as turq të ardhur nga Turqia, as arabë të ardhur nga Arabia. Persekutuesit e Atë Gjergj Vuskoviqit ishin arbër vendës, ose nga Shestani, ose nga Tivari, ose nga Shkodra. Dhe kjo, doemos, ka qenë shumë e rëndë për krejt popullin tonë.

-1650. Qeveritarët e Tivarit kërkonin plaçka e cohëra të çmueshme dhe klerikët duhej t'i gjenin ato. (f.128)

Korrupsioni ka qenë veçori legale e krejt administratës osmane. Ai fillonte që nga sulltani, me emrin gjithdrejtësisht të justifikueshëm: DHURATË, dhe shkonte me po atë emër deri te nëpunësi më i ulët. Kur vinte puna te përfaqësues të besimit

jomysliman ose te banorë jomyslimanë, kërkesat për “dhurata” kuptohet që e humbnin tërësisht njerëzillëkun.

-Vitet 1660. Në Tivar ka 1 xhami, 1 mesxhide, 1 shkollë (të ulët), 1 medrese. (f.304)

E dhëna që në Tivar ka medrese dëshmon që arsimi oriental, tashmë edhe në këtë qytet, si në të gjithë qytetet e Arbërisë (Arnautistanit), ka marrë një fare zhvillimi. Mirëpo, si është puna e arsimit për popullsinë katolike, të shohim këtu poshtë.

-1683. Në fshatin Shushan ishte Dom Prend Lukiqi me dije gjysmake, në fshatin Zupç ishte Dom Anton Tomazi me dije gjysmake. (f.193)

E keqja ka ardhur nga të gjitha anët: Pushteti është i huaji, jetesa është e vështirë, se pushtetarët e rrjepin popullin me tatime mbas tatimesh, me taksa mbi taksat, me gjoba e me marrje ryshfetesh. Duhet edhe kishës t’i japësh. Populli është pa shkollë. Doemos që, në një grumbull të këtillë të këqiash, edhe revoltat janë të pranishme. Shtoju këtyre edhe një prift injorant, i cili nuk di t’i udhëheqë besimtarët.

Lidhur me 2 fshatrat që përmenden këtu, Shushani dhe Zupçi, do të doja të kishim edhe informacion mbi përkatësinë etnike të tyre. Por kjo fatkeqësisht nuk jepet në relacionet. Emri i meshtarit të Shushanit, Prend Lukiqi, na dëshmon se ai ishte një arbër, madje nga fshati Lukiq i Shestanit. Po besimtarët ç’gjuhë flisnin? Nga emri i meshtarit të Zupçit, Anton Tomazi (ose Tomazeo), marrim vesh që ai nuk ishte sllav, por nuk e dimë konkretisht ç’gjuhë flisnin, as ai, as besimtarët e Zupçit. Në kohën tonë besimtarët e Zupçit flasin sllavisht, por etnokultura e tyre nuk duket kurrsesi të jetë sllave. Është thënë që zupçasit janë me prejardhje nga një krahinë Zupci e Hercegovinës. Por kjo nuk është e argumentuar. Unë mendoj që ata, ose janë një popullsi ilire e romanizuar në shekujt para Dioklecianit, pra shumë heret, ose janë një popullsi kolonësh ramakë, gjithashtu të tejhershëm, mbetur aty edhe pas shpërbërjes së Romës. Por, si shpjegohet që kanë marrë gjuhën sllave? Gjithsesi, ky është problem që do studiuar mirë.

-1684. Brenda murevet të Tivarit kishte 500 shtëpi, prej të cilavet 7 shtëpi katolikësh... Me ata jashtë, numri arrinte në 35 shtëpi të krishtera. (f.59-60)

100 vjet më parë, në vitet fill pas pushtimit osman, pra pas vitit 1571, tivari ish katandisur në madhësinë e një fshati, me 77 shtëpi. (Shih atje.) Tani vëmë re një gjashtëfishim të numrit të shtëpivet, por, tashmë, familjet që banojnë në ato shtëpi, nuk janë të krishtera. Pyetja shtrohet: A janë përgjithësisht familje vendëse, tivarase dhe nga rrethinat, apo janë banorë të ardhur. Historiografia malazeze e ka parë këtë punë cekët dhe njëanshëm, duke e konsideruar popullsinë myslimane të Tivarit, ashtu si edhe atë të Ulqinit, një popullsi të ardhur. Unë po përsëris atë që thashë pak më lart: Gjithsesi, ky problem do studiuar mirë.

-1701-1712.(Imz.Vinçenc Zmajeviqi, arqipeshkëv i Tivarit, 1701-1712, shkruan se) disa persona në famullitë e Briskut e të Shestanit, për shkak të tributevet, kishin qenë të detyruar të praktikonin në të njëjtën kohë besimin katolik dhe atë mysliman. (f.165)

Do të jetë fjala për disa familje të Thtjanit. Unë nuk e di të ketë pasur kriptokatolikë në ndonjë fshat tjetër të këtyre famullive. Sidoqoftë, është edhe kjo një dëshmi që feja e pushtuesit ushtronte presion mbi fenë e popullit tonë, të pushtuar.

-1738-1739, 1744. Pas kryengritjes, 1738-1739, në krahinën e Shestanit, në vitin 1744, kishin mbetur 2 klerikë, kurse të tjerët ishin larguar, se konsideroheshin si nxitës apo drejtues të kryengritjes. (f.189)

Marrim vesh kështu, që, edhe pas eksodit të shetanasvet drejt Dalmacisë, në vitet 1726-1733, eksod që i pat përgjysmuar banorët e këtyre maleve, në këtë krahinë, sigurisht, së bashku me të tjerat, paska pasur kryengritje antiosmane. Është detyrë e studiuesvet t'i hetojnë më me imtësi të këtillë informacione, duke u mbështetur, sigurisht, edhe në burime të tjerë.

-1738-1739, 1744. Sipas relacionit të V.Zmajeviqit, më 1744-n qyteti i Tivarit banohej nga myslimanë e katolikë. Me rastin e

rrethimit të kështjellës së Tivarit, katolikët u përzunë nga qyteti. Brenda murevet rrethues mbeti shtëpia e vjetër dhe e famshme fisnike Borishi. I pari i tyre kishte braktisur fenë e krishterë, kurse i vogli, i shpëtuar nga arqipeshkvi, aspironte të pranohej në kolegj. (f.314)

Nxjerrim 2 konkluzione prej këtij dokumenti: 1.Me gjithë diskriminimin fetar të pandërprerë 173-vjeçar, 1571-1744, prapëseprapë në Tivar ka ende katolikë, madje edhe nga familjet shumë të hershme. 2.Kalimi në Islam i pinjollit pikërisht të një të tillë familjeje të moçme tivarase demanton pohimet që banorët myslimanë të këtij qyteti ishin të ardhur.

-1744. Nga banorët katolikë të fshatravet Kllezën, Bukmirë, Shas, Selitë, Sumë e Braishë, gjendeshin skllevër në Ulqin 20 frymë. (f.318)

Ndonëse nuk lidhet ngushtësisht me trevën e Tivarit, e solla këtë të dhënë, për të kujtuar, për të mbajtur parasysh që ende në shekullin XVIII ekzistonte në shtetin osman tregtimi me skllevër. Shiteshin njerëzit. Në këtë rast, fill pas shtypjes së një kryengritjeje, shiteshin katolikët, të zënë robër.

-1744. Një pjesë të kishavet të komunitetit katolik filluan të përdoren nga skizmatikët. Një dukuri e tillë ndodhi në zonën e Tivarit, në Pashtroviq etj. (f.122)

Ndërsa, nga njëri krah rëndon islamizimi, dmth, jo vetëm tjetërsimi fetar, por humbja edhe e një vargu veçorish etnokulturore të moçme, por duke ruajtur gjuhën, nga krahu tjetër, vazhdon uzurpimi i kishavet nga pravosllavët, dmth, tjetërsimi fetar, i filluar 525 vjet më parë (1219) e bashkë me të edhe tjetërsimi tërësor etnokulturor i besimtarëvet, duke e humbur edhe gjuhën. Në kishat e Spiçit shërbehej mesha me 2 altarë: Njëri i ritit katolik, tradicional, tjetri, në formë invazioni, i ritit pravosllav.

E megjithatë, me gjithë të gjitha këto që u kanë pare sytë banorëvet të stërlashtë të këtij vendi e që ne e kemi shumë vështirë t'I konceptojmë e t'I përfytyrojmë, në mesin e shekullit XVIII, pikërisht në vitin 1744, gjendja demografike e katolikëvet është kjo:

-1744. Në qytetin e Tivarit: 78 shtëpi (familje**), me 206 frymë; Zupç: 36 shtëpi, me 202 frymë; Togjemil: 12 shtëpi, me 98 frymë; Shushan: 69 shtëpi, me 358 frymë; Spiç: 39 shtëpi, me 297 frymë; Kështjellë e Lastvës: 13 shtëpi, me 98 frymë; Brisk: 15 shtëpi, me 99 frymë; Thtjan: 4 shtëpi, me 31 frymë; Ljare: 21 shtëpi, me 178 frymë; Pinç: 55 shtëpi, me 86 frymë; Lukiq: 6 shtëpi, me 51 frymë; Gjuraç: 9 shtëpi me 77 frymë; Bujgër: 7 shtëpi, me 62 frymë; Gurrzë: 10 shtëpi, me 107 frymë; Rud: 5 shtëpi, me 35 frymë. (f.89)**

Pinçi, o banohet thuajse tërësisht me pleq e të rinjtë kanë ikur, o janë të dhënat gabim. Në Tivar, duket se banorët katolikë janë shtuar disi në lagjet jashtë kështjellës, por prapë familjet janë me më pak se 3 pjesëtarë. Të gjithë fshatrat, përveç Pinçit, i kanë familjet me mbi 7 e mbi 8 pjesëtarë. Gurrza, madje ka mesatarisht mbi 10 pjesëtarë për familje.

Mungojnë në këtë regjistër fshatrat: Brisku, pas gjasës, i Sipërmi, Dobreci, Muriqi i Poshtëm, Muriqi i Sipërm, Nënmali, Dedanjt, Bardhanjt, Besi, Sozina, por edhe vendbanimet rreth Tivarit: Maranjt, Sustashi, Velemuzi, Turçini, Mikuliqi, Tomba, Zalefi, Ujmiri (Dobrovoda), Tivari Poshtë, Bartulla, Podi.

-1770-1771. Nga krahinat e Ulqinit dhe të Tivarit u kërkua xhizja në masën 1500 grosh esedi. (f.153)

Xhizja ishte tatimi, taksa, që i paguanin shtetit osman të krishterët. Nëse ishe i krishterë, pra, duhej të paguaje, duhej ta blije besimin tend. Në shek. XVIII duket se shteti osman nuk ish i kënaqur me shkallën e islamizimit në Tivar e Ulqin, prandaj e kish rritur xhizjen.

3

REFERENCAT TE: Prof.Dr. Pavle Mijoviq,

VIRPAZAR, BAR, ULCINJ, f.11-29.

VIRPAZAR, BAR, ULCINJ

Obod, Izdavačko-štamparsko preduzeće

Cetinje-Beograd. 1974.

Libri ***Virpazar, Bar, Ulcinj (Vir, Tivar, Ulqin)*** është një vepër voluminoze me 600 faqe, format më i madh se A4, saktësisht 30x24 cm.

Nga f.11 deri në f.57 ka një studim të Dr.Pavle Mijoviqit me titull ***Vječno na Krajini (Përjetësisht në zonë kufiri)***.

Nga f.61 deri në f.98 ka një studim nga një profesor i historisë të gjimnazit të Tivarit, Gojko Vukmanoviq, me titull ***Razvoj revolucionarnog pokreta… do 1941.g.*** (***Zhvillimi i lëvizjes revolucionare… deri më 1941-shin***.)

Nga f.99 deri në f.173, janë kujtime autorësh të ndryshëm mbi periudhën midis 2 Luftëravet Botërore.

Nga f.175 dheri në f.219, është prapë profesori Gojko Vukmanoviq me studimin ***Narodnooslobodilački rat i Revolucija 1941-1945***. (***Lufta Nacional-çlirimtare dhe revolucioni 1941-1945***)

Nga f.221 deri në f.507, janë kujtime autorësh të ndryshëm nga koha e Luftës II Botërore.

Nga f.511 deri në f.553, janë emrat e viktimavet të Luftës II, emrat e dëshmorëvet dhe biografitë e heronjvet.

Prej f.557 deri në aqen 593, autorja Radmilla Kërcunoviq, me titull ***Na tekovinama Revolucije (Frytet e Revolucionit)***, ka përshkruar shkurt ndërtimet që janë bërë në hapërën Vir,Tivar, Ulqin, në vitet pas Luftës II Botërore.

Libri është rëndësishëm, për të njohur zhvillimet dhe gjendjen në këta 2 qytete të Shqipërisë Veriperendimore (Tivar e Ulqin) dhe në trevat rrotull tyre, në periudhat midis 2 Luftërave, gjatë Luftës II dhe pas Luftës II. Është i rëndësishëm dhe prandaj do të duhej përkthyer i tëri.

Por unë do të merrem këtu vetëm me pjesët që lidhen me Tivarin dhe komunën e sotme të Tivarit, duke plotësuar ç'të mundem nga ato që autorët malazezë kanë lënë mangut dhe duke korrigjuar ato që ata i kanë trajtuar gabim.

Me autorët malazezë, ashtu si edhe me ata sërbë, është tepër vështirë të punohet. Karakteristikë kryesore e tyre është: Të seleksionuarit e faktevet dhe të interpretuarit e atyre fakteve, ashtu siç mendojnë ata se është në interes të politikavet të tyre nacionale. Them: ***ashtu siç mendojnë ata***, sepse, në realitet, një i tillë trajtim i historisë shkon në dëm, jo vetëm tonin, si fqinjë të tyre, por edhe në dëm të vetë atyre, dmth në dëm të vetë kombit malazias. Kombet i çon përpara vetëm të trajtuarit me vërtetësi të atyre që tashmë kanë ndodhur dhe që s'mund të ndryshohen më.

-"Përjetësisht në zonë kufiri." (f.11)

-"Territorin më të gjërë të 2 qytetevet të mëdhenj e të lashtë, të Tivarit e të Ulqinit, asgjë s'e karakterizon më bukur se emërtimi i tij historik 'Krajina'... shqip: *Kranjë, Krahinë*, të cilën e përmend në shek.XII, *Kronika e Pop Duklaninit* (*... in loco qui Craini dicitur*, kreu XXXVI)" (f.11)

Emërtimi topik ***KRANJË,-A***, nuk i përfshin as Tivarin, as Ulqinin. Ai emërtim lokalizohet vetëm në trevat midis Liqenit të Shkodrës dhe kreshtavet malore që i ndajnë këto treva nga rrethinat e Tivarit e të Ulqinit. Emri topik ***KRANJË,-A***, vjen nga emri anatomik i arbro-shqipes: ***KRAH***, me kuptimin: ***ANË***, ***pjesë e një vendi***, dhe është më shumë krijim i popullsisë së Shkodrës, sepse ajo popullsi i kish **NË KRAH** trevat pranë Liqenit, sesa krijim i tivarasvet apo ulqinakëvet, që trevat anash Liqenit i kishin **PRAPA MALEVET**.

Shprehja: "**përjetësisht**" nuk pasqyron të vërtetën historike, sepse ky rrip toke midis Detit Adriatik dhe Liqenit të Shkodrës, përfshirë aty edhe **KRANJËN**, në pjesën më të madhe të historisë nuk ka qenë "**zonë kufitare**". Madje, në shumë raste, këto hapësira, kanë qenë **QENDRA** të shtetevet, kërthiza e shtetevet. Nuk e di përse i përdor të këtillë sajime Dr.P.Mijoviqi, kur dihet që ai është një njohës i mirë i historisë.

Dr.P.Mijoviqi thotë: "**Fjala sllave *KRAJISHNIK* ka hyrë edhe në poezinë popullore shqiptare me formën *KRESHNIK*, me kuptimin: *trim*(f.11)**." Mirëpo, këtu do sqaruar më parë, që vetë fjala ***KRAJ*** ka shkuar në gjuhët sllave nga iliro-arbro-shqipja. Pra, në thelb, fjala ***KRESHNIK*** nuk është një fjalë sllave.

Dr.P.Mijoviqi ka përdorur këtu edhe shprehjet: "**kjo krahinë e jona", "të kësaj krahinës sonë"(f.11)**. Kur thotë kështu, ai sigurisht ka parasysh zotërimin **SHTETËROR** të kësaj krahine prej sllavëvet, prej malazezëvet, filluar prej vitit 1878 e këndej, periudhë që në historinë mijëravjeçare të këtyre hapësirave, s'përbën as 0,5% të kohës. Nuk është mirë të shprehet kështu një historian, i cili e di më mirë se kushdo që kjo krahinë **GJEOGRAFISHT** i përket Shqipërisë. Këto 2 shprehje do t'i shkonin zotit P.Mijoviq, vetëm nëse ai do të ishte një shqiptar. Tivari, Ulqini, Ana e Malit, Bregu i Bunës, Kranja, Shestani, **GJEOGRAFISHT, HISTORISHT, ETNISHT**, janë **TË SHQIPTARËVET**. Vetëm **SHTETËRISHT** kjo hapësirë i është dhënë **MALIT TË ZI**. Prandaj, nuk duhet ngutur, për ta përdorur përemrin pronor: ***YNË, JONË*** etj. Nuk do ngutur, sepse, nga njëra anë përbën provokim, në anë tjetër, shpreh një lloj frike:

"***Po të themi të vërtetën, mos po çohen shqiptarët e po na kërkojnë lëvizje kufijsh?"***

-"Venediku e nguli gozhdën në trupin e shtetit të vogël mesjetar të Zetës dhe Malit të Zi, shtet i cili i ishte mbështjellë Rumisë më të 2 krahët." (f.11)

Në historiografi do të duheshin lënë mënjanë shprehjet letraro-artistike. Megjithatë, po i pranojmë edhe **"të ngulurit e gozhdës"**, edhe **"të mbështjellurit rreth Rumisë"**. Por shteti i Zentës Mesjetare nuk është e njëjta gjë me Malin e Zi të mëvonshmin. Unë mendoj se historiografia malazeze duhet njëherë e mirë ta zgjidhë problemin: A ishin Balshët sllavë apo arbër e, disa prej tyre, dhëndurë sllavësh? Në librat malazias duhet thënë prerë dhe shkoqur: Balshët, a ishin Balshiq apo Balshë? Nëse ishin Balshiq, kjo duhet vërtetuar dhe argumentuar. Shteti Mesjetar i Zentës, dmth shteti që krijuan Balshët pas Perandorisë Sërbe të Car Dushanit, a do të mund të quhej shtet i malazezëvet, edhe nëse për Balshët do të vërtetohej se janë një dinasti sllave? Përveç kësaj, Dr.P.Mijoviqi shtetin e Zentës Mesjetare e quan **"të vogël".** Për cilën fazë të ekzistencës së këtij shteti e ka fjalën?

"Deri në luftërat çlirimtare 1860-1878, krejt ky territor ka qenë një trekufijsh midis Turqisë (Godenjë, Selcë, Krricë, Shestan, Muriq, Tivar, Ulqin e Ana e Malit), Austrohungarisë (Spiçi) dhe Malit të Zi (Cërrnica) (f.12)

Prof.P.Mijoviqi e ka përdorur këtu krejt të pasaktë shprehjen "**Luftërat çlirimtare**". Shprehja e saktë do të ishte: "***luftërat për pushtimin e këtyre territoreve nga Mali i Zi***". Sepse dihet që krejt viset e Tivarit, Ulqinit, Anës së Malit dhe Shestanit, në vitet 1860-1881, janë pushtuar prej Malit të Zi dhe këtë të vërtetë nuk ka pse të mos e pohojë, me objektivitet, vetë historiografia e Malit të Zi. Do të ish në nderin e z.P.Mijoviq ta kish shkruar pikërisht kështu këtë fjali.

"Atje (në Zarë të Dalmacisë) **ata kanë themeluar një vendbanim, të cilit, në kujtim të Arbëneshit nën Tarabosh, i kanë vënë emrin Arbanasi." (f.12)**

Është fjala për popullatën arbneshe, të shpërngulur në gjysmën e parë të shekullit XVIII nga viset prej Briskut deri në Shestan, në Zarë të Dalmacisë. Z.P.Mijoviq bën edhe këtu një pohim shumë të pasaktë. Lagjja me emrin Arbnesh (Arbanasi) e

Zarës nuk e ka marrë emrin prej fshatit Arbnesh të Kranjës, por prej faktit që krejt ajo popullatë e shpërngulur prej këndej ishte një popullatë arbneshe.

Emri Arbnesh i njërit prej fshatravet të Kranjës, për mendimin tim, do të ketë lidhje me ndonjë familje të Arbërisë Pasgjergjkastriotase, e cila, e nisur, me shumë arbër të tjerë, për të kaluar në Dalmaci e prej andej në Itali, është ndalur dhe ka jetuar aty, duke i dhënë atë emër fshatit ku ka zënë vend. Por kjo është vetëm hamendje.

"Ndërsa midis 11 mijë të shpërngulurvet në Istri, ka pasur 362 arbër nga rrethina e Tivarit dhe Ulqinit dhe 2 mijë malazezë, midis të cilëvet, më 1659-n, Vuçeta Dupillo kish çuar 8 familje" "prej Dupilet, tokë turke në kufi me Arbërinë". (f.14)

Fakti që Dupila, fshat i Cërrnicës, konsiderohet "***tokë turke***" "***në kufi me Arbërinë***", ka domethënie të rëndësishme historike. Të 2 këta vende, edhe Dupila, dmth Cërrnica, edhe Arbëria, janë të pushtuar nga Turqia, megjithatë, kufiri midis tyre është qartësisht i përcaktuar. Këndej duhet të nxiret edhe konkluzioni, nëse mësymja ushtarake e Malit të Zi, 200 vjet më vonë, përtej këtij kufiri ka qenë çlirim apo pushtim.

Bie në sy edhe numri shumë i pakët i arbërvet, vetëm 362 frymë midis 11 mijë të shpërngulurish. Nuk e dimë si është nxjerrë dhe pse është vënë kjo shifër. Nëse kanë qenë vërtet aq pak arbër, as që ish nevoja të shënoheshin. Por nëse të 9 mijë të shpërngulurit e tjerë kanë qenë arbër nga krahina të tjera të Arbërisë e jo nga Tivari e Ulqini, kjo duhej theksuar. Madje, duhej analizuar, si ka ndodhur që, bashkë me 9 mijë arbër, të ikur nga represioni osman, kanë emigruar edhe 2 mijë malazezë.

"Kjo më e lashta krahinë e tokës sonë... mbas çlirimit të Tivarit e Ulqinit dhe daljes së Malit të Zi në det, ... është emërtuar Kranja e Malit të Zi (Cërrnogorska Krajina)" (f.14)

Në këtë fjali ka 2 të pavërteta dhe 1 të vërtetë. E pavërteta e parë është, që këta territore malazezët i quajnë "***tokë të tyren***", madje "***të lashtën krahinë të tokës së tyre***". E pavërteta e dytë është se prapë autori **PUSHTIMIN** e Tivarit e Ulqinit e quan **"*çlirim*"**. Konstatimi i tretë, këtë herë i vërtetë, është se treva e Kranjës është quajtur "***Kranja e Malit të Zi (Cërrnogorska***

Krajina)", vetëm **MBAS PUSHTIMIT**. Përndryshe, emri i vërtetë, tradicional, i kësaj krahine ka qenë dhe është: ***Kranja e Shkodrës***, që malazezët duhet ta thërrasin: ***Skadarska Krajina***, ashtu siç edhe thërrasin ***Liqenin e Shkodrës***: ***Skadarsko Jezero***. Është absurde të përdorë i njëjti popull njëkohësisht edhe ***Skadarsko Jezero*** (Liqeni i Shkodrës), edhe ***Cërrnogorska Krajina*** (Kranja e Malit të zi).

"Sipër zonës (së ulët, rreth Tivarit), zgjatet vargmali, të cilin e përbëjnë: Sozina me Majën e Vërsutës (1183m), Sutormani me lartësinë Lanec (1163m), Rumia (1593m). Midis Lanecit dhe Vërsutës ka një qafë mali me lartësinë 884m, ndërsa midis Sutormanit dhe Rumisë, qafa tjetër (që quhet) Shkalla e Bardhë (903m)" (f.14)

Prof.P.Mijoviqi i thotë këta oronime në gjuhën e tij. Nuk i thotë në original, në gjuhën e vendit dhe, veç kësaj, ka edhe disa të tjera pasaktësi: Maja e Vërsutës nuk i takon Malit të Sozinës, por Sutormanit. Laneci nuk i takon Sutormanit, por është vazhdim i kreshtavet të Rumisë. Shkalla e Bardhë nuk ndan Sutormanin e Ruminë.

Pasaktësi të këtilla, që janë rezultat e mosnjohjes së plotë, mund t'i ndodhin cilitdo dijetar, por sidoqoftë, është mirë të vihen në dukje.

Po e theksoj edhe njëherë: Emrat e vendevet, toponimet, pavarësisht etimologjisë së tyre, sllavët ardhës i kanë marrë prej shqiptarëvet vendës dhe, ose i kanë përkthyer, psh Shkalla e Bardhë – Bijella Skalla, shpeshherë edhe gabim, psh Lanec, që ka në rrënjën e vet emrin LANDË, pyll, "përkthyer" në Llonac, që do të thotë: kazan, ose, kur nuk kanë mundur t'ua gjejnë kuptimet, qoftë edhe gabim, i kanë përdorur pa i ndryshuar: Sozinë, Sutorman, Rumi.

"Brezin ranor pranë detit e përbëjnë kokërza shumë të imta kuarci, të cilat sillen këtu prej rrjedhës së epërme të Drinit, që gjendet në Shqipëri." (f.14)

Këtu hasim në një gabim që e bëjnë thuajse të gjithë shkrimtarët e kohës sonë: Ata përdorin, për terma gjeografikë termat administrativo-shtetërorë. Kështu, edhe këtu është thënë: "***në Shqipëri***" në vend që të thuhej: "***në Rep.Pop.Soc.të Shqipërisë***". Do thënë kështu, sepse edhe Tivari, edhe Ulqini, sado që ata janë sot

pjesë e shtetit malazias, gjeografisht gjenden dhe mbeten në Shqipëri. Kjo do korrigjuar me doemos, sepse, po s'u korrigjua, krijon injorancë, keqkuptime, dhe ushqen urrejtje ndër brezat që vijnë.

"Në pjesën më të madhe (Buna) ndan kufirin midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë." (f.15)

Edhe këtu hasim prapë në të njëjtin gabim koncepual, sepse duhej thënë: "***midis RFSJ-së dhe RPSSH-së***". Kështu duhen korrigjuar këto shprehje, si dhe shumë të tjera, gjatë gjithë librit.

"Pas gjetjes së mozaikëvet në Fushën e Tivarit, mund të rikonstruktohet pamja e Kohës së Romës, e pastaj ajo e Shfrytëzimit Agrar Bizantin. Si dhe të gjitha fushat pranëdetëse në bregdetin e Malit të Zi, edhe këto në territorin e Tivarit e të Ulqinit, u kanë qenë dhënë veteranëvet ushtarë dhe eprorë të ushtrisë romake, që aty të realizonin prodhimin e drithëravet." (f.17)

I gjithë ky pasazh ka nevojë të rishikohet dhe t'u nënshtrohet analizavet përkatëse shkencore: Ushtarët e liruar remake, ç'përbërje etnike kishin? Sipërfaqet që iu dhanë atyre, a i patën zënë krejt tokat e këtushme? Skllevërit, që i punonin ato toka, a ishin edhe ata romakë? Duke u hedhur nga koha antike në kohën tonë, do shtruar e do sqaruar njëherë e mirë kjo pyetje: A është e rregullt të quhet: "***Bregdeti i Malit të Zi***" kjo pjesë Shqipërisë Veriperendimore dhe deri kur do të vazhdojë kjo terminologji spekulative?

"Në kohën e shtegtimit të sllavëvet, prej shekullit VI deri në shekullin IX (fushat në trevat përrreth Rumisë) i kanë mbushur vërshimet me sasi të mëdha zhavorri dhe me prurje karstike, gjë që i ka bërë (këto fusha) joprodhuese." (f.16-17)

Bindja që sllavët janë vendosur në Dioklenë e dikurshme dhe në Zentën e mëvonshme në mënyrë masive duhet rishikuar shumë seriozisht. Sllavët nuk kanë shtegtuar dhe nuk janë vendosur në këto hapësira në sasi dominuese, as në shekullin VI dhe as më vonë, nga shekulli VII deri në shekullin IX, madje as në 2 shekujt e sundimit në këto anë të dinastisë sërbe të Nemanjiqvet, prandaj s'besoj të

kenë lidhje me këtë lloj migrimi, as gjendja e fushavet, dhe as mbushja e tyre me sasi të mëdha zhavorri prej vërshimevet.

"Meliorimi i këtyre fushave është kryer në shekujt X-XI." (f.17)

Sa është i vërtetueshëm ky pohim dhe kush e bëri meliorimin e këtyre fushave? Mos do të thotë këtu autori tërthorazi, se meliorimin, përmirësimin, e këtyre fushave e kanë bërë sundimtarët sllavë të dinastisë Vojisllavleviq?

"Aq sa në pikëpamje tektonike (Kranja) ka qenë e varur prej huqevet të ashpër të natyrës, aq edhe në pikëpamje historike është varur prej fatevet të paparashikueshëm e të vrazhdtë të jetës së vet të përjetshme në kufi." (f.18)

Kranja ka qenë **përjetësisht** e vendosur në KRAH të Shkodrës. (Këndej vjen edhe emir i saj.) Kufiri që është vendosur midis Shkodrës dhe Kranjës në vitin 1913, nuk është aq i lashtë sa jeta në Kranjë të mund të quhet: "***Jetë "e pëjetshme në kufi***". Në krahun tjetër të Kranjës ekziston një kufi edhe më i hershëm, ai me Cërrnicën. Këtë kufi me Cërrnicën e kanë shkaktuar dhe krijuar: pushteti i Nemanjiqvet të Sërbisë dhe Kisha Pravosllave Sërbe. Pse Prof.P.Mijoviqi nuk vë re që Cërrnica ka qenë dënuar deri në vitin 1978 të gjendet në kufi? Sidoqoftë, asnjëri prej këtyre kufijve s'ka qenë i përjetshëm.

"E tillë, gjithë kontraste e plot ndërrime, e mbushur thërrmijash të gjithfarë qytetërimeve dhe kulturave, herë e hapur, here e mbyllur, por më së shpeshti e prangosur e kundërshtivet të 3 religjioneve dhe gjuhëve, ajo (Kranja) është vetëvetiu një konglomerat i jashtzakonshëm antropogjeografik dhe antropologjik." (f.18)

Ky është karakterizimi i trevës së Kranjës prej një shkencëtari malazias. Pyetja që shtoj është kjo: Sa i informuar është për Kranjën ky shkencëtar? Në thelbin e vet Kranja nuk mund të konsiderohet kurrsesi konglomerat qytetërimesh e gjuhësh. Sado që në historinë e saj ka pasur ndikime pushtuesish të ndryshëm, në thelbin e vet Kranja ka qenë e ka mbetur iliro-arbro-shqiptare.

"Njeriu i kësaj krahine" (Këtu, me fjalën krahinë, autori ka përfshirë krejt rripin midis detit dhe liqenit) **"në krejt historinë e vet ka qenë një**

ndërtues i madh. Nërtimi madhështor i Olciniumit antik dhe i Tivarit mesjetar, simbas shkallës së urbanizimit, mund të renditen midis arritjevet më të përsosura ndërtimore të së kaluarës." (f.18)

Vlerësimi këtu është në nivelin e duhur. Vihet re që Z.P.Mijoviq e ul veten si shkencëtar vetëm atje ku, ndoshta edhe për inerci ose nga mosnjohja, u përshtatet qëndimevet kundërshqiptarë.

"Olcinium-Ulqini dhe Antibarens-Tivari përfaqësojnë ilustrimin më të bukur të energjisë së egër luftarake dhe të energjisë këmbëngulëse ndërtimore të kreshnikut të Nënrumisë." (f.18)

Edhe këtu, z.P.Mijoviq, ka rënë viktimë e shpjegimit të gabuar të fjalëvet ***KRANJË*** dhe ***KRAJISHNIK***. Ndërsa vlerësimi për Ulqinin dhe për Tivarin e lashtë është ai që duhet të jetë, ne nuk duhet të mbetemi të sigurtë, se themelet e Tivarit janë të Mesjetës e jo të Antikitetit.

"Kjo popullatë ilire, e zhdukur, ka lënë gjurmë të thella në kulturën materiale dhe shpirtërore të pasardhësvet të saj shqiptarë, e pjesërisht edhe te sllavët e ardhur, për çfarë është ky territor shumë i rëndësishëm për hulumtimin e kontaktevet kulturorë dhe të ndikimevet të ndërsjellë të këtyre 2 etniteteve sa të ndryshëm, aq edhe të ndërfutur te njëri-tjetri në rrjedhë të kohëve." (f.18)

Ky është një nga vlerësimet më objektivë shkencorë të z.P.Mijoviq, përjashtuar ndoshta shprehjen: ***"kjo populatë ilire e zhdukur"***. Unë nuk konsideroj që popullata ilire është zhdukur. Unë mendoj që ilirët janë transformuar ndër shekuj, deri sa përfundimisht është kristalizuar Kombi Shqiptar, ky që jeton sot. Veç kësaj, unë do të thosha që, jo ky territor, por veçanërisht Mali i Zi i Moçmi (Stara Cërrna Gora), është tejet i rëndësishëm për të hulumtuar kontaktet kulturorë dhe ndikimet e ndësjelltë midis iliro-arbërvet lashtovendës dhe sllavëvet të ardhur.

"Sot konsiderohet që në viset malorë të paarritshëm të Shqipërisë Qendrore, në provincën e atëhershme romake Epiri i

Ri, ka mbijetuar një pjesë e fisit, të cilin Ptolemei (shekulli II) e quan Albanon." (f.18)

Pikërisht këtu qëndron thelbi I interpretimit më të shtrembër të mundshëm të një informacioni: Ptolemei ka përmendur në shekullin II "fisin" Albanon dhe thuaj çfarë të ta marrë mendja pas këtij informacioni. Po sikur të mos ish fare ai informacion, çfarë do të thuhej në lidhje me arbërit e Mesjetës?

"Përkundër faktit që në kolonizimin shumëshekullor të Romës, janë zhdukur ilirët, duket se madje edhe mbas pranimit të krishtërimit, ndonëse e dobët, vazhdimësia ilire në malet e pashkelshëm të malësorëvet të Shqipërisë, nuk ka qenë ndërprerë asnjëherë." (f.19)

Shohim këtu pranimin e vazhdimësisë ilire të arbërvet, por nën një prizëm tejet dritështrembërues. Se si u shumuan më vonë këta malësorë të malevet të paarritshëm dhe se si e krijuan gjithatë popullsi të madhe arbërore në Antikitetin e Vonë dhe në Mesjetë, këtë doemos duhet t'ua lëmë ta shpjegojnë spekullantëvet të teorisë së Shtadtmyllerit. Se nga dolën gjithata perandorë ilirë të Romës në shekujt III, IV dhe V, këtë duhet ta kalojmë në heshtje, sepse, ose nuk dimë ta shpjegojmë, ose nuk na levërdis ta shpjegojmë. Shprehja ***"kolonizimi shumëshekullor i Romës"*** është aq skolastike, sa njeriu çuditet si nuk e bëjnë këta historian të paktën 1 pyetje fare të thjeshtë: A aq shumë qenë shtuar latinët në Itali dhe a aq shumë u varfëruan ata latinë, sa të iknin nga Italia e të vendoseshin në fushëzat e varfëra rrëzë Vergmalevet Dinarikë?! 1 apo 5 veteranë, edhe ata shumica jolatinë, nuk mund ta realizonin "***misionin***" e "***kolonizimit***" të një vendi. Në Tivar e në Ulqin nuk ka mbizotëruar kurrë elementi i ardhur romak. Në qytetet Tivar e Ulqin, ashtu si në Shkodër, Kotorr e gjetkë, mund të flitet vetëm për një përdorim luksoz të gjuhës latine prej një shtrese mendjemadhe qytetarësh vendës. E kjo kurrsesi nuk do të thotë që ata qytetarë ishin kolonë.

"Sot albanologët bëjnë përpjekje të mëdha për të marrë vesh çfarë ka në etnogjenezën e këtij populli (e popullit shqiptar) **prej burimit ilir, çfarë prej burimit dako-thrakas, çfarë prej burimit iliro-romak dhe çfarë është bizanto-sllave." (f.19)**

Është e vërtetë që shkenca ka për detyrë të zgjidhë disa nga problemet e mësipërm, por unë mendoj që këta probleme nuk janë dhe aq të vështirë për t'u zgjidhur. Madje nuk janë as aq thelbësorë, sa ç'është psh problemi: Çfarë kanë marrë sllavët prej popujvet të lashtë të këtij gadishulli? Është shumë më e rëndësishme të dihet ç'kanë marrë sllavët prej ilirëvet, prej dakëvet, prej thrakasvet, prej grekëvet apo prej latinëvet, se sa ç'kemi marrë ne këtu prej njëri-tjetrit.

"Tezën mbi ardhjen e shqiptarëvet nga Dardania fqinje". (f.19)

Nuk e mora krejt fjalinë, sepse do të lodheshin lexuesit me ngatërresat, të cilat, me sa duket, politika e sotme sërbe në drejtim të Kosovës përpiqet t'i transferojë edhe në historinë e lashtë të Kombit Shqiptar. A kanë ardhur paraardhësit e shqiptarëvet nga Dardania apo kanë shkuar ca arbër të mëvonshëm në Rrafsh të Dukagjinit e në Kosovë?! Janë mirëfilli dërdëllitje infantile dhe njeriu çuditet: Si mund t'i shkruajnë shkencëtarët e mirëfilltë, siç edhe është z.P.Mijoviq, të këtilla fjali, para se të hedhin firmën mbi atë çfarë kanë shkruar?

Të rropatesh për t'i paraqitur dardanët të ndryshëm nga pirustët apo albanët, sepse po dashkan të zbresin në Kosovën e shekullit XX ca sërbë të Çaçakut dhe ca malazezë të Vasojeviqit, kjo vërtet e ul shkencëtarin në nivelin e një agjitatori nga më të rendomtët. Të pretendosh që Tivarin e kanë pasë populluar sllavët qysh në shekujt VI-IX, për të përligjur ardhjen e ca beogradasvet në Utjehë apo e ca të tjerëvet aty në Topolicë, kjo prapë e ul shkencëtarin në nivelin e një agjitatori.

"Me ardhjen e sllavëvet, në shekujt VI-IX, krejt territory i Ballkanit ka qenë mbuluar me një lëvore të re etnike. Në atë kohë edhe ka mbizotëruar toponimia sllave në Arbëri." (f.19)

Teza që sllavët, në shekujt VI-IX, e kanë përmbytur Gadishullin e Ilirisë, është e gabuar themelisht, madje është shtrembëruar qëllimisht një realitet krerjt tjetër i atyre shekujve.

I.Në shekullin VI sllavët i kanë kaluar Danubin dhe Savën, duke ndjekur nga pas avarët, por nuk janë vendosur për të jetuar në këto hapësira. Ata, depërtonin në thellësi të tokavet të Perandorisë Romake Lindore, shkonin deri në Jug, plaçkitnin, digjnin, shkretonin dhe ktheheshin në kampet e tyre në veri të lumenjvet Danub dhe Sava. Për të gjitha këto ka dokumente të mjaftueshëm.

II.Sllavët që u vendosën në këtë gadishull në shekullin VII, me leje të peranorit, nuk e mbuluan vendin ***"me lëvore të re etnike",*** por u vendosën nëpër enklava të quajtura sklllavini dhe aty jetuan për më shumë se 3 shekuj.

III.Shekulli IX është vetëm fillimi i mbizotërimit të elementit sllav në këto hapësira dhe kjo ka ndodhur, sepse atij populli iu dha shkrimi, me anë të të cilit ai popull u bë i krishterë dhe, si i tillë, duke pasur një shkrim të vetin dhe një kishë të vetën, arriti të krijojë edhe shtetet e vet.

IV.Toponimet me veshje sllave në Arbërinë e Jugut, po edhe në pjesë të tjera të Arbërisë, e kanë zanafillën nga shekulli X e këndej e jo nga shekulli VI-IX.

Cili është synimi i Prof.P.Mijoviqit që na i servir të këtilla teza, nuk është vështirë të kuptohet, por është vështirë të pranohet që edhe shkencëtarë të tillë të palodhur të mund të shndërrohen në perhapës të zakonshëm hedhurinash mbi faqet e historisë, në vend që ato hedhurina t'i pastronin.

"As sllavët, si dhe romakët më parë, e në fund as turqit, nuk ia kanë arritur që t'i shmangin plotësisht shtresat autoktone të krijuara për një kohë të gjatë në përbërjen etnike të arbërvet." (f.19)

Ky është një pohim I mbështetur në një të vërtetë të madhe historike. Prof.P.Mijoviqi e pranon këtë të vërtetë dhe bën mire, por unë do të shtoja edhe këtë: Sikur ilirët të kishin praktikuar shkrimin e vet, siç paten bërë grekët dhe latinët, asnjë lloj pushtimi dhe asnjë lloj asimilimi nuk do të kish mundur ta tkurrte këtë popull në gjendjen që e pa veten në shekullin XIX.

Edhe pohimi pauses i z.P.Mijoviq që **"nuk ka as popuj të pastër, as raca të pastra, as gjuhë të pastra, as kultura nacionale të pastra" (f.19),** është i saktë dhe kjo vlen në mënyrë të veçantë për kombin malazias, të cilit z.P.Mijoviq i përket.

Duke folur për varrezën parahistorike të Mielles në Vir të cërrnicës dhe për varrezën Kalaja e Dalmacës të Komanit, Prof.P.Mijoviq, pohon që në të 2-ja këto varreza kemi të bëjmë me një përzierje të etnosit iliro-arbëror me etnosin sllav.

"Nekropoli i Mielles dhe i Komanit janë dëshmi e jashtzakonshme mbi praninë e kulturës materiale e shpirtërore ilire, ndonëse të degjeneruar, në kohën e shtegtimevet të sllavëvet, gjegjësisht mbi sinkretizmin e etnosit iliro-arbëror dhe të bshkëjetuarit të tij me (etnosin) sllav." (f.20)

Sa është e vërtetë që në këta 2 nekropole, kultura ilire paraqitet, del, e degjeneruar dhe sa është e vërtetë që në këta 2 nekropole ka prani të cultures slave, u takon për ta ristudiuar e ripërcaktuar arkeologëvet dhe historianëvet më më të kompletuar me dije e mjete saktësimi se ne të derisotmit.

Në f.20 radhitet një tekst prej 38 rreshtash, ku Prof.P.Mijoviqi merret me disa fjalë apo emërvende shpjeguar prej gjithfarë mosnjohësish të gjuhëvet. Unë nuk do të ndalem aty, pasi kjo do të kërkonte shumë punë, aq më tepër, kur tema nuk lidhet direct me Tivarin.

"Territori në të cilin janë themeluar Ulqini e Tivari u ka takuar në epokën parahistorike ilirëvet. Varrezat e tyre monumentale, mogilat e gurta, gjenden edhe sot nëpër kodrina, kodra dhe mbi faqet e malevet, kurse njëra prej tyre, përmbi kodrën e Ratëzit, midis Tivarit dhe Sutomores, shihet edhe në largësinë 10 kilometrash dhe tërheq vemendjen, ashtu siç bëjnë varrezat parahistorike nuraghi në Sardenjë etj" (f.20)

Kjo e dhënë që sjell këtu Prof.P.Mijoviqi, mbi ekzistencën në këto treva të varrezavet parahistorike, është shumë e rëndësishme. Sidomos duhet të tërheqë vëmendjen e arkeologëvet kodra e madhe tumulare sipër fshatit Shushan, e cila do të duhej eksploruar dhe hulumtuar një orë e më parë. Ajo varrezë gjigante, e cila duket që nga Dobrovoda e Zalefi, është aq e madhe, sa, pa ia thënë dikush, askujt nuk do t'i shkonte mendja që nuk është kodër natyrale. Është sa piramidat e Egjiptit, veçse nuk është ndërtuar me gur të gdhendur.

Pasi flet mbi gjetjet arkeologjike në pika të ndryshme (Liqeni i Zogajvet, Bregliqeni i Kranjës dhe Spiçi), z.P.Mijoviq me të drejtë shkruan: **"Territori i Tivarit dhe Ulqinit renditet midis trevavet amëtare të Ilirisë." (f.22)**

“Më 167 p.e.s. pretori Luc Anici ka njoftuar mbi vendimin e Senatit të Romës për anulimin e mbretërisë ilire dhe ndarjen e tokës së saj në tri krahina, prej të cilavet njëra, kjo e bregdetit, ka përfshirë: Rizonite, Agravonite dhe Olciniate. Është e qartë që emërtime të këtillë u janë dhënë banorëvet të territorit bregdetar sipas qytetevet: Rizon, Akruvium (Kotorr) dhe Olcinium, pra jo sipas përkatësisë fisnore.” (f.22-23)

Njoftimin e mësipërm e ka dhënë Tit Livi rreth 150 vjet mbasi ka ndodhur Lufta III Iliro-romake (167 p.e.s.). Por unë nuk mendoj që krahina e Agravonës ta ketë marrë emrin nga qyteti Akruion apo Akruvium, siç e shkruan z.P.Mijoviq. Këtë mendim ma përforcon pak edhe renditja që bën Tit Livi: “***E treta (pjesë e Ilirisë) përfshinte banorët e Agravonës, të Rizonit e Ulcinit si edhe të vendeve kufitare me ata***.” (*Ilirët dhe Iliria*, f,132) Këtë renditje mendoj se T.Livi e ka bërë në këtë mënyrë: Bregliqenin, nga Buna deri në Ceklinën e sotme, pastaj ka marrë Rizonin, me me të gjithë vendet kufitare (siç thotë edhe vetë) dhe Ulqinin, për të mbyllur krejt hapësirën bregdetare. Vetëkuptohet, jo çdo gjë që shkruan një studiues është detyrimisht e saktë.

4

REFERENCAT TE: Gojko Vukmanoviqi

VIRPAZAR, BAR, ULCINJ, f.61-97

VIRPAZAR, BAR, ULCINJ

Obod, izdavaçko-stamparsko preduzeqe

Cetinje- Beograd- 1974

“Gojko Vukmanoviq:

***Zhvillimi i lëvizjes revolucionare, krijimi i organizatavet të PKJ-së dhe veprimtaria e tyre deri më 1941.”* (Titulli i studimit, f.61)**

“Në luftërat çlirimtare 1876-1878, Mali i Zi ka fituar Tivarin, Ulqinin, Spiçin dhe ishullin Gërmozhur në Liqenin e Shkodrës. Në Kongresin e Berlinit 1878 Malit të Zi i është njohur pavarësia, por edhe zgjërimi territorial.” (f.61)

Krejt fjalitë do të ishin në rregull, sikur të mos ishte shprehja: ***“luftërat çlirimtare”***. Në vitet 1876-1878 Mali i Zi nuk ka bërë luftëra çlirimtare, por ka bërë luftëra zaptuese në drejtim të tokavet të Shqipërisë. Çlirimtare kanë qenë kryengritjet hercegovase, por Knjaz Nikolla i ka tradhtuar hercegovasit, me qëllim që të përfitonte nga Austro-Hungaria një dalje fare të vogël në det, në veri të Sutomores, një gji i cili quhet Çanj. Kongresi i Berlinit i ka miratuar Malit të Zi zgjërim, jo mbi tokat e çliruara, por mbi tokat dhe qytetet e pushtuar të Shqipërisë.

“Fill pas Kongresit të Berlinit, Tivari ka pasur 6000 banorë, ndërsa Ulqini 5000 banorë.” (f.61)

Autori, vetëkuptohet, ka llogaritur këtu vetëm ata banorë që nuk kishin emigruar në drejtim të Shkodrës e Durrësit, para dhunës dhe reprezalievet nga ana e ushtrisë malaziase. Në Shkodër e në Durrës sot jetojnë me mijëra pasardhës të atyre shqiptarëve që ikën prej Tivarit e prej Ulqinit në vitet 1878-1880, ndërsa në Tivar e në Ulqin pasardhësit e atyre 6000 apo 5000 banorëve të mbetur, kanë ardhur gjithnjë duke u pakësuar.

Në krejt këtë kapitull, deri në faqen 63, flitet për gjendjen ekonomike të krejt këtij rajoni. Në të vërtetë, ky studim do të duhej përkthyer krejt, sepse, pa e njohur mirë historinë e Tivarit, nuk mund të thuhet se e njohim historinë e Shqiprisë. Mirëpo, me këtë rast, unë do të mund të ndalem vetëm në disa fragmente, kryesisht atje ku do të has në gjëra që duhen korrigjuar ose kundërshtuar. Zotin Gojko Vulmanoviq e kam pasur mësues të historisë në 8-vjeçare të Tivarit, prandaj edhe nuk do të doja

të gjej në tekstin e tij pohime që të bien në kundërshtim me të vërtetën historike. Sidoqoftë, atje ku Prof. Gojko Vukmanoviqi ka mbajtur qëndrim jokorrekt ndaj nesh shqiptarëve, unë jam i detyruar t'ia bëj vërejtjet përkatëse.

"Ndërtimi i rrugës Vir-Tivar, me gjatësi 36km, ka filluar më 1896-n dhe është mbaruar më 1905-n, kurse ndërtimi e rrugës Tivar-Ulqin, e gjërë 5m dhe e gjatë 32km, ka filluar më 1903-shin e ka mbaruar më 1906-n." (f.61)

"Porti i Tivarit u vu në punë më 1909-n." (f.62)

"Në vitet 1881 dhe 1882, në Tivar ka pasur 51 njësi tregtie dhe 33 punishte artizanale." (f.62)

"Marrë në tërësi, në fillim të shekullit XX, në Tivar, Ulqin e Vir ka pasur gjithsej: 331 njësi tregtie, 154 njësi artizanati dhe 77 kafene." (f.62)

"Në Tivar janë ngarkuar në anije, më 1902-shin, 25 mijë kokë (krerë) bagëti." (f.62)

"Më 1888 në Tivar fillon punën fabrika e sapunit (dhe e vajit të ullirit), pronë e Masho Vërbicës." (f.62)

"Në vitin 1901 në Tivar hapet një bankë e Malit të Zi." (f.62)

"Në vitin 1904, më 5 maj, në Vollujcë të Tivarit Poshtë vendoset stacioni telegrafik." (f.62)

"Qeveria e Malit të Zi më 1908 ka vendosur që, në Fushën e Tivarit, pranë bregut të detit, të ndërtohet një qytet i ri me emrin Bar. Qyteti i mëhershëm është emërtuar Stari Bar." (f.62)

Shqiptarët, Tivarin e Vjetër e kanë quajtur Tivari Nalt, ndërsa atij që malazezët e quajtën Bar ose Novi Bar, shqiptarët më parë, para malazezëvet, i kanë pasë thënë N'Han t'Tivarit, kurse më vonë e quajtën Tivari Poshtë.

"Fill pas çlirimit të Tivarit, në vitin shkollor 1878-1879, është hapur në Tivar Nalt një shkollë me 57 nxënës, prej të cilëvet

vetëm 4 ishin myslimanë... E para shkollë 6-klasëshe është hapur në Sutomore më 1885, me 90 deri 100 nxënës. Në Zupç është hapur në vitin 1892. Në vitin shkollor 1892-1893 është hapur një shkollë në Kranjë, por, siç duket, është mbyllur në të njëjtin vit. Në vitin 1902-1903 është hapur shkolla fillore në Shestan. Në Kranjë, shkolla fillore është rihapur shumë vonë, në vitin 1929." (f.62-63)

Autori bën mire që i shënon vitet, kur ka filluar shkollimi i fëmijëvet në Tivar e rrethinë të Tivarit, por bën gabim kur pushtimin e Tivarit nga Mali i Zi e quan çlirim. Ai, gjithashtu, nuk sqaron që ato shkolla që hapte Mali I zi, ishin në gjuhën malazeze e jo në gjuhën shqipe, kështu që për shqiptarët vendës shkollimi ish i njëjtë si në kohën e Perandorisë Osmane, kur mësimi nëpër mejtepe bëhej në gjuhën arabe apo turke. Një popull që nuk shkollohet në gjuhë të vet, nuk mund të përparojë dhe arsyeja që në Kranjë është mbyllur shkolla në vitin 1893, ka qenë pikërisht sepse shteti i Malit të Zi nuk pranonte të hapte për shqiptarët shkolla shqipe. Prof.Gojko Vukmanoviqin, sado gjithë jetën punëtor i arsimit, si duket, nuk e ka shqetësuar fare kjo padrejtësi kaq e madhe që u bëhej shqiptarëvet. Nuk e ka shqetësuar, ose nuk ka dashur të thotë të vërtetën.

"Në Tivar Nalt më 1910-n krijohet Shoqata e të Kënduarit Pjevaçko Drushtvo) me merin 'Bratimstvo'" (f.63)

As në këtë shoqatë nuk ka të ngjarë të ketë pasur këngëtarë vendës, sepse të gjitha këngët këndoheshin sllavisht. I gjithë repertori ishte në gjuhën e pushtuesit.

"Fill pas çlirimit, në mars 1881, në Tivar është hapur leximorja (e quajtur) Barska Narodna Çitaonica." (f.63)

Prapë këtu autori shprehet gabim, kur, në vend të fjalës pushtim, përdor fjalën Ռlirim dhe nuk duhet të harrojmë që Gojko Vukmanoviqi e konsideronte veten komunist dhe jo pak here e ka kënduar himnin "*Internacionale do të jetë Bota e Re*." Në Tivar, nga viti 1878, kur ky qytet është pushtuar prej Malit të Zi, asnjëherë nuk ka funksionuar kurrfarë internacionalizmi. Në bibliotekën, për të cilën flitet këtu, nuk ka as edhe 1 libër në gjuhën shqipe, në një kohë kur në vitin 1901, sipas

Edith Durhamit, në Tivar, veç malazezëvet të sapoardhur, nëpër të gjitha familjet flitej shqip.

"Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Mal të Zi kanë filluar të përhapen idetë socialiste. Vasa Pellagiqi, i cili më 1871 jeton për disa muaj në Mal të Zi, thotë se aty ka pare robëri më të keqe se san ë Turqi. Më 1881-shin, në shkollën fillore të tivarit gjendet mësuesi Dushan Bërkanoviq. Por idetë e Bërkanoviqit nuk u përshtaten pushtetarëvet të atëhershëm të tivarit dhe ai largohet për 7 vjet prej shtetit malazias. Në vitin shkollor 1888 -1889 ka qenë mësues në Ulqin. Më në fund, me sa duket, është larguar nga arsimi." (f.63)

Do të ish mire të denim çfarë qëndrimi kishte socialisti apo komunisti Dushan Bërkanoviq ndaj shqiptarëvet? A e quante edhe ai çlirim shtrirjen e shtetit malazias mbi këto krahina të Shqipërisë, apo i vinte emrin e vërtetë: pushtim?

"(Më 1900-tën) qeveria italiane ka subvencionuar Shoqërinë e Lundrimit të Puljes, që anijet e saja të mund 'prekin' edhe në Tivar. Shoqëria Puljeze më 1902 ka filluar lundrimin edhe në Liqenin e Shkodrës dhe në bunë." (f.63)

Nga këto të dhëna del qartë çfarë interesash ka parashikuar Italia për vete, kur ka hedhur në Berlin firmën që tokat shqiptare të njihen si pjesë e shtetit malazias. Unë shoh këtu edhe haraçin që shqiptarët i paguajnë paaftësisë së pashallarëvet bushatas, për të ndjekur mirëfilli një politikë kombëtare në vitet kur ata i pëtën në dorë edhe ekonominë, edhe forcën ushtarake. Mbi të gjitha, ata patën në dorë të promovonin kulturën tonë kombëtare, duke hapur shkolla në gjuhën shqipe. Por nuk e bënë këtë dhe tash brezat janë të detyruar të vuajnë pasojat.

"Me marrëveshjen e 14 qershorit 1906, është krijuar, me kapitalin Italian, ndërmarrja 'Shoqëria e Tivarit' ('Compagnia di Antivari') për shfrytëzimin e Limanit të Tivarit, për ndërtimin e hekurudhës Tivar-Vir, si dhe për lundrimin në Liqenin e Shkodrës." (f.63)

"Në vitin 1903 krijohet në Tivar organizata 'Lëvizja e Punëtorëvet', me 243 anëtarë. Këtë lëvizje e ka organizuar juristi nga Podgori i Cërrnicës, Jovan Hajdukoviq, i cili ishte njohur, në Beograd e në Zagreb, me idetë komuniste të kohës." (f.64)

S'e dimë a bëjnë pjesë punëtorë ashqiptarë në atë organizatë dhe si do të jetë trajtuar aspekti nacional në atë organizatë, e cila, doemos, ka pasur në programin e vet të drejtat njerëzore.

"Në ndërtimin e linjës hekurudhore Tivar-Vir (1906-1908) kanë punuar rreth 1000 punëtorë malazezë dhe rreth 200 të huaj, kryesisht italianë. Italianëvet u paguheshin 250 korona në muaj, kurse malazezëvet, vetëm 100 korona." (f.64)

Për ne është me interes të dimë sa shqiptarë ka pasur në mesin e atyre 1000 punëtorëve, që këtu autori i quan malazezë.

"Në tunelin e Sutormanit (1906-1908), kanë punuar disa qindra punëtorë, malazezë, boshnjakë hercegovca dhe fare pak italianë. Për shkak se mbikqyrësi i punëtorëvet, një italian, ishte jashtzakonisht i egër, disa punëtorë, që kishin punuar edhe në Amerikë, ia dalin të organizojnë një grevë të madhe." (f.64)

Prapë na bie në sy që autori po thotë: malazezë, boshnjakë e hercegovas, por nuk po i përmend askund shqiptarët. Ndërsa unë e di që aty ka pasur edhe shqiptarë, sepse, kur kam qenë i vogël, kam pasë dëgjuar të flitet për punën në atë tunel dhe për njerëzit tanë që kanë punuar atje.

"Në proklamatën e qeverisë malazeze të 6 nëntorit 1908 (1 ditë mbasi Austro-Hungaria ka shpallur aneksimin e Bosnjë-Hercegovinës), përveç tjerash thuhet se Mali i Zi e konsideron veten të çliruar së gjitha barrësh që i pat ngarkuar Kongresi i Berlinit. Vendimet e asaj marrëveshjeje kishin të bënin me Bregdetin Malazias, e në radhë të parë me Tivarin." (f.65)

Po shikojmë këtu një përfitim diplomatik nga ana e qeverisë malaziase, si kundërpërgjigje vendimit të Austro-Hungarisë për të aneksuar Bosnjën dhe

Hercegovinën. Bosnjë-Hercegovina, vend sllav, pushtohet nga Austro-Hungaria, Tivari e Ulqini, vende të Shqipërisë, mbeten në duart e Malit të Zi. Nga njëra anë vërejmë dobësinë e Austro-Hungarisë për të kundështuar Malin e Zi, nga ana tjetër, dobësinë edhe më indinjuese të shqiptarëvet për t'u organizuar dhe për ta nxjerrë Malin e Zi përjashta. Në vitin 1908 gjithë vëmendja e atdhetarëvet shqiptarë ishte përqëndruar drejt çlirimit nga Perandoria Osmane, ndërsa ishin lënë thuajse në harresë tokat e pushtuara prej malit të Zi dhe prej Sërbisë.

"Më 10 nëntor 1908 në Tivar fillojnë demonstratat disaditore kundër Austro-Hungarisë. Demonstruesit, nja 200 punëtorë, hyjnë në konsullatën austrohungareze dhe hedhin poshtë kurorën (stemën) perandorake dhe flamurin austrohungarez." (f.65)

Fakti që në revoltë marrin pjesë 200 e jo 1000 a më shumë punëtorë, na sugjeron tërthorazi se pjesa tjetër e punëtorëvet ekzistues në Tivar mund të kenë qenë shqiptarë e jo malazezë. Po rata kanë ndenjur mënjanë. Ata s'ka pasë kush t'I organizojë në luftë kundër pushtuesit, I cili kish tashmë plot 30 vjet në token tone. duke sulmuar konsullatën hungareze, malazezët sillen në Tivar sin ë token e vet dhe s'ka kush t'ua bëjë të qartë që Tivari s'është tokë malaziase.

"Neni 29 i Marrëveshjes së Berlinit përcaktonte kufizime lidhur me sovranitetin e Malit të Zi. Me pëlqimin e Austro-Hungarisë u arrit që neni 29 të zëvendësohej me një tekst më të butë: 'Limani i Tivarit është i detyruar të ruajë karakterin e një limani për tregti, në të nuk do të mund të ngrihen objekte të cilët ta shndërronin në një liman me karakter ushtarak.'" (f.65)

Kjo do të thotë që Malit të Zi po i bëheshin vazhdimisht lëshime dhe kjo u jepte malazezëvet guximin që të sillen si zotër të vendit në një vend të huaj. Ne, që nuk ishim pak në numër, ishim në të gjitha pikëpamjet e tjera tepër dobët, aq dobët, sa nuk do t'i lejohej asnjë populli, në çfarëdo rrethane.

"Në Krizën Aneksioniste (1908-1909) mllefi i qytetarëvet të Tivarit ka qenë pjesë e mllefit të Malit të Zi kundër të gjithë atyre që i kanë mohuar Malit të Zi të drejtat e fituara me gjak. Aksionet e pjesëmarrësvet në demonstratat e Tivarit kundër

nenit 29 të Marrëveshjes së Berlinit bëjnë pjesë në traditat e shkëlqyeshme luftarake të malazezëvet për liri." (f.65)

Këtu, vlerësimi i autorit, z.Gojko Vukmanoviq, është thjeshtë propagandistiko-justifikues dhe, rrjedhimisht, tërësisht joreal. Neni 29 i Marrëveshjes së Berlinit përbënte një lëshim të madh ndaj Malit të Zi, sepse Mali i Zi në Limanin e Tivarit duhej të kish të drejtë të hynte vetëm si i huaj. Zbutja e atij neni përbënte një shkallë tjetër lëshimi, i cili s'kish të bënte fare me gjakun e derdhur për liri të malazezëvet. Sepse, edhe në paçin derdhur gjak malazezët në Tivar, atë gjak ata nuk e kanë derdhur për liri, por përkundrazi, për të shkelur mbi larinë e një populli tjetër.

Rishikimi i nenit 29 të Marrëveshjes së Berlinit, 30 vjet mbas atij Kongresi, dëshmon që vendimet ndërkombëtarë edhe mund të modofikohen apo abrogohen. Kjo ka shumë rëndësi të njihet prej juristëvet shqiptarë, sepse, mbështetur pikërisht në këtë fakt, ne shqiptarët mund të kërkojmë edhe anulimin e plotë të Kongresit të Berlinit.

"(Marksisti) Jovan Tomasheviq, nga bërçeli i Cërrnicës, jurist i diplomuar në Francë, merr pjesë në Luftën Ballkanike, në pozicionet përballë Shkodrës." (f.65)

Sado që Jovan Tomasheviqi më vonë e korrigjon disi qëndrimin e vet, kjo është një dëshmi që malazezët, ndërsa në planin e brendshëm luftonin për të drejtat e klasavet të shtypura, në planin e jashtëm ata kanë luftuar për të shtypur popujt e tjerë. Kjo vlen jo vetëm për një Jovan Tomasheviq, por për ktrejt ose pothuaj krejt klasën e komunistëvet malazezë dhe sërbë, midis të cilëvet, siç shihet, edhe vetë autori i këtij studimi, z.Gojko Vukmanoviq. Z.Gojko vVkmanoviqit i takonte të paktën të thoshte që sulmi mbi Shkodrën ishte një tentativë për ta zgjëruar edhe më shumë pushtimin mbi tokat e Shqipërisë.

"Gusht 1914, flota e Austro-Hungarisë bllokon Limanin e Tivarit. 2 mars 1915 austriakët mbysin jahtin 'Rumija' në Gjirin e Tivarit, më 24 shkurt 1915 në Portin e Tivarit Austro-Hungaria mbyt edhe një anije lufte të Francës me 40 pjesëtarë të ekipazhit. (f.66)

"Në janar 1916 kapitullon Mali i Zi dhe në Tivar e Ulqin hyjnë trupat austrohungareze." (f.66)

"Austro-Hungaria e ndan shtetin e Malit të Zi në 7 qarqe. Në Qarkun e Tivarit Nalt përfshihen: Tivari Poshtë, Viri, Kranja dhe Ulqini." (f.66)

"Në gjysmën II të tetorit 1918 komitët ishin shumë active. Atyre u ishte bashkuar edhe populli. Ata kanë vepruar në Bregdetin Malazias, rreth Budves, Tivarit dhe Ulqinit, kurse kanë luftuar në Krythë (të Anës së Malit, Gj.D.)**, në Peçuricë, në Ujmirë (Dobrovodë) etj. Në këta luftime komitët kanë zënë 4 topa, 2 në Ujmirë (Dobrovodë) e 2 në Vollujcë, dhe, në një farë mase, e kanë penguar ushtrinë austriake për ta tërhequr me vete materialin e luftës." (f.66-67)**

Autori nuk esqaron se çfarë kombësie ishin komitët, por ne e nënkuptojmë që ata nuk mund të ishin shqiptarë, pasi do të ishte absurde të bënin luftë shqiptarët për të rirënë nën Malin e Zi. Por është për t'u habitur si mund të vepronin komitët malazezë në token shqiptare dhe pse nuk pati fare organizimi të tivarasvet vendës dhe të ulqinakëvet vendës për t'u shkëputur prej Malit të Zi në atë valë lufte. Arsyeja do kërkuar te humbja që pësoi Austro-Hungaria, dhe s'kish sit ë mos humbte, pasi lufta që nisi ajo, jo vetëm ish popujshtypëse, por ish edhe aventurë nga më shkurtpamëset.

Nëse Mali i Zi do të kish pranuar ofertat e Austro-Hungarisë për të mos hyrë në luftë kundër saj, ndoshta objektivisht do të mund të ish realizuar diçka ndryshe. Austro-Hungaria i kish premtuar Malit të Zi zgjërim kufijsh në drejtim të Hercegovinës dhe në drejtim të Shkodrës, nëse nuk hynte në luftë përkrah Sërbisë. (f.66) Pra, Austro-Hungaria, faktikisht, ia ka dhënë Malit të Zi, përveç Tivarit, Ulqinit, Tuzit, Plavës dhe Malësisë, edhe Shkodrën. Lexuesi mund ta marrë me mend çfarë pazaresh të ndyrë janë bërë mbi Kombin tonë.

Por Kral Nikolla nuk ishte një politikan aq moslargpamës, që të mos mund ta parashikonte fundin e asaj lufte. Njëkohësisht, ai nuk ishte as aq largpamës, sat ë kuptonte se ku mund ta çonte Malin e Zi një afrim I tepruar me Sërbinë.

Sidoqoftë, ne mund ta zëmë sikur Mali i Zi ta kish pranuar subjektivisht premtimin e Austro-Hungarisë. Në një të tillë rast ndoshta objektivisht do të krijohej një farë mundësie që, jo vetëm Shkodra të mos binte në duart e Malit të Zi, por edhe Tivari e Ulqini të çliroheshin pas humbjes së luftës. Por kjo ish një mundësi fare e pakët, pasi Anglia, Franca dhe Rusia, as që e kishin ndërmend krijimin e një shteti të plotë shqiptar.

"Tivari, Viri dhe Ulqini janë çliruar në tetor 1918. Pjesë të trupavet sërbe, pasi kanë hyrë në Podgoricë më 18 tetor 1918, kanë vazhduar lëvizjen drejt Cetinjës, Tivarit, Kotorrit dhe vendevet të tjerë në Malin e Zi të Moçmin. Pjesë të këtyre trupave kanë hyrë në Vir më 25 e në Tivar më 26 tetor. Popullata, pas një robërie 3-vjeçare nën pushtetin e Austro-Hungarisë, e ka pritur ushtrinë sërbe me entuziazëm." (f.67)

Në Tivar e Ulqin nuk është pritur dhe s'kish si pritej ushtria sërbe me entuziazëm. Ushtria sërbe ishte pushtuese në këta vende njëlloj si ushtria malazeze apo ajo austriake, sadoqë ushtria austriake të paktën shkollat na i kish hapur në gjuhën tonë.

Por ushtria sërbe ishte ushtri pushtuese edhe për vetë Malin e Zi. Dëshmi për këtë është shndërrimi i atij shteti në një banovinë dhe mosardhja më kurrë e Kral Nikollës në atdheun e vet.

"Në Tivar kanë hyrë forcat franceze dhe angleze, për t'i ndihmuar ushtrisë sërbe që të vendosë pushtetin." (f.67)

Edhe kjo që, në Tivar, por edhe gjetkë në ish-shtetin e Malit të Zi, kanë qenë detyruar të hyjnë forcat e 2 fuqive aleate, dëshmon sa me "entuziazëm" është pritur aty ushtria e Sërbisë. Ndërkaq, për drejtësi as që mund të bëhet fjalë. Forcat franceze e angleze nuk kanë ardhur në Tivar për të vendosur drejtësi, përndryshe, ato do t'i thoshin ushtrisë sërbe: Shko në Sërbi!

"Pas mbarimit të Luftës I Botërore, në qarkun e Tivarit s'ka qenë e mundur, as lehtë, as shpejt, që të qetësohet situata. Në trevat kufitare bëhej propagandë për bashkimin me Shqipërinë." (f.67)

Vërtetohet kështu që njerëzit tanë, populli i Tivarit e i Ulqinit, nuk është pajtuar kurrë me pushtimin malazias, aq më tepër tash që ekzistonte shteti shqiptar.

"Komandanti i trupavet italiane në Tivar nuk ishte i gatshëm të bashkëpunonte me përfaqësuesit ushtarakë e civilë të Tivarit, por shfrytëzonte të gjitha mënyrat e mundshme që gjendja në qark të bëhej përherë e më e tendosur." (f.67)

Në një vend ku s'ka arsye të ketë trazira, s'ka pse sillet ashtu një ushtri paqëruajtëse. Por qëndrimi i komandës italiane tregon së paku 2 gjëra: 1.Shqiptarët donin të çliroheshin nga sllavët pushtues dhe 2.Italia s'kish interes të krijohej përballë saj një Jugosllavi e madhe.

"Asambleja e Madhe Popullore në Podgoricë, më 26 nëntor 1918, ka shpallur bashkimin e Malit të Zi me Sërbinë, gjë që është kryer me ndihmën e ushtrisë sërbe dhe të ushtrivet aleate në mënyrën më të ashpër me anë të forcës dhe mashtrimit." (f.68)

Autorit po i bie rëndë mënyra se si është kryer bashkimi i Malit të Zi me Sërbinë, por nuk po thotë asgjë për mënyrën se si janë pushtuar tokat shqiptare nga Mali i Zi. Një qëndrim i këtillë e zhvlerëson njeriun në pikëpamje morale. Në këtë rast, z.Gojko Vukmanoviq e ka zhvlerësuar vetëveten, edhe si dijetar, edhe si njeri.

"Rrebelimi i Krishtlindjevet (21 dhjetor 1918, me kalendarin e vjetër) ka përfshirë territorin e qarkut të Tivarit... Jovan Pllamenci ka hyrë në lidhje me përfaqësuesit legalë të Italisë në Vir e në Tivar, dhe, nëpërmjet tyre, edhe me ata të Romës, dhe ka siguruar jo vetëm armë, por edhe ndihmë materiale... Ka lajmëruar që të gjithë cërrniçanët të mblidhen në Godenjë... Aty kanë ardhur 250-300 vetë. Është nisur me ato forca për të marrë Virin, por ka parë që do të derdhej gjak midis vetë cërrniçanëvet, prandaj ka hequr dorë nga kryengritja. Është tërhequr në Kranjë, me nja 50 përkrahës dhe, pas disa ditësh, nga Zoganjt është hedhur nnë Shëngjin e prej Shëngjinit në Itali." (f.68)

Forcat e Jovan Pllamencit, që quheshin zelenashë, ishin kundër bashkimit të Malit të Zi me Sërbinë dhe për kthimin e Kral Nikollës në Mal të Zi. Italia ishte

përkrahëse e kësaj tendence. Shqiptarët, të ndodhur përballë 2 të këqiave, në atë situate, kanë zgjedhur të keqen më të vogël: Përkrahjen e Malit të Zi në përpjekjet e tija për t'u shkëputur nga Mbretëria SHS. Prandaj dhe Jovan Pllamenci ka zgjedhur si vend pikënisjeje Godenjën, që është në kufi me Shestanin shqiptar, dhe prandaj, kur është tërhequr, ka përdorur Kranjën shqiptare dhe shtetin shqiptar, pasi s'kish rrugëdalje tjetër.

"Komandanti i vendit në Tivar lajmëron më 13 janar 1919: 'Jemi të rrethuar me mitralozë, ka demonstrime të përditshëm, me nga 6-8 mitralozë nëpër rrugët e qytetit dhe me njësi të armatosura ushtarake... Italianët janë aq të lirë, sa, njësi të tëra ushtarake lëvizin nëpër fshatra.'" (f.68)

Autori, z.Gojko Vukmanoviq, nuk e thotë dhe, me sa duket, nuk dëshiron të shikojë që ushtria italiane kish këtu përkrahjen e popullit, me përjashtim të së quajturës ***'RINI'***, e cila ishte një rini malaziase, joshqiptare, dhe që ushqehej me ide pansllaviste. Shqiptarët, më parë bëheshin promalazezë, duke pasur edhe Italinë në krah, sesa projugosllavë, duke e tretur si kripa në ujë në detin e popujvet sllavë.

"Në mars 1919, në Tivar ka pasur: forca angleze, forca franceze dhe, më së shumti, forca italiane (rreth 1300 oficerë dhe ushtarë)." (f.70)

"Gjatë gjithë vitit 1919 në qarkun e Tivarit ka qenë gjendja e çrregulluar. Një numër i atyre që nuk e kanë pranuar bashkimin me Sërbinë, janë arratisur në Rumi, Sutorman e gjetkë." (f.70)

"Natën e 18-19 korrikut italianët kanë zbarkuar me anijet e veta, në bregun midis Tivarit e Ulqinit, rreth 100 emigrantë malazezë të armatosur. Disa janë përleshur me xhandarmerinë më 25-26 korrik dhe me atë rast u janë vrarë 7 dhe u janë plagosur 2. Ardhja e këtij grupi ka shkaktuar panik... Kundër zelenashëvet (të gjelbërtvet) krijohen njësi ushtarake me emrin *'Organizovana Omladina' ('Rinia e Organizuar')*." (f.70)

Në vitin 1919, njësi të kësaj "***Rinie të Organizuar***" kanë rrethuar fshatin shqiptar Gurrzë, të krahinës së Shestanit, me qëllim që të arrestojnë Stjepë Nikën e fisit

Dabanj, që ishte përkrahës dhe strehues e njërit prej kundërshtarëvet më të zjarrtë të bashkimit të Malit të Zi me Sërbinë, Savo Raspopoviqin. Savo Raspopoviqi, nga Kuçi i përtejliqenit, vepronte në krahinën e Shestanit me një çetë rreth 20-vetëshe. "***Të rinjtë e organizuar***" malazezë nga Cërrnica, ardhur në Shestan nga krahu i Tivarit, e kanë plagosur rëndë Stjepë Nikën dhe e kanë terrorizuar krejt katundin. Savo Raspopoviqi u ka zënë pritë xhandarëvet në vendin e quajtur Kunorë dhe, në shenjë hakmarrjeje për Stjepë Nikën, ka mundur të vrasë 2 xhandarë, pjesëtarë të "***Rinisë së Organizuar***".

"Në një fjalim të tijin në Vir, Jovan Tomasheviqi ka thënë: '*Rruga jonë e vërtetë është ajo që na ka treguar revolucioni në Rusi.*'" (f.71)

E gjithë kjo nuk do të kosiderohej punë e keqe, nëse po këta komunistë malazezë nuk do të mbanin qëndrim të keq ndaj nesh shqiptarëvet, që na kish pushtuar Mali i Zi e që tash kishim rënë edhe nën sundimin e Mretërisë Jugosllave. Komunistët malazezë, ndonëse flisnin për të drejtat e punëtorëvet e të fshatarëvet, si dhe për të drejtat nacionale të popujvet, asnjëherë nuk u deklaruan për të drejtën tonë që të bashkohemi me shtetin të cilit duhej t'i përkisnim: me shtetin shqiptar.

"Në prill 1919 krijohet PKJ... Organizatat e para të komunistëvet jugosllavë malazezë janë krijuar po në vitin 1919: në Cërrnicë, në Petrovac dhe në Ulqin. Në Ulqin janë këta komunistë malazezë: Millosh Strugar, Janko Ivankoviq dhe Dragisha Vujanoviq." (f.71)

Duhet vënë në dukje këtu që asnjëri prej këtyre komunistëve nuk ishta vendës në Ulqin. Që të gjithë ishin të ardhur, në kohët pasi Mali I Zi e kish pushtuar Ulqinin.

"Në Tivar krijohet më 7 nëntor 1920 dega e Partisë Radikale." (f.71)

"Jovan Tomasheviqi, kryesuesi i komunistëvet në Mal të Zi, në zgjedhjet e nëntorit 1920, kandidon për deputet në qarkun e Tivarit. Në Tivar e në Ulqin aktivizohet edhe komunisti Vaso Sërzentiq." (f.74)

"Në qarkun e Tivarit kishte gjithsej 3068 zgjedhës. Nga këta, 1113 votonin pë Jovan Tomasheviqin. Radikalët marrin 990, republikanët 892, demokratët 751, Piletiqi i pavarur 420, Radoviqi 13 dhe Shauliqi 2 vota." (f.74)

Po shqiptarët ku janë? A nuk i pasqyron autori Gojko Vukmanoviq, apo nuk kanë ekzistuar fare si subjekt politik? Shqiptarët, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë në Tivar, shqiptarët që janë vendës në Tivar, nuk kanë këtu kurrfarë subjektiviteti. Ky është treguesi më i mirë që Tivari ishte një qytet i pushtuar prej të huajvet, në të cilin të huajt silleshin sikur janë në vendin e vet. Historiografia moderne nuk ka si ta anashkalojë një të vërtetë kaq të qartë.

Megjithatë, nuk do lënë në harresë edhe një hollësi: **"Rrethet militarist në Mal të Zi, në vitin 1920, kanë kërkuar që Shkodra t'i bashkëngjitej shtetit të sapoformuar.** (Dmth Mbretërisë SKS, Gj.D.) **Është organizuar edhe aksioni i grumbullimit të vullnetarëvet për një sulm mbi Shkodër. Jovan Tomasheviqi ka reaguar energjikisht kundër një të tillë aksioni, duke e konsideruar si të padrejtë dhe si aventuror. Kundër kësaj përgatitjeje për të sulmuar Shkodrën ai ka shkruar edhe një trakt me titull 'Drugovi'** ('Shokë'), **por nuk e ka shpërndarë dot, sepse e kanë arrestuar." (f.75)**

Ky qëndrim i J.Tomasheviqit nuk është për t'u nënvleftësuar, por, megjithatë, nuk do krijuar mendimi që mund të ishte pjesë e botëkuptimit të tij fakti që, psh Tivari, i pushtuar prej Malit të Zi monarkik, ka qenë i padrejtë dhe se ai si i tillë i duhej kthyer shtetit shqiptar. J.Tomasheviqi nuk arrinte deri aty dhe kjo ka qenë dobësia kryesore e shumicës së komunistëvet të Malit të Zi, Sërbisë, si dhe e komunistëvet të së quajturës Maqedoni. Ata ishin për liri nacionale të vetën, por jo edhe për larinë nacionale të shqiptarëvet.

Regjistrimi i 31 janarit 1921 në Qarkun e Tivarit, sipas shifrës që jep autori G.Vukmanoviq, ka nxjerrë 28638 banorë. Nga këta: Rrethi i Tivarit 5679, i Bunës 3765, i Kranjës 4253, i Ulqinit 5028, i Cërrnicës 7502, i Spiçit 1253. (Krs: f.75)

Duke mbledhur këto shifra, mua më dalin 27480. Duhet të jetë bërë diku ndonjë gabim. Sidoqoftë, duke qenë se regjistrimi nuk e ka dalluar kombësinë, unë si

vendës jam i detyruar, në interest ë temës që po trajtoj, ta përcaktoj, qoftë edhe me përafërsi, numrin e shqiptarëvet dhe numrin e malazezëvet si dhe jomalazezëvet joshqipfolës. Numri i malazezëvet dhe i një numri të vogël katolikësh sllavishtfolës do të ketë qenë afërsisht ky: Në Rrethin e Tivarit 1500, në Rrethin e Bunës 100, në Rrethin e Ulqinit 500, në Rrethin e Cërrnicës 7502, në Rrethin e Spiçit 1253. (I shkruajmë me të mëdha, sepse janë emërtime administrative.) Gjithsej sllavishtfolës 10855.

Numri i shqiptarëvet do të ketë qenë afërsisht ky: Në Rrethin e Tivarit 4179, në Rrethin e Bunës 3665, në Rrethin e Kranjës 4253, në Rrethin e Ulqinit 4528. Gjithsej 16625.

Nëse heqim Cërrnicën dhe Spiçin, që unë i mora 100% joshqiptarë, del që në krahinën e Tivarit e të Ulqinit, përfshirë aty, veç 2 qytetevet, Anën e Malit, Kranjën e Shestanin, që janë 100% shqiptarë, të ketë pasur më 1921 jo më shumë se 2100 banorë sllavishtfolës.

Duke pasur parasysh këtë statistikë, sado që ajo të jetë përafërsisht ose jo përafërsisht e saktë, pyetja logjike që shtrohet, është kjo: Pse nuk flitet këtu për organizata shqiptarësh, për shoqëri apo shoqata shqiptarësh, për shkrimtarë e gazetarë shqiptarë, për veprimtari të shqiptarëvet të këtij qarku në emigracion, për revolta shqiptarësh, të organizuara ose spontane?

Përgjigjja, ndonëse e paezauruar deri në hollësi, është: Ose nuk ka pasur gjëra të tilla në komunitetin tonë, ose autori nuk i pasqyron.

Nëse autori nuk i ka pasqyruar këto dukuri, shoqëri, shoqata apo lëvizje të shqiptarëvet, i del detyrë historiografisë shqiptare të nxjerrë në dritë çdo gjë që ka ndodhur midis nesh në atë kohë.

Nëse nuk ka pasur dukuri apo lëvizje të tilla midis shqiptarëvet, midis 16325 shqiptarëvet, sa më dolën mua, ka e pakta 2 arsye: 1.Regjimi malazias ka qenë, jashtë çdo përfytyrimi, i egër, ka qenë pra terror. 2.Prapambrtja e shqiptarëvet, si pasojë e pushtimit të gjatë osman, ka qenë tepër gjurmëlënëse. Bashkimi i të 2-ja këtyre arsyeve duhet të jetë më pranueshëm.

"Gjendja në Qarkun e Tivarit, në vitet 1921-1922, ka qenë e rëndë: papunësi, shtrenjtësi, mungesa të mëdha. Komunikacioni i

parregullt, posta e parregullt, gazetat në Tivar e Ulqin arrinin me 10-15 ditë vonesë." (f.75)

"Tivari e Ulqini ishin kthyer në territoret më të prapambetur, në një kohë kur mundësitë i kishin më të mira se në vendet e tjerë të banovinës së Malit të Zi." (f.75)

"Punëtorët e 'Barsko Drushtvos' bëjnë grevë 20-ditore. Më në fund u rritet rroga për 20%, kurse koha e punës u shkurtohet në 8 orë në ditë." (f.75-77)

Të gjitha këto i thotë autori nga pozitat e një komunisti, por prapë asgjë për gjendjen e keqe, në mënyrë të veçantë për shqiptarët, që ishin aty shumicë.

"Më 1923 krijohet, në vend të PKJ-së, të ndaluar, Partia Punëtore e Pavarur Jugosllave. Për Malin e Zi e kryeson këtë parti Jovan Tomasheviqi. Për Tivarin kandidat për deputet i kësaj partie është Nikolla Kovaçeviq." (f.77)

Pyetja që i intereson historiografisë së Tivarit, është: Ku janë shqiptarët? Ç'bëhet me shqiptarët këtu në Tivar e në Ulqin? Autori Gojko Vukmanoviq nuk thotë asgjë.

Më poshtë kemi një statistikë revoltuese e njëkohësisht komike, për shkak të mospasqyrimit të gjendjes së vërtetë.

"Në rrethin elektoral të Tivarit, mars 1923, nga 7596 zgjedhës, dalin në zgjedhje 4825." (f.77)

S'e di ç'përfaqëson ky "***rreth elektoral***" i Tivarit, kur më 1921-shin Rrethi i Tivarit, jo qarku, ka pasur, banorë, jo zgjedhës, vetëm 5679. Shih f.75. Nga dolën 7596 zgjedhës? Unë po e marr si qark, i cili më 1921-shin kishte gjithsej banorë 27480, nga të cilët shqiptarë mund të ishin 16325.

Sidoqoftë, në një qark, pra, jo srez,por okrug, ku përfshihen edhe Cërrnica e Spiçi, tërësisht sllavë, dhe ku 60% e popullsisë është shqiptare, emrat e kandidatëvet janë që të gjithë kolonistë: Gjonoviq i republikanëvet 353 vota, Tomasheviq i punëtorëvet, në të vërtetë i komunistëvet, 319 vota, Shauliq i fshatarëvet 34 vota,

Tomiq 86, Ivanoviq federalist 1532, Vukotiq 1007, Çubroviq 304 dhe Bakiq radikalist 1190.

Nuk ka asnjë shqiptar, ose, së paku, nuk dallohet nga pranemri, nga llagapi, që ndonjëri prej tyre të ketë përkatësi shqiptare.

Ku janë shqiptarët? Ne e dimë që ata janë aty. Por, çfarë bëjnë shqiptarët? Jo, mbas 1000 vjetësh, por as mbas 100 vjetësh, asnjë historishkrues nuk do të mund të pohojë, me dokumente, se këtu, në vitin 1923, ka pasur një popullsi që fliste shqip.

Gojko Vukmanoviq, ish-profesori im, jep më poshtë një vlerësim realist për gjendjen në vitin 1923. Unë po e sjell të plotë, por të shoqëruar, si përherë, me vërejtjet përkatëse.

"Pozita e masavet punonjëse keqësohej nga dita në ditë. Në territorin e qarkut të Tivarit nuk kryheshin kurrfarë punimesh, të cilët do të bënin të mundur punësimin e njerëzvet. Fshatarët s'ishin në gjendje të bëjnë para as për të larë tatimet dhe të tjerë detyrime. Prodhimet bujqësorë e blegtoralë, që i nxirnin në tregjet e Tivarit, Virit e Ulqinit, i shisnin thuajse falas ose i kthenin mbrapsht të pashitur. Pushteti ekzistues nuk ndërmerrte asgjë për të pëmirësuar gjendjen e popullatës së varfër. Përkundrazi, regjimi ushtronte presion dhe terror, i cili ish vështirë të përballohej." (f.77-78)

Tabloja është sa realiste, aq edhe rrënqethëse. Ne që kemi lindur dhe jemi rritur aty, e dimë që këtë barrë varfërie dhe represioni në radhë të parë e mbante mbi shpinë popullata shqiptare. Por autori ka heshtur lidhur me këtë aspekt të realitetit. Përse ka heshtur?! Unë kam vetëm 1 përgjigje. Ai ka frikë të flasë për të drejtat e mohuara të shqiptarëvet, sespe, po foli, bëhet "shkaktar" që një ditë Tivari e Ulqini të mos jenë më pjesë e shtetit malazias. Pra, nëse do të dilte në mbrojtje të një territori të pushtuar, ai do të quhej tradhtar. Por, si është më mire: Të jesh "tradhtar" i kombit tend pushtues apo tradhtar (pa thonjëza) i idealevet gjithnjerëzorë?

"Në gusht 1923, në zgjedhjet locale për Tivarin fiton një Sreten Tukoviq (S'e kam idenë se nga është. Gj.D.)**, në Ulqin fiton Cafobeg**

Alibegoviqi (Në të vërtetë: Alibegaj, Gj.D.)**, në Kranjë një M.Rolloviq** (S'e di a është shqiptar apo malazias. Gj.D)**" (f.78)**

"Më 24 prill 1924 vdes Jovan Tomasheviqi, revolucionar malazias nga Bërçeli i Cërrnicës, i cili për pak kohë ka jetuar e punuar edhe në Tivar." (f.78)

Ndonëse në vitin 1912, në moshën 21vjeçe, ka marrë pjesë në sulmet e malazezëvet kundër Shkodrës, më 1918-n ai e ka kundërshtuar me forcë një sulm të ri kundët tokavet të Shqipërisë. Historiografia, edhe kjo e jona, shqiptare, njerëz si ai duhet t'i vlerësojë pozitivisht. Për popullin e tij ai e meriton të jetë një shembull përkushtimi.

"Festa e 1 Majit në Tivar është shënuar me përleshje midis punëtorëvet dhe policies." (f.78)

Përmenden si veprimtarë komunistë, luftëtarë kundër padrejtësivet klasore: Në Tivar Dushan Vujoviqi, në Ulqin Bogdan Vujosheviqi. Nuk përmendet asnjë shqiptar, as në planin shoqëror dhe as në planin nacional.

"Bogdan Vujosheviqi (kolonist malazias në Ulqin, Gj.D.) **caktohet, në zgjedhjet e vitit 1925, kandidat për deputet në Qarkun e Tivarit." (f.79)**

"Në Tivar shpërndahet një trakt. Policia e arreston Bogdan Vujosheviqin dhe e çon më këmbë nga vendi i arrestit deri te zyrat e qarkut dhe atje e torturojnë për 4 ditë." (f.79)

"Platforma e Partisë Punëtore e Fshatare të Jugosllavisë për Malin e Zi (në të vërtetë, parti komuniste, Gj.D.) **ka qenë: Të luftohet kundër diskriminimit nacional të malazezëvet," (f.79)**

Mirë e kishte PPFJ për Malin e Zi, për të luftuar kundër diskriminimit NACIONAL të malazezëvet. Po kundër diskriminimit NACIONAL të shqiptarëvet, që vetëm në Tivar e Ulqin me rrethina arrinin në 20 mijë e edhe aq në trevat në verilindje të Liqenit të Shkodrës e në Plavë e Gusi?! I duhen këto të dhëna historiografisë shqiptare, për të kuptuar sa më mirë gjendjen e kësaj pjese të Shqipërisë, midis 2 Luftëravet Botërore.

Në zgjedhjet vendore më 31 korrik 1927 duket më në fund një gjallërim i popullatës shqiptare. Kandidatit të vet, M.Omerbashiqit (M.Omebshës) shqiptarët japin 632 vota, përkundër 348 që merr kundërshtari i tij malazias, Ilija Hajdukoviqi. (Krs.f.80)

Për zgjedhjet e 11 shtatorit 1927, në Tivar kandidat i Lidhjes Republikane të Punëtorëvet e Katundarëvet (Republikanski Radniçko-seljaçki Savez), është Petar Lekoviqi nga Godenja, kurse zëvëndësi i tij është Bllazho Gjuranoviqi (kolon, Gj.D.) në Ulqin. Cafobeg Alibegu është kandidat i Partisë Popullore Radikale për Qarkun e Tivarit. (Krs.f.80)

Cafobeg Ulqini ose Cafobeg Alibegu, të cilit sllavët i thonë: Cafo Alibegoviq, ka qenë thuajse i vetmi personalitet shqiptar që ka bërë politikën e kombit të vet në rrethanat e një pushtimi nga më të egrit.

"Radikalët dhe demokratët nuk janë ndalur para asnjë lloj mjeti as metode. Populli nganjëherë ka rënë pre e premtimevet të tyre. Presioni i regjimit, veçanërisht në disa nga katundet, ka qenë dukshëm. Njerëzit kanë qenë detyruar të votojnë për njeriun që donte shteti." (f.80)

Radikalët i ka përfaqësuar Cafobegu, sigurisht, duke përfituar me zotësi përkrahjen e dikujt në qendër. Shqiptarët e kanë votuar atë, sepse,në radhë të parë, ai ishte njeriu i tyre, i fuqishëm, por edhe punëmbarues për popullin e vet. Malazezët, kuptohet që nuk e kanë dashur. Megjithatë, kur ka ardhur në pushtet, ai u ka kryer punë edhe kolonëvet malazezë.

Në qytetin e Tivarit, në vitin 1927, ka pasur 1860 banorë (470 shtëpi). Në të njëjtin vit, Tivari kish 54 punëtori artizanale, 45 njësi tregtare, 23 kafe dhe 13 të ndryshme. Punëtorë të punësuar kishte 120 dhe 42 çirakë. (Krs.f.80)

Nuk tregohet nacionaliteti i banorëvet, sado që çështjen e vet nacionale ky studiues, Gojko Vukmanoviq, e ka pasur pjesë të idealit të vet.

"Në vitin 1926 themelohet Barska Pllovidba (Lundrimi i Tivarit) me 2 anije, '*Galeb*' dhe '*Primorac*'" (f.80)

Vëmë re që anijet nuk kanë emra shqip dhe kjo ndodh, sepse shoqërinë nuk e themelojnë shqiptarët.

"Arqipeshkvi Nikolla Dobreçiq kontakton në SHBA me Henrih Fordin dhe tenton ta tërheqë atë për të ndërtuar në Tivar një fabrikë automobilësh, por nuk ia arrin qëllimit." (f.81)

Imz.Nikollë Dobreci, shqiptar nga fshati Dobrec pranë Ljares, ka qenë tërësisht i angazhuar në shërbim të sllavëvet. Duhen krahasuar me këtë rast 2 personalitetet më të shquar shqiptarë të këtyre anëve: Kryetari shumëvjeçar i Rrethit të Ulqinit, Cafobeg Alibegu, i cili i la vetes emër të mirë, dhe arqipeshkvi shumëvjeçar i Tivarit, Imz.Nikollë Dobreci, i cili, fatkeqësisht, nuk i la vetes emër të mirë. Të 2 jetuan e punuan në të njëjtat rrethana dhe në të njëjtën kohë, por ja që u varka shumë nga mënyra se si e trajton njeriu vetëveten!

"Më 1927-n vëllezërit Mariq ndërtojnë në Tivar fabrikën e vajit, e cila përpunonte 20 ton ullinj në ditë. Vaji eksportohej në SHBA, Francë dhe Gjermani." (f.81)

Për familjen Mariq nuk e kam të qartë, a ishte shqiptarë apo sllavë. Gjithsesi, shqiptarët nuk fitojnë asgjë, përveçse shesin ata ullinj me çmim fare të ulët.

"Më 1933 fillon ndërtimi i disa rrugëve: Rruga Vir-Ostros dhe rruga Tivar-Zalef. (f.81)

Rrugës Vir-Ostros iu desh të presë gjysmën e dytë të shekullit XX për t'u përfunduar, ndërsa ajo e Zalefit ishte fare e shkurtër.

"Me ndarjen territorial më 1931, Rrethi i Tivarit ka sipërfaqen 963 km² me 36247 banorë. Kishte 13 komuna, 153 vendbanime dhe 8305 familje. Komunat ishin: e Tivarit, e Bunë-Katërkollës, e Bojoviqit, e Bërçelë-Podgorit, e Virit, e Glluhodolit, e Kranjës, e Mozhur-Shtojit, e Selcë-Krricës, e Mërkotit, e Pashtroviqit, e Spiçit, e Ulqinit. Kanë qenë në punë 32 shkolla fillore dhe 10 biblioteka e leximore. Në Tivar është rihapur gjimnazi 4-klasësh. (f.82)

Komuna me popullsi shqiptare ishin: E Tivarit, e Bunë-Katërkollës, e Kranjës, e Mozur-Shtojit dhe e Ulqinit. Autori nuk e ka vënë në dukje këtë aspekt të gjendjes demografike, ndonëse kjo do të ishte shumë e rëndësishme. Madje, do të duhej shënuar: Nga 8305 familje, sa familje ishin shqiptare?

"Në vitin 1933, në Tivar e në Ulqin ka organizatë të LKJ-së. Komunistët e Tivarit shpërndajnë trakte me okelion: 'Popullit punonjës të Malit të Zi dhe të Bokës." (f.84)

Të ndalemi pak këtu. Krejt kjo lëvizje komuniste në Ulqin e në tivar udhëhiqet dhe realizohet prej malazezëvet, të ardhur në këto anë pas pushtimit të vitit 1978-1980. Traktet nuk shpërndahen në gjuhën shqipe dhe ndarja midis nacionaletetevet është aq e thellë, sa duket sikur janë 2 botë krejt të ndryshme. Bien ë sy okelioja e traktit, ku dallohen, si nocione gjeografikë, Boka e Kotorrit dhe Mali i Zi. Ndërkaq, Tivari e Ulqini, që gjeografisht nuk i kanë takuar kurrë Malit të Zi, konsiderohen 'Cërrnogorsko Primorje' ('Bregdet Malazias'). Kjo duhet të rregullohet një herë e mirë në terminologji dhe këtë gjë duhet ta kuptojnë në mënyrë bashkëkohore të kulturuar sidomos historishkruesit dhe gjeografët e Malit të Zi.

"Në gjysmën e dytë të vitit 1934 është krijuar Komiteti i Qarkut të Tivarit i PKJ-së me qendër në Vir. Ai komitet qarkor kish komitetet vendorë: në Tivar, në Vir, në Ulqin dhe, prej vitit 1935, në Petrovac. Krejt organizata e PKJ-së e Qarkut të Tivarit, në vitin 1935, kishte 100 anëtarë. Në Cërrnicë 45, në Ulqin 24, në Tivar 15, në Petrovac 18. Në Tivar, sekretar i komitetit vendor ishte Ilija Purlija, në Ulqin Boshko Strugari. (f.84)

Një qark administrativ si ai i Tivarit, në vitin 1935, ka 100 komunistë, kurse një shtet shqiptar me mbi 1 milion banorë, në vitin 1941, ka vetëm 200 komunistë. Madje, as në Tivar e Ulqin, ku shumica e popullsisë janë shqiptarë, komunistë shqiptarë nuk shënohen, përjashtuar Boshko Strugarin, i cili ka qenë një shqiptar i sllavizuar, për shkak të përkatësisë fetare. E gjithë kjo dëshmon që lëvizja komuniste në Ballkan, midis sllavëve, e ka pasur shumë të theksuar aspektin e vet nacionalist dhe kjo për shkak se flamurin e komunizmit në Botë tashmë nuk e mbante Evropa Perendimore, por Rusia. Ky element (që Evropa Perendimore e la

Rusinë ta udhëhiqte këtë ide sociale gjithbotërore, lindur e formuluar në Angli, Francë e Gjermai), ka nevojë për një trajtim shumë më të thelluar shkencor.

"Midis 2 luftërave (1918-1941) disa territore të Rrethit të Tivarit kanë mbetur jashtë ndikimit të Partisë Komuniste (Kranja, Shestani, Mërkoti, Ana e Malit)" (f.84)

Kranja,Shestani, ana e malit janë treva tërësisht shqiptare. Autori nuk e ka vënë në dukje këtë fakt shumë të rëdësishëm. Në të vërtetë, është po ajo dukuri që e trajtova pak më lart: Nacionalizmi sllav, në formën e pansllavizmit, tani po maskohej nën flamurin e luftës për të drejtat sociale. Përsëritet kështu e njëjta skemë si në Mesjetë, kur nën flamurin e krishtërimit kamuflohej etniteti sllav dhe dukej sikur fenë e Krishtit po e mbronin vetëm sllavët. Puna pat arritur deri atje, sa Moska u quajt Romë e Tretë. I mori ajo të gjitha meritat. Gati sa nuk tha: Të mos ishim ne sllavët, s'do të kish krishtërim mbi faqe të Dheut. Kështu ndodhi edhe me komunizmin. Në Tivar duhej të ishe sllav ose të paktën të flisje sllavisht, pa të quhej se je në gjendje të merresh me punë të mëdha.

Shqiptarët, në Tivar e në Ulqin, problemin më madhor e kishin robërimin nacional. Komunistët malazezë as që e kishin në programin e vet zgjidhjen e këtij problemi më kryesor e më madhor për shqiptarët. Komunistët malazezë e kërkoni çlirimin nacional të malazezëvet, por për çlirimin nacional të shqiptarëvet as që donin t'ia dinin. Cilat do të mund të ishin atëherë të drejtat sociale të shqiptarëvet, kur ata s'do të kishin të drejtë të çliroheshin nacionalisht? Duke e parë në këtë prizëm, krejt problemin, del që komunistët malazezë kanë qenë komunistë me mangësira thelbësore në botëkuptimin e tyre. Duke mos qenë internacionalistë, në terrenin konkret, aty ku jetonin, derë më derë me shqiptarët, ata, madje, nuk mund as të quheshin komunistë.

Por edhe sikur ata malazezë që e quajtën veten komunistë, të ishin vërtet të tillë, pra, sikur çështjen e çlirimit nacional të shqiptarëvet të atyre trevave ta vinin në programin e vet, borgjezia sllave do të kapej pikërisht pas këtij fakti dhe ata kurrë nuk do të mund të vinin në pushtet.

Përfundimisht, ka qenë detyrë e vetë shqiptarëvet t'i analizonin e t'i kuptonin të gjitha këto rrethana, të organizoheshin vetë, doemos, edhe ilegalisht, krahas kërkesavet legale, dhe t'u vinin kushte jugosllavëvet. Mirëpo, shqiptarët e Tivarit

e të Ulqinit nuk qenë në gjendje të bënin punë të këtilla, sepse ishin tmerrësisht të prapambetur nga ana arsimore.

"Komiteti Krahinor i PKJ për Malin e Zi (Mali i Zi nuk ishte Republikë, Gj.D.) **ka zgjedhur për kryetar Nikolla R. Lekiqin** (një malazez me origjinë shqiptare nga një ish-katund i Shestanit, Gj.D.) **dhe detyrë kryesore e atij komiteti ka qenë: Propaganda e Bashkimit Sovjetik, ... ndërsa popullin malazias e konsiderojnë të robëruar dhe në një gjendje më të keqe se nën Turqinë." (f.85)**

Për zgjedhjet e 5 majit 1935, midis kandidatëvet për deputetë është edhe shqiptari Dr.Filip Dobreci (regjistruar Dobreçiq). Ai ishte vëllai i arqipeshkvit të Tivarit, por nuk tha asnjë fjalë për të drejtat e shqiptarëvet. Ka pasur dallim të madh midis Cafobeg Ulqinit dhe Filip Dobrecit. Gjithsesi, në vitin 1935 në Tivar është zhvilluar kampanjë (fushatë) shumë e fuqishme elektorale, pa bërë askush asnjë kërkesë për të drejtat nacionale të popullsisë vendëse. Krejt peshën e lëvizjevet politike dhe sociale e kanë mbajtur të ardhurit, dmth të 2 pushtuesit: sërbët dhe malazezët. Malazezët e quanin veten të pushtuar, "***më keq se nën Turqinë***", ndërsa edhe vetë ishin dhe mbetën pushtues.

"Kongresi VII i Kominternit (25 korrik – 25 gusht 1935) ka tërhequr vëmendjen në lidhje me rrëziqet e fashizmit dhe ka kërkuar që të krijohet fronti antifashist në sjkallë botërore." (f.86)

"Komiteti i Qarkut në Tivar ka zhvilluar në të gjithë katundet një veprimtari të gjallë politike me qëllim pjesëmarrjen sa më të gjërë nëpër tubime. Janë krijuar këshillat e aksionet për të mbledhur sa më shumë njerëz." (f.86)

"Më 16 gusht 1935 mbahet tubimi i opozitës së bashkuar në Tivar. Në atë tubim marrin pjesë shumë fshatarë nga Rrethi i Tivarit. U vu re prania e një numri të madh myslimanësh, të cilëvet u interesoni posaçërisht çështjet ekonomike dhe përmirësimi i jetës në fshat." (f.88)

Nuk mund të mos vëmë re këtu që autori, në vend të fjalës ***SHQIPTAR,*** ka përdorur fjalën ***MYSLIMAN***. Ka qenë ky një qëndrim dinak, I ulët, por edhe I neveritshëm, I politikanëvet malazias, jo vetëm në trevat tona në tivar e Ulqin, porn ë të gjithë viset shqiptarë që I kish pushtuar Jugosllavia.

"Nikolla Gjonoviqi, avokat nga Cërrnica, ka qenë organizatori i tubimit të 16 gushtit 1935 dhe ka mbajtur fjalimin kryesor. Një komunist, po nga Cërrnica, e ka ndërprerë: *'Ne nuk na duhet çështja kroate, por duam çështjen malazeze!'* Dhe ka bërtitur: *'Rroftë Mali i Zi i lirë!'* Nikolla Gjonoviqi, (i cili nuk ishte komunist, Gj.D.) **sigurisht, nën sugjerimin e cërrniçanëvet** (komunistë, Gj.D.)**, e ka prekur edhe çështjen e Rusisë, duke theksuar që *'ne malazezët duhet të vendosim lidhje me këtë vend sllav, pa marrë parasysh regjimin që sot sundon atje.'"* (f.88)**

Tani ne mund të përfytyrojmë: Tubimi mbahet në Tivar, pra, në Shqipëri. E organizojnë dhe drejtojnë, jo vendësit, por të ardhurit malazezë. Politika e tyre është nacionale, e cila arrin deri atje, sa të kërkojë një Mal të Zi të shkëputur nga Jugosllavia. Kërkon lidhje me Rusinë, sepse edhe Rusia është vend sllav. Nuk shikohet regjimi, por shikohet kombi. Ndërkaq, shqiptarët që marrin pjesë në atë miting, në atë tubim, nuk thonë dhe nuk bëjnë asgjë për vete. Madje, edhe vetë Nikolla Gjonoviqi, gjykuar nga pranemri, llagapi i tij, që vjen nga një Gjon, është me prejardhje arbërore. Por ai bën tashmë politikën ruse. Ç'po ndodh kështu me ne shqiptarët? Pse po ndodh kështu?

Boshko Strugari, një ortodoks me prejardhje nga Struga, pra me prejardhje shqiptare, dhe që jeton në Ulqin, midis shqiptarëvet, bën gjithashtu politikë malazeze dhe politikë sllave. Ai e mbyll fjalimin e tij me thirrjen: ***"Rroftë rinia revolucionare e Malit të Zi!"* (f.88)**

Andon Zako Çajupi ynë, ortodoks edhe ai, por jo si Boshko strugari, do të kish thënë: ***"Të plastë koka, more Strugari ynë! Si s'fole një fjalë për Shqipërinë, more Strugari ynë!"***

Më 23 gusht 1935 Svetozar Vukmanoviqi është i pozicionuar kundër Sërbisë. **"Shokë dhe vëllezër, u mbushën 17 vjet nga bashkimi i dhnshëm që është kryer nën presionin e trupavet të Sërbisë." (f.89)**

Por, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai shkoi në Shkup, Tetovë e Dibër, pikërisht për të organizuar shtypjen e përpjekjevet të shqiptarëvet për liri. Ai organizoi terror në Tetovë, Gostivar, Kërçovë e gjetkë dhe e mbushi atë tokë me varre shqiptarësh.

Në rezolutën e mitingut të Virit, më 26 gusht 1935, kërkohet, midis tjerash, edhe ndërtimi i rrugës Vir-Ostros (f.90), gjë që për shqiptarët e anëvet tona do të ishte gjë shumë e mirë. Por ajo punë, ndonëse filloi, nuk u realizua për vite me radhë.

Është kërkuar edhe rregullimi i Liqenit të Shkodrës (f.90). edhe kjo është kërkesë progresiste, por ne na shkon mendja që liqenin tone, i cili është në shumicën e tij i shqiptarëvet, tash e kanë marrë fqinjët tanë dhe po duan ta rregullojnë për vete.

"Xhandarmeria e udhëheqja e Rrethit të Tivarit ka ndërmarrë hetimet dhe përndjekjen e Svetozar Vukmanoviqit." (f.90)

Autori Gojko Vukmanoviq tregon më tutje që një tatimmbledhës i Tivarit ka ofenduar me fjalë cërrniçanët, por nuk ia thotë emrin atij personi dhe nuk jep asnjë hollësi tjetër. Kështu që ne nuk e dimë: A ka qenë kjo një sharje e rendomtë ndërkrahinore, apo ka ndodhur mbi baza nacionale? Madje, mundet që incidenti të mos ketë përbërë kurrfarë ofendimi, përkundrazi, të ketë pasur një domethënie më të thellë, por që autori e denigron duke e banalizuar me termin ***ofendim***.

Në shkurt 1936 mbahet në bojoviq të Cërrnicës Konferenca e Komitetit të PKJ-së për Qarkun e Tivarit. Konferenca zhvillohet natën. Marrin pjesë nga 2 delegatë nga komitetet vendorë të Tivarit, Ulqinit, Petrovacit dhe Cërrnicës. (f.90) Unë po i jap këtu edhe emrat e atyre që kanë folur në atë konferencë: Nikolla R. Lekiq, Bllazho Joshov Orllandiq, Bllazho Mashanoviq, Dushan Maroviq, Boshko strugar, Risto Lekiq, Velisha t. Lekoviq, Nikolla Lekiq, Lubo Klisiq, Ilija Purlija, Marko Gregoviq. Mua më bie në sy që këtu nuk ka asnjë shqiptar, ose të paktën të atillë që e quan veten shqiptar. Pra, diskutojnë për fatet e kësaj pjese të atdheut të shqiptarëvet, Tivarit e Ulqinit, njerëz që nuk janë shqiptarë. Nëse kjo conference do të ishte veprimtari e njerëzvet që që janë në pushtet, nuk do ta merrnim në shqyrtim fare, sepse do të thoshim: Pushtuesi ka në dorë t'I lërë mënjanë përfaqësuesit e një populli të pushtuar. Por konferenca është e një shtrese që kërkon të vijë në pushtet dhe shihet që as këtu nuk ka vend për shqptarët. Pyetja që shtroj unë tani është kjo: Në kohën kur malazezët bëjnë organizime jo vetëm shtetërorë, por edhe kundër atij pushteti, po shqiptarët a bëjnë organizime nga

çfarëdo pozicioni qoftë? Fundja, a duhej të lëviznin edhe shqiptarët, apo të rrinin ashtu, siç rrinë bagëtitë të mbyllura në një oborr?

Në vitin 1936, komunistët Nikolla Lekiq, Risto Lekiq dhe Boshko Strugar, kanë kaluar ilegalisht në shtetin shqiptar. (f.92) Do të ish me interest ë dihej cila ka qenë veprimtaria e tyre midis shqiptarëve në shtetin shqiptar, pasi tashmë e dimë që ata, si të quajtur internacionalistë, në drejtim të rreth 20 mijë shqiptarëvet në trevat e Tivarit e të Ulqinit, kanë mbajtur thuajse të njëjtin qëndrim si feudokapitalistët: Kral Nikolla, Kral Aleksandri etj. Do theksuar këtu që, si strugari, ashtu edhe 2 Lekiqët e selcës, kanë qenë me prejardhje shqiptare, ashtu siç kanë qenë me prejardhje shqiptare edhe shumë bejlerë në kohën e Perandorisë Osmane, të cilët, si kur i shërbenin Perandorisë, ashtu edhe kur luftonin kundër Perandorisë, nuk merreshin fare me hallet e etnisë apo kombit të vet, te i cili i kishin rrënjët. Ose merreshin thjeshtë për ta shfrytëzuar.

Në vitin 1937 krijohet Komiteti Vendor i PKJ-së për Tivarin. Sekretar bëhet Bllazho Jokov Orllandiqi. (Edhe ky nga Selca, fshat shqiptar deri në shekullin XIX.) Anëtarë janë: Bozho Gojniqi, Marko Vuletiqi dhe Dushan Maroviqi. Krijohen celulat e PKJ-së nëpër fshatra, por: **"Në zonën ku banonte populate myslimane dhe shqiptare Komitetit Vendor** (I PKJ-së për Tivarin) **nuk ia ka dalë të krijojë organizatat e Partisë dhe as të realizojë një ndikim më të madh në masat." (f.93).** Në pyetjen: Pse?, përgjigjja është fare e thjeshtë: PKJ nuk kërkonte çlirimin nacional edhe të shqiptarëvet. Komunistët malazezë që jetonin në Tivar e në Ulqin, me pak përjashtime, nuk denjonin as të mësonin gjuhën shqipe, nuk kërkonin të hapeshin shkolla shqipe për shqiptarët, e si, pastaj, të kishin influencë midis shqiptarëvet?!

Në faqet 93-94, autori i studimit, Gojko Vukmanoviq, flet për shkuarjen e pjesëmarrjen e malazezëvet, kryesisht të Cërrnicës, në Luftën e Spanjës. Ka edhe nga ata që vriten në luftën për çlirimin e popullit spanjoll nga zgjedha fashiste. Shtrohet pyetja: Nëse në Kranjë apo Anë të Malit do të kish shpërthyer një revoltë fshatarësh për çlirim nacional, sa prej këtyre luftëtarëvet të Spanjës do të ishin bashkuar me kryengritësit shqiptarë? Nuk po i shtroj kot këto pyetje dhe nuk po i bëj kot këta komente. Çështja e madhe që do analizuar është: Ç'do të ndodhë në të ardhshmen në marrëdhëniet midis nesh, shqiptarëvet të Tivarit dhe të Ulqinit, dhe

malazezëvet? A thua është zgjidhje ajo që shqiptarët e Tivarit të shndërrohen në malazezë, pastaj të presin ditë më të mira?!

"Në vitin 1938 krijohet në Cërrnicë dhe në Pashtroviq, pra atje ku popullata është sllave, shoqata 'Seljaçka samopomoq' ('Vetëndihmesa fshatare'). Kjo shoqatë, përveç lehtësisë ekonomike për anëtarët e vet, ka në program edhe arsimimin e fshatarëvet... Në vitin 1941 (kjo shoqatë) **u ndan mësuesvet** (vetëkuptohet, sllavë) **të Tivarit, 500 dinarë." (f.94-95).**

Fshatarë janë edhe shqiptarët e Shestanit, Kranjës, Anës së Malit e të fshatravet rreth Ulqinit, por atje nuk janë krijuar të këtilla shoqata për t'u vetëndihmuar në kushtet e një shtypjeje jo të njëfishtë, por të dyfishtë: edhe nacionale, edhe shoqërore, dhe në kushtet e mungesës së plotë të arsimit në gjuhën shqipe.

"Me rastin e hyrjes së trupavet ushtarake italiane në shtetin shqiptar, në Cetinjë, më 8 prill 1939 janë organizuar demonstrata, në të cilat kanë qenë të pranishëm edhe shumë komunistë e të rinj nga Cërrnica." (f.95)

Për shqiptarët e Tivarit e të Ulqinit nuk thuhet asgjë, çfarë qëndrimi kanë mbajtur ndaj pushtimit fashist të shtetit shqiptar. E vërteta është se edhe këta rronin nën diktaturën monarkiste jugosllave. Cili ishte edhe cili duhej të ishte reagimi i kësaj pjese të robëruar të Shqipërisë?

"Në zgjedhjet parlamentare të 11 dhjetorit 1938 në Qarkun e Tivarit merren këto vota: Gjuro Çejoviq 5353, Nikolla Gjonoviq 1589, Petar Lekiq 523 dhe Dimitrije Ljotiq 8 vota." (f.95)

Nuk ka as edhe 1 shqiptar. E pra, në këto hapësira jetonin mbi 20 mijë shqiptarë.

"Më 1939 krijohet Komiteti Vendor i Përkohshëm i PKJ-së për Tivarin, në të cilin hyjnë: sekretar, Ljubo Klisiq dhe anëtarë, Vllado Rolloviq, Dushan Maroviq, Marko Vuletiq." (f.96)

Nuk duhet të harrojmë që një pjesë e mirë e këtyre, jo vetëm komunistë të thjeshtë, por edhe në udhëheqje, në krye, edhe bukën e përditshme e kishin të pakët, njëlloj si shqiptarët. Por dallimi midis nesh shqiptarëvet dhe atyre ishte, se ata, malazezët,

ishin bërë tashmë me shkollë dhe shkollimi i tyre ishte funksional. Dmth i mbushur me ideale. Ne shqiptarët nuk kishim njerëz të shkolluar, përveç priftërinjvet, edhe ata fare të pakët dhe thuajse jofunksionalë për kohën në të cilën kish hyrë tashmë shoqëria njerëzore.

"Në të gjithë katundet e Cërrnicës, PKJ ka cellulat e veta. Po kështu edhe në Tivar, Ulqin e Petrovac. Përpjekja që të bëhet diçka edhe në Shestan e Kranjë, nuk ka pasur ndonjë sukses të dukshëm." (f.96)

Thotë kështu historiani Gojko Vukmanoviq, por nuk hyn më thellë, për të zbuluar shkaqet e një të këtillë mospërhapjeje të lëvizjes midis shqiptarëvet, të një lëvizjeje të paktën antiqeveritare.

"Në vitin 1939 në Tivar ka qenë i ndaluar organizimi sindikal i punëtorëvet. Në manifestimin e mbajtur në Podgoricë më 15 tetor 1939 është shprehur protesta kundër ndalimit të organizimit sindikal në Rrethin e Tivarit." (f.96)

"Mbas vitit 1938 çetat e sokollashëvet (organizim qeveritar i rinisë slave, Gj.D.)**, nëpër fshatra thuajse nuk kanë ekzistuar. Ato janë zëvendësuar me klube futbolli nën udhëheqjen e komunistëvet. Çetat e sokollashëvet ekzistonin akoma në Tivar e në Ulqin, por ishin krejt të izoluara prej rinisë përparimtare." (f.96)**

"Rinia përparimtare, në vitin 1938, në Tivar ka qenë grumbulluar rreth klubit sportiv 'Orao' ('Shqiponja'). Klubi ka pasur edhe grupin kulturo-artistik." (f.96)

Do bërë pyetja: Meqë ky klub sportiv i bënte ndeshjet në një qytet shqiptar, në të cilin, sipas Edith Durhamit, në vitin 1901, çdo familje, brenda në shtëpi, nuk përdorte gjuhë tjetër, përveç shqipes, lojtarët në ç'gjuhë flisnin njëri me tjetrin në vitin 1938? Do bërë gjithkështu edhe kjo pyetje: Shfaqjet e grupit kulturo-artistik të Tivarit, në ç'gjuhë jepeshin? Dhe përgjigjja është kjo: Në të gjitha këto forma organizimi përdorej gjuha sllave, sepse shqiptarët nuk ishin robëruar vetëm fizikisht, por tashmë po robëroheshin edhe shpirtërisht.

"Në Tivar, në vitin 1939, janë hapur: 1 bibliotekë dhe 1 leximore, të cilat i ka udhëhequr PKJ, por qeveritarët i kanë mbyllur ato mbas disa muajsh." (f.97)

Lexuesi e di tashmë, megjithatë, nuk është keq që ta përmendim: Librat e asaj biblioteke ishin në gjuhën sllave! Madje, aty mund të kish libra edhe në gjuhë të tjera, frëngjisht, gjermanisht, italisht, anglisht, vetëm në shqip, jo kurrsesi! Dhe kishin moral, komunistët malazezë të Tivarit, të flisnin për të drejtat sociale e kombëtare!!

Në anë tjetër, të parët tanë, shqiptarët, kishin moral të bënin festa e dasma, të këndonin e të kërcenin, të thernin qe e lopë, për t'i bërë dasmat sa më të bujshme, dhe nuk hapnin një bibliotekë në gjuhën shqipe, në mos në Tivar, në një shpellë diku sipër Tivarit!!

"Në Godenjë, në nëntor 1939, është hapur, me nismën e komunistëvet, Universiteti Popullor." (f.97)

Godenja është një fshat mu në kufi me Shestanin.

"Në kampin e Smederevska Pallankës, në fund të vitit 1940, janë çuar disa komunistë dhe simpatizantë të tyre nga Tivari. Komunistët e Rrethit të Tivarit e kanë nxitur opinionin publik kundër të këtillë kampeve (përqëndrimi) **dhe kanë gjetur përkrahje të plotë midis popullatës." (f.97)**

Megjithkëtë, autori nuk lë pa vënë në dukje, dhe bën mirë, që **"në trevat e tjera të Rrethit të Tivarit, (Kranjë, Anë e Malit, Shestan, Mërkot) puna dhe ndikimi i PKJ-së kanë qenë ndijshëm të dobët." (f.97)**

Kjo është edhe mbyllja e këtij shkrimi studimor të ish-profesorit të shkollës së mesme të Tivarit. Ne jemi të detyruar të konstatojmë, me shumë keqardhje, se forcat politike malaziase, të të gjithë llojeve e orientimeve, që nga monarkistët deri te komunistët, janë sjellë në Tivar, në Ulqin e në të gjithë atë pjesë të Shqipërisë Veriperendimore si **PUSHTUES**.

Çështja që shtrohet për tash e tutje është kjo: Gjeneratat e reja të malazezëvet, a do të duan dhe a do të dinë të sillen me shqiptarët, si me fqinjët e vet, të barabartë në çdo pikëpamje? Kjo, sigurisht, varet shumë edhe prej nesh shqiptarëvet.

Gjokë Dabaj - Durrë, 17 gusht 2013

5

REFERENCAT TE: Gojko Vukmanoviqi

VIRPAZAR, BAR, ULQIN, f. 175-219

Virpazar, Bar, Ulcinj

Obod, izdavačko-štamparsko preduzeće

Cetinje-Beograd, 1974

"Gojko Vukmanoviq: Lufta Nacionalçlirimtare dhe revolucioni, 1941-1945."

(Titulli i studimit, f.175)

"Më 25 mars 1941 Jugosllavia ka nënshkruar aderimin në Paktin Tripalësh, Gjermani-Itali-Japoni." (f.177)

Do të mjaftonte vetëm kjo, aderimi në Paktin e Boshtit, që Jugosllavisë të mos i liheshin më brenda kufijvet të saj pjesët e Shqipërisë, nga Manastiri deri në Tivar. Si ndodhi që kësaj Jugosllavie, sado që, pas Luftës, me një qeveri komuniste në vend të asaj monarkiste, jo vetëm iu lanë viset shqiptarë dhe ata hungarezë, por iu

dhanë edhe Ishujt e Dalmacisë dhe krejt Bregu Dalmatin?! Bashkimi Sovjetik dihej që donte t'ia jepte edhe gjysmën e Austrisë, Korushkën, por, si ndodhi që Anglia dhe Amerika u treguan jo vetëm kaq të padrejtë, por edhe kaq jolargpamës?!

"PKJ organizon demonstrata në të gjithë Jugosllavinë... Në Tivar, më 27 mars 1941, mbahet një miting gjysmëilegal, në të cilin marrin pjesë afër 200 vetë. Flet (në miting) Nikolla Vukçeviqi, sekretar i celulës së PKJ-së për Tivarin." (f.177)

Pjesëmarrja e pakët, më pak se 200 vetë, dëshmon se shqiptarët kanë qëndruar larg këtyre demonstratave, që i organizonte Partia Komuniste Jugosllave, sigurisht, për interesat e vet, duke parashikuar dhe duke punuar që Tivari edhe pas Luftës të mbetej nën Jugosllavinë.

"Të nesërmen (më 28 mars) në manifestimin e Tivarit ka folur Lubo Klisiqi, sekretar i Komitetit Vendor të PKJ-së për Tivarin. Organizata partiake e PKJ-së në Ulqin ka organizuar gjithashtu miting. Aty kanë marrë pjesë një numër i madh banorësh të qytetit dhe të fshatravet përrreth. Ka folur Boshko Strugari. Mbas mitingut, Boshko Strugarin e ka arrestuar policia." (f.177)

"Në prill 1941 selia e Komitetit Vendor të PKJ-së për Tivarin ka qenë vendosur në Cërrnicë. Në udhëheqje të atij Komiteti ishin: Lubo Klisiqi, Vllado Rolloviqi, Marko Vuletiqi, Velisha Lekoviqi, Mihaillo Dobërkoviqi, Vido Matanoviqi, Vllado Kavaja, Niko Vukoviqi, Maria Sholaga." (f.177)

Asnjëri prej veprimtarëvet që u përmendën, nuk janë as tivaras, as ulqinakë. Vukçeviqtë janë të Glluhi Dolit në Cërrnicë, Klisiqtë janë të Limjanit, Rolloviq ka në Podgor, Bërçelë e Limjan, edhe Vuletiqtë janë të Limjanit, Lekoviq ka në Godenjë e në Bojeviq, Dobërkoviqi është nga Maçuga, Matanoviqtë mund të jenë edhe qekliqas, Vukoviqtë i gjejmë në Svibë të Piperit, por ky, Niko Vukoviq, mund të jetë edhe nga ndonjë fshat tjetër, gjithsesi jo tivaras, Sholagët janë të Pashtroviqit. Nuk e di ç'lidhje ka pranemri, llagapi, Kavaja me qytetin tonë të Kavajës, por, që personi në fjalë, Vllado Kavaja, ka qenë ortodoks, shihet nga emri Vllado. A ish me prejardhje nga Kavaja dhe a e quante veten shqiptar, kjo duhet hulumtuar. Edhe për Strugarët mund të themi të njëjtën gjë: ata janë shqiptarë nga

Struga, të cilët, për shkak të fesë, si dhe Janinoviqtë, morën anën e malazezëvet dhe, për inerci, u bënë edhe komunistë.

"Në prill 1941 Jugosllavia është thyer, dmth pushtuar për 10 ditë. Territorin e Rrethit të Tivarit e kanë pushtuar njësitë e korpusit 14 të ushtrisë italiane, divizioni 'Mesina'. Ulqini, Ana e Malit, Kranja, Shestani dhe Peçurica i janë bashkuar së quajturës Shqipëri e Madhe. Ato treva i kanë qeverisur njësitë ushtarake kuislinge dhe pushteti civil i Shqipërisë së Madhe nëpërmjet prefekturës dhe komunavet, por atje kanë qenë të pranishme edhe trupat italiane." (f.177)

Emërtimi ***"Shqipëri e Madhe"*** ka qenë i gabuar. Kushdo që ta ketë "shpikur" atë emërtim, ka qenë një mosnjohës i historisë, ndërsa shqiptarët janë treguar edhe më mosnjohës, kur kanë pranuar një të tillë emërtim. Emërtimi "***Shqipëri e Madhe"*** do të mund të përdorej vetëm atëherë, kur një shtet shqiptar do të synonte apo do të përfshinte realisht tokat nga Gjiri i Prevezës deri në lumin Sava në Kroaci e në Bosnjë. Meqë një gjë e tillë nuk mund të ndodhë kurrë, rrjedhimisht, as ky emërtim nuk duhet dhe nuk mund të përdoret, sepse nuk ka logjikë.

Lënia e Tivarit jashtë asaj që u quajt ***"Shqipëri e Madhe"*** e që nuk ish aspak e madhe, ka qenë një padrejtësi nga ana e italianëvet dhe ka sjellë ngatërresa të shumta në komunikimin normal të popullatës sonë.

Te akti i të bashkuarit të visevet të Ulqinit, Anës së Malit, Kranjës e Shestanit, me shtetin, atëherë vërtet kusling, të Shqipërisë, duhet të shikojmë, jo përkrahjen ndaj pushtuesit italian, por dëshirën e madhe të kësaj popullate për të qenë pjesë e shtetit të vet. Nuk e duartrokiste populli ynë Italinë Fashiste. Populli ynë duartrokiste bashkimin me Shkodrën, mundësinë për të mos pasur kufi midis së njëjtë popullatë. Le të ish dreqi i mallkuar ai që do ta hapte atë kufi! Ne do t'i gëzoheshim, jo dreqit, por heqjes së kufirit.

"Në territorin e Rrethit të Tivarit pushtuesi ka vendosur garnizonet, si dhe stacionet e karabinierisë dhe të financavet: në Tivar, Ulqin, Vir e gjetkë." (f177)

Këtu na bie në sy që autori përdor termin ***PUSHTUES,*** për italianët, gjë që është e saktë, por për malazezët e për jugosllavët, që më vonë e ripushtojnë këtë vend, ai nuk thotë asnjëherë se janë **PUSHTUES**. Ky pozicion gjykimi nuk çon asnjëherë në mirëkuptim midis popujvet.

"Macolini ka emëruar, më 28 prill 1941, për komisar të Tivarit Gjovani Miletin, i cili deri atëherë kish qenë përfaqësues i *'Shoqërisë së Tivarit'* në Beograd. Për kryetar rrethi është vënë Nikolla Debelja, kurse për kryetar komune Pero Jovoviq Qekliqi. Është vendosur kufizimi i shpërndarjes së produktevet nga ora 9 deri në 11. Magazinat e duhanit në Tivar dhe dogana, janë sekuestruar." (f.178)

Siç shihet, pushteti fashist Italian në Tivar nuk ka vënë as edhe 1 shqiptar. Diskriminimi i shqiptarëvet të këtij qyteti dhe rrethinës së tij të ngushtë bëhet kështu i dyfishtë.

"Në qershor, komisari i lartë Macolini ka vizituar Virin dhe Tivarin. Në Tivar Nalt ka pritur pushtetarët kuislingë dhe përfaqësuesit e klerit. Duke iu përgjigjur besnikërisë së tyre, ai ka vënë në dukje që Italia, në frymën e miqësisë 'luajale', do të shqyrtojë nevojat e Malit të Zi, i cili *'do të ketë flamurin e vet dhe pavarësinë'*." (f.178)

Duken mjaft cinike dhe janë cinike këto fjalë të Macolinit, por se herë kanë thënë pushtetarët malazezë, filluar që nga Kral Nikolla, dhe pushtetarët sërbë, që Tivari dhe Ulqini "***gëzojnë larinë***"?! A nuk është kulmi i cinizmit antinjerëzor t'i quash gjithandej Tivarin dhe Ulqinin "***Bregdet Malazias***" ("Crnogorsko Primorje") dhe të thuash që këta vende i ka "***çliruar***" ushtria malaziase apo ajo sërbe?!

"Qeveritarët e Italisë pushtuese, që në ditët e para, kanë dhënë urdhër që të dorëzohen armët dhe municioni. Urdhëri nuk ka dhënë rezultatin e pritshëm dhe ai është përsëritur." (f.178)

"Në fund të prillit 1941 mbahet takimi i Komitetit Vendor i PKJ-së për Tivarin. Sekretari i Komitetit, Lubo Klisiq, pasi sihte kthyer nga Komiteti Krahinor i PKJ-së për Malin e Zi, jep

udhëzimin për grumbullim armësh dhe për depozitimin e tyre në vende të sigurtë.” (f.178)

“Në Tivar për çështjen e armëve ngarkohet Bllazho Joshov Orllandiqi.” (f.178)

Nuk është e tepërt të vëmë në dukje që, as Klisiqi, as Orllandiqi, nuk janë tivaras. Klisiqi është nga Limjani i Cërrnicës, ndërsa Orllandiqi, nga Selca, e cila deri në shekullin XIX ka qenë shqiptare, por është sllavizuar nën ndikimin e fesë pravosllave. Kemi të bëjmë, pra, me një ndeshje, me një luftë, midis 2 pushtuesvet: Kush do ta mbajë Tivarin? Italia apo Mali i Zi? Malazezët bëjnë luftë të drejtë kundër fashizmit italian, por nuk mbajnë qëndrim të drejtë ndaj vendësvet shqiptarë. Madje, nuk mjafton të thuhet që bëjnë luftë të drejtë kundër fashizmit, por ata bëjnë shumë sakrifica, në fund të fundit, jo vetëm për të çliruar një krahinë të tyren, Cërrnicën, por edhe për të mbajtur për vete një trevë të huajën, Tivarin. Në pikëpamje filozofiko-sociale, patriotike, politike dhe organizative, kjo dukuri kërkon analiza të hollësishme. Shqiptarët nuk e kanë arsimin e duhur, nuk kanë struktura ekonomike të orientuara nga ekonomia moderne, rrjedhimisht, nuk kanë as struktura politiko-organizative të përshtatshme. Kjo është tragjedia e Tivarit. Dhe jo vetëm e Tivarit.

“Në terrenin e Komitetit Vendor të PKJ-së për Tivarin, vendfshehjet e armëvet gjendeshin: në Tivar, në Ulqin dhe në nja 5 pika grumbullimi në Cërrnicë dhe në Spiç. Në fshatin Selcë ishin fshehur rreth 50 pushkë, 2 mitralozë të lehtë dhe një sasi e konsiderueshme municioni dhe bomba. I ngarkuar për këtë punë në fshatin Selcë, në mënyrë shumë sekrete, ka qenë Millo Orllandiqi. Në Tivar ka pasur 10 pushkë dhe 600 fishekë. Në Ulqin, 15 pushkë, 10 revole, 2 mitralozë të lehtë dhe 1 arkë me municion, për të cilat ishin përgjegjës: Zaro Jankoviqi dhe Vido Matanoviqi.” (f.178)

Nuk është aspak e kotë të shikohen këto gjëra. Historia duhet të njihet. Është e domosdoshme të bëhen analiza. Cila ishte shkalla e organizimit **ILEGAL** e komunistëvet malazias në këtë vend shqiptarësh dhe pse pikërisht ata organizoheshin, ndërsa ne, në shumicën e rastevet, nuk dinim ç’duhej të bënim?

Nuk them se s'pat lëvizje dhe veprime konkretë edhe në radhët tona. Vepruam në ato rrethana edhe ne shqiptarët. Por: Si vepruam dhe cili qe rezultati? Sidomos në 2 aspekte: Në organizimin partiak me vizion qartësisht të studiuar dhe në organizimin ILEGAL të punëvet.

"Organizata partiake vendore e PKJ-së, në korrik 1941, ka pasur 141 anëtarë. Ato ishin si më poshtë: në Tivar (13 anëtarë), në Ulqin (19 anëtarë), në Cërrnicë (93 anëtarë) etj. Sekretar i organizatës partiake për Tivarin ka qenë Nikolla Vukçeviqi, për Ulqinin Vido Matanoviqi. Anëtarë të Rinisë Komuniste Jugosllave ka pasur: në Cërrnicë rreth 200, në Ulqin 23." (f.178)

Shikojmë edhe këtu, që, si në udhëheqje të komunistëvet, ashtu edhe në anëtarësi, edhe në Tivar, edhe në Ulqin, nuk ka shqiptarë. Shenjë që lëvizjen komuniste në këto hapësira e kanë pasur në dorë vetëm malazezët, domethënë sllavët, është edhe krahasimi numerik: Në Tivar e Ulqin ka vetëm 32 komunistë, në Cërrnicën malazeze, që, për nga popullsia s'është as sa ¼ e popullsisë shqiptare në viset ku banonin shqiptarë, ka 93 komunistë. Edhe të rinj komunistë në Cërrnicë ka 200, ndërsa në Ulqin vetëm 23. Vetëvetiu nxiret konkluzioni që në Tivar e në Ulqin popullsia sllave, edhe ajo e ardhur, ka qenë mjaft e kufizuar.

"Janë krijuar skuadra ushtarake dhe stërvitja e tyre është bërë ilegalisht. Në Tivar kishte 15 luftëtarë të ndarë në 2 njësi. Në Ulqin kish, gjithashtu, 15 luftëtarë që i udhëhiqnin Boshko strugari dhe Nikolla Gjakonoviqi." (f.178)

Edhe numri i guerrilëvet në Tivar e në Ulqin ka qenë i vogël në krahasim me Pashtroviqin e me Cërrnicën. Në Cërrnicë kish rreth 310 guerrilë, ndërsa në Ulqin e Tivar vetëm 30. Edhe ky fakt u dëshmon historishkruesvet që Ulqini e Tivari, në mesin e shekullit XX banoheshin kryesisht me shqiptarë.

"Më 11 korrik 1941 në një vend sekret në Fushë të Cërrnicës është mbajtur një takim i udhëheqësvet komunistë të Rrethit të Tivarit, gjithsej nja 20 vetë, dhe është marrë vendimi që më 13 korrik të fillonin veprimet kryengritës kundër pushtuesvet italianë. Është bërë një plan i hollësishëm mbi veprimet luftarakë të njësitevet që tashmë ishin krijuar. Midis tjerash

(gjithsej 9 pika të planit), njësiti guerril i Tivarit do të hidhte në erë të quajturën Ura e Madhe që gjendej poshtë Tivarit Nalt, si dhe linjën hekurudhore në Sutorman. Pjesë të çetës së Selcës e të Krricës do të vendosnin pusi në drejtim të Kranjës." (f.181)

Në tekst thuhet ***Kranjë***, por në të vërtetë është Shestani që ndryshe quhet ***Kranjë e Epërme***. Të 3 këta veprime (organizuar prej njësiteve ilegalë malazezë), edhe hedhja në erë e Urës së Madhe në Tivar, edhe prishja e linjës hekurudhore në Sutorman, edhe vendosja e pusivet në kufi me Shestanin, dëshmojnë që popullsia shqiptare nuk ishte përfshirë në organizimin e kryengritjes. Përkundrazi, ajo konsiderohej bashkëpunuese me okupatorin, ashtu siç edhe ishte në të vërtetë, pasi malazezët (jugosllavët) konsideroheshin prej nesh okupatorë më të këqinj se italianët. Italianët nuk e rrëzikonin ekzistencën tonë, ndërsa sllavët kërkonin: ose asimilimin, ose dëbimin (me forma të ndryshme), ose asgjësimin e shqiptarëvet.

"Të gjithë veprimet kryengritës të 13 korrikut janë bërë jashtë territorit shqiptar, me përjashtim të aksionit mbi Urën e Madhe dhe sulmit mbi një kamion me ushtarë në Togjemil." (Krs: f.182-183)

"Nga Petrovaci tërhiqen në Tivar, me anije, nja 16 ushtarakë, për t'i shpëtuar sulmit të guerrilëvet. Në orën 6 të 13 korrikut sulmohen 3 kamionë me ushtarë italianë në vendin e quajtur Kufi. Në orën 8 të 13 korrikut niset prej Tivarit në drejtim të Pashtroviqit një kolonë e motorizuar me rreth 250 ushtarë. Në vendin që quhet Kufi (Është kufiri që tradicionalisht ka ndarë Shqipërinë prej visevet joshqiptarë, Gj.D.), kolona bie në pritë. Bëhet luftë gjithë ditën, italianët lënë 27 të vrarë." (f.183)

"Një kolonë kamionësh ushtarakë italianë nisen prej Tivarit për në Vir, por hasin në pritë në Qafën e Sutormanit (kufi me Cërrnicën, Gj.D.) në orën 17 të 13 korrikut prapënisen prej Tivarit për në sutorman 5 kamionë. Aty vriten 30 ushtarë italianë." (f.183)

"forca të shumta (rreth 80 mijë ushtarë italianë) nisen nga Shqipëria (nga shteti shqiptar, Gj.D.) për të shuar kryengritjen

në Mal të Zi. Aty bën pjesë edhe njësia 'Skënderbej' me ushtarë shqiptarë. Në Tivar zbarkon një anije 700 ushtarë, që kanë me vete edhe 20 kuaj. Më 15 korrik, prapë një kamion i nisur nga Tivari për në Pashtroviqin bregdetar, has në pritën e guerrilëvet. Më 18 korrik ka zbarkuar në Tivar një batalion i divizionit 'Taro'. Në operacionet kundër kryengritjes merr pjesë edhe aviacioni italian." (f.183)

Një batalion i motorizuar niset më 17 korrik nga Tivari në drejtim të Budvës. Zhvillohet beteja në Brajiq më 18 e 19 korrik. Vriten 22 ushtarë italianë, kurse 169 konsiderohen të humbur. Prej të zënëvet rob, kryengritësit pushkatojnë 24, duke i konsideruar fashistë, sepse mbanin këmisha të zeza. 7 ushtarë të zënë rob i lënë të lirë. (krs. f.184)

Tivari nuk është zonë ku bëhen luftime, gjë që vërteton tërthorazi se ky qytet dhe rrethinat e tija ende në mesin e shekullit XX nuk ishin të banuar me sllavë. Në vend që të ishte edhe kjo trevë vatër e kryengritjes, si Cërrnica, e cila banohej me malazezë, Tivari në këtë kohë shërbeu vetëm si terren grumbullimi të forcavet ushtarake italiane dhe si një nga pikat prej nga nisnin mësymjet mbi kryengritësit.

Luftimet në Grykat e Sozinës, midis Cërrnicës e Petrovacit, vazhdonin. Janë vrarë 43 ushtarë italianë dhe rreth 100 janë plagosur. Kryengritësit malazezë kbërë qëndresë edhe në Qafën e Sutormanit, si dhe në malin Sutorman, kufi midis Malit të Zi dhe Tivarit. Bien ë sy që në Malet e Shestanit, fqinjë të drejtpërdrejtë me Cërrnicën, nuk ka as luftime, as mësymje të forcavet italiane drejt Cërrnicës. Prej pales malazeze vriten 8 e plagosen 16 vetë. Më 25 korrik, në një vend që autori e quan Bjellashi, afër Tivarit, Bllazho M. Raiçeviq has në rojat italiane dhe e vrasin.

Autori Gojko Vukmanoviq shkruan: *"***Në ditët e para të kryengritjes, forcat kryengritëse kanë zotëruar krejt territorin e Rrethit të Tivarit, me përjashtim të vetë Tivarit dhe pjesëvet që i ishin bashkuar së quajturës Shqipëri e Madhe." (f.185)**

Kjo më së miri e dëshmon atë që thashë më parë se Tivari me rrethinë, me Shesatnin në verilindje dhe me viset e tjerë në lindje e në jug, është një territor

jomalazias, pra josllav. Përndryshe edhe këtë territor do ta kishin zotëruar forcat kryengritëse malaziase.

"Më 22 korrik 4 batalione të grupit 'Skënderbej' kanë kryer spastrime në rajonin e Mikuliqit, në lindje të Tivarit, ndërsa një njësi ushtarësh shqiptarë ka hyrë në fshatin Ljare." (f.186)

Fshati Mikuliq ka qenë një fshat me popullsi të përzier. Aty kanë banuar, midis tjerëvet, edhe disa familje ortodokse të sllavizuara. Fshati Ljare ka qenë fshat tërësisht shqiptar, pa asnjë familje sllave.

"Më 24 korrik regjimenti 208 i këmbësorisë ka mbërritur prej Tivarit në Petrovac." (f.186)

"Përfundimisht, të rrethuar midis Kranjës, Liqenit të Shkodrës dhe Detit Adriatik, rreth 600 kryengritës të Cërrnicës, nuk kanë mundur të rezistojnë." (f.186-187)

"Nga 83 anëtarë të PKJ-së që kish Cërrnica, 39 janë dorëzuar dhe, pushtuesit italianë i kanë internuar në Shqipëri." (f.187)

"Sekretari i Komitetit Vendor të PKJ-së për Rrethin e Tivarit, Nikolla Nikiq, është dorëzuar vetë, e kanë çuar në kampin e Klosit në Mat, pastaj e kanë sjellë nga Klosi në Cetinjë, e kanë gjykuar dhe e kanë pushkatuar." (f.187)

"Në Nahijen e Cërrnicës okupatori ka ushtruar terror të jashtzakonshëm. Janë çuar në kampet e përqëndrimit në Shqipëri, Klos, Kavajë, Tepelenë, rreth 1400 banorë të kësaj krahine. Në Tivar janë përqëndruar forca të mëdha ushtarake. Vetëm në Qafë të Sutormanit ka qenë vendosur 1 batalion me ushtarë italianë." (f.187)

"Pikërisht në ditën kur bëhej luftë në Malin e Sozinës, në Çërvanj të Tivarit është pushkatuar Rado Gj. Vuksanoviqi, nga Glluhadoli i Cërrnicës. Më 27 korrik janë pushkatuar në Tivar Nalt: Nikolla Vukçeviqi, Vllado Kavaja, Miliq Miroviqi, Radomir Mirkoviqi, dhe janë hedhur në një pus. Në Topolicë, më 1 gusht,

është vrarë Llabud Marotiqi, kurse në Tivar Nalt janë pushkatuar Gjuro Raiçeviqi, Andrija Markoloviqi dhe Ilija Tërceta. Më 20 gusht pushkatohen në Tivar studentja Vukosava Ivanoviq dhe Tomo Mashanoviqi. Më 22 gusht pushkatohet në Tivar studenti Jovan Boshkoviq nga Limjani. Po në muajin gusht, në Ulqin, është pushkatuar shqiptari Marko Nuculloviq, viktima e parë e pushtuesit në këtë qytet." (f.187)

Midis 13 të pushkatuarvet, janë vetëm 2 shqiptarë: Andri Markolaj (shënuar Markolloviq) dhe Mark Nucullaj (shënuar Nuculloviq). Gjithsesi, viktimat në një luftë për liri, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, meritojnë të nderohen prej gjithkujt.

"Në tetor 1941 në Tivar e në Spiç ka pasur nja 10 luftëtarë, të organizuar (sigurisht, ilegalë, Gj.D.)**, kurse në Ulqin kish 15 luftëtarë. Gjithsej në Çetën partizane të Cërrnicës ka pasur 60 deri 80 luftëtarë, pjesë e të cilëvet konsideroheshin edhe këta të Tivarit." (f.188)**

"Në Kranjë, Anë të Malit, Shestan dhe Mërrkot, ndikimi i organizatës së PKJ-së për Rrethin e Tivarit ka qenë i pakët." (f.188)

Shkakun që lufta kundër pushtuesvet italianë nuk po përhapej në trevat e banuara me shqiptarë, tashmë e kam shpjeguar: shqiptarët e këtyre anëve nuk e kishin detyrë parësore çlirimin nga italianët. Përkundrazi, ata donin të çliroheshin prej sllavëvet. Por fati i keq i yni ishte se italianët e kishin dënuar me kohë veten për ta humbur luftën. Bashkë me italianët (e më vonë gjermanët), do ta humbnim edhe ne kauzën tonë të çlirimit prej sllavëvet. Kjo do të ndodhte, sepse angloamerikanët nuk deshën të na kuptojnë. Angloamerikanët nuk e kuptuan dot që këtu jeton një popull, i cili duhet mbrojtur për të mirën edhe të vetë angloamerikanëvet.

"Këshilli nacionalçlirimtar ilegal për Tivarin është krijuar më 26 dhjetor 1941. Anëtarë këshilli ishin: Dushan Jovoviqi, Hoxhë Hasan Shllakoviqi, Millo Gjengjinoviqi, Ivo Vuçkoviqi dhe Gojko Gërboviqi." (f.189)

I vetmi shqiptar është hoxha Hasan Shllaku, i cili shënohet Shllakoviq. Një i tillë këshill nuk i përgjigjej përbërjes etnike e nacionale të Tivarit. Si i tillë, ai edhe nuk mund t'i mbronte interesat e banorëvet të qytetit tonë. Për më tepër, mund të themi që komunistët ateistë jugosllavë e kishin mashtruar hoxhën tonë, për të krijuar përshtypjen sikur vërtetë ishin demokratë.

"Po ashtu është krijuar këshilli nacionalçlirimtar edhe për Shushanin, njërin nga fshatrat e Tivarit." (f.189)

"Edhe në Ulqin është krijuar po në atë kohë këshilli nacionalçlirimtar, me përbërjen: Mitar Vujanoviq, Pero Bevenja, Andrija Petriçeviq, Mitar Gjuroviq e më vonë Bogdan Vujosheviq." (f.189)

As këtu, asnjëri nga "këshilltarët" nuk është shqiptar. Shqiptarët e Ulqinit në atë ohë e kishin shpallur bashkimin me shtetin e vet dhe, vetëkuptohet, as që kish nevojë për një këshill të tillë. Këshilli illegal i krijuar aty prej malazezëvet, s'është tjetër, veçse një organ, i cili do të ndihmonte më vonë në ripushtimin e këtij qyteti. Por nuk është këtu problem. Problemi është: Si e pranuan Aleatët ripushtimin e këtyre pjesëve të Sqipërisë?!

"Më 8 shkurt 1942 mbahet në Ostros të Kranjës një konferencë e patriotëvet malazias. Përfaqësues të Rrethit të Tivarit kanë qenë: Pop Bllazho Markoviqi, klerik nga fshati Brijege (i Cërrnicës), Gjuro I. Boshkoviqi, student avokatie nga Bërçeli (i Cërrnicës), Andrija S.Vukosavoviqi, nga Sotoniqi (i Cërrnicës) dhe Spiro Sërzentiqi, fshatar nga Pashtroviqi." (f.189)

Së pari, këta nuk kanë qenë përfaqësues të Tivarit, sepse asnjëri prej këtyre nuk është tivaras. Së dyti, se kush ka marrë pjesë në atë konferencë "patriotësh malazias" mbajtur jashtë Malit të Zi, autori, fatkeqësisht, nuk e thotë. Por ne e dimë që Kranja në atë kohë e kish shpallur shkëputjen nga ish-shteti i Jugosllavisë dhe bashkimin me shtetin e Shqipërisë, të pushtuar qysh prej 3 vjetësh nga Italia. Malazezët s'kishin më punë në Ostros, përveçse si fqinjë. Çfarë iu tha kranjanëvet në atë konferencë? As këtë nuk na e thotë autori.

"Nga fundi i shkurtit apo fillimi i marsit 1942 krijohet Këshilli Nacionalçlirimtar për Rrethin e Tivarit, në të cilin kanë hyrë: Pop Bllazho Markoviqi, Gjuro Boshkoviqi dhe Mirko Stojoviqi nga Cërrnica, Hoxhë Hasan Shllakoviqi dhe Sërgja Hajdukoviqi nga Tivari, Ivo Bevenja e Tomash Vojvodiqi nga Ulqini dhe Ivo Masoniçiqi nga Spiçi." (f.189)

Edhe përbërja e këtij këshilli është krejtësisht sllave, përjashtuar Hoxhë Hasan Shllakun. As ky këshill s'ish tjetër, veçse organ parapërgatitës për ripushtimin e kësaj pjese të Shqipërisë Veriperendimore, përveç Cërrnicës, e cila s'është prerj kohësh pjesë e Shqipërisë.

"Komiteti i Qarkut i PKJ-së për Cetinjën, ku përfshihej edhe Rrethi i Tivarit, i ka dërguar Komitetit Vendor të PKJ-së për Tivarin porosinë që të gjenden mundësi për të krijuar lidhje." (f.189)

Kështu na vërtetohet që puna për ripushtimin, edhe të Tivarit, edhe të Ulqinit, nga ana e pushtetit komunist që synonte të vendosej në Jugosllavi pas Luftës, nuk ka qenë një veprimtari e komunistëvet lokalë, por një strategji e PKJ-së, që në qendër. Është mjaft interesante të studiohet nga ana socio-historike, se si një vend i pushtuar, punon, jo vetëm të çlirohet për vete, por edhe të pushtojë vende të tjerë.

"Komiteti Vendor i PKJ-së për Rrethin e Tivarit e ka informuar Komitetin e Qarkut në Cetinjë që situata në organizatën e PKJ-së për Ulqinin është e rëndë. Atje kish 15 anëtarë të PKJ-së, të ndarë në 3 grupe, por 4 prej tyre kishin dalë partizanë." (f.189)

"Rreth 20 dhjetorit 1941 jepet urdhër që të krijohet batalioni partisan i Cërrnicës dhe Bregdetit, si pjesë e aradhës së Llovqenit. Ky batalion do të kishte 4 kompani (çeta): 1 në Cërrnicë, 1 në Pashtroviq, 1 në Tivar e Spiç dhe 1 në Mainë dhe në një pjesë të Bokës së Kotorrit." (f.189)

"Shtabi Qendror i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë ka porositur komandën e batalionit, që do të krijohej, që të vendosen lidhje me arnautët ushtarë, të cilët në atë kohë

gjendeshin në Rrethin e Tivarit, dhe nëpërmjet tyre të tentohet për të siguruar sa më shumë armë dhe municione." (f.191)

"Në batalionin e shqiptarëvet 'Taraboshi' ka pasur disa komunistë, të cilët, para se të vinin në Tivar, kanë pasur lidhje me komunistët e Ulqinit dhe u kanë pasë dhënë një sasi pajisjesh ushtarake. Nga mesi i dhjetorit 1941 disa shqiptarë nga Shkodra kanë shfaqur dëshirën që të hyjnë në lidhje me Komitetin Vendor të PKJ-së për Tivarin, sepse edhe ata po përgatisnin aksione dhe demonstrata kundër pushtuesit. Një anëtar i Komitetit të PKSH-së për Shkodrën ka shfaqur dëshirën të vijë në Komitetin Vendor për Tivarin, me qëllim që të bisedohet mbi bashkëpunimin. Komiteti Vendor i PKJ-së për Tivarin ka qenë i mendimit që do të ish mirë që Komiteti Krahinor ose Komiteti i Qarkut të hartojë një trakt dedikuar ushtarakëvet shqiptarë. Komiteti Krahinor i PKJ-së për Malin e Zi ka qenë dakord që kërkesa e shqiptarëvet të merret parasysh dhe që shoku nga Shkodra të vijë në takim për bisedime. Udhëzimi ka tërhequr vëmendjen që të tregohet kujes se mos që andej, nga Shqipëria, vjen ndokush me farë prapamendimesh." (f.191)

Fjalia e fundit e zbulon krejt politikën e komunistëvet jugosllavë ndaj çështjes shqiptare qysh në vitin 1941. Del qartë puna me hile që ata bënin në kontaktet me shqiptarët. A e dinte Enver Hoxha këtë punë me hile të "kolegëvet" jugosllavë? Sigurisht që e dinte, por detyrohej edhe ai të bënte "diplomaci", të shtirej si mik pa rezerva. Kjo duhet të mbahet parasysh në hulumtimet e historiografëvet.

"Fill pas kësaj, Komiteti i Qarkut i PKJ-së për Cetinjën, ka shkruar një proklamatë kushtuar shqiptarëvet, ushtarëvet në shërbim të italianëvet dhe popullatës shqiptare në Rrethin e Tivarit (ku përfshihej edhe Ulqini). Proklamata është përkthyer në gjuhën shqipe dhe nga fundi i dhjetorit 1941 është shpërndarë në territorin e këtij rrethi. Në proklamatë shkruhej se partizanët malazias luftojnë për larinë e të gjithë popujvet të shtypur, se PKJ-ja është i vetmi luftëtar për të drejtat dhe larinë e arnautëvet në Jugosllavi dhe se partizanët malazias përshëndesin

dhe ndihmojnë luftën e arnautëvet për liri. Në fund të dhjetorit në Komitetin Vendor të PKJ-së për Rrethin e Tivarit ka ardhur Krsto Popivoda që të kryente punët rreth vendosjes së lidhjevet me Shqipërinë, sepse ekzistonin për këtë punë kushte të përshtatshëm." (f.191).

Në faksimilin përkatës gjendet edhe kjo frazë: **"ushtarë shqiptarë qi jeni dërgue me force në token malazeze". (f.190)**

Ushtarët shqiptarë, sado që ishin në shërbim të okupatorit, në të vërtetë nuk gjendeshin në tokën malaziase. Ulqini, Kranja, Ana e Malit, ku ishin dislokuar forcat ushtarake shqiptare, ishin tokë shqiptare, nuk ishin tokë malaziase. Këto hapësira edhe sot janë toka shqiptare, sado që gjenden në shtetin malazias. Këto gjëra duhet të sqarohen njëherë e mirë: Të bëhet dallimi midis nocionit administrativ ***shtet*** dhe nocionit gjeografik ***atdhe***.

Na bie në sy që, autori, në tekstin e vet, ka përdorur, për ne që gjendeshim përkëtej kufirit, fjalën ***Arnaut*** në vend të fjalës ***Albanac*** (shqiptar). Përse të ketë vepruar kështu ish-profesori im?!

"Rreth 10 janarit 1942 është dërguar në shtabin e batalionit '*Jovan Tomasheviq*' Vaso Strugari për të folur lidhur me vendosjen e kontaktevet politikë me komunistët dhe patriotët shqiptarë dhe për sigurimin e ushqimevet në Shqipëri. Vaso Strugari ka shkuar në Shqipëri dhe, kur është kthyer, ka lajmëruar shtabin, se në Shqipëri është e mundur të sigurohen produkte ushqimorë." (f.191)

Unë këtu jam i detyruar të bëj një analizë. Mali i Zi nuk ka ushqime. Cërrnica, që ne e kishim fqinjë, vuante në atë kohë për një grusht miell. Ashtu edhe pjesët e tjera të Malit të Zi. Por malazezët e gjejnë nundësinë për të organizuar luftën çlirimtare. Ata janë aq të pjekur politikisht, sa dinë të vënë interesin e atdheut të tyre para çfarëdo interesi vetjak, edhe në kushtet e një skamjeje vërtet të papërballueshme. Nuk e lëshojnë atdheun e vet, sado që s'kanë as bukë për të ngrënë. Përkundrazi, bëjnë çmos për ta zgjëruar shtetin e tyre me mënyrat që dihen. Kurse ndër ne shqiptarët ka një tjetër mentalitet. Një shumicë shqiptarësh përpiqen të jenë mire për vete, të kenë mire familjen, ndërsa punët e atdheut të vet

ua lënë të tjerëvet. Se ku do t'i gjejë atdheu këta ***TË TJERË***, ne shqiptarët nuk e vrasim shumë mendjen.

E gjithë kjo kërkon jo vetëm analizë historike, por edhe analizë etnopsikologjike, politikopsikologjike dhe përgjithësisht analizë socilogjike. Nuk do harruar që malazezët janë një komb simbiozë arbro-sllave, krijesë e Kishës Pravosllave Sërbe. Të mos kish qenë veprimtaria e Kishës Pravosllave Sërbe, sot malazezët nuk do të quheshin popullsi sllave.

"Komiteti Vendor i PKJ-së për Tivarin ka njoftuar Komitetin e Qarkut në Cetinjë që kontakti me Shqipërinë nëpërmjet Ulqinit është bërë i pamundur për shkak të kontrollevet të shumtë. Prandaj lidhja me Shkodrën është realizuar perms fshatit Selcë dhe Liqenit të Shkodrës." (f.191)

"Më 29-30 dhjetor 1941 vriten në Sozinë komunistët (partizanë) Ivo Vuçkoviq, Branko Çalloviq, Kërsto Dobërkoviq dhe Millo Milloviq. Pas bjerrjes së këtyre komunistëve në Sozinë, në organizatën partiake të Tivarit ka mbetur vetëm 1 anëtar. Kushtet për zgjërimin, për rigjallërimin e organizatës së komunistëvet në Tivar janë tepër të vështirë." (f.191)

Situata shpjegohet vetëm me faktin që populli i Tivarit nuk donte të bashkëvepronte me malazezët. Malazezët, që realisht nuk ishin vendës, por të ardhur, në Tivar vepronin fare vetëm ose pothuaj vetëm. Edhe ata tivaras, që do të donin të ishin kundër italianëvet, pikërisht për shkak të malazezëvet, rrini në shtëpi dhe prisnin se çfarë do të ndodhte. Është historikisht e vërtetë që shumë shqiptarë, të ndodhur nën shtetin jugosllav, nuk kanë luftuar kundër fashizmit pikërisht, sepse i druheshin ripushtimit prej sllavëvet.

"Gjendja është e parregullt në Gërbal dhe në rrethinën e Tivarit e të Ulqinit." (f.192)

"Me Tivarin e Ulqinin as në fillim të marsit udhëheqja e PKJ-së nuk e kish vendosur lidhjen, prandaj dhe mungonin informacionet mbi gjendjen në terren." (f.192)

E gjithë kjo na dëshmon që Tivari e Ulqini i rezistonin ripushtimit prej jugosllavëvet.

Është e vërtetë që në këta vise ishin përqëndruar forca të shumta të pushtuesvet fashistë italianë. **"Në Ulqin kish 1500 ushtarë, në relacionin nga Ulqini në Tivar ishin 3 batalione, në Tivar rreth 2000 ushtarë, në Sutorman 2 çeta." (f.192)** Por nuk është kjo krejt arsyeja që partizanët jugosllavë nuk kishin influencë në këto zona. Megjithkëtë, komunistët jugosllavë do ta gjejnë mënyrën për t'i ripushtuar këto treva të Shqipërisë. Në vijim do t'i shikojmë këto ngjarje.

"Në Peraziqa Doll, afër Petrovacit, më 4 shkurt 1942, nga nëndetsja Thorn ka zbarkuar misioni anglez, i përbërë prej majorit britanik Terens Aterton, kapitenit të ushtrisë jugosllave Radoje Nedelkoviq dhe një nënoficeri anglez. Ai mision ka kaluar nga formacioni në formacion nëpër ushtrinë partizane jugosllave, deri sa ka mbërritur në Shtabin Qendror." (f.192)

Kjo është një nga dëshmitë që luftën partizane të jugosllavëvet, sado që ajo udhëhiqej nga komunistët, e ka përkrahur Britania e Madhe. Në Tivar ky mision nuk ka ardhur, ndonëse e kishte fare afër. Pse?

"Në Tivar e Ulqin ka ndodhur gjallërimi i 'anglofilëvet', të cilët kanë gravituar rreth njëfarë 'lëvizjeje anglofile'" (f. 195)

Do hulumtuar çfarë ka qenë kjo lëvizje dhe a ka mbledhur rreth vetes shqiptarë apo malazezë. (Sepse autori nuk e thotë.)

"Bashkëpunimin me pushtuesit italianë, në Tivar dhe në Cërrnicë, paria kuislinge e ka kamufluar me të quajturën 'lëvizje nacionaliste', duke mashtruar një numër fshatarësh të lëkundur dhe politikisht të papërcaktuar." (f.195)

Autori nuk e përcakton për ç'lëvizje nacionaliste bëhet fjalë, shqiptare apo malaziase. Por mund të nënkuptohet që është fjala për malazezët.

"Tentativë për t'i bërë për vete banorët e Shestanit dhe të Kranjës." (f.195)

Vetë kjo shprehje "***për t'i bërë për vete***"" (za pridobijanje) dëshmon që malazezët nuk i kishin me vete banorët shqiptarë të Shestanit dhe të Kranjës. Kjo shprehje mund të kuptohet edhe si mashtrim. Të bësh dikënd për vete, kur prapamendimi yt është i dëmshëm për objektin e të bërit për vete, do të thotë ta mashtrosh atë.

"Në fillim të marsit 1942 në Shestan rreth 300 njerëz kanë pranuar armë prej pushtuesit, me justifikimin se do të mbronin territorin e fisit të vet." (f.195)

Në të vërtetë, pranimi i armëvet prej komandës italiane nuk ka qenë kurrfarë justifikimi, por një marrëveshje serioze midis forcavet italiane dhe vendësvet, të cilët, qysh prej vitit 1880 pushtuesit malazias i kishin pasë çarmatosur. Pranimi nga ana e pushtuesvet italianë për ta armatosur këtë krahinë shqiptare, do të thoshte që kjo krahinë tash e tutje do të mund të vetëmbrohej. Do vënë në dukje këtu se kërkesa e shestanasvet ishte që komanda italiane të mos mobilizonte asnjë banor të kësaj krahine në ushtrinë e vet. Dhe është fakt që gjatë gjithë Luftës së Dytë asnjë shestanas nuk shërbeu as në ushtrinë italiane, as në atë gjermane, që erdhi më vonë në Tivar. Do theksuar edhe kjo që, gjatë gjithë kohës sa i patën armët, nuk ndodhi asnjë vrasje midis banorëvet të kësaj krahine.

"Komiteti Vendor i PKJ-së për Tivarin ka tentuar të lidhet me përfaqësuesit e fshatravet të Shestanit dhe të bëjë një mbledhje me ta, në të cilën do të ish i pranishëm edhe sekretari i Komitetit Vendor, por ajo mbledhje, siç duket, nuk është bërë." (f.195)

"Janë bërë përpjekje të vendosen kontakte edhe me Kranjën, por pa rezultate të dukshëm. Në fillim të marsit kranjanët kanë çuar një njeri në shtabin e batalionit *'Jovan Tomasheviq'* për t'u këshilluar nëse duhej t'i pranonin pushkët italiane, duke e siguruar komandën e atij batalioni që (me ato pushkë) do të kishin dalë që të gjithë partizanë." (f.195)

Nuk thuhet, as kush ka qenë ai njeri, "***i dërguar i Kranjës***", as cili ishte qëllimi i "***këshillimit***". Ç'punë kishin kranjanët me batalionin malazias, kur Kranja ishte shpallur tashmë pjesë e shtetit shqiptar?! Megjithatë, në një informacion të batalionit "Jovan Tomasheviq' thuhet: **"Kalimi i Kranjës në anën tonë do të kishte rëndësi shumë të madhe." (f.195)**

Kjo deklaratë dëshmon që komunistët malazias ia kishin frikën shkëputjes përfundimtare të Kranjës prej shtetit jugosllav pas përfundimit të luftës dhe se, ndonëse në themel të doktrinës së tyre qëndronte çlirimi nacional i të gjithë popujve, ata nuk kishin ndërmend ta zbatonin këtë parim në lidhje me shqiptarët.

"Në fund të shkurtit ose në fillim të marsit 1942, shtabi i batalionit '*Jovan Tomasheviq*' u është drejtuar banorëvet të Kranjës dhe Shestanit me një proklamatë, ku u drejtohet me fjalët *VËLLEZËR SHESTANAS DHE KRANJANË*." (f.195)

Fjala ***VËLLEZËR*** do të zinte vend në proklamatat e komunistëvet malazias, nëse ata do ta shoqëronin atë fjalë me deklaratën: ***"Ju jeni shqiptarë dhe pas luftës do të bëni pjesë në shtetin shqiptar."*** Por komunistët jugosllavë nuk e shqiptuan kurrë një të tillë deklaratë, as për shqiptarët e Tivarit e të Ulqinit, as për të tjerët, deri në Shkup e në Manastir. Kjo mungesë cinike e internacionalizmit në politikën e PKJ-së, në dekadat dhe shekujt që do të vinin, do të shkaktonin tragjedi të mëdha në këtë pjesë të Ballkanit.

Në të njëjtën linjë gabimi, me pasoja të rënda tragjike, ecën edhe anglo-amerikanët. Ndërsa fashistët italianë dhe nazistët gjermanë e kishin zbatuar, në një farë mase, në praktikë, korrigjimin e diskriminimit të shqiptarëvet më 1913-n, demokratët anglo-amerikanë vepruan ndaj shqiptarëvet edhe më keq nga ç'kish vepruar Konferenca e Ambasadorëvet e Londrës më 1913-n.

Nuk themi: Pse nuk e zgjidhën demokratët anglo-amerikanë kërkesën e shqiptarëvet? Por themi: Pse nuk e shtruan demokratët perendimorë këtë problem të shqiptarëvet në asnjë nga bisedimet që bënë me komunistin J.V.Stalin? Për shqiptarët nuk u bisedua as në Teheran, as në Jaltë. Pse?! Sepse anglo-amerikanët as që e kishin ndërmend të korrigjonin padrejtësinë që u ishte bërë shqiptarëvet. Në këtë pikë, historiografia botërore duhet ta pranojë që demokratët perendimorë janë treguar më jorealistë se nazi-fashistët.

Në të njëjtën kohë anglo-amerikanët e atëhershëm pranuan t'ia jepnin Jugosllavisë Komuniste edhe Dalmacinë, edhe Istrinë, me përjashtim të Triestes. Ndërsa për Tivarin, që i takonte shtetit shqiptar, ata as që e morën mundimin të flisnin të paktën brendapërbrenda qarqevet të tyre diplomatikë.

“Vëllezër shestanas dhe kranjanë, lufta jonë nuk do të duhej të ishte e huaj as për ju, sepse okupatorët fashistë i kanë robëruar edhe vëllezërit tuaj në Shqipëri. Bijtë më të mirë të Shqipërisë, bartësit e luftës çlirimtare dhe për larinë nacionale shqiptare, po kalben nëpër burgjet e fashizmit.” (f.196)

Bukur. Proklamata e komunistëvet malazias e pranon që shestanasit dhe kranjanët janë vëllezër me ***“shqiptarët e Shqipërisë”***. Atëherë, përse komunistët malazias nuk thonë që, pas luftës, Shestani dhe Kranja do t’i takojnë shtetit shqiptar?! Sepse ata nuk janë komunistë të mirëfilltë. Ata janë, në këtë drejtim, në drejtimin ndaj shqiptarëvet, demagogë të mirëfilltë.

“Kemi besim se e dëshironi miqësinë tonë, prandaj po ju këshillojmë që të hiqni dorë prej pushkëvet të okupatorit dhe prej përkrahjes së shërbëtorëvet të tyre.” (f.196)

Shprehja “po ju këshillojmë” shpreh mendjemadhësi. Kush janë ata, që të na këshillojnë ne?! shqiptarët dinë vetë çfarë bëjnë e çfarë nuk bëjnë. Madje do të duhej më pare ata të dëgjonin këshillat tona, pastaj t’I dëgjonim ne këshillat e tyre.

“Do të fitojmë, sepse po luftojmë për një çështje të dejtë, sepse kemi aleatë të fuqishëm: Rusinë, Anglinë dhe Amerikën, si dhe të gjithë popujt e robëruar e liridashës të Eropës e të krejt Botës.” (f.196)

Rusinë e kanë vënë në krye, pastaj Anglinë dhe Amerikën. Edhe sot, po t’i pyesësh malazezët, Rusinë kanë primare, pastaj, po s’u doli gjë andej, kthehen me gjysmë faqeje nga Perendimi. Mirëpo, Perendimi është i verbër. Ai nuk i shikon dot të këtilla shfaqje, që ditë për ditë shkojnë në dëm të vetë inteesavet të tij.

Autori thotë: **“Proklamata nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm në zhvillimin e lëvizjes nacionalçlirimtare në këtë krahinë, si për shkak të veprimevet të kolonës së pestë, ashtu edhe për shkak të ngurrimit dhe rezervavet të një pjese të konsiderueshme të popullsisë.” (f.196)**

S’kish si të kish, një proklamatë e komunistëvet malazias, ndikim në popullsinë shqiptare të Kranjës e të Shestanit, përderisa aty nuk premtohej asgjëkundi e drejta

për t'u shkëputur prej shtetit të huaj sllav dhe për t'u bashkuar me shtetin e vet shqiptar.

"Megjithatë, ndonëse okupatori është përpjekur me të gjithë mjetet e mundshëm, me propagandë, me presione dhe me kërcënime, t'i mobilizonte dhe t'i përdorte shestanasit dhe kranjanët në luftë kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, ai nuk ia ka arritur qëllimit. (f.196)

Kjo është shumë e rëndësishme të vihet në dukje në historiografi. Mali i Zi i ka pasë shkaktuar shumë dhimbje këtij populli, që nga djegia e shtëpivet dhe plaçkitjet, deri te dhunimi i kishavet, psh në Shestan të Sipërm, dhe thyerja e varrevet, psh në Ostros. Cërrnica, në ata vite, ishte e përçarë dhe e shkallmuar nga lufta civile. Shestanasit dhe kranjanët e kishin mundësinë, jo vetëm ta sulmonin atë pjesë të Malit të Zi, por edhe ta shkatërronin tërësisht. Megjithatë, shqiptarët e këtyre viseve nuk e shfrytëzuan atë rrethanë për t'u bërë të keqen fqinjëvet. Ata nuk i dëgjuan, as italianët dhe as pjesën e vet të ekzaltuar. Ky është humanizmi i etnisë dhe i kombit shqiptar, humanizëm që duhet të merret si shembull në historinë njerëzore. Por mirënjohja e komunistëvet malazias, fatkeqësisht, gjatë Luftës së Dytë dhe sidomos në vitet e Pasluftës, u shpreh me masa të njëpasnjëshme për të na e minimizuar ndjenjën kombëtare dhe, në fund, për të na e asgjësuar qenien tonë kombëtare.

"Gjatë gjithë kohës së Luftës ata (shestanasit dhe kranjanët) kanë anuar nga lëvizja nacionalçlirimtare, në mënyrë që, pas kapitullimit të Italisë, në shtator 1943, kjo lëvizje të fillonte e të gjallërohej edhe në trevat e tyre. (f.196)

Ka një pasaktësi këtu. Në Kranjë e në Shestan përpjekjet për çlirimin nacional kanë qenë të vazhdueshme, por jo masivisht në anën e komunistëvet. Ata, shestanasit dhe kranjanët, fillimisht e pane mundësinë e çlirimit nacional me ndihmën e italianëvet. Pastaj, kur u pa që Boshti po e humbte luftën, kranjanët dhe shestanasit filluan të kërkojnë rrugë për t'u lidhur me lëvizjen nacionalçlirimtare në shtetin shqiptar. Vëllezërit Ardolli, të lidhur me Shkodrën, dolën në mal pikërisht për këtë qëllim. Ndërkaq, depërtimi i ndikimit të jugosllavëvet në këta vise ka qenë një

subversion i pastër disa muaj para pushtimit, apo, më mirë të themi, para ripushtimit.

"Në Tivar, gjatë marsit 1942 janë mbajtur 4 tubime nacionalistësh, 1 në Tivar Nalt, 1 një Sutomore dhe 2 në Tivar Poshtë. Në të gjithë ata tubime ka folur Dom Frano Çermaku, sekretar i Arqipeshkvisë së Tivarit, i cili ishte zgjedhur për kryetar të 'Këshillit Nacional', të krijuar (si duket, pas mbledhjevet, Gj.D.) **më 29 mars. Ai 'Këshill' kish marrë përsipër detyrën e ruajtjes së rendit dhe qetësisë në Tivar dhe në kufijtë e tij." (f.196)**

Që Dom Frano Çermaku ishte në shërbim të italianëvet, ashtu si të gjithë ata që e pranonin atë pushtim si diçka më të mirë se pushtimi jugosllav, kjo s'është për t'u vënë në mëdyshje. Dom Frano Çermaku ishte një klerik kroat, i cili shërbente në Arqipeshkvinë e Tivarit dhe duhej ta njihte psikologjinë e popullatës së atyshme. Nuk e di në çfarë gjuhe ka folur në të 4 tubimet nacionalistë të mbajtur në Tivar. Nuk di gjithashtu ç'kuptohej në atë kohë në Tivar me fjalën ***nacionalizëm***, me shprehjen ***'Këshilli Nacionalist'*** etj. Nëse me fjalën ***nacionalizëm*** është kuptuar nacionalizmi shqiptar, atëherë veprimtaria e Dom Frano Çermakut, sado që ai ishte hallkë e pushtuesit fashist në Tivar, duhet vlerësuar si pozitive, ashtu si ajo e Cafobegut në Ulqin. Jo në përmasat e Cafobegut, se Cafobegu është i rrallë në punën për interest e vendit dhe popullit të vet në kushtet e një pushtimi, por në përmasat e një veprimtari në përkrahje të kërkesavet të një popullate shumëfish të diskriminuar.

"Kërcënimi ka qenë evident edhe nga ana e shetanasvet, të cilët kanë marrë prej italianëvet urdhër që më 8 mars të zënë pozicionet në drejtim të Krricës." (f.198)

Shestanasit e kanë marrë urdhërin për të sulmuar Cërrnicën, por ata e kanë refuzuar atë urdhër. Këtë nuk e ka vënë në dukje autori Gojko Vukmanoviq. Por ai ka shënuar këtu një të dhënë, të cilën unë deri tani nuk e kam hasur në ndodnjë vend tjetër.

"Një numër luftëtarësh nga krahu i Godenjës, Selcës dhe Krricës, nuk ia ka dalë që të kalojë me kohë në Glluhi Do. Disa prej tyre

kanë tentuar që, përkohësisht, deri sa të zgjaste aksioni, të strehohen në Shestan. Mirëpo, atje i kanë çarmatosur dhe ua kanë dorëzuar italianëvet." (f.198)

Si ka ndodhur në të vërtetë, natyrisht që nuk duhet të ndalemi vetëm në këtë të dhënë, vetëm në këtë burim, por, edhe po të ketë qenë pikërisht kështu, ne duhet t'i përfytyrojmë ata malazezë si njerëz të armatosur, të cilët, hyjnë në një territor me kufij të përcaktuar dhe me roja të rregullta në çdo majë kodre apo qafë mali. Si hynin malazezët në një të tillë territor?! Çështja e dytë është: A bënë mirë shestanasit që ua dorëzuan italianëvet shkelësit e kufirit shqiptaqr? Jo. Por pyetja është edhe: Ku mund t'i çonin?! Cërrnica ish thuajse e tëra nën kontrollin pikërisht të italianëvet.

"Është plagosur rëndë dhe zënë rob në Selcë partizani Shpiro Dabanoviq, i cili, 2 ditë më vonë, është pushkatuar në Tivar bashkë me Stevo Medigoviqin, prej Petrovacit." (f.199)

Vëmë re që, as njëri, as tjetri, nuk janë tivaras. Tivari është zonë që tashmë zotërohet prej pushtuesvet italianë. Italianët e shfrytëzojnë pozicionin e Tivarit si bazë për të vepruar kundër visevet kryengritës në Mal të Zi.

Situata keqësohet aq shumë, sa batalioni ***'Jovan Tomasheviq'*** merr urdhër për ta braktisur Cërrnicën. Më 2 prill 1942 formacionet partizanë, 180 luftëtarë dhe 85 gra, që iu bashkëngjitën luftëtarëvet, largohen nga territori i rrethit të Tivarit. (f.199)

"'Këshilli Nacional" në Tivar, në mbledhjen e vet të 14 prillit, ka diskutuar rreth kthimit nga kampet 'e Shqipërisë' (thonjëzat Gj.D.**), të atyre të internuarve që llogaritehsin si antikomunistë, kurse në mbledhjen e 21 prillit është shtruar kërkesa për të siguruar armë, në mënyrë që njerëzit të armatosen, sepse, siç është theksuar, ajo ishte puna e parë dhe më e rëndësishmja në këto kohë të pasigurta. Kryetari Çermak i ka njoftuar të pranishmit se në lidhje me atë kërkesë janë ndërmarrë të gjitha masat dhe se së shpejti vijnë pushkët nga Podgorica. Është vendosur që të krijohen njësitë ushtarake dhe të armatosen meshkujt, të moshës nga 22 deri 55 vjeç. Për organizimin e atyre njësive janë**

ngarkuar 5 oficerë të ushtrisë së Ish-Jugosllavisë. Në mbledhjen e 6 qershorit Çermaku ka propozuar që të krijohet çeta e milicisë popullore, e ndërtuar mbi baza ushtarake, ose të sillet aty një njësi prej 50 çetnikësh të Bajo Stanishiqit, i cili do ta mbronte Tivarin nga sulmet e treshevet komuniste." (f.199)

Hamenda pak më parë që veprimtaria e Dom Frano Çermakut, në rast se ai është mbështetur në popullsinë shqiptare të Tivarit, do të mund të quhej pozitive, sado që dihej se u shërbente pushtuesvet italianë. Mirëpo, këtu zbulohet që ai ka qenë plotësisht në shërbim të nacionalizmit sllav. Ka prurë aty 5 oficerë të Ish-Jugosllavisë dhe synon të ftojë një njësi me 50 çetnikë, gjoja për të mbrojtur Tivarin, por që, në të vërtetë, ata do ta terrorizonin Tivarin. Këto gjëra janë të domosdoshme për t'u sqaruar në historiografi, sepse me analiza të njëanshme edhe mund të gabohet.

"Trupat pushtuese (italiane) kanë qenë të stacionuara në TIVAR, Budvë, ULQIN, Milloçer, Petrovac, SUTOMORE, pastaj në Brajiq (fortesa Kosmaç), në SUTORMAN, në Vir dhe në Bërçelë." (f.203)
(Shkronjat e mëdha, Gj.D.)

Në viset shqiptarë, pra, ka pasur 4 pika përqëndrimi të ushtrisë italiane: Tivar, Ulqin, Sutomore dhe Sutorman.

"Kërsto Popoviqi ka ardhur në Tivar dhe ka vizituar komandën e garnizonit (italian), ku e kanë pritur përfaqësuesit e pushtetit vendor me në krye Dom Frano Çermakun. Në mbledhjen e 4 korrikut 1942 kanë folur Kësto Popoviqi, Dr.Novica Radoviqi dhe Dom Frano Çermaku. Dom Frano Çermaku ka shprehur gëzimin që Mali i Zi, nëpërmjet revolucionit nacional, e ka mundur komunizmin dhe që populli malazias dhe Mali i Zi, me përkrahjen miqësore e dashamirëse të Italisë dhe të Fuqivet të Boshtit, do të zënë vendin e merituar midis popujvet të kulturuar të Evropës." (f.203)

Vërtetohet edhe njëherë që Dom Frano Çermaku, në përputhje të plotë me politikën e Italisë Fashiste, nuk e ka trajtuar Tivarin si një qytet shqiptar, por si një qytet malazias. Pushtuesit italianë, qysh në fillim ia kishin lënë Tivarin Malit të Zi,

duke vendosur një kufi jo të natyrshëm te vendi që quhej ***Ullia e Egër***, pak përtej Ujëmirit (Dobrovodës). Shestani ish shpallur zonë neutrale, por realisht i ishte bashkuar shtetit të vet shqiptar, ndërsa Tivari kish mbetur me Malin e Zi. Kjo ka shkaktuar vështirësi të mëdha për popullsinë. Autori i këtij libri i ka përjetuar ato peripeci me mbresa të pashlyeshme fëminore.

"Në një vendstrehim në malin Golik të Shestanit, kuislingët, më 5 janar 1943, kanë zbuluar ilegalët Millo Orllandiq dhe Danica Lekiq nga Selca. Pas një luftimi të shkurtër, të 2 janë bjerrë heroikisht." (f.203)

Duhet sqaruar këtu që Leka i Macit Kols, i fisit Perkolanj, që ish kryetar i Komitetit Kombëtar të Shestanit, nuk mund të quhet me plot kuptimin e fjalës kuisling, sepse ai, sado që e ka pranuar pushtetin Italian, nuk i është bindur komandës italiane për të sulmuar Cërrnicën fqinje, nuk i ka pranuar në territorin e vet çetnikët malazias dhe nuk i ka lejuar gjithashtu as nacionalistët shqiptarë të kalojnë përms territorit shestanas për të dëmtuar Cërrnicën fqinje.

Lidhur me ilegalët komunistë, Millo Orllandiq dhe Milica Lekiq, të 2 nga fshati Selcë, do sqaruar se focat e armatosura të Shestanit nuk kanë shkuar atje për t'i vrarë, por vetëm për t'i larguar prej territorit të Shestanit. U kanë bërë thirrje të dalin prej shpellet dhe të largohen, kanë shtirë disa pushkë në ajër, por ata, në vend që të dilinin prej shpellet e të largoheshin, janë vetëvrarë. Millo Orllandiqi ka vrarë më parë, me pëlqimin e saj, shoqen e vet Milica Lekiqin, pastaj ka vrarë edhe veten. E vërteta ish që ata janë vetëvrarë, jo aq se trembeshin prej shestanasvet, por se nuk guxonin të kthehesin në territorin e vet, mbasi e dinin që pikërisht atje do t'i vrisnin kuislingët bashkëfshatarë. Autori Gojko Vukmanoviq nuk e sqaron këtë çështje ashtu si duhet. Ai thotë: ***"Pas një luftimi të shkurtër, janë bjerrë heroikisht"***. Në të vërtetë, aty nuk është bërë kurrfarë luftimi, sepse forcat rrethuese kanë shtirë vetëm 1 herë në ajër dhe fill pas kësaj janë dëgjuar 2 krisma pistolete brenda në shpellë. Ky episod është treguar me dhjetëra herë nëpër Shestan dhe unë e kam dëgjuar prej vetë pjesëmarrësvet në atë ngjarje.

"Në fund të prillit 1943 krijohet një çetë pratizane prej 15 luftëtarësh. Komandant është Bllazho Kazhanegra, Marko

Kulaça zëvendëskomandant, Millo Medigoviqi komisar, Gojko Lekoviqi zëvendëskomisar." (f.203)

Ky është veprimi i parë i riorganizimit të ushtrisë partizane malaziase dhe bregdetase në pjesën sllave të Rrethit të Tivarit, pasi formacionet e mëparshëm, ose ishin detyruar të largoheshin në drejtim të Bosnjës, ose ishin asgjësuar. Për ta kryer këtë riorganizim kish marrë urdhër komunisti Bllazho Joshov Orllandiq nga fshati Selcë. Nuk është pa interest ë vihet në dukje që fshati Selcë, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ka qenë pjesë e Shestanit dhe se, në mos të gjithë, shumica e banorëvet të tij janë me prajardhje jo të largët shqiptare.

"Në fund të prillit 1943 kjo çetë ka kryer një aksion luftarak në Sutorman, duke sulmuar një kamion me ushtarë italianë." (f.203)

"Komiteti i PKJ-së për Rrethin e Tivarit e ka selinë në Gora Pashtrovska. Në krye të atij Komiteti janë: Nikolla Gazheviqi, i dërguar nga Komiteti Krahinor i PKJ-së për Malin e Zi, Millo Medigoviqi, Bozho Mitroviqi, Marko Kulaça, Gjoko Lekoviqi, Mato Petroviqi dhe Panto Mitroviqi." (f.205)

E shënova këtë fakt për të kuptuar se si fati i Tivarit dhe i Ulqinit (sepse edhe Ulqini konsiderohej pjesë Rrethit të Tivarit), i Shestanit, Kranjës, Anës së Malit, Bregbunës e tjerë vise të shqiptarëvet, vendosej jashtë Tivarit dhe nga njerëz që nuk ishin shqiptarë.

"Komiteti Krahinor i PKJ-së për Malin e Zi ka tentuar të vendosë lidhjet me Tivarin e me Ulqinin, nëpërmjet Shqipërisë. Në letrën që Komiteti Krahinor i PKJ-së për Malin e Zi i dërgon Komitetit Qarkor të PKJ-së për Cetinjën, më 9 gusht 1943, thuhet: 'Ne kemi kërkuar që njëri prej tyre të vijë tek ne për të paraqitur informacionin dhe që ne t'i japim udhëzime më konkretë për punën. U kemi dhënë detyrë që të lidhen me Cërrnicën dhe me ju edhe me rrëzik jete. Këtë detyrë po e japim edhe për ju.'" (f.205)

“Lidhjen me Komitetin Krahinor të PKJ-së për Malin e Zi e ka vendosur Lluka Knezheviqi nëpërmjet Shkodrës, kështu që Komiteti Krahinor është informuar mbi gjendjen në viset e Ulqinit në fillim të gushtit dhe i ka dhënë udhëzim Komitetit Qarkor në Cetinjë që një numër anëtarësh të PKJ-së të mbeten në terrenin e Ulqinit, kurse të tjerët të kalojnë në terrenin e Komitetit të Qarkorit të Cetinjës.” (f.205)

“Në gusht Komiteti i PKJ-së për Rrethin e Tivarit ka ndërmarrë veprime për të vendosur lidhjet me Tivarin e me Ulqinin. Me atë qëllim janë hedhur në rajonin e Rumisë dhe në territorin e Ulqinit Velisha Lekoviqi dhe Ivo Nikiqi dhe janë lidhur me disa komunistë të Tivarit dhe të kampit të përqëndrimit që ndodhej në Fushë të Tivarit, si dhe me organizatën e PKJ-së për Ulqinin. Kjo ka qenë lidhja e parë e Komitetit Vendor, gjegjësisht e Komitetit të Rrethit të PKJ-së për Tivarin, me organizatën e Ulqinit që nga prilli 1942.” (f.205)

Të gjitha këto janë përpjekje të komunistëvet jugosllavo-malazias për të siguruar ripushtimin e Tivarit e të Ulqinit. Nuk janë përpjekje për çlirimin e këtyre 2 qyteteve, sepse, po të ishte qëllimi të çliruarit e këtyre hapësirave, jugosllavët do të ndihmonin PK Shqiptare për të krijuar organizatat e veta e jo e kundërta.

Na duhet të pranojmë që edhe PK e Shqipërisë ka bërë gabim që, në vend që të dhtrinte vetë organizimin partiak dhe luftën guerrile në këto anë, ku me siguri do të gjente shumë përkrahje, ka ndihmuar jugosllavët për të krijuar këtu lidhjet e veta. Me kë do të lidheshin jugosllavët në Tivar e Ulqin? Me komunistët jugosllavë. Shqiptarët do të mbeteshin thjeshtë objekt pushtimi. Asnjë ustifikim nuk ka. Enver Hoxha ka bërë gabim të rëndë që nuk e ka shtrirë organizimin partiak dhe luftën partizane në të gjitha trevat e Shqipërisë. Është e vërtetë që kanë qenë rrethana jashtzakonisht të papërcaktueshme, por unë do të thosha që rol vendimtar ka luajtur aty, jo situate, port ë kuptuarit e çështjes. Në vitet 1948 e këndej thonë që Enveri e ka shprehur pendimin e vet në biseda me gojë, por në shtyp, me sa di unë, nuk e ka deklaruar asnjëherë.

“Në lajmin mbi kapitullimin e Italisë, Komiteti i PKJ-së për Rrethin e Tivarit ka reaguar me shpejtësi. Po atë ditë (më 8 shtator 1943) partizanët kanë zbritur nëpër fshatrat e Pashtroviqit, kurse më 10 shtator ata kanë hyrë në Petrovac. Një numër i madh i atdhedashësvet të komunavet të Petrovacit dhe të Sveti Stefanit, u është bashkuar partizanëvet, kështu që është krijuar batalioni partisan i Pashtroviqit me mbi 100 luftëtarë. Për komandant është caktuar Bllazho Kazhanegra, kurse për komisar politik Marko Kulaça.” (f.205)

Ç’do të bëjë tani ky batalion, pa asnjë shqiptar në përbërjen e tij? Puna e parë e tija do të jetë, të niset për në Tivar. Sigurisht, jo për ta çliruar, por për ta pushtuar për vete, meqë italianët kapitulluan.

“Mbas lirimit të të burgosurvet në Budvë, bataliomi është nisur për Tivar, duke çliruar Bularicën dhe Sutomoren.” (f.205)

Është e njëjta pamje si në kohën kur në Tivar sundonin turqit. Pashtroviqi, një fis, dikur barinj arbër, i sllavizuar nën ndikimin e Kishës Pravosllave, në të gjithë ata shekuj ka synuar të depërtojë në drejtim të Tivarit. Herë me sulme e me plaçkitje e herë me uzurpim kishash në fshatrat e Spiçit.

“Kur i është afruar Tivarit, batalioni ka zënë pozicione në fshatin Shushan dhe në breg të lumit Zheleznica. Me përfaqësuesit e komandës italiane në Tivar, Bllazho Kazhanegra dhe Nikolla Gazheviqi kanë bërë bisedime për lirimin e të internuarvet në kampin e përqëndrimit në Tivar, por bisedimet nuk kanë pasur sukses, kështu që të internuarit nuk janë liruar.” (f.205)

“Në ndërkohë, një batalion kuislingësh nga Cërrnica dhe rreth 150 çetnikë nga Cetinja ia kanë dalë të hyjnë në Petrovac. Ata kanë pasë detyrë të zënë Bregdetin nga Boka deri në Tivar, sepse në ato ditë, siç thuhej, është pritur zbarkimi i ushtrivet aleate.” (f.205)

Edhe komunistët, edhe nacionalistët synojnë të zënë Tivarin. Në qëndrimin ndaj tokavet të shqipërisë, politikanët malazezë e sërbë, po edhe ata sllavojugorë lindorë, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim: T'i pushtojnë apo t'i ripushtojnë, madje, çuditërisht, edhe atëherë kur për vete janë të pushtuar. Se si mund t'i shkojë mendja dikujt, që i ka grabitësit në shtëpi, të shkojë për të grabitur shtëpitë e të tjerëvet, kjo është vërtet e vështirë për t'u kuptuar.

"Me rastin e kapitullimit të Italisë, edhe partizanët e Ulqinit kanë reaguar shpejt. Më 9 shtator ata kanë tentuar të hyjnë në Ulqin, ku gjendeshin rreth 1000 ushtarë italianë dhe shqiptarë. Në bisedimet me komandantin italian janë marrë vesh që italianët të mos rezistonin, që ushtarët italianë t'i mbanin armët dhe të fillonin së bashku luftën kundër gjermanëvet. Megjithatë, kur kanë hyrë partizanët në qytet, një çetë karabinierësh ka rezistuar, gjë që e ka shtyrë hyrjen në qytet për 1 ditë më vonë. Ndërkohë, më 11 shtator, kolona e motorizuar gjermane, e cila ka ardhur nga Shkodra, ka depërtuar në Ulqin. Të befasuar nga kjo ardhje, partizanët janë tërhequr në drejtim të Mozhurit, por një grup më të vogël gjermanët e kanë zënë rob dhe më 12 shtator e kanë pushkatuar. Pasi janë grumbulluar në Mozhur, më 14 shtator, partizanët kanë vazhduar lëvizjen drejt Rumisë. Gjatë rrugës, në Goranë, ka ndodhur një ndeshje me një kolonë gjermane, të cilën, pas një luftimi të ashpër e kanë shmangur. Në këtë përplasje është vrarë luftëtari Gjoko Gazivoda dhe disa të tjerë janë plagosur. Edhe gjermanë janë vrarë 2 dhe disa janë plagosur." (f.206)

Njeriut që i njeh këta vise, që njeh Ulqinin dhe fshatrat përrreth, që njeh Malin e Bardhë dhe Mozhurin, këta rreshta i shkaktojnë habi. Ku janë shqiptarët, banorët e këtij vendi?! Në krejt këtë territor, vetëm në lagjen Meteriz ka pasur disa familje malazeze, të ardhura aty pas vitit 1880, disa në Mal të Brinjës dhe fare pak të tjera aty-këtu. Si arritën ata të organizohen në një të tillë ambient të huaj?! Si arritën, aq shpejt, brenda 2 ditësh, të pretendojnë për të shtirë në dorë Ulqinin?! Habinë më të madhe e shkakton mosveprimi apo veprimi tejet i ngathtë i popullsisë vendese, i

shqiptarëvet. Ne se merreshin burrat dhe gratë e atij vendi në kohën kur të tjerët lëviznin?!

"Me kapitullimin e Italisë janë krijuar kushte të favorshëm për zhvillimin e lëvizjes nacionalçlirimtare në Rrethin e Tivarit. Prej njerëzish të riardhur në Tivar e Ulqin është formuar në rajonin e Rumisë një batalion partizan me rreth 100 luftëtarë dhe një çetë me rreeth 40 luftëtarë. Komandant i batalionit ka qenë Gjuro Gjakonoviqi, kurse komisar politik Nikolla Gjakonoviqi. Pas disa aksionesh të vegjël të suksesshëm dhe qëndrimit të shkurtër në këtë rajon, shumica e batalionit ka kaluar permes Pashtrovska Gorës dhe permes Lubotinjës, në Katunska Nahija, me qëllim për të plotësuar atje njësi të tjera partizane, ndërsa një numër i vogël i luftëtarëvet ka mbetur në terrenin e Rumisë." (f.206)

Në shpatin perendimor të malit të Rumisë, në fshatrat Mikuliq i Madh dhe Mikuliq i Vogël, kanë jetuar prej kohësh, përzier me shqiptarë, edhe disa familje sllavishtfolëse. Malazezët e kanë shfrytëzuar këtë rrethanë dhe i kanë shndërruar ata 2 fshatra në baza të veta të luftës. Prapë edhe këtu ka vend për t'u çuditur. I gjithë krahu i përtejmë i Rumisë ka qenë plot me banorë shqiptarë. Mbi 30 fshatra të Shestanit e të Kranjës nuk kanë pasur as edhe 1 familje sllave. Vetë Tivari ka qenë plot me shqiptarë. Malazezët gjejnë disa shtëpi sllavishtfolëse, jo më shumë se 3-4 shtëpi, dhe krijojnë atje bazat e veta të luftës. Kjo nuk mund të shpjegohet ndryshe, veçse me paaftësi, me pazotësi skandaloze të ne shqiptarëvet. Nëse do të vazhdojmë të jemi edhe në të ardhshmen kaq të paaftë, Kombi Shqiptar ka për t'i humbur dalëngadalë e një nga një, edhe Shkodrën, edhe Lezhën, edhe Përmetin, edhe Korçën, dhe çdo gjë që ka arritur të ruajë, si pa dashur e si rastësisht, gjer më sot. Them, me gjithë mllefin e mundshëm të një shpirti të alarmuar: Si pa dashur dhe si rastësisht!

Një bazë lufte, në një situatë të favorshme për ta, sllavët do të mund ta krijojnë edhe në Koxharë të Shijakut, edhe në Libofshë të Fierit e kudo ku ata i kanë 2 apo 3 familje sllavishtfolëse, qoftë edhe aksidentalisht sllavishtfolëse, siç Ishin Mikuliqi i Madh dhe Mikuliqi i Vogël në rrëpirat e malevet përsipër Tivarit.

"Në Tivar është formuar Komiteti Komunal i SKOJ-it (i Lidhjes Komuniste të Rinisë Jugosllave) me disa aktive. Organizata e SKOJ-it në Ulqin ka pasur 37 anëtarë. Është punuar dhe për krijimin e organizatavet të rinisë antifashiste. Janë krijuar edhe disa këshilla nacionalçlirimtarë, në Pashtroviq, në Cërrnicë, në Tivar, në Ulqin, si dhe këshilli nismëtar i AFZH-së (i Frontit Antifashist të Gruas)." (f.206)

Ja tani, edhe organizimet sipas modelit sovjetik. Komunistët malazias, e më tej, ata jugosllavë, në kushtet e pushtimit nazist dhe me një nacionalizëm çetnik shumë të fuqishëm, me një luftë civile nëpër këmbë, tejet të përgjakshme, dinin të bënin edhe organizime për pushtetin e ardhshëm në një vend që s'ish i tyre.

"Më 20 shtator 1943 sekretar i Komitetit të PKJ-së për Rrethin e Tivarit caktohet Nikolla Gjakonoviqi, kurse anëtarë janë: Millo Medigoviqi, Bozho Mitroviqi, Marko Kulaça, Velisha Lekoviqi dhe Vllado Popoviqi." (f.206)

Shqiptarët, në të gjithë këta vite, vazhdojnë të jenë tërësisht të papërfshirë, tërësisht të përjashtuar, sikur të mos ekzistonin. Ata shohin, por nuk dinë të shikojnë çfarë po ndodh rreth tyre. Format shqiptare të organizimit janë aq të lashta, sa nuk i hyjnë më në punë askujt dhe unë jam i bindur që, përveç ndonjë prifti a hoxhe, në krejt ata 20 mijë a më shumë banorë vendës, as edhe 1 tjetër nuk kish lexuar as edhe 1 libër. Si mund ta përballoje Luftën e Dytë Botërore duke e lënë veten me dashje analfabet?!

Më në fund, në nëntor të vitit 1943, midis veprimtarëvet qind për qind malazias, që s'i zë gjumi i natës për tokat e Shqipërisë, shohim edhe 1 shqiptar. Ai shënohej aty me formën sllave, Lluka Margjonoviq (f.206), por, në të vërtetë, është Lukë Margjonaj. Mund të ketë aty edhe ndonjë tjetër shqiptar, por është vështirë të dallohen, sepse janë me emra të shkombëtarizuar. Kuptohet që, një person, i shkombhëtarizuar deri në atë shkallë, sa as emrin nuk e shkruan dot ashtu si e ka, s'i shërben dot as vetëvetes, jo më vendit të vet e popullit të vet.

Më 4 nëntor 1943, vritet me atentat, në rrugën që çonte nga Tivari Nalt në Biskupadë, në një kthesë përroi, midis ullishtës, kryetari i 'Nacionalni Odborit' ('Këshillit Nacional'), Dom Frano Çermaku.

“Pas vrasjes së kryetarit, Dom Frano Çermakut (4 nëntor 1943), ‘Nacionalni Odbor’ nuk ka përbërë më ndonjë pengesë serioze për zhvillimin dhe veprimtarinë e lëvizjes nacionalçlirimtare në Tivar, armiqtë nuk ia kanë dalë që t’i krijojnë vetes ndonjë mbështetje të fortë. As në fshatrat rreth Tivarit, të banuar me myslimanë, okupatori nuk ka mundur të sigurojë mbështetje.” (f.206)

Autori Gojko Vukmanoviq, popullsinë e fshatravet përrreth Tivarit e quan popullsi myslimane. Në të vërtetë, në ata fshatra, shumica e banorëvet kanë qenë e janë shqiptarë, qoftë të konfesionit mysliman, qoftë të konfesionit katolik, mirëpo, autori I shmanget emërtimit shqiptar, me qëllim që aty të mos identifikohet përkatësia nacionale e popullsisë.

Ndërkaq, është e vërtetë që përkrahja e pushtuesit gjerman nga ana e asja popullsie nuk ka qenë në shkallën që e kanë dëshiruar gjermanët dhe kjo ka ndodhur, sepse tashmë po shihej që Boshti po e humbte luftën. Gjermanëvet u lavdëroheshin, madje u adhuroheshin, disiplina dhe korrektësia që i karakterizonte. Veç kësaj, gjermanët nuk e kërcënonin identitein e kësaj popullsie. Por e gjithë kjo shoqërohej me një keqardhje, sepse të gjithë e kuptonin që prania e tyre aty ishte e përkohshme. Populli po e kuptonte përditë e më mirë që Tivari sërish do t’i lihej Jugosllavisë.

Mbështetur në një logjikë nënshtrimi ndaj fatit, dmth ndaj më të fortit, ndaj atij që bën ligjet, popullsia e Tivarit ka filluar të përgatitet për ta pritur pa luftë ripushtimin prej ushtrisë, këtë herë jo monarkike, por komuniste jugosllave.

“Komiteti i PKJ-së për Qarkun (me qendër në Cetinjë), ka vlerësuar që në popullin e Kranjës ekziston urrejtja ndaj elementëvet çetniko-krillashë.” (f.206)

Është e kuptueshme, pse populli i Kranjës (dhe i Shestanit) i urrente çetniko-krillashët. Ata ishin fytyra e Jugosllavisë monarkiste. Shqiptarët e këtyre anëve i njihnin mirë veprimet e tyre dhe politikën e tyre antishqiptare. Komunistët jugosllavë e shfrytëzojnë këtë ndjenjë tonën dhe duan që veten ta paraqesin ndryshe.

"Janë mbajtur disa konferenca nëpër qendra vendbanimesh, dhe grupe partizanësh kanë filluar të hyjnë nëpër disa fshatra. Komiteti i PKJ-së për Qarkun e Cetinjës u është drejtuar udhëheqësvet politikë të Shqipërisë (Kuptohet: udhëheqësit politikë komunistë në shtetin shqiptar, Gj.D.) **për bisedime dhe për punë të përbashkët në terren, në mënyrë që Kranja të orientohej në anën e partizanëvet. Ata** (Udhëheqësit politikë komunistë në shtetin shqiptar) **e kanë pranuar këtë nismë dhe kanë premtuar se do të zhvillonin veprime të nevojshëm me qëllim bashkimin e popullit të Kranjës me NOP-in** [Narodno-Osllobodillaçki Pokretin (jugosllav), Lëvizjen Nacionalçlirimtare (jugosllave), Gj.D.] **(f.206-207)**

Historiografia ka për detyrë të sqarojë këtu 1 pikë: Udhëheqja komuniste në shtetin shqiptar dhe personalisht Enver Hoxha, a i tradhtuan shqiptarët që kishin mbetur jashtë kufijvet të vitit 1913, apo vepruan ashtu, sepse s'kishin si bënin ndryshe? Mendimi im është ky: PKSH gaboi që, qysh më 8 Nëntor 1941, nuk e shtriu organizimin e vet partiak në krejt Shqipërinë, prej Tivarit deri në Prevezë dhe prej Vlorës deri në Kumanovë. PKSH gaboi që nuk e organizoi vetë luftën nacionalçlirimtare në krejt territorin e Shqipërisë Gjeografike. (Them, gaboi, ndonëse ndoshta edhe s'ka pasur mundësi tjetër.) Me këtë rast, PKSH-së do t'i duhej të përballej me PKJ-në, por, në qoftë se kjo punë do të bëhej qysh në fillim, jugosllavët ndoshta do të ishin detyruar ta pranonin kushtin e shqiptarëvet. Më vonë, me krijimin dhe forcimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, Enver Hoxha, edhe në e pastë kuptuar hilen e komunistëvet jugosllavë, s'ka pasur më kurrfarë mundësie për të vepruar hapur, aq më tepër, kur anglo-amerikanët nuk e kanë përkrahur Enverin në këtë punë tepër të rëndësishme, madje jetike për Kombin tonë. Kështu, mendoj unë, duhet kuptuar edhe pranimi i udhëheqjes komuniste shqiptare për t'u mbushur mendjen shqiptarëvet të Kranjës dhe të Shestanit që t'i bashkohen ushtrisë partizane jugosllave.

"Nga fundi i tetorit 1943 në regjionin e Tivarit gjendeshin: 1 batalion i regjimentit 334 të divizionit 181 gjerman, 1 kompani e batalionit gjuajtës kundërajror 222, pastaj 1 divizion i regjimentit 222 të artillerisë dhe disa njësi të marinës. Në Tivar gjendej edhe 1 batalion fashistësh italianë me 400 ushtarë.

Përmbi Tivarin Poshtë, në lagjen e Skelës (sllavisht: Pristan) gjendej 1 bateri topash, kurse 1 bateri tjetër afër Topolicës." (f.207)

Kjo statistikë e forcavet ushtarake, që gjendeshin në muajt e fundit të vitit 1943 në hapësdirat e Tivarit, dëshmon më së miri sa shumë rëndësi i kushtonin nazistët gjermanë kësaj pjese të bregdetit, qoftë për shkak të veprimevet të partizanëvet malaziaso-jugosllavë, qoftë sepse aty do të mund të zbarkonin Aleatët dhe kjo do të mund të konsiderohej si hapje e një fronti të ri të luftës.

"Në territorin e Rumisë gjendeshin rreth 60 partizanë të organizuar në një batalion. Shtabi Kryesor për Malin e Zi dhe Bokën e ka udhëzuar Shtabin e Aradhës së Llovqenit të NOP-it (Lëvizjes Nacionalçlirimtare) që ky batalion të zmadhohet e forcohet dhe që me të të mbahen lidhje të rregullta. Njëkohësisht është vënë detyrë që në territorin e Pashtroviqit, Cërrnicës dhe Tivarit të formohet edhe një battalion tjetër sulmues." (f.207)

Me shprehjen '*territori i Rumisë'* kuptohen 2 fshatrat e përmendur pak parë, Mikuliqi i Madh dhe Mikuliqi i Vogël. Batalioni me 60 luftëtarë, në të vërtetë, ka përfaqësuar aty një forcë të subversionit jugosllav në tokat shqiptare. Udhëzimet që dërgohen nga instancat më të larta e dëshmojnë këtë më së miri. Jugosllavia Komuniste (në formim e sipër), nuk kish synim vetëm të çlirohej, por kish synim edhe të ripushtonte tokat jojugosllave, që dikur i kishin pushtuar Monarkia Malaziase dhe Monarkia Jugosllave.

"Përgatitet një goditje mbi forcat kuislinge në Malin e Zi të Moçmin (në Stara Cërrna Gora), Cërrnicë, Rijeçka Nahija e Leshanska Nahija. Është paracaktuar që të ketë bashkëveprim edhe me njësinë partizane që gjenmdej në territorin e Rumisë." (f.207)

"Ndërsa po zhvilloheshin luftimet për të marrë Bërçelën në Cërrnicë, grupi partizan nga rajoni i Rumisë (nga Mikuliqi) ka ndërmarrë aksionin në drejtim të Krricës, Selcës dhe Uzhdabiqit." (f.208)

Duhet të vëmë re këtu, që, për të dalë nga Mikuliqi në Krricë (dikur edhe kjo pjesë e Shestanit), duhej kaluar nëpër Malet e Shestanit. Shestani nuk i kish lejuar italinët dhe nacionalistët shqiptarë të sulmonin Cërrnicën, por tani vetë cërniçanët dhe malazias të tjerë shfrytëzojnë Shestanin për të bërë luftë civile me bashkëkrahinasit e vet.

Thuhej që Leka i Macit Kols, kryetari i atëhershëm i Shestanit, e lejonte, në heshtje, kalimin e forcavet partizane malaziase nëpër tokën tonë. Kjo mirësi fqinjësore iu shpërblye më vonë këtij patrioti shqiptar me pushkatim. Komunistët malazias, pasi e morën pushtetin dhe pasi e ripushtuan Shestanin, e dënuan me vdekje Lekën e Macit Kols dhe e pushkatuan mu në Cetinjë.

"Në Rrethin e Tivarit kuislingët kanë krijuar batalionin e xhandarmerisë, komandant i të cilit është vënë Radica Ronçeviq. Në përbërje të atij batalioni kanë qenë 4 çeta: E Tivarit, e Cërrnicës së Epërme, e Cërrnicës së Poshtme dhe e Petrovacit." (f.209)

Kuptohet edhe këtu që Tivari qëndron I ndarë prej Ulqinit në të gjithë vitet e Luftës së Dytë. Këtë ndarje e ka bërë vetë Italia Fashiste, e cila "kufirin" s'e kish vënë atje ku ka qenë shekullisht, por te vendi i quajtur Ullija e Egër midis Ujëmirit (Dobrovodës) dhe Peçuricës. Kuislingët malazias nuk e kalojnë atë "pikë kufitare" fashiste, në dallim prej komunistëvet, të cilët, në të gjithë ata vite, janë munduar që të organizohen edhe në viset e Ulqinit.

"Nga fundi i vitit 1943 dhe në fillim të 1944-s, në Rrethin e Tivarit ka ardhur një numër i konsiderueshëm çetnikësh nga viset e tjerë të Malit të Zi, midis të cilëvet edhe oficerë të Ish-Jugosllavisë." (f.209)

Dëshmi e preokupimit që kishin për Tivarin të 2-ja palët: edhe komunistët, edhe nacionalistët sërbomalazezë. Të gjitha tokat e Shqipërisë janë lakmuar ndër shekuj prej sllavëvet, por Tivari i ka tërhequr ata në mënyrë të veçantë, qoftë për klimën e tij të butë, qoftë për detin, qoftë ndoshta edhe për konfiguracionin, i cili u ka mundësuar atyre për ta mbajtur këtë qytet të izoluar prej pjesëvet të tjera të Shqipërisë. Ndër sllavët që erdhën në Tivar pas vitit 1878, u krijua madje edhe një

proverb: ***"Nema Bara do cara" ("S'ka si Tivari, deri te perandori"***), me kuptimin, vend më i mirë se ky nuk gjendet në krejt perandorinë.

"Njësia partizane (e Mikuliqit, në lartësinë perendimore të Rumisë), në të cilën bënin pjesë rreth 100 luftëtarë, nuk ka mundur të mbahet më në Rrethin e Tivarit, prandaj Shtabi i Aradhës së Llovqenit ka urdhëruar që rreth 50 luftëtarë të rrinë në terren, me detyrën për të sulmuar grupe të vegjël të armikut, për të likuiduar kuislingë të dalluar, për të bërë punë politike midis banorëvet dhe për të shërbyer si bazë e formimit të një batalioni, kur për të të jenë krijuar kushtet, kurse të tjerët të kalojnë në territorin e çliruar të Aradhës. Ndërkaq, Shtabi Qendror në të njëjtën kohë i ka kërkuar Aradhës së Llovqenit që Çetën e Tivar-Ulqinit ta tërheqë krejt nga terreni dhe ta nisë për në Brigadën VII Malaziase, gjë që edhe është bërë." (f.210)

Baza e partizanëvet malazias e Mikuliqit ka qenë krijuar , mes tjerash, edhe për t'iu kundërvënë Shestanit e Kranjës që, fill pas hyrjes së Italisë, e kishin deklaruar veten, o zonë neutrale (Shestani), o të bashkuar me shtetin shqiptar (Kranja e Poshtme). Ndërkaq, largimin e përkohshëm, ata nuk e bëjnë për shkak të Kranjës e Shestanit, por për shkak të shtimit të madh të forcavet gjermano-çetnike në Tivar.

"Majori Bllazho Gojniq, ardhur në Cërrnicë për riorganizimin e ushtrisë kuislinge, në gjysmën e parë të janarit 1944, ka bërë takim me përfaqësuesit e Kranjës dhe ka tentuar që t'i detyrojë kranjanët për të bashkëpunuar me nacionalistët në Cërrnicë. Ai premtonte që do të merrte masa dhe do t'i ruante Cërrnicën dhe Bregdetin nga bolshevizmi." (f.210)

Autori nuk e thotë, por nga të dhëna të tjera, gojore dhe të shkruara, marrim vesh që, as shestanasit (Kranja e Sipërme), as Kranja e Poshtme, nuk e kanë pranuar bashkëpunimin me çetnikët e Cërrnicës.

"Forcat më të mëdha armike në Rrethin e Tivarit kanë qenë grumbulluar në janar 1944: Në Tivar rreth 2300 gjermanë, 500 fashistë italianë dhe 150 çetnikë. Në Ulqin e rrethinë, 800 gjermanë dhe rreth 400 shqiptarë kuislingë të armatosur. Midis

Bunës dhe Ulqinit ka qenë e vendosur një togë, kurse në Ujëmir (Dobrovodë) gjithashtu një togë me gjermanë. Rreth 500 të ashtuquajtur kosovarë kanë qenë vendosur nga Shkodra deri në Ujmir (Dobrovodë). Në Sukë afër Ulqinit, në Ujëmir e në Vollujcë, nga 1 bateri artilerie, në Tivar Nalt 1 bateri kundërajrore, në Ullishtën pranë Topolicës 1 top, në Sustash 1 top. Në Spiç, në Prruo-Lish (Lish-Potok) 1 kompani pionierësh, në Sutomore 40 gjermanë e 30 xhandarë dhe në Ratëz 10 gjermanë." (f.210)

Në Tivar janë çetnikët, në Ulqin ushtarët shqiptarë, në relacionin Shkodër-Ujmir (Dobrovodë), prapë shqiptarë, për të cilët autori thotë "***të ashtuquajtur kosovarë***". Të 2 palët, çetnikët sërbo-malazias dhe shqiptarët, mbrohen prej gjermanëvet. Është tepër e vështirë të kuptohet se si kishin menduar gjermanët t'i rregullonin marrëdhëniet e fqinjësisë midis këtyre 2 popujve. Nuk është e nevojshme të sjellim shumë shembuj. Mjafton të përmendim Masakrën e Bihorit, kryer pikërisht prej çetnikëvet, ku janë vrarë, djegur e ngrirë në borë, mbi 3700 shqiptarë, midis të cilëvet 1853 fëmijë. (Krahaso: Shaban Braha "*Genocidi*…", f.401.) Kjo masakër kish ndodhur në janarin e vitit 1943. Tani ish janari 1944.

"Nga mesi i majit 1944 në Tivar ka filluar puna për formimin e një batalioni të milicisë, kurse për komandant është caktuar P.Gjurishiqi. Me gjithë kërcënimet, formimi i këtij batalioni ka qenë i vështirë. Vetëm më 26 qershor, pra pas 1 muaji, është lajmëruar komanda e Trupavet Nacionale (sllave, Gj.D.) **që ish kryer tashmë organizimi i atij batalini, duke u lutur që t'u dërgoheshin sa më shumë pushkë, municion, armë automatike dhe bomba dore, sepse këtij vendi (Tivarit) i kërcënohen rrëziqe prej partizanëvet** (sllavë, Gj.D.) **dhe prej shqiptarëvet. Mbi formimin e këtij batalioni është njoftuar edhe komanda gjermane, prej së cilës është kërkuar ushqim për efektivin." (f.211)**

Në këtë mënyrë, Tivari, në gjysmën e parë të vitit 1944, i ngjan një kazerme të tejmbushur me ushtarë nga më të ndryshmit dhe me armë nga më të ndryshmet. Por, në mes të kësaj mizërie forcash të armatosura, shumica pa perspektivë, në prag të dështimit, këmbëngulëse dhe brutale, veprimtaria e komunistëvet malazias, gjegjësisht jugosllavë, edhe më brutale, duket se është më qëllimqarta: ***"Të mos i***

lëshojmë këto toka të Shqipërisë, që na i kanë lënë trashëgim monarkët tanë, Petroviqtë dhe Karagjorgjeviqtë. Ne kemi luftuar dhe po luftojmë kundër Petroviqvet dhe kundër Karagjorgjevivet, pushtetin nuk do t'ua japim atyre, por tokat që ata i kanë pushtuar, do t'i mbajmë." Luftën e tyre ata po e quanin përditë **nacionalçlirimtare**, por ajo ishte edhe **NACIONALROBËRUESE**.

"Terrori dhe dhuna e Hasan Isufit dhe e njerëzvet të tij në Ulqin e kishin bërë të vështirë zhvillimin e lëvizjes nacionalçlirimtare, veçanërisht nëpër fshatra. Mjaft vështirë ka qenë të depërtohet në Shestan dhe në Kranjë. Në Komunën e Tivarit disponimi ndaj NOP-it [Lëvizjes Nacionalçlirimtare (jugosllave, Gj.D.)] **ka qenë i madh. Këshillat popullorë komunalë ishin formuar: në Petrovac, në Tivar, në Ulqin dhe në Spiç. Këshilla popullorë** (të krijuar prej komunistëvet malaziaso-jugosllavë, Gj.D.) **në fshatra ka pasur disa: 2 në Cërrnicë, 10 në Tivar, 3 në Ulqin, 3 në Spiç, 7 në Petrovac dhe 4 në Sveti Stefan. Nga mesi i shkurtit 1944 është formuar Këshilli Nacionalçlirimtar i Rrethit të Tivarit. Këshilli nismëtar i AFZH-së (Gruas Antifashiste) ka bërë një mbledhje me 4 shkurt dhe ka caktuar për Këshillin Vendor (Gjithjugosllav) delegatet: Danica Sholaga, Lubica Kazhanegra, Marica Gjonoviq dhe Hristina Vuçkoviq." (f.211)**

Hasan Isufi vërtet ka ushtruar edhe dhunë mbi popullsinë, qoftë koloniste (malaziase), qoftë shqiptare. Ai ka qenë një nacionalist arrogant, me tiparet e një shovinisti dhe gjithsesi i papërshtatshëm për të realizuar synimet e shqiptarëvet në Ulqin e në Tivar. Shqiptarët e Shestanit (Kranja e Sipërme), por as shqiptarët e Kranjës së Poshtme, ose, siç quhet ndryshe, Kranja e Madhe, përgjithësisht, nuk i miratonin veprimet jonjerëzorë të Hasan Isufit. Madje, edhe brenda shtabit të tij kish mosmiratues, psh Hasan Dani, dhe ish vërtet fatkeqësi që, në krye të lëvizjes atdhetare shqiptare, nuk kish njerëz më të denjë se Hasan Isufi. Kjo gjendje sigurisht që do t'i favorizonte synimet ripushtues të komunistëvet jugosllavë.

"Në mars 1944 në Rrethin e Tivarit ka pasur 9 celula të PKJ-së, me 41 anëtarë partie dhe 11 kandidatë. 2 celula kanë qenë në Tivar e 1 në Ulqin." (f.211)

Do të duhen edhe gati 2 vjet për t'u çliruar Jugosllavia, por në territorin tonë komunistët jugosllavë veprojnë (ilegalisht) pa ndërprerje. Punojnë me celula të vogla. Bëjnë kujdes duke e kaluar secilin veprimtar nëpër stazhin e kandidatit. Bëjnë propagandë, krijojnë organizma të gruas dhe të rinisë, hedhin bazat e pushtetit shtetëror , krijojnë të quajturit këshilla nacionalçlirimtarë, dhe e gjithë kjo bëhet pa ndonjë financim, krejt në baza të një ideali social, nacional, por edhe kriptoshovinist.

"Në prill dhe në fillim të majit 1944 në Shestan është formuar aktivi i SKOJ-it (i Lidhjes së Rinisë Komuniste Jugosllave) me 8 anëtarë dhe një këshill i USAOJ-it [i Lidhjes së Bashkuar të Rinisë Antifashiste Jugosllave (Ujedinjeni Savez Antifašističke Omladine Jugoslavije)] me 14 anëtarë." (f.211)

Në këtë kohë, në Shestan vepronte në të gjitha sferat e jetës së kësaj krahine, Komiteti Kombëtar Shqiptar, i kryesuar nga patrioti Lekë Perkolaj (Leka i Macit Kols), por, siç shihet, komunistët jugosllavë gjejnë mënya për t'u infiltruar edhe këtu. Ata zgjedhin kryesisht të rinj, të cilët, falë politikës arsimore antishqiptare të Kral Nikollës dhe të Karagjorgjeviqvet, ishin thuajse pa kurrfarë shkollimi. Janë pikërisht këta të rinj, thuajse analfabetë, të cilët mbas nja 1 viti e gjysmë do t'i shërbejnë këtu shtetit titist jugosllav si kuislingë të mirëfilltë. Komunistët jugosllavë luftonin kundër kuislingëvet në tokat e tyre, por punonin ditë e natë për të krijuar për vete kastën e kuslingëvet shqiptarë në tokat shqiptare.

"Këshilla nacionalçlirimtarë të fshatravet ka pasur: në Tivar 10, në Spiç 8, në Shestan 4 etj." (f.211)

Me këto forma të pushtetit shtetëror, paralel dhe ilegal, komunistët jugosllavë i ndërtonin vetes themelet e pushtetit legal, që do të vendosej këtu fill pas kapitullimit të Gjermanisë. Në krahun e shqiptarëvet të Tivarit e të Ulqinit, ndërkaq, po priteshin me shpejtësi të gjitha fijet e shpresës. Kjo ndodhte, midis tjerash, madje kryesisht, edhe për shkak se aleatët perendimorë, Anglia dhe SHBA-ja nuk e kishin fare në program krijimin e shtetit të plotë shqiptar.

Në Shestan, Leka i Macit Kols, kryetari i Komitetit Kombëtar Shqiptar, ish-punonjës i përfaqësivet franceze në Stamboll dhe në Tiranë, ka qenë një nga frankofilët më të përkushtuar të krejt këtij rajoni. Megjithatë, për fatin e Shestanit,

në krye të të cilit qëndronte ai, as që u interesua dikush nga pala perendimore. As kur e dënuan me vdekje dhe e pushkatuan në vitin 1946, ambasada franceze në Beograd, e cila s'është e mundur të mos e ketë ditur kush ishte Lekë Perkolaj, as që u interesua dhe as që ndërhyri sado pak te qeveria jugosllave për të mos e pushkatuar një të atillë adhurues të Francës. Madje, as sot e kësaj dite shteti francez nuk po tregon kurrfarë interesi nëpërmjet ambasadës franceze në Podgoricë, të paktën për ta kujtuar atë njeri, i cili, duke adhuruar kulturën franceze, adhuronte në të vërtetë krejt demokracinë evropiane. Të kish qenë malazias Leka i Macit Kols, të mos kish qenë shqiptar, dhe të kish punuar për Jugosllavinë në kohën e Luftës së Dytë, unë kam bindjen që ai njeri dhe familja e tij sot do të ishin të paktën bartës të një dekorate.

"Kryetari kuisling i Rrethit të Tivarit, në një njoftim që u dërgon eprorëvet të vet në Cetinjë, midis tjerash, ka shkruar: 'Sjelljet e xhandarëvet në këtë vend janë më të këqia se sjelljet e Hasan Isufit. Në Tivar, komandanti i batalionit i xhandarmerisë, me pjesëtarët e shtabit të vet, i ka mbyllur në Tatarovicë (burg në kështjellën e vjetër të Tivarit, Gj.D.) **mbi 100 persona. Ka arrestuar kënd ka hasur në rrugë, shumë prej tyre janë keqtrajtuar kafshërisht.'" (f.212)**

"Komanda e batalionit të xhandarmerisë ka dhënë urdhër që të sigurohen rrugët nga Podgorica deri në vendin e quajtur Kufin dhe në Rezheviq, nga Tivari në Sutorman e në Vir etj. Për ta zbatuar këtë urdhër, krahas xhandarëvet, janë angazhuar me dhunë të gjithë meshkujt nga 18 deri 60 vjeç." (f.212)

Kur thuhet "*janë angazhuar me dhunë*", duhet kuptuar që të detyruarit për t'i shërbyer asaj xhandarmerie sllave, krijuar aty prej komandës gjermane, kanë qenë kryesisht vendës, pra, shqiptarë. Mund të përfytyrohet kaosi informativ që ka sunduar në ata vite në Tivar. Me kë të shkosh? Kujt t'i mbështetesh? Kë të besosh? Kë të përkrahësh? Italianët janë të huaj, nacionalistët malazias janë të huaj, komunistët malazias janë të huaj, gjermanët janë të huaj. Me kë të shkojnë shqiptarët?

"Më 25 qershor 1944 është formuar 'Grupi i gjahtarëvet të Cërrnicës' me 50 anëtarë, I cili kish detyrë të spastronte terrenin nga partizanët. Një I tillë grup gjahtarësh do të krijohej edhe në territorin e Pashtrovska Gorës, sutormanit dhe Rumisë." (f.212)

"Më 17 qershor 1944 në vendin e quajtur Kufin partizanët malazias kanë sulmuar 1 kamion armik, kanë vrarë 1 gjerman dhe 1 xhandar dhe kanë plagosur disa ushtarakë të tjerë. Më 3 korrik, në aksionin pranë Nehajit dhe Hajit, partizanët malazias kanë asgjësuar 1 makinë gjermane dhe me atë rast janë vrarë 12 ushtarë gjermanë." (f.213)

"Më 6 korrik 1944 pushtuesit gjermanë dhe kuislingët në shërbim të gjermanëvet kanë kryer një krim, duke pushkatuar në Tivar 10 të rinj e të reja: Andrija Martinoviq, Vojisllav Ratkoviq, Gjorgjie Gjuroviq, Zorka Gjuroviq, Riza Isakoviq, Milenko Kiroviq, Stojan Kovaçeviq, Lubica Kovaçeviq, Velisha Popoviq dhe Matija Zankoviq." (f.212)

Me përjashtim të Riza Isakut, shënuar Isakoviq, për të cilin, për shkak se është mysliman, mund të mendohet se ishte shqiptar, asnjërit prej të tjerëvet nuk i dallohet nacionaliteti. Kjo ndodh për arsye se pushtuesit slave, qysh fill pas pushtimit, në vitet 1877-1880 e këndej, si punë kryesore të tyren kanë konsideruar sllavizimin e emravet. Sidoqoftë, krimi ka gjithkund të njëjtën fytyrë. Gjermanët dhe kuislingët malazias në atë kohë po bënin kërdinë nëpër Tivar. Ata të rinj nuk u vranë se ishin shqiptarë apo sllavë, por sepse dyshoheshin për komunistë.

"Një grup partizanësh, më 18 korrik 1044, ka sulmuar stacionin e xhandarmerisë në Mikuliq. Aty është vrarë 1 xhandar dhe 1 tjetër është plagosur." (f.213)

"Nga fundi i korrikut, në rrethinë të Tivarit, nëpër fshatra, ka pasur 10 këshilla nacionalçlitrimtarë (jugosllavë, Gj.D.)**: në Spiç 8, në Shestan 5." (f.213)**

Tingëllon shumë absurd emërtimi ***"nacionalçlirimtar"*** në Shestan, kur dihej se popullsisë shqiptare të këtushme, prej këtyre këshillave nuk do t'u vinte kurrfarë

çlirimi nacional. Ndoshta pikërisht kjo ka qenë dhe arsyeja që, në sllavisht, nuk përdorej shprehja ***"nacionallnoosllobodillaçki odbor"***, por ***"narodnoosllobodillaçki"***. Pra, jo nacionalçlirimtar, por popullorçlirimtar. Gjithsesi, popullit tonë as që kish kush t'ia sqaronte këto gjëra. Por, edhe po t'ia sqaronte dikush, a do të mund t'i shkonin në vesh, psh V.Çërçillit, këto padrejtësira?!

"Në fund të shtatorit dhe në fillim të tetorit 1944 janë bërë përgatitje për të krijuar në Shestan e në Ulqin këshillat nacionalçlirimtarë (në shkallë komunash, Gj.D.)**." (f.213)**

Këta janë veprime të ashtuquajtur të organizimit të vogël në terren, por çështja e Tivarit dhe e Ulqinit, të cilën spekullativisht historishkruesit e quajnë pjesë e Bregdetit Malazias, i ka preokupuar edhe organet më të lartë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave dhe vetë komandantin e asaj ushtrie, J.B.Titon.

"Në planet e veprimevet të Korpusit të Dytë Sulmues të NOV-it (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, Gj.D.)**, Bregdeti Malazias ka zënë vend më të rëndësishëm, vetëm mbas disa intervenimeve të Komandantit të Përgjithshëm (**Marshallit Tito, Gj.D.)**. Nga mesi i vitit 1944 Shtabi i Korpusit ka dhënë urdhër që, prej personelit të Aradhës së Llovqenit, të krijohet Batalioni i Vëzhguesvet, me 120 luftëtarë, i cili do të dërgohej në rajonin e Tivarit dhe në relacionin Tivar-Shkodër me detyrë që të kryente sulme mbi trupat e armikut në këtë territor, duke përfshirë edhe komunikimin gjatë bregdetit, të rrënonte objektet në linjat e transportit dhe në rrugën hekurudhore Tivar-Vir, si dhe të kryente mobilizime në terren." (f.213)**

"'Disa herë' thotë në një telegram J.B.Titoja, 'ju kam dhënë direktiva që të depërtoni në bregdetin hercegovas dhe atë malazias dh eta aktivizoni.'" (f.213)

Ç'do të thotë kjo që vetë Titoja të ngulë këmbë për t'i zaptuar, midis tjerash, edhe Tivarin e Ulqinin? Kjo do të thotë që udhëheqja komuniste jugosllave i kish të qartë planet e vet mbi moslëshimin e asnjë pëllëmbe tokë që atyre u kishin lënë

mbretërit. Madje mundësisht t'i shtonin ato toka, siç bënë psh me Dalmacinë, me ishujt e Dalmacisë dhe gadishullin e Istrisë, që, para Luftës së Dytë, i kish pasur Italia.

Por kjo na dëshmon që as Aleatët Perendimorë, Amerika dhe Anglia, nuk kishin ndërmend ta pengonin komunistin Tito në realizaimin e planevet të tij. Në marrëveshjet me Stalinin, Perendimorët nënshkruanin për mosndryshime kufijsh, por në praktikë kjo zbatohej vetëm atëherë kur vinte fjala për Shqipërinë. Për Jugosllavinë këto marrëveshje u shkelën, sepse asaj iu dhanë Dalmacia dhe Ishujt Dalmatë. Shqiptarëvet u thuhej: ***"Është vendosur në Jaltë që të mos ndryshohen kufijtë."*** Kurse komunistëvet jugosllavë Perendimi nuk u tha që ish vendosur në Jaltë mosndryshimi i kufijvet. Themi ***Perendimi***, sepse Rusia dihet që do t'i përkrahte jugosllavët. Themi ***Perendimi***, sepse ai Perendim kish më shumë interes (Intres që kurrë s'e ka kuptuar dot!) të përkrahte shqiptarët, se sa këdo tjetër në Ballkan.

"Në fillim të shtatorit 1944 luftëtarë të rinj po hynin në NOVJ (në Ushtrinë Nacionalçlirimtare Jugosllave, Gj.D.) **nga të gjitha trevat e Rrethit: nga Tivari, Cërrnica, Ulqini, Spiçi e Pashtroviqi. Ndër banorët e Spiçit po rritej disponimi i mirë ndaj NOP-it** [Lëvizjes Macionalçlirimtare (Jugosllave) Gj.D.]**. Në gjysmën e dytë të shtatorit 16 djem nga Spiçi kanë dalë partizanë." (f.214)**

Duhet sqaruar për lexuesit e rinj, që në Rrethin e Tivarit, që përbëhej, siç shuhet këtu, prej 5 njësive administrative, 3 ishin tërësisht joshqiptare: Cërrnica, Pashtroviqi dhe Spiçi. Ata, vetëkuptohet, kishin arsye që t'i bashkoheshin Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave.

"Në Tivar dhe fshatrat përrreth populli u është afruar masivisht partizanëvet: Mbi 400 njerëz, bashkë me muzikantët ushtarakë, u janë bashkuar njësitevet partizanë. Që të gjithë formacionet kuislingë në Tivar janë shpërbërë, kurse edhe një numër xhandarësh u është bashkuar partizanëvet." (f.214)

"Midis popullsisë myslimane në qytet e rrethinë përherë e më shumë rritej simpatia për NOP-in. Me rastin e festimit të Revolucionit të Tetorit është mbajtur një tubim në shkallë

komune, në të cilin kanë qenë të pranishëm 400 pjesëmarrës. Nga tubimi, 40 njerëz kanë dalë partizanë." (f.214)

"Edhe në komunën e Ulqinit situatat janë zhvilluar sipas dëshirës sonë, ndonëse një numër i banorëvet nën ndikimin e Cafobegut, ende ishte i lëkundur." (f.214)

"Ndërkohë, midis banorëvet shqiptarë gjithnjë e më shumë po rritej ndikimi i njertëzvet përparimtarë nga mesi i tyre, të cilët i ofronin përkrahje të gjithanshme dhe ndihmë Luftës Nacionalçlirimtare (Jugosllave, Gj.D.)." (f.214-215)

Nuk ka qenë krejt ashtu. Popullsia shqiptare, ajo më e vetëdijshmja, ishte tepër e shqetësuar: Ç'do të bëhej me Ulqinin e me Tivarin?! A prapë nën jugosllavët?! Gjermani ia kishte dhënë Ulqinit të drejtën për t'u bashkuar me shtetin e vet, Tivarit jo. Anglezët po e bombardonin Ulqinin dhe bombat e tyre po vrisnin vetëm shqiptarë. Ç'do të thoshte kjo?! Kjo do të thoshte që Anglia, në Luftën e dytë Botërore, realisht, nuk ishte në anën e shqiptarëvet. Bashkë me anglinë, edhe Amerika. 2 shtetet e fuqishëm aleatë, anglia dhe amerika, të cilët gjatë gjithë Luftës së Dytë, kishin pasur misionet e vet pranë 2 shtabevet nacionalçlirimtarë, të Titos dhe të Enver Hoxhës, kishin zgjedur ta përkrahnin Jugosllavinë e ardhshme komuniste dhe të mos e përkrahnin shqipërinë e ardhshme komuniste. Kjo kurrsesi nuk do të shkonte në të mire, as të popujvet të Ballkanit, as të vetë Anglisë e Amerikës. Por pësimin më të madh do ta përjetonin shqiptarët. Jo vetëm këta që mbeteshin jashtë kufijvet të shtetit shqiptar, por edhe ata që gjendeshin Brenda atyre kufijve.

"Shqiptarët merrnin pjesë në këshillat nacionalçlirimtarë (jugosllavë, Gj.D.)**, në organizatat e KPJ-së** (Partisë Komuniste Jugosllave)**, në organizatat e SKOJ-it** (Lidhjes së Rinisë Komuniste Jugoasllave) **dhe të gravet. Është vënë re edhe ardhja te partizanët** (jugosllavë, Gj.D.) **edhe prej atyre viseve të cilët gjendeshin në përbërjen e Shqipërisë së Madhe." (f.215)**

Duhet thënë që, ata shqiptarë të cilët merrnin pjesë në këta organizma jugosllavë zgjidheshin me shumë kujdes nga komunistët jugosllavë. Shfrytëzohej shoqëria me ta, besnikëria që i karakterizon shqiptarët, por mbi të gjitha naiviteti, egoizmi,

karrierizmi dhe servilizmi. Në organet e organizmat që u krijuan në ata vite në tokën shqiptare të Tivarit e të Ulqinit, prej komunistëvet jugosllavë, nuk ka hyrë asnjë shqiptar me edukatë patriotike ose me ndonjë vizion prapamendues patriotik. Që të gjithë ishin, në radhë të parë, inferiorë ndaj udhëheqësvet të tyre dhe ishin zbatues të verbër, tërësisht qorra, të direktivavet demagogjike jugosllave. Ishin pra, shërbëtorë mendjetrullosur të një pushtuesi tjetër. Edhe ata që deri atëherë qenë inkuadruar në organizmat italianë apo gjermanë, vetëkuptohet që u shërbenin italianëvet e më vonë gjermanëvet, por midis tyre kish patriotë, madje jo pak, të cilët gjithsesi e kishin një vizion kombëtar. Disa, madje, ishin atdhetarë të shquar, siç qenë psh Cafobeg Ulqini apo Leka i Macit Kols, Hasan Dani etj. Midis këtyre që u lidhën me komunistët jugosllavë, sapo të vihej re se nuk i shkonin për fije politikës zyrtare, ata shmangeshin, largoheshin me marifet ose thjeshtë hiqeshin.

"Situata në Shestan është përmirësuar dukshëm. Ndër më të moshuarit, aty-këtu, ndihej ende ndikimi i reaksionit shqiptar, por më të rinjtë po i bashkoheshin me dëshirë Ushtrisë Nacionalçlirimtare (Jugosllave, Gj.D.)**. Rreth 20 djem të rinj në ato ditë kanë dalë partizanë. Nëpër Shestan partizanët** (jugosllavë, Gj.D.) **lëviznin lirshëm. Janë mbajtur 2 tubime të suksesshëm, në të cilët ka pasur mjaft pjesëmarrës." (f.215)**

Komenti i këtij informacioni, pasi kanë kaluar 70 vjet, është tërësisht i zi për Shestanin.

Shestani pat jetuar diç më shumë se 2 vjet në një ëndërr më se të bukur. Kish shfaqur dëshirën për t'u bashkuar me shtetin e vet, me shtetin shqiptar. Kish dërguar një delegacion në Tiranë. (Në atë delegacion, unë, autori i këtyre komenteve, kam pasur: 1 hallë, 1 dhëndër familjeje, 1 axhë dhe 1 nuse axhe.)

Shestani, në ata vite, kish ndjekur me fqinjët malazezë një politikë të shkuarjes mirë nga më të qytetëruarat. Nuk kish lejuar që nëpër të të kalonin ushtri të huaja, për të sulmuar njërin apo tjetrin krah. Kish bërë tregti fare të rregullt me Shkodrën dhe shpresonte që, mbas luftës, të ish edhe më mirë. I kish mundësuar furnizimin me bukë edhe Cërrnicës fqinje, në ditët e saja më të vështira. Kish hapur shkollë shqipe. Gjuhë zyrtare ishte gjuha shqipe. Të gjithë dokumentet e identifikimit ishin në gjuhën shqipe.

Tani, në vjeshtën e vitit 1944, komunistët malazias e kishin shtrirë ndikimin e vet, sidomos midis të rinjvet dhe, të gjithë shenjat ishin që ajo ëndërr e bukur kish për t'u shuar, ndoshta njëherë e përgjithmonë.

Në të vërtetë, Fuqitë Aleate, duke e shpallur veten si mbrojtëse të drejtësisë, po bënin ndaj shumë popujve padrejtësinë më të madhe. Fuqitë Aletate, duke luftuar kundër krimit fashisto-nazist, ndaj nesh shqiptarëvet, po bënin krim edhe më të madhe se fashisto-nazistët.

Sot, pas 70 vjetësh, ai Shestan, në të cilin profesori im Gojko Vukmanoviq thotë se rrethanat ishin ***"përmirësuar"***, është shndërruar i tëri në **GËRMADHA**. **GËRMADHA** shtëpitë, **GËMADHË** edhe kultura, gjuha, tradita, dinjiteti. Të gjitha janë shembur e **SHKATËRRUAR**.

Ata të rinj naivëe, të cilët i pranuan komunistët jugosllavë si miq e si sjellës të një epoke të re, tash ka kohë që kanë vdekur, ndërsa bijtë dhe nipërit e tyre janë shndërruar në qenie pa kurrfarë identiteti.

"Më 8 tetor 1944 një batalion partizan ka sulmuar, midis Sutormanit dhe Limjanit, trenin që shkonte nga Tivari në Vir. Në sulm kanë marrë pjesë edhe 6 oficerë anglezë, prej të cilëvet 1-ri është vrarë. Armikut i janë vrarë 20 vetë, 4 gjermanë. 6 fashistë italianë dhe 10 çetnikë." (f.215)

Prania e 6 oficerëvet anglezë, jo komunistë, në një sulm krejt anësor të një batalioni të ushtrisë partizane jugosllave, dëshmon që "Armata e Titos", komunist, gëzonte tashmë përkrahje më se të plotë nga ana e anglezëvet. Por, pyetja që shtrojmë ne edhe sot, pas 70 vjetësh, është kjo: Ata oficerë anglezë a e kanë informuar qeverinë e vet që në ato hapësira, në Tivar, Shestan, Kranjë, Anë të Malit, Ulqin, jetonte një numër i madh shqiptarësh, të cilët gjithashtu duheshin përkrahur, ndonëse edhe mund të mos ishin komunistë?

"Më 12 tetor 1944 janë sulmuar pozicionet e armikut në Sutorman. Janë vrarë 16 dhe plagosur 12 italianë (fashistë) dhe armiku është detyruar të tërhiqet drejt Tivarit. Edhe qytezën e Virit gjermanët janë detyruar ta lëshojnë. Në këtëmënyrë krejt Cërrnica ka qenë e çliruar" (f.215)

“Me çlirimin e Cërrnicës janë krijuar kushte të pëeshtatshëm për veprime të mëtejshëm të forcavet partizane në drejtim të Tivarit, Shestanit dhe Kranjës.” (216)

Ushtria partizane jugosllave, në këtë mënyrë, nga çlirimi i një krahine të vet, kalon në pushtimin e një vendi të huaj. Është e njëjta pamje me vitet 1877-1880. Ushtria e atëhershme malaziase i sulmoi Tivarin, Ulqinin dhe krejt krahinat tona, me pretekstin që po i çlironte këta vende nga pushtuesit osmanë. Në të vërtetë, këtu po zëvendësohej një pushtues me një pushtues tjetër.

“Më 17 tetor 1944 janë nisur nga Sotoniqi, Viri, Godenja e Selca për në Shetan e Kranjë 2 toga të Batalionit të Parë të Brigadës së Gjashttë. Të nesërmen batalioni ka hyrë në Shestan. Populllata i ka pranuar partizanët me gëzim. Për disa ditë batalioni ka qëndruar në Shestan dhe më 23 tetor ka dalë në Ljare dhe ka hyrë në kontakt me përfaqësuesit e Kranjës. Megjithatë, (partizanët jugosllavë) nuk janë futur në Kranjë, sepse atje tashmë gjendej Hasan Isufi me një numër të konsiderueshëm xhandarësh. Partizanët (jugosllavë) i janë shmangur konfliktit me 26 tetor dhe kanë kaluar (janë tërhequr, Gj.D.) në fshatin Dediq, prej nga janë kthyer në Cërrnicë.” (f.216)

Nuk është e vërtetë që partizanët malazias, gjegjësisht jugosllavë, janë pritur me gëzim. Shestanasit e kanë pritur në heshtje ushtrinë pushtuese malaziaser, duke e ditur që rezistenca do të ishte e kotë. Ata e kishin marrë vesh që aleatët kishin vendosur që këta vise të Shqipërisë do t’i mbeteshin përsëri Jugosllavisë dhe, duke qenë edhe numerikisht të pafuqishëm për të kundërshtuar, ata paten zgjedhur heshtjen. Shërbëtorë të rekrutuar doemos që ka pasur dhe ata kanë mjaftuar për të krijuar përshtypjen se populli i Shestanit po i priste me gëzim. Unë kam qenë atëherë 6 vjeç dhe e mbaj mend si e ka pritur populli i krahinës sime hyrjen e sllavëvet të armatosur, të frikshëm dhe krejtësisht të panjohur. Në një mbledhje të organizuar në Gjuraç, disa banorë naivë e servilë kanë filluar t’u flasin sllavisht pushtuesvet të sapoardhur, por komisarët dinakë u kanë thënë: ***“Ju mund të flisni lirisht në gjuhën tuaj. Ne luftojmë për larinë e popujvet, jo për skllavërimin.”*** Mundet që ndonjëri prej atyre komisarëve ta ketë pasur seriozisht, por nuk do të

kalonin as 4 vjet dhe komisarë të tillë do të burgoseshin dhe do të çoheshin në Goli Otok.

Batalioni malazias arriti deri në Ljare, por më tej nuk mundi të shkojë. Hasan Isufi kish ardhur aty me forcat e veta, por mospërparimi I partizanëvet pushtues slave nuk do shpjeguar me ardhjen e Hasan Isufit. Në atë kohë krejt Kranja ish e revoltuar. Ajo kërkonte të mos shkëputej nga Shkodra.

Komandës së ushtrisë jugosllave nuk i ntetresonte që të ndodhë aty një konflikt me armë, në një kohë kur e dinte se, në bazë të marrëveshjevet ndërkombëtare, të gjitha tokat shqiptare të pushtuara prej mbretërvet jugosllavë do të mbeteshin pronë edhe e komunistëvet jugosllavë. Mbështetur në këtë qëndrim të angloamerikanëvet, ata do t'i detyronin komunistët e Enver Hoxhës që edhe Kranja e Poshtme t'u dorëzohej "***paqësisht***" jugosllavëvet, ashtu siç ishte dorëzuar tashmë Shestani (Kranja e Sipërme). Do sqaruar këtu që, komunistët shqiptarë, edhe po të mos donin, ishin të detyruar ta pranonin verdiktin e padrejtë të Aleatëvet, për të mos i ndryshuar kufijtë në favor të shqiptarëvet. Aleatët e quanin me vend ndryshimin e kufijvet në favor të shtetit komunist jugosllav (në drejtim të Dalmacisë e deri në Trieste), por nuk e quanin të arsyeshme t'u bëhej i njëjti favor edhe shqiptarëvet (në drejtim të Tivarit, Podgoricës, Plavës, Mitrovicës, Medvegjës, Vranjës, Velesit dhe Manastirit).

Kur shtrohet pyetja: Pse Shestgani (Kranja e Epërme) nuk rezistoi dhe pse Kranja e Pshtme mundi të rezistojë përkohësisht, përgjigjja do të jetë kjo: Malazezët, gjegjësisht jugosllavët, e shfrytëzuan me dinakëri përkatësinë fetare të shestnasvet. Me qenë se shumica e Kranjës së Epërme, deri në Thtjan, ishin katolikë, aty bëhej propaganda e madhe, e nëndhshme, kundër myslimanizminit. E njëjta metodë përçarëse përdoret edhe sot, në mënyrë perfide, ashtu si është përdorur dhe përdoret në Jugun tonë dhe në Rekë të Dibrës.

"Nga fundi i tetorit Batalioni I i Brigadës VI e ka shtuar veprimtarinë vëzhguese në drejtim të Tivarit, Pashtroviqit dhe në krahun e Liqenit të Shkodrës. Ai ka marrë urdhër të qëndrojë në pozicionet Vir-Sutorman." (f.216)

Shohim këtu një pozicionim të përkohshëm të ushtrisë jugosllave në kufirin natyral të Malit të Zi. Për të hyrë territoret e Shqipërisë, ata duhej të prisnin zhvillimet e mëtejshëm të situatavet.

"Në fund të tetorit (pra, po në atë kohë, Gj.D.) **forca të mëdha gjermane (3 divizione) kanë mbërritur prej Shqipëriet në Podgoricë... Është vënë re edhe një tërheqje forcash të mëdha armike në rrugën Shkodër-Ulqin dhe Tivar-Kotorr." (f.216)**

Shprehja ***"prej Shqipëriet në Podgoricë"*** është gabim, sepse Podgorica tradicionalisht ka qenë dhe është edhe sot pjesë gjeografike e Shqipërisë.

(Është e nevojshme të shënoj këtu, në parantezë, një fakt tepër kompromentues të poltikës së gabuar të atëhershme angleze në dëm të shqiptarëvet. Podgorica është bombarduar atëherë aq shumë prej aviacionit anglez, sa thuhej se nuk ka mbetur shtëpi më këmbë. Njerëzit tanë, sado popull pa shkollë, bënin në atë kohë pyetjen: Pse kështu? Gjermani ish në ikje. Popullsia nuk e përkrahte një ushtri në ikje. Përse të bombardoheshin lagjet e qytetit? Pas të këtilla pyetjeve, jepej një përgjigje si e nëndheshme: Duan të ndërtojnë një Podgoricë të re, prandaj po e shkatërrojnë.

Dhe vërtet, ashtu ndodhi. Pas Luftës së Dytë, Podgorica u ndërtua krejt e re, iu ndërrua edhe emri, u quajt Titograd dhe u shndërrua në kryeqytet të Rep.së Malit të Zi.

Se ç'manovra e se ç'marrëveshje kanë bërë komunistët jugosllavë, në ato ditë lufte, me komandën e forcavet ajrore angleze, mbetet për t'u hulumtuar. Por është më se i dukshëm fakti që aviacioni anglez i ka shkaktuar me atë rast popullsisë së Podgoricës një tragjedi të pamerituar, në përpjekje për t'i siguruar Malit të Zi një zgjërim afatgjatë në brendësi të tokës shqiptare.

Avionët anglezë kanë bombarduar, në verë të atij viti, edhe Ulqinin, Pejën e Gjakovën, dhe nuk kanë vrarë atje as gjermanë, as sërbë, as malazezë, por vetëm shqiptarë. Ka ardhur koha që të shikohen dokumentet: Pse i bëri aviacioni anglez këto masakra ndaj shqiptarëvet? A ish protagonist apo viktimë?

Pas vitit 1960, jugosllavët do të përsërisnin të njëjtin skenar për të dëbuar shqiptarët nga Shkupi, veçse këtë herë ata do të shfrytëzonin, jo aviacionin e Mbretërisë së Bashkuar, por **tërmetin**.)

“Duke ndjekur gjurmë pas gjurme armikun, Brigada e Parë Bokele (Përva Bokeljska Brigada), më 24 nëntor, duke ardhur nga Budva, i ka çliruar Petrovacin dhe Tivarin. Me rastin e hyrjes në Tivar, janë zënë rob 14 çetnikë dhe 12 fashistë italianë. Nga pala partizane është vrarë 1 luftëtar dhe është plagosur 1 tjetër.” (f.217)

“Batalioni i Dytë I Brigadës së Parë Bokele e ka vazhduar më 25 nëntor ndjekjen e armikut dhe të nesërmen e ka çliruar edhe Ulqinin. Me kaq është çliruar krejt Bregdeti Malazias.” (f.217)

Shprehjet janë tërësisht të gabuara, në kundërshtim me të vërtetat e shkencës së historisë. As Tivari, as Ulqini nuk janë çliruar, por janë pushtuar prej ushtrisë jugosllave, komanduar këtë herë, jo prej oficerëvet monarkistë malazias apo sërbë, por prej oficerëvet komunistë, të cilët më shumë ishin pansllavistë sesa komunistë.

As shprehja ***“Bregdeti Malazias” (“Cërnogorsko Primorje”)*** nuk është e saktë. Shumicën e banorëvet të Bokës së Kotorrit e përbënin katolikët, që nuk e quanin veten malazezë. Pashtroviqi dhe, në kohët më të vona, edhe Spiçi, qenë bërë në rrjedhë të kohëvet pravosllavë, por as ata gjeografikisht nuk i kanë përkitur Malit të Zi. Tivari e Ulqini banoheshin thuajse tërësisht me shqiptarë, me përjashtim të pak banorëve tradicionalisht sllavë dhe të një pjese malazezësh, ardhur aty pas vitit 1878 si kolonizues. Në këtë mënyrë kjo ngastër gjeografike ndoshta do të mund të quhej ***Bregdat i Shtetit Malazias***, por jo ***“Bregdet i Malit të Zi”***.

“Mbas çlirimit të Ulqinit njësitë partizane janë bashkuar me Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe së bashku i kanë hyrë punës për të rregulluar gjendjen në Kranjë.” (f.217)

Komenti ynë: Ulqini s’është çliruar, por është pushtuar prej ushtrisë partizane jugosllave. Kjo është tashmë e qartë dhe kudo që përdoret fjala ***çlirim*** në lidhje me vendosjen e pushtetit jugosllav mbi tokat shqiptare, natyrisht, edhe në historiografinë jugosllave, duhet përdorur fjala ***pushtim***. Por këtu historiografia duhet të ndalet edhe për të bërë të tjera analiza. Bashkimi i partizanëvet shqiptarë, të udhëhequr nga PKSH-ja (Partia Komuniste Shqiptare) me partizanët jugosllavë, të udhëhequr nga PKJ-ja (Partia Komuniste Jugosllave), a përbën tradhti nga ana e partizanëvet shqiptarë?

Për mendimin tim, faji, apo gabimi, ose edhe tradhtia, bie më parë mbi anglo-amerikanët. Pët ta mbështetur këtë pohim, po krhasojmë 2 marrëveshje.

Në Konsultën e Visit (të ishullit Vis), midis komunistëvet jugosllavë dhe nacionalistëvet jugosllavë, nuk u përjashtua, nuk u ekskludua Marshalli Tito. Përkundrazi, atij iu njohën të gjitha meritat në luftën kundër nazizmit dhe fashizmit dhe ashtu doli që andej Marrëveshja Tito-Shubashiq. Shubashiqi, përfaqësues i nacionalistëvet në atë marrëveshje, kish atë pozitë që i takonte: pozitën thuajse afër zeros. Anglezët në atë konsultë luajtën rol vendimtar.

Në Mbledhjen e Mukjes, midis komunist6ëvet shqiptarë dhe nacionalistëvet shqiptarë, Enver Hoxha ishte përjashtuar, ishte ekskluduar plotësisht ose thuajse plotësisht. Kjo ka ndodhur, jo se Enver Hoxha ka qenë më komunist se Titoja, por sepse politika e madhe anglo-amerikane nuk e kish fare në agjendën e vet përkrahjen e çështjes së madhe shqiptare. Përkundrazi, në atë mbledhje u tentua të vihen shenja barazimi midis luftës që kishin bërë partizanët (të udhëhequr nga PKSH-ja) dhe zogisto-ballistëvet, të udhëhequr nga Abaz Kupi dhe Mit'hat Frashëri. E gjithë kjo u bë në zbatim të orientimevet qëvinin nga Britania e Madhe e nga SHBA-ja. Aty vrtet u shtrua edhe çështja e bashkimit të krejt Shqipërisë, por kush do ta komandonte atë luftë për bashkim? Ata që kishin bashkëpunuar me fashito-nazistët? Veç kësaj, kush do të ndërmjetësonte te Titoja, nëse do të përkrahej ideja e bashkimit të krejt Shqipërisë? Këto gjëra në Mukje nuk janë trajtuar fare. Çdo të ndodhte, nëse Enver Hoxha do ta kish pranuar atë marrëveshje?

Është vështirë të parashikohet. Mund të vinte puna deri te asgjësimi shtetëror edhe i asaj pjese të Shqipërisë që ishte njohur ndërkombëtarisht më 1913-n. Themi kështu, sepse tash, as Italia, as Gjermania apo Austria, nuk do të mund të kërkonin më një Shqipëri të pavarur, ndërsa në Konferencën e Paqes në Paris, më 1946-n, edhe ashtu u tentua të mos i njihet kurrfarë merite Shqipërisë në luftën kundër Boshtit Fashisto-nazist.

Ç'do të ndodhte, nëse partizanët shqiptarë nuk do të ndërhynin për t'u mbushur mendjen shqiptarëvet të Kranjës të pajtoheshin me fatin që u kishin caktuar Aleatët? Mund të ndodhte gjakderdhja dhe Kranja do t'u mbetej përsëri jugosllavëvet. Kështu, unë nxjerr konkluzionin që komunistët shqiptarë kanë

vepruar kundër vullnetit të krejt shqiptarëvet të kësaj ane, nga halli, sepse nuk mund të vepronin kurrsesi ndryshe.

Gabimin, apo fajin, apo tradhtinë ndaj shqiptarëvet, që bënë anglezët dhe amerikanët në vitet e Luftës së Dytë, u munduan ta korrigjojnë anglezët dhe amerikanët e fundit të shekullit XX, por ia arritën vetëm pjesërisht, sepse shqiptarët e Tivarit e të Ulqinit, se edhe ata të Podgoricës, Tuzit, dhe Malësivet të Mbishkodrës, të Gusisë e të Plavës, mbetën përsëri nën trysninë e pakuptimtë dhe antinjerëzorte të shkombëtarizimit, deri në asgjësim të plotë.

"Mbas çlirimit të Vlladimirit, Brigada e Parë Bokele ka mbajtur një konferencë, në të cilën u janë parashtruar banorëvet synimet e luftës nacionalçlirimtare dhe u janë shpalosur qëndrimet mbi zgjidhjen e çështjes nacionale, gjë që populli e ka pritur me entuziazëm. Në Ulqin, Vlladimir dhe Tivar, kjo brigadë ka organizuar disa shfaqje artistike për ushtrinë dhe për banorët." (f.217)

Sllavët i thonë Vlladimir Katërkollës dhe krejt Anës së Malit, duke qenë se Shën Gjon Vladimirin, që ka jetuar në fund të shekullit X dhe në fillim të shekullit XI, malazezët dhe sërbët e konsiderojnë shenjtor sllav.

Fjala "çlirim" edhe këtu është përdorur gabim, në vend të fjalëvet zaptim apo pushtim.

Lidhur me çështjen nacionale duhet pohuar që komunistët jugosllavë kanë vepruar më drejt se Ish-Mali i Zi apo Jugosllavia e Karagjorgjeviqvet, që ishin shtete totalisht diskriminues. Në krahasim me mënyrën si ka vepruar shteti grek me popullsinë tonë atje, e quajtura Jugosllavi e Re ka qenë shumë më demokratike. Por kjo nuk do të thotë që shqiptarëvet në atë shtet, që quhej Jugosllavi e Re, u qenë njohur të gjitha të dtrejtat. Përkundrazi, e drejta themelore, për t'u bashkuar me shtetin e vet, nuk na u dha kurrë, ndërsa të drejtat e tjera na u shkelën brutalisht dhe vazhdimisht.

"Në gjysmën e dytë të dhjetorit Brigada e Dhjettë ka mbërritur në Cërrnicë dhe në Kranjë me detyrën për ta pastruar terrenin prej grupevet kuislingë që kishin mbetur, të cilët fshiheshin afër

fshatravet të tyre. Ardhjen e Brigadës së Dhjettë banorët e Kranjës e kanë pritur me entuziazëm. Janë organizuar tubime, në të cilët kanë marrë pjesë rreth 600 frymë, veçanërisht të rinj prej të gjithë fshatravet të Kranjës." (f.217)

Në atë kohë, siç e kamë thënë edhe më parë, unë kam qenë 6 vjeç. Njerëzit e prisnin me ankth ardhjen e asaj ushtrie të armatosur. Plakat dhe pleqtë thoshin: ***"Asnji asqer i huoj s'ka kaluo kne pa ba zullume."*** Pëshpëritej se disa djem, kryesisht nga Lukiqi, kishin marrë pushkët dhe kishin dalë në mal, nga frika se mos i vrisnin partizanët malazias. Ata s'kishin dalë për të luftuar, por thjeshtë nga frika. Në kësulat e tyre, në gjuhën sllave, me qëllim që ushtarakët e huaj të numd t'i lexonin, kishin shkruar: ***"SPAS ŽIVOTA" ("spas zhivota", "shpëtim jete")*** që kish kuptimin: ***"Kemi dalë e po fshihemi nëpër shpella për të shpëtuar jetën."*** Me fjalë të tjera: ***"Aman, mos na vrisni, se s'kemi gjë me ju!"*** Ka qenë, sigurisht, një veprim qyqarësh, por pushtimet, ardhjet e ushtrivet të huaja, krijojnë edhe të tilla situata. Brigade e Dhjettë jugosllave, sapo ka hyrë në Shestan, të parin njeri që ka hasur, e ka vrarë. Ishte një bari. Rrinte majë një muri të një prozhmeje. Emrin nuk ia mbaj mend, por më kujtohet që thoshin: ***"E vranë të birin e Kols Tucit, kotnasikot."*** Ishte prej Pinçit. Gratë e pështërisnin këtë vrasje me frikë të madhe dhe me zemëtim: ***"Si u vraka ashtu njeriu, bigarihak?!"***

Por, mbas 3 muajsh, po kjo brigadë, që i pushtoi në atë mënyrë Shestanin e Kranjën, do të bënte krdinë mbi djemtë tanë, prurë në Tivar prej visesh të tjerë të Shqipërisë Verilindore. Aty do të masakroheshin në mënyrën më çnjerëzore mbi 3500 djem të Kombit tone, për të mos u ngushëlluar kurrë, as nënat e atëhershme, as nënat e mëvonshme.

"1 javë mbas çlirimit, me 1 dhjetor 1944, në Tivar është mbajtur një miting i madh popullor, në të cilin është zgjedhur Këshilli i Frontit Nacionalçlirimtar i Rrethit të Tivarit. Mbi atë miting impozant gazeta *'Pobjeda'* ka shkruar: *'Kurrë më parë Tivari nuk e ka përjetuar një manifestim aq të madh të ndërgjegjes njerëzore si më 1 dhjetor të këtij viti, kur një masë e madhe e popullit prej mbi 5 mijë frymësh ka zbritur në Tivar në mitingun e vet të madh. Në kolona të gjata, me flamuj të Jugosllaviasë dhe të Malit të Zi kanë ardhur, pleq e të rinj,

***meshkuj e femra, duke kënduar këngë dhe duke i brohoritur Jugosllavisë së Re, Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Titos, marshallit të parë të Jugosllavisë.'"* (f.217)**

Të gjithë pushtuesit kanë metodat e veta të propagandës. Partitë komuniste, para dhe pasi ta merrnin pushtetin, kanë pasë përpunuar një tërësi metodash nga më efikaset, për t'i bërë masat për vete. Ata hynin në politikë dhe vinin në pushtet me parulla e premtime të jashtzakonshëm, madje të mrekullueshëm. Madje, duhet thënë që shumë prej parimevet të tyre edhe ishin realisht përparimtarë, por ata, ose shkeleshin që në fillim, ose prisheshin me kalimin e kohës. Vendosja e pushtetit të komunistëvet jugosllavë në Tivar ka qenë liri për malazezët, që do të thoshte: mundësi më të mira për të jetuar, mundësi për të zhvilluar gjuhën dhe kulturën e vet, mundësi shkollimi, mundësi punësimi, shanse për t'u ngjitur në karrierë. Për shqiptarët, verndosja e pushtetit komunist në Tivar dhe në krejt këto hapësira, nga deti deri në Liqen të Shkodrës dhe nga Buna deri në Qafë të Sutormanit, ka qenë, në kuptimin më libertal të fjalës, liri e kufizuar, që do të thoshte: të drtejta nacionale të cunguara, jo të plota dhe vazhdimisht të kërcënuara, mundësi për të ruajtur e zhvilluar gjuhën e kulturën e vet fare të pakta, deri në asgjësim të plotë, siç ndodhi në Shestan dhe brenda në Tivart, të drejta pune gjithashtu të kufizuara, jo ligjërisht, por subjektivisht, në çdo hap jete që bënte individi, shanset për karrierë thuajse pa shpresë, me përjashtim të ndonjërit që e ndryshonte dhe e shkelte ndërgjegjen e vet në atë mënyrë që, mbas disa vjetësh të mos i njihte më as veten, as të tjerët. Megjithatë, duhet pranuar që, një pjesë e shqiptarëvet, të Ulqinit, të anës së Malit dhe të Kranjës së Madhe (jo ata të Tivarit e të Shestanit) i shfrytëzuan më mirë shanset për të shkuar dhe për t'u shkolluar në Kosovë. Ata, përgjithësisht, pas 30 apo 40 vjetësh mundën t'i përgjigjen pozitivisht pyetjes: ***"Kush jam unë?"***

Kapitalizmi i sotëm, i restauruar në këta vende, ku dikur ishte komunizmi, metodat e propagandës i ka edhe më të sofistikuara. Kush nuk di të gjendet në këto situata, jo veç individët, por edhe bashkësitë komunitare, deri edhe kombet, janë të rrëzikuar.

"Në Këshillin e Frontit Nacionalçlirimtar të Rrethit të Tivarit janë zgjedhur: Tomo Popoviq, Dushan Gjuroviq, Hasan

Shllakoviq, Kërstinja Vuksanoviq, Bozho Mitroviq, dhe 40 anëtarë këshilli, nga 1 për secilin fshat." (f.217)

Në vend të fjalës **"*zgjedhur*"**, është më saktë të thuhet **"*caktuar*"**. Në këtë kryesi shikohet që ka vetëm 1 shqiptar, edhe ai me pranemër, llagap, krejt të përçudnuar, ku emrit të fshatit **SHLLAK** të Shkodrës i janë prapangjitur 2 prapashtesa -OV dhe -IQ.

"Në Tivar, më 31 dhjetor 1944, është mbajtur Konferenca e Parë e AFZH-së (Frontit të Gruas Antivashiste) për Rrethin. Kanë marrë pjesë më shumë se 1000 gra nga të gjitha komunat. Shumë pjesëmarrëse kanë folur për sakrificat dhe vuajtjet e gravet nëpër burgje e nëpër kampe si dhe mbi pjesëmarrjen e tyre e kontributin në Luftën Nacionalçlirimtare. Vasfie Shehoviq, mësuese, u ka bërë thirrje gravet myslimane që të bashkohen rreth Frontit Nacionalçlirimtar dhe t'i ofrojnë përkrahje të plotë Luftës Nacionalçlirimtare dhe pushtetit të ri." (f.217)

Është edhe kjo një nga format e rëndxësishme që i përdorën komunistët për t'i bërë për vete masat e popullit. Të përmendurit këtu të Vasfie Shehut, pranemri i së silës është transformuar në Shehoviq, tregon që jugosllavët po mundoheshin t'i afronin politikisht edhe banorët jomalazias, që, në fakt, kanë qenë shumica e popullsisë. Mirëpo, shqiptarët nuk përmenden askund. Kjo ka të bëjë edhe me politikën e mëvonshme, me vitin 1974, kohën e shkruarjes së këtij studimi nga autori, Gojko Vukmanoviq, kur në historiografinë malaziase synohej që ekzistenca e shqiptarëvet në Tivar të mos pohohej. Më mirë të përmendeshin myslimanët sesa shqiptarët, sepse myslimanët nuk do ta vinin kurrë në pyetje pushtetin malazias në këtë qytet.

"Para Kongresit të Dytë të Rinisë të Malit të Zi (mbajtur më 15 dhjetor 1944) rinia e Rrethit të Tivarit ka zhvilluar një veprimtari parakongresiane, duke grumbulluar një sasi të konsiderueshme produktesh ushqimorë. Njësitë e punës kanë kryer 3545 ditëpune vullnetare. Në punë janë dalluar 122 sulmues. Janë themeluar 7 shtëpi të rinisë. Në punët e organizuara prej USAOJ-it (Lidhja e Bashuar e Rinisë

Antifashiste Jugosllave) janë përfshirë 1379 anëtarë." (f.217-218)

Edhe nxjerrja e rinisë në punë vullnetare ka qenë njëra nga format e punës së komunistëvet në vitet e parë të qeverisjes së tyre. Në të gjithë vendbanimet bëhej propagandë e madhe dhe, për të arritur rezultatet e kërkuar, përdorej jo vetëm presioni psikologjik, me anë të agjitacionit, por edhe dhuna. Sidoqoftë, të organizoje pastrimin e fshatravet nga mbeturinat e nga pisllëqet, të ndihmoje familjet në nevojë me ushqime, të punoje për të siguruar ujin, nuk ishin punë të këqia. E keqja vinte atëherë kur njerëzit shtyheshin me sakrifikue veten për qejf të të tjerëvet.

"Në fund të vitit 1944 dhe në fillim të 1945-s, në Rrethin e Tivarit kanë funksionuar 35 shkolla fillore me 72 mësimdhënës-mësues, prej të cilëvet 58 me arsim përkatës. Janë regjistruar 4000 nxënës. Janë hapur 2 shkolla me mësim në gjuhën shqipe në Ulqin dhe në Salç." (f.218)

Shkolla shqipe e Salçit e ka pasë jetën fare të shkurtër. Ajo ka pasë punuar gjatë Luftës së Dytë, por më 1945-n, një familje ortodokse shqiptare, e ardhur aty nga Janina dhe gjysmë e sllavizuar në ndërkohë për shkak të martesavet me malazeze, ia ka dalë që mësimi shqip në atë shkollë të ndërpritet e të mos rifillojë kurrë më. Ishin 4 fshatra, Salçi, Kullomza, Krruçi e Krytha, të banuar 100% me popullsi shqiptare, përveç asaj familjeje, së cilës, për shkak të fesë, i shte mbushur mendja për t'u transformuar, dhe të 4 fshatrat nuk qenë në gjendje ta mbrojnë gjuhën shqipe. Mbaj mend që pleqtë e asaj kohe thoshin: ***"Janinanjt janë të fortë, se kanë gjeverinë me vete."*** Mirëpo, nëse duam të jemi objektivë në analiza, duhet të pranojmë si faktor shpërbërës edhe faktin që shumica e banorëvet të këtyre fshatrave kanë qenë e janë me prejardhje nga Shestani dhe të besimit katolik.

Shestani në atë kohë, vendorigjina e banorëvet të këtyre 4 fshatarave, pasi qe arrestuar e më vonë pushkatuar Leka i Macit Kols, udhëheqësi i asaj krahine, nuk pat hapur më shkollë shqipe e madje as nuk qe regjistraur me kombësi shqiptare. Ilirë, arbër dhe shqiptarë në të gjithë shekujt, krahina ku është shkruar ***Meshari*** i Gjon Buzukut, libri i parë në gjuhën arbërishte që njohim deri më sot, në vetëm pak muaj është shfytyruar tërësisht nën presionin e propagandës perfide jugosllave,

se gjoja ***"kshtu do të jemi më mirë"***. Një tragjedi që do të meritonte të përjetësohej në dhjetëra vepra arti.

Banorët e Krruçit, Krythës, Salçit dhe Kullomzës, duhet të jenë ndikuar edhe nga këto ngjarje të Shestanit, prej nga e kishin origjinën dhe me të cilin mbanin lidhje të shumta familjare. Dhimbja e këtyre ngjarjeve do të ndjehej e rëndë dhe e padurueshme vetëm pas 50 vjtësh.

"Gjimnazi i Tivarit, në të cilin janë regjistruar 233 nxënës, ka filluar punën më 19 shkurt 1945, kurse shkolla e ulët bujqësore më 15 mars. Për shkak të numrit të madh të analfabetëvet (rreth 2650) kanë qenë çelur edhe 18 kurse kundër analfabetizmit. Në Komunën e Vlladimirit dhe të Kranjës shkollat janë çelur diç më vonë." (f.218)

Në gjimnazin dhe në të gjitha shkollat e Tivarit kishte shumë shqiptarë, por në të gjitha ato shkolla mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën sllave. Edhe analfabetët kanë qenë shumica shqiptarë, por mësimet ata i bënin në gjuhën sllave, kështu që ata kurse, madje as shkollat, nuk patën kurrfarë rezultati pozitiv për shqiptarët. Aq e vërtetë është kjo, sa sot, le në qeverinë qendrore të Malit të Zi, por as në organet lokalë nuk ka drejtues me kombësi shqiptare. Asnjë kryetar i komunës së Tivarit, në gjithë këto 60 a 70 vjet, nuk ka qenë shqiptar.

"Në fillim të dhjetorit 1944 Këshilli Nacionalçlirimtar i Rrethit të Tivarit ka krijuar një ekip kulturo-arsimor i cili ka dhënë 12 shfaqje në Cërrnicë, Pashtroviq, Sutomore, Ulqin, Tivar Nalt, Tivar Poshtë, programet e të cilit kishin këngë korale, recitime, numra muzikorë dhe skeçe. Shfaqjet janë frekuentuar mirë." (f.218)

A kanë rëndësi këto të dhëna? Sigurisht që kanë rëndësi. Mjaft të shënojmë që asnjëra nga këto shfaqje kulturore-artistike nuk janë dhënë në gjuhën shqipe. Si do t'i shikonin shqiptarët këto shfaqje pa e mësuar gjuhën sllave?

"Kanë ekzistuar 3 komitete komunalë të PKJ-së: i Tivarit, i Petrovacit dhe i Cërrnicë-Shestanit. Në dhjetor 1944 janë krijuar

komitetet e PKJ-së në Spiç e në Ulqin, kurse në janar 1945 është krijuar Komiteti Komunal i PKJ-së për Kranjën. (f.218)

Në këtë mënyrë, PKJ-ja (Partia Komuniste Jugosllavwe) po I merrte pozitat e drejtimit të punëvet, ashtu siç dëshironte ajo vetë, në të gjitha këto hapësira ku jetonin edhe shqiptarët. Vetë fakti që kjo parti ishte një parti jugosllave, e dëshmon mjaftueshëm që shqiptarët do të merrnin çfarë t'u jepte kjo parti e huaj. Kjo ka shumë rëndësi të kuptohet. Shqiptarët nuk ishin të lire, sado që mund të thuhej gjithandej: U çliruam! U çliruam! PKJ-ja s'ish parti e shqiptarëvet. Shqiptarët nuk e kishin partinë e vet. Rrjedhimisht, të gjitha punët do të bëheshin siç u interesonte të ardhurvet: që nga punësimi e deri te pamundësia për të ruajtur veçantitë etnokulturore.

Bien ë sy që, në ata vite, Shestani udhëhiqej prej një organizate partie të përbashkët me Cërrnicën. Kjo, nëtë vërtetë, do të thoshte që punët e Shestanit nuk I drejtonin sheastanasit. Për punët e Shestanit vendosnin komunistët e Cërrnicës dhe kjo është e mjaftueshme për të kuptuar pse në Shestan nuk u hap shkollë shqipe në vitin 1946.

Gjokë Dabaj - Pjezë 19 shkurt 2014

Kërkesë për kontibut financiar: Nëse dikush ka mundësi financiare ta botojë këtë libër e pakta në 300 ekzemplarë, I lutem të lidhet me mua në rumia-pind@gmail.com ose në telefon 00355 692567880. Me shumë mirënjohje, Gj.D.

© Pashtriku.org, Dhjetor'2016